UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА

FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË
FACULTY OF BUSINESS AND ECONOMY
ФАКУЛТЕТ ЗА БИЗНИС И ЕКОНОМИЈА

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I TRETË

DISERTACIONI I DOKTORATËS

Politikat kreditore të bankave komerciale dhe ndikimi i tyre në sektorin real të ekonomisë së kosovës (2005 – 2018)

Kandidati:
Ph.D. (c) Fisnik Morina

Mentori:
Prof. Dr. Rufi Osmani

Korrik, 2019

DEKLARATË

Unë Fisnik Morina, deklaroj se ky punim doktorature me titull "*Politikat kreditore të bankave komerciale dhe ndikimi i tyre në sektorin real të ekonomisë së Kosovës (2005 – 2018)"* është punë e imja origjinale, nën mentorimin e Prof. Dr. Rufi Osmanit, nga Fakulteti i Biznesit, Universiteti i Evropës Juglindore në Maqedoni, me qëllim të marrjes së titullit Doktor i shkencave ekonomike.

Deklaroj se punimi në fjalë nuk është botuar më parë për ndonjë vlerësim apo kualifikim tjetër dhe as nga ndonjë institucion tjetër arsimor. Nuk ka tekst apo argument të përdorur në punim që është shkruar nga dikush tjetër, përpos rasteve të cilat janë të cituara dhe referuar autorëve përkatës. Librat, artikujt shkencor dhe faqet e internetit, të cilat i kam përdorur, njihen në vendin përkatës në tekst.

Anëtarët e Komisionit

Prof. Dr. Rufi Osmani

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë, Universiteti i Europës Juglindore, Tetovë

Prof. Dr. Besnik Fetai

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë, Universiteti i Europës Juglindore, Tetovë

Prof. Asoc. Dr. Jeton Mazllami

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë, Universiteti i Europës Juglindore, Tetovë

Prof. Asoc. Dr. Shenaj Haxhimustafa

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë, Universiteti i Europës Juglindore, Tetovë

Prof. Asoc. Dr. Rrustem Asllanaj

Fakulteti Ekonomik, Universiteti "Hasan Prishtina", Prishtinë.

"E mira e të mirës është se njerëzit e kombit nuk e kuptojnë sistemin tonë bankar dhe monetar, sepse po ta kuptonim, besoj se do të kishte revolucion para mëngjesit të së nesërmes".

Henri Ford

FALENDERIM

Falënderimi më i madh i takon Zotit për shëndetin dhe mundësinë që më dha të përfundoj me sukses disertacionin. Po ashtu, dua të falënderoj shumë prindërit dhe familjen time të dashur për sakrificën, durimin, ndihmën dhe mirëkuptimin e tyre gjatë tërë periudhës së përgatitjes së këtij disertacioni, si dhe mbështetjen dhe dashurinë e tyre të vazhdueshme gjatë gjithë jetës time. Ju dua pafundësisht!

Dua të falenderoj edhe mentorin tim të doktoraturës Prof. Dr. Rufi Osmani, i cili me kontributin dhe dijen e tij shkencore, profesionale dhe metodike si dhe me këshillat e tij të vazhdueshme më ka ndihmuar në hartimin dhe finalizimin e këtij disertacioni.

Dëshiroj të falenderoj gjithashtu të gjithë profesorët e Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë, pranë Universitetit të Evropës Juglindore, për mbështetjën dhe udhëzimet e tyre të vazhdueshme në përgaditjen e këtij disertacioni.

Falenderime të veçanta ju shpreh edhe të gjithë kolegëve në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë për ndihmën dhe mbështetjën e vazhdueshme që më kanë dhënë.

Abstrakt

Studimi ka për qëllim të analizojë ndikimin e politikave kreditore të bankave komerciale në financimin dhe zhvillimin e sektorit real të ekonomisë së Kosovës. Në këtë kontekst janë aplikuar disa modele dhe teknika statistikore dhe ekonometrike me qëllim të testimit të ndikimit të bankave komerciale nëpërmjet procesit të kreditimit në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë së Kosovës për periudhën kohore 2005 – 2018, duke shfrytëzuar seritë kohore në baza mujore.

Në fillim të analizës ekonometrike janë realizuar disa teste statistikore të cilat përcaktojnë saktësinë e të dhënave të përfshira në modelet ekonometrike. Për vërtetimin e validitetit të hipotezave të parashtruara në këtë studim janë aplikuar këto modele ekonometrike: regresioni i shumëfishtë standard, efekti fiks, efekti random, Hausman – Taylor regression, GMM Model (Arellano Bond Estimation), Generalized Estimating Equations, analiza e variances nëpërmjet racio testit dhe T-testit, analiza faktoriale nëpërmjet metodës së komponentëve themelorë dhe analiza e besueshmërisë sipas Alpha Cronbach e cila është përdorur për hipotezën e fundit të këtij studimi. Po ashtu, për t'i dhënë më shumë mbështetje testimit të hipotezave dhe analizës ekonometrike, në këtë disertacion janë aplikuar edhe analizat e trendeve lineare, logaritmike dhe eksponenciale, nëpërmjet të cilave janë nxjerrë trendet mesatare kumulative për variablat e përfshira në modelet ekonometrike.

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se bankat komerciale nëpërmjet procesit të kreditimit dhe menaxhimit efikas të kredive të këqija kanë ndikuar pozitivisht në sektorin real të ekonomisë së Kosovës. Për sa i përket ndikimit të garancive kreditore dhe zbatimit të reformave institucionale, në funksion të përmirësimit të biznes klimes, rezultatet dëshmojnë ndikim pozitiv në rritjen e kreditimit të sektorit bankar ndaj sektorit real të ekonomisë. Rezultatet e këtij studimi do të kenë rendësi shkencore dhe praktike për avancimin e politikave të duhura kreditore, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë së Kosovës.

Fjalët kyçe: *bankat komerciale, sektori real, risku kreditor, kreditë, garancitë kreditore, kreditë jo-performuese, reformat institucionale.*

JEL Classification: G2, G21, E4, E5, E52, E2, G28, C1

Abstract

The doctoral dissertation aims to analyze the impact of commercial banks' credit policies on financing and development of the real sector of Kosovo's economy. In this context, several statistical and econometric models and techniques have been applied in order to test the impact of commercial banks through the lending process in the real sector development of the Kosovo economy for the period 2005 - 2018, using time series on monthly basis.

At the beginning of the econometric analysis several statistical tests were carried out which determine the accuracy of the data contained in the econometric models. To validate the validity of the hypotheses set forth in this study, the following econometric models were applied: multiple standard regression, fixed effect, random effect, Hausman - Taylor regression, GMM Model (Arellano Bond Estimation), Generalized Estimation Equations, ratio test and T-test, factor analysis using the basic component method and reliability analysis according to the Alpha model. Also, to give more support testing of hypotheses and econometric analysis in this doctoral dissertation are applied the analysis of linear trends, logarithmic and exponential, and through which are derived cumulative average trends for the variables included in the econometric models.

The findings of this study show that commercial banks through the process of lending and efficient management of non-performing loans have positively impacted the real sector of Kosovo's economy. Regarding the impact of credit guarantees and implementation of institutional reforms in function of improving business climate, the results show a positive impact on the growth of banking sector credit to the real sector of the economy. The results of this study will have scientific and practical importance for the advancement of appropriate credit policies, which will influence the development of the real sector of the economy of Kosovo.

Keywords: *commercial banks, real sector, credit risk, loans, credit guarantees, non-performing loans, institutional reforms.*

JEL Classification: G2, G21, E4, E5, E52, E2, G28, C1

Përmbajtja

ABSTRAKT **5**

ABSTRACT **6**

KAPITULLI I **19**

HYRJE DHE FUSHËVEPRIMI I HULUMTIMIT **19**

1.1. Hyrje 19

1.2. Përkufizimi i problemit 20

1.3. Pyetjet kërkimore 22

1.4. Hipotezat e hulumtimit 22

1.5. Objektivat e hulumtimit 23

1.6. Metodologjia e hulumtimit 24

1.7. Rëndësia e hulumtimit 25

1.8. Kufizimet e hulumtimit 26

1.9. Diskutime dhe gjetje empirike nga literatura 27

1.10. Rezultatet e pritura 29

2.11. Përmbledhje 30

KAPITULLI II **31**

NDËRMJETËSIMI FINANCIAR, POLITIKAT KREDITORE DHE NDIKIMI I TYRE NË RRITJEN EKONOMIKE **31**

2.1. Ndërmjetësimi financiar dhe rritja ekonomike 31

2.2. Ndikimi i bankave komerciale në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë 35

2.3. Zhvillimi i ndërmjetësimit financiar dhe efektet në performacen e sektorit real të ekonomisë 39

2.4. Financimi i sektorit real 42

2.5. Faktorët që ndikojnë në raportin mes bankave komerciale dhe sektorit real të ekonomisë 45

2.6. NdikimNdikimi i krijimit të rrjetit të ndërmarrjeve të sektorit real dhe qasja e tyre në procesin e kreditimit bankar 50

2.7. Ekonomia e Kosovës – rritja reale e PBB-së dhe inflacioni 53
2.7.1. Rritja reale e PBB-së në Kosovë (2005 - 2018) 54
2.7.2. Ecuria e inflacionit në Kosovë (2005-2018) 56

2.8. Struktura e depozitave në sektorin bankar në Kosovë (2005-2018) 57

2.9. Struktura e kredive në sektorin bankar në Kosovë (2005 - 2018) 60

2.10. Normat e interesit në kredi dhe në depozita në sektorin bankar në Kosovë dhe analizë krahasuese me vendet e Ballkanit Përendimor 63

KAPITULLI III 69

KREDITË JO-PERFORMUESE DHE MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR 69

3.1. Menaxhimi i riskut kreditor dhe ndërlidhja e tij me kreditë jo-performuese 72

3.2. Ndikimi i menaxhimit të kredive jo-performuese në profitabilitetin e sektorit bankar 74

3.3. Faktorët makrokonomik që përcaktojnë nivelin e kredive jo-performuese 76

3.4. NdikimNdikimi i menaxhimit të kredive jo-performuese në rritjen ekonomike 80

3.5. Kreditë jo-performuese në vendet e Bashkimit Evropian 85

3.6. Reduktimi i kredive jo-perfomuese dhe efektet ekonomike 89

3.7. Niveli i kredive jo-performuese në vendet e Ballkanit Përendimor 90

3.8. Rreziku kreditor në sistemin bankar në Kosovë 91

3.9. Koncetrimi i riskut kreditor në bankat komerciale në Kosovë (2010-2018) 94

KAPITULLI IV 96

FONDET PËR GARANCI KREDITORE, RËNDESIA E TYRE NË KREDITIMIN E SEKTORIT REAL DHE MENAXHIMIN E RISKUT KREDITOR 96

4.1. Një studim i shkurtër i literaturës 100

4.2. Karakteristikat operacionale të fondeve për garanci kreditore 103

4.3. Performanca e fondeve për garanci kreditore 105

4.4. Fondet për garanci kreditore në vendet e BE-së 106

4.5. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore 109

4.6. Performanca e FKGK-së, struktura e kapitalit dhe investimet 111

4.7. Ndikimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në financimin e ndërmarrjeve të sektorit real në Kosovë 113

4.8. Zhvillimi i portfolios kreditore dhe statistikat e garancive kreditore në Kosovë 115

4.9. Menaxhimi i riskut kreditor dhe performanca sipas kualitetit kreditor të FKGK-së 123

KAPITULLI V 125

REFORMAT INSTITUCIONALE, PËRMIRËSIMI I KLIMËS SË BIZNESIT DHE KREDITIMI I SEKTORIT REAL TË EKONOMISË 125

5.1. Korniza konceptuale e reformave institucionale 128

5.2. Përvoja e BE-së në përmirësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet e sektorit real 131

5.3. Reformat institucionale dhe elementet strukturore të të bërit biznes – Rasti i Kosovës (2010 – 2018) 134
5.3.1. Fillimi i një biznesi 136
5.3.2. Marrja e lejës së ndërtimit 139
5.3.3. Furnizimi me energji elektrike 141
5.3.4. Regjistrimi i pronës 144
5.3.5. Qasja në kredi 147
5.3.6. Mbrojtja e investitorëve 150
5.3.7. Pagesa e tatimeve 153
5.3.8. Tregtimi përtej kufijve 156
5.3.9. Zbatimi i kontratave 158
5.3.10. Zgjidhja e paaftësisë paguese 160
5.3.11. Rregullimi i tregut të punës 163

KAPITULLI VI 165

ANALIZA EMPIRIKE, VLERËSIMI EKONOMETRIK I HIPOTEZAVE DHE GJETJET E STUDIMIT 165

6.1. Vlerësimi ekonometrik dhe testimi i hipotezës së parë 165
6.1.1. Statistikat deskriptive dhe analiza e korrelacionit për modelin e parë ekonometrik 168
6.1.2. Specifikimi i modelit ekonometrik dhe analiza e regresionit të shumëfishtë linear 173
6.1.3. Random – Effects GLS Regression 176
6.1.4. Fixed – Effects Regression 177
6.1.5. Hausman - Taylor Regression 179
6.1.6. Generalized Method of Moments (GMM) – Arellano Bond Estimation 180
6.1.7. Analiza e trendit linear dhe logaritmik në mes PBB-së në bujqësi dhe kredive agro 182
6.1.8. Analiza e trendit linear në mes PBB-së dhe kredive në sektorin e industrisë, prodhimtarisë, energjetikës dhe ndërtimtarisë 186
6.1.9. Analiza e trendit linear në mes PBB-së dhe kredive në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve 189
6.1.10. Analiza e trendit logaritmik në mes PBB-së dhe normës së inflacionit në Kosovë (2005 – 2018) 191
6.1.11. Analiza e trendit eksponencial në mes PBB-së dhe normës së interesit në kredi 193

6.2. Vlerësimi ekonometrik dhe testimi i hipotezës së dytë 195

6.3. Statistikat deskriptive dhe analiza e korrelacionit për modelin e dytë ekonometrik 198

6.4. Specifikimi i modelit ekonometrik dhe rezultatet ekonometrike të hipotezës së dytë 203

6.5. Analiza e trendit linear në mes vëllimit të kredive dhe faktorëve të tjerë determinues.....209

6.6. Përshkrimi i variablave dhe specifikimi i modelit ekonometrik për hipotezën e tretë 218

6.7. Ndikimi i garancive kreditore në rritjen e vëllimit të kredive ndaj sektorit real të ekonomisë së Kosovës 220

6.8. Ndikimi i garancive kreditore në zvogëlimin e riskut kreditor të bankave komerciale.....229

6.9. Përshkrimi i variablave dhe specifikimi i modelit ekonometrik për testimin e hipotezës së katërt.....236

6.10. Analiza empirike e të dhënave sekondare dhe rezultatet e anketimit të bizneseve dhe bankave komerciale 238

6.11. Analiza faktoriale – metoda e komponentëve themelorë 251

6.12. Analiza e besueshmërisë sipas modelit Alpha dhe analiza e regresionit të shumëfishtë standard 254

KAPITULLI VIII 263

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....263

LITERATURA DHE REFERENCAT 276

SHTOJCA 1 288

SHTOJCA 2 291

SHTOJCA 3 295

SHTOJCA 4 298

LISTA E FIGURAVE

Kapitulli 2

Figura 2. 1. *Indeksi i efikasitetit alokues në vitin 2010 për vendet dhe sektorët e përzgjedhur* 44

Figura 2. 2. *Dinamika e ndërmarrjeve në sektorin real dhe qasja e tyre në financa* 44

Figura 2. 3. *Rritja reale e PBB-së në Kosovë (2005-2018)* 55

Figura 2. 4. *Ecuria e Inflacionit në Kosovë (2005-2018)* 57

Figura 2. 5. *Paraqitja grafike e strukturës së depozitave në sektorin bankar në Kosovë (2005-2018)* 59

Figura 2. 6. *Struktua e kredive në përqindje në sistemin bankar në Kosovë (2005-2018)* 61

Figura 2. 7. *Paraqitja grafike e normës së interesit të kredive dhe depozitave në sektorin bankar në Kosovë (2005-2018)* 64

Figura 2. 8. *Paraqitja grafike e normës së interesit në depozita për vendet e Ballkanit Përendimor (2005-2018)* 66

Figura 2. 9. *Paraqitja grafike e normës së interesit në kredi për vendet e Ballkanit Përendimor (2005-2018)* 67

Kapitulli 3

Figura 3. 1. *Zhvillimi i raportit të kredive jo-performuese në vendet e Bashkimit Evropian* 78

Figura 3. 2. *Raporti mesatar i KJP-ve dhe kreditë jo-performuese si përqindje e PBB-së* 83

Figura 3. 3. *Raporti i kredive jo-performuese në vendet e Bashkimit Evropian (2008-2017)* 85

Figura 3. 4. *Vlera mesatare (e lartë/e ulët) për kreditë jo-performuese në bankat e mëdha evropiane* 86

Figura 3. 5. *Kreditë jo-performuese të ndara sipas sektorit në disa vende të Bashkimit Evropian* 87

Figura 3. 6. *Kreditë jo-performuese të ndara sipas sektorit në disa vende të Bashkimit Evropian* 88

Figura 3. 7. *Paraqitja grafike e nivelit të kredive jo-performuese në mes Kosovës dhe vendeve tjera* 91

Figura 3. 8. *Raporti i kredive jo-performuese në sektorin bankar në Kosovë (2005-2018)* 92

Figura 3. 9. *Raporti ndërmjet gjithsej ekspozimet e mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë (2009 -2018)* 94

Kapitulli 4

Figura 4. 1. *Vëllimi i papaguar i garancive kreditore si përqindje e PBB-së* 107

Figura 4. 2. *Pronësia, struktura ligjore dhe statusi tatimor i Fondeve për Granci Kreditore në vendet e BE-së*. 108

Figura 4. 3. *Pjesëmarrja e donatorëve të FKGK-së në përqindje* 112

Figura 4. 4. *Paraqitja grafike e statistikave për kreditë dhe garancitë e aprovuara nga FKGK-ja – viti 2016* ... 116

Figura 4. 5. *Paraqitja grafike e shpërdarjes së kredive të FKGK-së sipas rajoneve për vitin 2016* 117

Figura 4. 6. *Paraqitja grafike e statistikave për kreditë dhe garancitë e aprovuara nga FKGK-ja – viti 2017* ... 118

Figura 4. 7. *Shpërndarja e kredive sipas sektorit nga FKGK-ja për vitin 2017* 119

Figura 4. 8. *Destinimi i kredive të FKGK-ja për vitin 2017* 120

Figura 4. 9. *Shpërndarja e kredive sipas rajoneve të FKGK-ja për vitin 2018* 121

Figura 4. 10. *Shpërndarja e kredive dhe garancive kreditore sipas sektorëve kryesore ekonomik – Viti 2018* 122

Figura 4. 11. *Performanca e FKGK-së sipas kualitetit kreditor – Viti 2017* 123

Kapitulli 5

Figura 5. 1. *Raportimi i kredive duke u bazuar në historinë e ripagimit nga kompanitë financiare* 133

Figura 5. 2. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business - Fillimi i një biznesi* 137

Figura 5. 3. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Fillimi i një biznesi* 138

Figura 5. 4. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Marrja e lejës së ndërtimit* 139

Figura 5. 5. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Marrja e lejës së ndërtimit* ... 141

Figura 5. 6. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Furnizimi me energji elektrike* 142

Figura 5. 7. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Furnizimi me energji elektrike* 143

Figura 5. 8. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Regjistrimi i pronës* 144

Figura 5. 9. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Regjistrimi i pronës* 146

Figura 5. 10. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Qasja në kredi* 148

Figura 5. 11. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Qasja në kredi* 149

Figura 5. 12. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Mbrotja e investitorëve* 151

Figura 5. 13. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Mbrojtja e investitorëve* 152

Figura 5. 14. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Pagesa e tatimeve* 154

Figura 5. 15. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Pagesa e tatimeve* 155

Figura 5. 16. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Lehtësimet tregtare* 157

Figura 5. 17. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Lehtëstimet tregtare* 158

Figura 5. 18. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Zbatimi i kontratave* 159

Figura 5. 19. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Zgjidhja e paaftësisë paguese* 161

Figura 5. 20. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Zgjidhja e paftësisë paguese* 162

Kapitulli 6

Figura 6. 1. *Paraqitja grafike e shpërndarjes normale të PBB-së dhe kredive bankare nëpërmjet histogramit*.. 169

Figura 6. 2. *Paraqitja grafike e shpërndarjes normale të normave të interesit në kredi dhe IÇK-së* 170

Figura 6. 3. *Paraqitja grafike e korrelacionit Pearson në mes PBB-së me kreditë bankare dhe normat e interesit në kredi* 171

Figura 6. 4. *Paraqitja grafike e korrelacionit Pearson në mes PBB-së me IÇK-së si dhe në korrelacioni mes kredive dhe normave të interesit në kredi* 172

Figura 6. 5. *Paraqitja grafike e funksionit të trendit linear dhe trendit logaritmik për PBB-në dhe kreditë në sektorin e bujqësisë* 184

Figura 6. 6. *Paraqitja grafike e funksionit të trendit linear për PBB-në dhe kreditë në sektorin e IPEN-it* 187

Figura 6. 7. *Paraqitja grafike e funksionit të trendit linear për PBB-në dhe kreditë në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve* 190

Figura 6. 8. *Paraqitja grafike e funksionit të trendit logaritmik për PBB-në dhe indeksin e çmimit të konsumatorit në Kosovë* 192

Figura 6. 9. *Paraqitja grafike e funksionit të trendit eksponencial për PBB-në dhe normat e interesit në kredi*.. 194

Figura 6. 10. *Paraqitja grafike e shpërndarjes normale të kredive jo-performuese dhe depozitave nëpërmjet histogramit* 200

Figura 6. 11. *Paraqitja grafike e korrelacionit në mes kredive bankare me kreditë jo-performuese dhe PBB-në* 201

Figura 6. 12. *Paraqitja grafike e korrelacionit në mes kredive bankare me IÇK-në dhe depozitat* 202

Figura 6. 13. *Paraqitja grafike e korrelacionit në mes kredive jo-performuese me GDP-në, CPI-në dhe depozitat* 203

Figura 6. 14. *Paraqitja grafike e lidhjes lineare në mes kredive, papunësisë dhe kredive jo-performuese* 208

Figura 6. 15. *Paraqitja grafike e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive dhe kredive jo-performuese* 210

Figura 6. 16. *Paraqitja grafike e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive dhe PBB-së* 213

Figura 6. 17. *Paraqitja grafike e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive dhe IÇK-së* 214

Figura 6. 18. *Paraqitja grafike e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive dhe depozitave* 216

Figura 6. 19. *Paraqitja grafike e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive dhe normës së papunësisë* 217

Figura 6. 20. *Shpërndarja normale e shumës së kredive dhe garancive kreditore*..... 221

Figura 6. 21. *Paraqitja grafike e trendit linear në mes shumës së kredive dhe garancive kreditore* 225

Figura 6. 22. *Paraqitja grafike e trendit linear në mes shumës së kredive dhe garancive kreditore* 226

Figura 6. 23. *Paraqitja grafike e trendit linear në mes shumës së kredive dhe garancive kreditore për vitin 2018* 227

Figura 6. 24. *Korrelacioni Pearson dhe matrica e shpërndarjes normale në mes të vlerave të KJP-së dhe GK-së* 230

Figura 6. 25. *Paraqitja grafike e trendit linear në mes të kredive jo-performuese dhe garancive kreditore për vitet 2016 – 2017* 233

Figura 6. 26. *Paraqitja grafike e trendit linear në mes të kredive jo-performuese dhe garancive kreditore për vitin 2018* 235

Figura 6. 27. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – fillimi i një biznesi* 240

Figura 6. 28. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – marrja e lejës së ndërtimit* 241

Figura 6. 29. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – furnizimi me energji elektrike* 242

Figura 6. 30. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – regjistrimi i pronës*..... 243

Figura 6. 31. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – reformat e qasjës në kredi*..... 244

Figura 6. 32. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – mbrojtja e investitorëve*..... 245

Figura 6. 33. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – pagesa e tatimeve*..... 247

Figura 6. 34. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – tregtimi përtej kufijeve* 248

Figura 6. 35. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – zbatimi i kontratave*..... 249

Figura 6. 36. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – zgjidhja e paaftësisë paguese*..... 250

Figura 6. 37. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – rregullimi i tregut të punës* 251

Figura 6. 38. *Grafiku i analizës faktoriale për hipotezën e katërt*..... 253

LISTA E TABELAVE

Kapitulli 2

Tabela 2. 1. *Struktua e depozitave në përqindje në sistemin bankar në Kosovë (2005-2018)* 58

Tabela 2. 2. *Struktua e kredive në përqindje në sistemin bankar në Kosovë (2005-2018)* 60

Tabela 2. 3. *Normat e interesit në kredi dhe depozita në sistemin bankar në Kosovë (2005-2018)* 63

Tabela 2. 4. *Norma e interesit në depozita në vendet e Ballkanit Përendimor (2005-2018)* 65

Tabela 2. 5. *Norma e interesit në kredi në vendet e Ballkanit Përendimor (2005-2018)* 67

Kapitulli 3

Tabela 3. 1. *Niveli i kredive jo-performuese në vendet e Ballkanit Përendimor* 90

Kapitulli 4

Tabela 4. 1. *Struktura e tarifave për fondet e garancisë kreditore* 105

Tabela 4. 2. *Shuma e donatorëve dhe fondet e dhuruara për kapitalin e FKGK-së* 111

Tabela 4. 3. *Statistikat e kredive dhe garancive kreditore të FKGK-së për periudhën Shtator 2016 – Dhjetor 2016* 115

Tabela 4. 4. *Shpërdarja e kredive dhe garancive kreditore të FKGK-së sipas rajoneve për vitin 2016* 116

Tabela 4. 5. *Statistikat e kredive dhe garancive kreditore të FKGK-së për vitin 2017* 118

Tabela 4. 6. *Shpërdarja e kredive dhe garancive kreditore të FKGK-së sipas rajoneve për vitin 2017* 119

Tabela 4. 7. *Statistikat e kredive dhe garancive kreditore të FKGK-së për vitin 2018* 121

Kapitulli 5

Tabela 5. 1. *Elementet strukturore të të bërit biznes dhe përshkrimi i reformave institucionale* 135

Tabela 5. 2. *Analizë krahasuese e indikatorëve për fillimin e një biznesi në Kosovë (2010 – 2018)* 137

Tabela 5. 3. *Analizë krahasuese e indikatorëve për marrjen e lejës së ndërtimit në Kosovë (2010 – 2018)* 140

Tabela 5. 4. *Analizë krahasuese e indikatorëve për furnizimin me energji elektrike në Kosovë (2012 – 2018)* .. 143

Tabela 5. 5. *Analizë krahasuese e indikatorëve për regjistrimin e pronës në Kosovë (2010 – 2018)* 145

Tabela 5. 6. *Analizë krahasuese e indikatorëve për qasjen në kredi në Kosovë (2010 – 2018)* 149

Tabela 5. 7. *Analizë krahasuese e indikatorëve për mbrotjën e investitorëve në Kosovë (2010 – 2018)* 152

Tabela 5. 8. *Analizë krahasuese e indikatorëve për pagesën e tatimeve në Kosovë (2010 – 2018)* 154

Tabela 5. 9. *Analizë krahasuese e indikatorëve për matjen e lehtësimeve tregtare në Kosovë (2010 – 2015)* 157

Tabela 5. 10. *Analizë krahasuese e indikatorëve për zgjidhjen e paaftësisë paguese në Kosovë (2010 – 2018)* .. 162

Kapitulli 6

Tabela 6. 1. *Përshkrimi i variablave për modelin e parë ekonometrik – hipoteza e parë* 167

Tabela 6. 2. *Statistikat deskriptive për variablat e hipotezës së dytë* 169

Tabela 6. 3. *Analiza e korrelacionit Pearson për variablat e përfshira në modelin e parë ekonometrik* 170

Tabela 6. 4. *Rezultatet e analizës së regresionit linear shumëfaktorial* 174

Tabela 6. 5. *Rezultatet e analizës së regresionit linear shumëfaktorial pas largimit të IÇK-së* 175

Tabela 6. 6. *Rezultatet e modelit Random – Effect GLS Regression* 176

Tabela 6. 7. *Rezultatet e modelit Fixed – Effect Regression* 177

Tabela 6. 8. *Rezultatet e modelit Hausman - Taylor Regression* 179

Tabela 6. 9. *Rezultatet e modelit GMM Model – Arellano Bond Estimation* 181

Tabela 6. 10. *Analiza e trendit në mes GDP-së dhe kredive në sektorin e bujqësisë* 183

Tabela 6. 11. *Analiza e trendit në mes PBB-së dhe kredive në sektorin e industrisë, prodhimit, energjetikës dhe ndërtimtarisë* 186

Tabela 6. 12. *Analiza e trendit linear në mes PBB-së dhe kredive në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve* 189

Tabela 6. 13. *Analiza e trendit logaritmik në mes PBB-së dhe inflacionit në Kosovë (2005 – 2018)* 191

Tabela 6. 14. *Analiza e trendit eksponencial në mes GDP-së dhe normës së interesit në kredi* 193

Tabela 6. 15. *Përshkrimi i variablave për modelin ekonometrik të hipotezës së dytë* 196

Tabela 6. 16. *Statistikat deskriptive për variablat e hipotezës së dytë* 199

Tabela 6. 17. *Analiza e korrelacionit Pearson për variablat e përfshira në modelin e dytë ekonometrik* 200

Tabela 6. 18. *Rezultatet empirike për modelin e dytë ekonometrik* 205

Tabela 6. 19. *Rezultatet e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive për biznese dhe kredive jo-performuese* 210

Tabela 6. 20. *Rezultatet e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive për biznese dhe PBB-së* 212

Tabela 6. 21. *Rezultatet e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive për biznese dhe IÇK-së* 213

Tabela 6. 22. *Rezultatet e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive për biznese dhe nivelit të depozitave* 215

Tabela 6. 23. *Rezultatet e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive për biznese dhe normës së papunësisë* 216

Tabela 6. 24. *Përshkrimi i variablave për modelin ekonometrik të hipotezës së tretë* 220

Tabela 6. 25. *Statistikat deskriptive për shumën e kredive bankare dhe garancive kreditore* 221

Tabela 6. 26. *Rezultatet e analizës së regresionit standard linear për ndikimin e garancive kreditore në vëllimin e kredive* 222

Tabela 6. 27. *Rezultatet e analizës së variancës (Racio Test) për ndikimin e garancive kreditore në vëllimin e kredive* 223

Tabela 6. 28. *Rezultatet e analizës së variancës (T-Test) për ndikimin e garancive kreditore në vëllimin e kredive* 224

Tabela 6. 29. *Rezultatet e analizës së trendit për kreditë totale dhe garancitë kreditore në vitin 2016*..... 224

Tabela 6. 30. *Rezultatet e analizës së trendit për kreditë totale dhe garancitë kreditore në vitin 2017*..... 225

Tabela 6. 31. *Rezultatet e analizës së trendit për kreditë totale dhe garancitë kreditore në vitin 2018*..... 227

Tabela 6. 32. *Statistikat deskriptive për kreditë jo-performuese dhe garancive kreditore*..... 229

Tabela 6. 33. *Rezultatet e analizës së regresionit standard linear për ndikimin e garancive kreditore në kreditë jo-performuese* 231

Tabela 6. 34. *Rezultatet e analizës së variancës (Racio Test) për ndikimin e garancive kreditore në KJP-ve* 231

Tabela 6. 35. *Rezultatet e analizës së variancës (T-Test) për ndikimin e garancive kreditore në kreditë jo-performuese* 232

Tabela 6. 36. *Rezultatet e analizës së trendit për kreditë jo-performuese dhe garancitë kreditore në vitin 2016 – 2017* 233

Tabela 6. 37. *Rezultatet e analizës së trendit për kreditë jo-performuese dhe garancitë kreditore në vitin 2018* 234

Tabela 6. 38. *Përshkrimi i variablave për testimin e hipotezës së katërt* 237

Tabela 6. 39. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe fillimin e një biznesi* 239

Tabela 6. 40. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe marrjen e lejës së ndërtimit* 240

Tabela 6. 41. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe furnizimin me energji elektrike* 242

Tabela 6. 42. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe regjistrimin e pronës* 243

Tabela 6. 43. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe mbrojtjën e investitorëve* 245

Tabela 6. 44. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe pagesën e tatimeve* . 246

Tabela 6. 45. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe tregtinë përtej kufijve* 247

Tabela 6. 46. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe zbatimin e kontratave* 248

Tabela 6. 47. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe zgjidhjen e paaftësisë paguese* 250

Tabela 6. 48. *Rezultatet – KMO dhe Bartlett's Test* 252

Tabela 6. 49. *Numri i faktorëve në fidhje me vlerën Eigen dhe përqindja shpjeguese e variancës* 252

Tabela 6. 50. *Matrica e faktorëve të rrotulluar* 253

Tabela 6. 51. *Rastet e selektuara për analizën e besueshmërisë* 255

Tabela 6. 52. *Vlera e koeficientit Alpha* 255

Tabela 6. 53. *Statistikat e analizës së besueshmërisë* 255

Tabela 6. 54. *Matrica e korrelacionit* 256

Tabela 6. 55. *Përmbledhja e statistikave deskriptive të analizës së besueshmërisë* 256

Tabela 6. 56. *Përmbledhja e statistikave të përgjithshme të analizës së besueshmërisë* 257

Tabela 6. 57. *Statistikat e shkallës* 257

Tabela 6. 58. *Përmbedhja e statistikave të modelit të parë ekonometrik* 258

Tabela 6. 59. *Rezultatet e analizës Anova për modelin e parë ekonometrik* 259

Tabela 6. 60. *Rezultatet e analizës së regresionit të shumëfishtë standard për modelin e parë ekonometrik* 259

Tabela 6. 61. *Përmbedhja e statistikave të modelit* 261

Tabela 6. 62. *Rezultatet e analizës Anova për modelin e dytë ekonometrik* 261

Tabela 6. 63. *Rezultatet e analizës së regresionit të shumëfishtë standard për modelin e parë ekonometrik* 262

KAPITULLI I

HYRJE DHE FUSHËVEPRIMI I HULUMTIMIT

1.1. Hyrje

Studimet mbi politikat kreditore të bankave komerciale kanë për qëllim të identifikojnë faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin e sektorit real në Kosovë, pra në performancën e këtyre bizneseve, si dhe cilat janë efektet që japin këto politika kreditore në rritjen ekonomike të sektorit real. Në këtë diseratacion do të trajtohen disa çështje të rëndësishme dhe problematika të sistemit të kreditimit, të performancës financiare dhe profitabilitetit të sektorit real në Kosovë.

Ky disertacion, do të paraqesë si nga aspekti teorik edhe nga ai empirik lidhjen ndërmjet treguesve kryesorë të performancës, apo rritjes së sektorit real nëpërmjet sistemit të kreditimit dhe do të analizohet se sa ka ndikuar kreditimi bankar në sektorin real të ekonomisë së Kosovës. Pavarësisht kësaj, mjedisi në vendet e Europës Juglindore, duke marrë parasysh komponentin rajonal, është mjaft i kufizuar dhe jo aq i favorshëm për rritje dhe zhvillim të sektorit real gjë e cila do t'i hapte rrugë zhvillimit më të madh të këtyre vendeve. Elemente si: politika jo të mira fiskale, konkurrenca jo lojale, raporti negativ shumë i lartë i bilanceve tregtare pengojnë sektorin real që të japin efektet si në vendet e tjera.

Marrëdhëniet bankë-biznes janë baza e vëllimit të bizneseve të ndërsjellta midis ty. Sistemi bankar është ai që ka mundësi të mbështesë gjithë ciklin e operacioneve financiare të një biznesi. Banka krediton për investime, teknologji, blerje të lëndës së parë e mundësi të tjera. Bankat realizojnë edhe shërbime të ndryshme të pagesave që tashmë janë bërë detyrim ligjor për bizneset. Nga një ballafaqim i kohëve të fundit të biznesit me bankat dhe ndërmjetësit e tjerë financiarë në sektorin bankar të Kosovës, u evidentuan një sërë problemesh reciproke: bankat mbajnë një nivel të lartë të interesit të kredive ndaj bizneseve, që përkthehet si një klimë jo miqësore e bankave ndaj bizneseve; bankat kanë pagesa shërbimi shumë të larta, gati të papërballueshme nga bizneset e vogla, për shërbimet që ofrojnë, por që janë të detyrueshme përmes sistemit bankar dhe sipas statistikave të raporteve të ndryshme hulumtuese, bankat kanë arritur norma fitimi të larta në raport me vështirësitë për mbijetesë që kanë bizneset e tjera në kohën e tanishme të krizës globale.

Prandaj, krijimi i sistemeve të fondeve të garancive dhe kredive të buta duhet të kthehet në një politikë konstante kreditore e raportit bankë-biznes. Sistemi kreditor ka ndikime pozitive dhe negative në mobilizimin e kursimeve, ndarjen e kapitalit, diversifikimin e risqeve si dhe përpunimin e informacionit për lehtësimin e transaksioneve financiare. Sistemi kreditor në çdo fazë të zhvillimit të tij ndikon në ecurinë dhe zhillimin e sektorit industrial dhe si rrjedhojë edhe në sektorët e ekonomisë reale. Nga ana tjetër i njejti përbën faktor përcaktues të shpërndarjes së burimeve dhe nevojave për financime. Në përgjigje të rritjes së nevojave për prodhim kërkohet rritja e financimeve e cila shoqërohet jo vetëm me rritje të aktivitetit dhe aktiveve të sistemit financiar, por dhe të rentabilitetit të tyre.

Ndërmjetësimi financiar reflekton te format e financimit mënyrën se si është stukturuar në llojet dhe kategoritë e shfaqjes së tij. Kjo ndërlidhje shpreh rëndësinë që ka shpërndarja e duhur e fondeve si funksioni kryesor i ndërmjetësimit financiar tek ekonomia reale (industria, shërbimet etj). Stade të ndryshme të zhvillimit ekonomik të një vendi pasqyrojnë nivele të ndryshme të organizimit të strukturës së sistemit financiar. Specifikat e kërkesave për fonde, kryesisht nga agjenti ekonomik biznes, diktojnë mënyrën se si një sistem financiar organizohet në qëllimet e tij drejt tregut të synuar.

1.2. Përkufizimi i problemit

Një ekonomi e zhvilluar është një ekonomi që prodhon vlerë, por alokimi i burimeve dhe fondeve në mënyrën e duhur e dikton këtë zhvillim. Një zhvillim i qëndrueshëm duhet të jetë gjithmonë investim rentabël për të ardhmen. Ndaj një ekonomi ka dy sektorë të rëndësishëm: sektorin bankar që siguron finacimet dhe sektorin real që realizon investimet. Këta dy sektorë idealisht janë shumë të lidhur, por parregullsitë e tregut, stadi i zhvillimit të secilit prej këtyre sektorëve, faktorët politikë etj. e zbehin këtë lidhje. Ekonomia e Kosovës është ende shumë e ndikuar nga informaliteti dhe të tjera parregullsi që shtrembërojnë parimet e ekonomisë së tregut, ndaj është me interes studimi i lidhjes mes këtyre dy sektorëve për të kuptuar se zhvillimi i tyre i pavarur ndikon te tjetri.

Sipas teorisë së Wicksell (1954) kreditimi ka pasur ndikim të vogël në rritjen ekonomike në kuadër të normave të interesit. Nëse normat e interesit janë nën normën e kthimit të kapitalit, sipërmarrësit do të huazonin në normën e parasë për të blerë mallra kapitale që do të nxisnin një normë më të lartë të rritjes ekonomike. Në anën tjetër, nëse normat e interesit janë mbi nivelin e kthimit të kapitalit, sipërmarrësit do të shesin mallrat kapitale dhe do të mbajnë paratë në fakt duke zvogëluar rritjen ekonomike.

Cracknell (2012) argumenton se lehtësimi i qasjes financiare siguron shtysë në forcimin e sektorit financiar, i cili është një lojtar kyç në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e sektorit real. Shumë vende evropiane duket se e kanë huazuar këtë argument dhe kanë rritur qasjen e sektorit real në kreditimin bankar, duke aplikuar më shumë lehtësira financiare nga bankat për të nxitur rritjen ekonomike. Megjithatë, duket se nuk ka marrëdhënie automatike pozitive midis kreditimit dhe rritjes ekonomike. Sipas Kelly, McQiunn & Stuart (2013) kanë realizuar një studim qëllimi i të cilit ishte të identifikonte dhe të vendoste marrëdhënien midis kredive të sektorit real dhe rritjes ekonomike në Irlandë, e cila kishte përjetuar një qasje më të gjerë në kredi. Kredia e sektorit real u përcaktua si kredi e dhënë për banorët privatë irlandezë nga të gjitha institucionet e kreditimit, që ishin rezident në Irlandë. Hulumtimi është bërë për periudhën mes viteve 1983 dhe 1997. Gjetjet treguan se ka një marrëdhënie të fortë pozitive midis kredisë së sektorit real dhe rritjes ekonomike.

Gjetjet e ngjashme janë paraqitur më parë edhe nga autori Caporale et al (2009). Ky studim është bërë për të vendosur lidhjen ndërmjet rritjes ekonomike dhe kredisë bankare për vendet që ishin shtete anëtare të reja në Bashkimin Evropian në mes viteve 1994 dhe 2007. Këto ishin dhjetë vende në total. Për të vendosur këtë lidhje empirike, ky studim rezultoi me regres midis normës së rritjes ekonomike dhe zhvillimit financiar të matur nga treguesit e brendshëm të kredisë dhe treguesit makroekonomikë specifikë të vendit, si efiçienca bankare dhe kapitalizimi i tregut të aksioneve. Gjetjet empirike nga ky studim treguan se ekziston një lidhje e ngushtë midis rritjes ekonomike dhe kredisë bankare në një kuptim që disponueshmëria e dobët e kreditit shkaktoi rritje të dobët ekonomike në këto dhjetë vende (Caporale, Rault & Sova, 2009).

Duke u bazuar në gjetjet e studimeve të shumta nga autorë të ndryshëm, në këtë disertacion do të vendosim qëllimin kryesor të këtij kërkimi shkencor, i cili do të identifikoj kontributin e kreditimit bankar në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë së Kosovës. Pra, duke e shtjelluar problemin e këtij kërkimi shkencor, ne do të analizojmë politikat kreditore të bankave komerciale dhe ndikimin e tyre në performacën e ndërmarrjeve të sektorit real (tregtisë me shumicë, tregtisë me pakicë, prodhimit, ndërtimit dhe sektorit të shërbimeve).

1.3. Pyetjet kërkimore

Duke u bazuar në thelbin e temës e cila trajtohet në këtë punim, dhe ajo çfarë është thënë në përkufizimin e problemit, disa pyetje mund të ndihmojnë realizimit dhe të kuptuarit më mirë të punimit:

1. Sa kanë ndikuar kreditë e bankave komerciale në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë së Kosovës?
2. Cilat janë efektet e politikave të menaxhimit racional dhe me efikasitet të kredive të këqia në rritjen e kreditimit ndaj sektorit real?
3. Çfarë ndikimi ka krijimi i fondit për garanci kreditore në rritjen e kreditimit dhe në zvoglimin e riskut kreditor?
4. Cilat janë efektet në rritjen e kreditimit të sektorit bankar ndaj sektorit real të ekonomisë së Kosovës nga zbatimi i reformave institucionale në funksion të përmirësimit të klimës biznesore?

1.4. Hipotezat e hulumtimit

H1: Bankat komerciale nëpërmjet procesit të kreditimit kanë realizuar ndikim përmbajtësor në sektorin real të ekonomisë së Kosovës.

H2: Politikat e menaxhimit me efikasitet të kredive të këqia kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e vëllimit te kreditimit ndaj sektorit real të ekonomisë.

H3: Krijimi i fondit për garancitë kreditore ka zvogëluar riskun kreditor dhe kanë rritur kreditimin e bankave komerciale ndaj sektorit real të ekonomisë.

H4: Zbatimi i reformave institucionale në funksion të përmirësimit të klimes biznesore ka pasur ndikim pozitiv në rritjen e kreditimit të sektorit bankar ndaj sektorit real të ekonomisë.

Kreditë për ndërmarrjet e sektorit real përbëjnë rreth 65 përqind të gjithsej kredive të sektorit bankar, andaj vlerësimi i shëndetit dhe zhvillimeve të sektorit të ndërmarrjeve është aspekt kyç i vlerësimit të rrezikut të stabilitetit financiar. Nëpërmjet testimit të hipotezave të parashtruara do të tentohet të analizohet ndikimi i kredive bankare në zhvillimin e sektorit real në Kosovë.

Duke u bazuar në vlerësimet e ndryshme empirike dhe analizat e situatës në Kosovë, vërehet se kredia për sektorin real ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e dy treguesve kryesorë makroekonomik: investimeve në sektorin real dhe konsumit privat. Në lidhje me bilancin tregtar, analizat e ndryshme

ekonometrike tregojnë se kredia për biznese ndikon pozitivisht, ndërsa kredia për individë ndikon negativisht. Prandaj, nëpërmjet hipotezave të parashtruara, do të tentojmë t'i sqarojmë të gjitha dilemat e paraqitura dhe të nxjerrim përfundime të sakta se si ka ndikuar kreditimi bankar në sektorin real të ekonomisë së Kosovës.

1.5. Objektivat e hulumtimit

Ky kërkim shkencor ofron një analizë të gjendjes aktuale të sistemit bankar, funksionet e politikave kreditore të bankave komerciale dhe ndikimin e tyre potencial që kanë në zhvillimin e sektorit real. Ky studim kërkon në veçanti të konstatohet, studiohet dhe analizohet se sa kanë ndikuar politikat kreditore të bankave komerciale në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë së Kosovës. Identifikimi i këtyre faktorëve, do të krijojë mundësi për analizimin e performancës së vetë ndërmarrjeve të sektorit real.

Në mënyrë të përmbledhur studimi synon të realizojë këto objektiva:

- Të përcaktojë ndikimin e politikave kreditore të bankave komerciale në financimin dhe zhvillimin e sektorit real në Kosovë;
- Të studiojë përmes analizave krahasuese lidhjen ndërmjet politikave kreditore sipas percpetimeve të bizneseve dhe sipas rezultateve empirike dhe atyre faktike;
- Të analizojë rolin dhe rëndësinë e sektorit real në ekonomi dhe rrethinës institucionale për mbështetjen e zhvillimit të tyre;
- Pasqyrimi i gjendjes aktuale të financimit të sektorit real nëpërmjet kreditimit dhe qasjes në burimet eksterne të financimit, si barrierë e zhvillimit të biznesit;
- Identifikimi i mundësive për zbutjen e kriteriumeve dhe kostove të politikave kreditore të institucioneve financiare bankare;
- Të studiojë dhe analizojë faktorët që ndikojnë në qasjen për kredimarrje të biznesit
- Nxjerrja e rekomandimeve për avancimin e kredimit bankar për sektorin real
- Rezultatet e këtij punimi t'i shërbejnë sektorit të biznesit, institucioneve të Kosovës dhe sektorit bankar për bashkëpunim më të avasnuar në kuptim të rritjes se kreditimit dhe zvogëlimit të riskut të kreditimit në dobi reciproke të sektorit real dhe sektorit bankar

- Nëpërmjet këtij punimi të arrij titullin Doktor i Shkencës.

1.6. Metodologjia e hulumtimit

Për të realizuar objektivat e parashtruara më lart në këtë studim mbledhja e të dhënave do të realizohet duke u bazuar në grumbullimin e të dhënave nga burimet sekondare: publikime të Bankës Qendrore të Kosovës, Bankës Botërore, Agjensisë së Statistikave të Kosovës, Shoqatës së Bankave të Kosovës, Ministrisë së Financave, Fondi Monetar Ndërkombëtar, OECD, Bankës Qendrore Evropiane etj. Ndërsa për grumbullimin e të dhënave primare do të aplikohen dy pyetësor të realizuar me ndërmarrjet apo kompanitë e ndryshme të sektorit real (tregtisë me shumicë, tregtisë me pakicë, prodhimit, ndërtimit dhe shërbimeve) në Kosovë dhe me bankat komerciale në Kosovë.

Për realizimin e këtij disertacioni , një vend të veçantë ze metodologjia shkencore e përdorur. Fazat kryesore në bazë të të cilave do të realizohet ky punim janë: përzgjedhja e literaturës, mbledhja e të dhënave sekondare dhe primare, zgjedhja dhe përshkrimi i mostrës si dhe analiza dhe interpretimi i të dhënave empirike. Rishikimi i literaturës përmban studime të shumta të autorëve vendas dhe të huaj, studimin e librave, artikujve, kumtesave, konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare etj.

Për realizimin e këtij studimi, faza empirike u mbështet në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave sekondare nga Banka Qendrore e Kosovës, Banka Botërore, Agjensia e Statistikave të Kosovës, Shoqata e Bankave të Kosovës, Banka Qendrore Evropiane, Fondi Monetar Ndërkombëtar etj, dhe mbledhjen apo përpunimin e të dhënave primare në terren nëpërmjet metodës së anketimit.

Për testimin e validitetit të hipotezave të parashtruara në këtë disertacion do të aplikojmë metodat kuantitative nëpërmjet të dhënave sekondare dhe primare. Për testimin e tri hipotezave të para, do të përdorim të dhënat sekondare zyrtare, të publikuara në raportet vjetore financiare të institucioneve të ndryshme. Ndërsa për vërtetimin e hipotezës së katërt do të aplikohet një miks i të dhënave primare dhe sekondare. Të dhënat sekondare për këtë hipotezë do të bazohen në raportet Doing Business të Bankës Botërore, ndërsa të dhënat primare do të grumbullohen nëpërmjet një anketimi që do të përfshijë 56 ndërmarrje të sektorit real në Kosovë dhe 10 banka komerciale nga të cilat do të merren percptimet e tyre lidhur me ndikimin e reformave institucionale në funksion të përmirësimit të klimës biznesore në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë. Pyetësori do të përmbajë disa seksione të pyetjeve, të cilat synojnë mbledhjen e të dhënave reale nga subjekte të ndryshme biznesoredhe nga bankat komerciale. Të dhënat embledhura nëpërmjet burimeve sekondare dhe pyetësorit, janë të përpunuara me metoda statistikore dhe ekonometrike në programin SPSS dhe STATA.

Për ti dhënë përgjigjje pyetjeve kërkimore dhe për testimin e hipotezave të parashtruara në këtë disertacion, studimi do të përdorë disa metoda shkencore të cilat janë përdorur edhe në shumë hulumtime të tjera ekonomike nga autorë të ndryshëm. Për të pasur një fleksibilitet më të madh në aspektin e mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të dhënave, në këtë studim janë përdorur këto metoda e mëposhtëme shkencore:

1. Metoda e induksionit dhe deduksionit
2. Metoda e analizës dhe sintezës
3. Metoda krahasuese
4. Metoda historike dhe
5. Metodat kuantitative nëpërmjet të dhënave primare dhe sekondare

Gjatë analizave empirike dhe rishikimit të literaturës një metodë mjaft e rëndësishme është **metoda e induksionit dhe deduksionit.** Nëpërmjet **metodës së induksionit** prej rasteve të veçanta arrijmë deri te rastet e përgjithshme dhe nëpërmjet **metodës së deduksionit**, do të fillojmë nga rastet e përgjithshme duke kaluar në rrethana të veçanta të cilat do të hulumtohen. Metoda e dytë që do të aplikohet në këtë disertacion është metoda e analizës dhe sintezës. Nëpërmjet aplikimit të kësaj metode, do të realizohen analiza të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse, ku nëpërmjet sintezës do të japim përgjigjje pyetjeve kërkimore dhe do të vërtetohen hipotezat e parashtruara në këtë studim.

Metoda krahasuese konsiderohet një ndër metodat më të aplikuara në çdo shkencë, e cila ka për objektiv përcaktimin e interferencave të ndërsjellta për dukuritë që krahasohen. Duke u bazuar në këtë metodë, gjatë rishikimit të literaturës, do të elaborohen edhe raste të ndryshme të studimit nga vende të ndryshme, në lidhje me ndikimin e bankave komerciale në zhvillimin e sektorit real të këtyre vendeve. Për këtë qëllim, për ti dhënë përgjigjje pyetjeve kërkimore të këtij studimi, do të paraqesim disa modele ekonometrike, nëpërmjet të cilave do të studiohet ndërvarësia në mes variablave të ndryshme të pavarura dhe të varura.

1.7. Rëndësia e hulumtimit

Ky studim do të ketë rëndësi shkencore dhe praktike për avancimin e politikave të duhura kreditore, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë së Kosovës. Së pari, studimi do të ofrojë një analizë teorike dhe praktike në lidhje me format bashkëkohore të kreditimit të sektorit real si dhe rëndësinë e reformimit të politikave kreditore në financimin dhe zhvillimin e këtij sektori.

Së dyti, ky studim do të ofrojë një evidencë empirike mbi atë se sa kanë ndikuar kreditë bankare në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë së Kosovës. Evidenca e ofruar nga ky studim do të mund të shërbejë si pasqyrim i gjendjes aktuale në lidhje me atë se sa kanë arritur bizneset në Kosovë të zhvillohen përmes kredive të ofruara nga bankat komerciale. Rezultatet e dala nga ky studim synojnë që të ndikojnë në veprimet e ndërmarra nga rregullatorët financiarë, që këto veprime të tyre të jenë të orientuara nga industria bankare në aspektin e ofrimit të kushteve më të volitshme për ndërmarrjet dhe një qasje më të lehtë në financimin e tyre përmes kredive dhe që bankat komerciale të bëhen një faktor suksesi për këto biznese.

Për studiuesit, studimi do të përcaktojë efektin e kredive të bankave komerciale në zhvillimin e sektorit real. Ky hulumtim do të kontribuojë në diskutimin akademik mbi faktin nëse kredia është nxitës i rritjes ekonomike apo jo. Studiuesit e ardhshëm dhe studiues të tjerë do të përdorin gjetjet e këtij studimi në avancimin e diskutimeve të tjera akademike.

Për drejtuesit e bankave komerciale në rajon hulumtimi në fjalë do të ofrojë dëshmi të cilat do të vërtetojnë faktin nëse injektimi i kredisë në ekonominë e Kosovës sjell rritje ekonomike apo jo. Në rast se kreditë e bankave komerciale, sipas rezultateve të analizave tona, do të kenë ndikim të madh në rritjen ekonomike, atëherë ky do të jetë një kanal që ata mund ta përdorin jo vetëm për të rritur fitimin për institucionet e tyre, por edhe një kanal për nxitjen e rritjes ekonomike.

Për politikëbërësit ky hulumtim do të nxjerrë rezultate nëse huamarrjet e kredisë tregtare nxisin rritjen ekonomike. Nëse këto rezultate nuk janë ashtu si pritet ateherë kjo gjë, do të nxisë kureshtjen për të gjetur se si popullata e këtyre vendeve shpenzon shuma që ata huazojnë nga bankat ose se si kreditë kontribuojnë në rritje duke dalë kështume politika të përshtatura posaçërisht për mjedisin ekonomik rajonal.

1.8. Kufizimet e hulumtimit

Duke marrë në konsideratë se ky studim kryesisht përmban të dhëna sekondare, atëherë gjatë procesimit të të dhënave mund të hasim në vështirësi në përpunimin e këtyre të dhënave që përfshin seri më të mëdha kohore.

Si kufizim tjetër në kuadër të realizimit të këtij hulumtimi, do të theksoja vështirësitë në mbledhjen e të dhënave primare nëpërmjet pyetsorëve tek ndërmarrjet e sektorëve të ndryshëm në Kosovë, dhe kompleksitetin sistematik që e përcjell punën e grumbullimit të këtyre të dhënave.

1.9. Diskutime dhe gjetje empirike nga literatura

"Në mjedisin e lirisë ekonomike nuk falimentojnë bizneset, sistemi financiar edhe falimenton"!

Tony Blair

Institucionet financiare dallojnë nga firmat e tjera sepse vetëm një pjesë relativisht e vogël e aseteve në bilancet e tyre është reale. Kështu, ndikimi i drejtpërdrejtë i institucioneve financiare në ekonominë reale është relativisht i vogël. Por ajo që mbetet e rëndësishme është lidhja e tërthortë e institucioneve financiare dhe e performancës..

Sektori financiar mobilizon kursime dhe ndan kredi në hapësirë dhe kohë. Një sektor financiar eficient ul kostot e financimit dhe për pasojë uletedhe rreziku i prodhimit dhe tregtimit të mallrave dhe shërbimeve pa rentabiltet shtesë. Dy janë hipotezat që studiuesit adresojnë rreth ndërlidhjes dhe ndërmjetësimit financiar me aktivitetin e ekonomisë reale:

I. E para është nëse zhvillimi financiar ndikon në aktivitetin/investimet e ekonomisë reale.

II. E dyta është nëse struktura e sistemit financiar ndikohet nga rezultatet e ekonomisë reale (Ndikumana L. , 2003).

Hulumtimet empirike lidhur me këto hipoteza e sidomos me të parën janë zhvilluar gjerësisht. Duke u nisur nga teoria e rritjes ekonomike e Schumter dhe pikëpamja e tij, King and Levine (King & Levine, 1993) paraqitën prova, për të vërtetuar nëse hipoteza që sistemi financiar mund të nxisë rritjen ekonomike qëndron. Ata përdorën të dhënat nga 80 vende gjatë periudhës 1960-1989. Ky studim shqyrton nëse nivelet e ndryshme të zhvillimit financiar janë të lidhura fort me rritjen e PBB-në reale. Kjo lidhje e cila është e ndërsjelltë, është parë nga studiuesit si ndikim pozitiv ose si ndikim i pavarur dhe jo i qëndrueshëm.

Dëshmitë përgjithësisht mbështesin fuqishëm pikëpamjen se zhvillimi financiar ka efekt pozitiv mbi aspekte të ndryshme të aktivitetit të ekonomisë reale, përfshirë investimet (Ndikumana L. , 2001) në sektorë të ndryshëm. Të dhënat tregojnë se zgjerimi dhe thellimi i sistemit financiar çon në rritje më të shpejtë ekonomike. Deri në vitet e '90, ka patur relativisht pak studime empirike mbi ndikimin e strukturave financiare në aktivitetin ekonomik.

Historikisht, debati mbi rolin e strukturës së sistemit financiar mbi aktivitetin ekonomik sillej rreth studimeve krahasuese lidhur me avantazhet dhe diavantazhet e sistemit bankar kundrejt tregjeve kapitale. Trajtimet venë përballë zhvillimet në vendet që kanë sisteme financiare kryesisht të bazuara mbi bankat (Gjermani dhe Japoni) dhe ato që kanë sisteme të bazuara në tregjet kapitale (në Shtetet e Bashkuara dhe Anglia) (Allen & Gale, 1995).

Studimet e fundit kanë arritur në përfundimin se të dy sistemet si ato bankare ashtu edhe tregjet e aksioneve janë të rëndësishme për ecurinë ekonomike dhe se ato janë komplementare në efektin e sistemit financiar në ekonominë reale. Sistemet financiare nëpërmjet shërbimit të ndërmjetësimit luajnë rol në zbutjen e defekteve të tregut dhe duke ofruar shërbime kryesisht për sektorin privat rrisin performancën ekonomike (Merton & Bodie, 1995).

Sistemet financiare duke përmirësuar performancën ekonomike dhe duke nxitur mundësitë e investimeve sjellin rritje të vlerës së shtuar në sektorët e ekonomisë, duke lehtësuar menaxhimin e risqeve, ulur kostot dhe mobilizuar burimet (Levine, 1997). Roli i investitorit dhe kreditorit është vendimtar në përçimin e efektit që ekonomia reale ka tek sistemi financiar dhe ndikimit të anasjelltë që shprehet më drejtëpërdrejtë nga investimet.

Një sistem ligjor që zbaton në mënyrë efektive të drejtat e investitorëve, e bën sistemin financiar më efikas në ofrimin e shërbimeve për sektorin privat. Rrjedhimisht do kemi zhvillim të qëndrueshëm jo vetëm ligjërisht të sistemit financiar gjë që pritet të sjellë efekte pozitive edhe në ekonomi. Pra, rritje të prodhimit ekonomik (Porta, Silanes, Shleifer, & Robert, 2002). Ndërsa Herring dhe Santomero bënë analizën e lidhjes sistem financiar - ekonomi reale duke e filluar analizën e tyre nga një ekonomi pa sektorin financiar, për të vazhduar pastaj me përfshirjen e sektorit financiar në trajtën e thjeshtuar me transaksionet financiare të drejtpërdrejta midis kursimtarëve dhe investitorëve.

Kjo qasje thekson se sektori financiar mund të përmirësojë sasinë dhe cilësinë e investimeve dhe në këtë mënyrë rrit dhe të ardhurat e bizneseve (Herring & Santomero, 1995). Autorët gjithashtu konsiderojnë se tregjet financiare të efektshme kërkojnë edhe infrastrukturë ligjore të plotë dhe në harmoni me rregulloret ndërkombëtare pasi, kjo krijon besim tek sistemi financiar duke nxitur investimet.

Ndërmjetësimi financiar ndikon në investimet e brendshme sidomos me zbutjen e kufizimeve të financimit, duke lejuar për firmat rritjen e investimeve në përgjigje të rritjes së kërkesës për prodhim.

Por Ndikumana në studimin e tij empirik me një përfshirje prej 99 shtetesh në periudhën 1965-1997 (Ndikumana L. , 2003) arrriti në rezultatin që struktura e sistemit financiar ka efekt të pavarur të investimeve, në kuptimin se kjo nuk do të rrisë reagimin e investimeve ndaj ndryshimeve në lëvizje të fondeve, ndërsa zhvillimi financiar i bën investimet më të përgjegjshme për rritjen e prodhimit, pra reflektohet në ekonominë reale. Efekti mbi/në strukturën financiare u shqyrtua duke klasifikuar vendet në katër kategori në stade të ndryshme financiare, të ndara përkatësisht për vendet e zhvilluara dhe të pazhvilluara me sistem financiar mbi bazën e sistemit bankar dhe tregut kapital.

1.10. Rezultatet e pritura

Bazuar në përvojën e vendeve të tjera nërishikimin e literaturës dhe duke u bazuar edhe në rezultatet empirike të autorëve të tjerë, konstatojmë se sistemi bankar i një vendi ka rëndësi shumë të madhe në zhvillimin e sektorit real në kuadër të ekonomisë së një vendi.

Zhvillimi ekonomik nuk mund të ndodhë pa pasur një zhvillim të sektorit privat dhe bankat janë ato të cilat mund të ndihmojnë dhe po ndihmojnë këtë sektor. Legjislacioni i viteve të fundit dhe sistemi i përmbaruesve privat nga ata që përfaqësojnë sistemin bankar vlerësohet si një ndihmesë e madhe në kthimin më të shpejtë të kredive gjë e cila paraqet edhe njërën ndër sfidat e këtij sektori.

Prandaj në bazë të përfundimeve që kemi gjetur, japim propozimet apo rekomandimet e mëposhtme:

- Duke ditur se sektori real është shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik të një vendi, edhe procesi i financimit dhe kreditimit të këtij sektori kërkon një vëmendje më të madhe nga të gjithë akterët e sistemit financiar. Sektori real ka nevoja permanente për shfrytëzimin dhe përdorimin e kredive të llojeve të ndryshme. Bankat vendore dhe ato të huaja në Kosovë duhet të zbatojnë politika kreditore që ndihmojnë zgjerimin e aktivitetit ekonomik dhe që njëkohësisht sigurojnë kthime.

- Bankat komerciale duhet të ulin nivelin e kolateralit si kërkesë për kredi në nivelet mesatare të rajonit, si dhe të përmirësohen ofertat e kredive për biznese, në mënyrë që të mundësohet qasja më e lehtë në kredi për ndërmarrjet e sektorit real.

- Hartimi i politikave kreditore që ndihmon sektorin real të përballet me efektet e dështimit në treg dhe rregullimet e sektorit bankar duhet t'i njohin më shumë vështirësitë e financimit të sektorit real, si dhe të futen instrumente të përshtatshme ligjore dhe rregulluese, për t'iu mundësuar këtyre kompanive përdorimin e e aseteve si kolateral.

- Banka Qendrore e Kosovës duhet të përgatisë dhe implementojë një legjislaturë bankare adekuate dhe të përshtatshme, me qëllim të krijimit të një lloj fleksibiliteti dhe zbutjes së kritereve kreditore për kompanitë që dëshirojnë të shfrytëzojnë format e ndryshme kreditore për zhvillim të biznesit.

- Afatet kohore për kthimin e kredisë duhet të zgjatën, dhe njëkohësisht rekomandohet që bankat komerciale të aplikojnë politika kreditore më të arsyeshme, në mënyrë që kreditë bankare të ndihmojnë zhvillimin e biznesit e jo të bëhen pengesë e zhvillimit të tij.

2.11. Përmbledhje

Performanca e zhvillimit financiar dhe ndërmjetësimit financiar luan një rol kyç në aktivitetin ekonomik në të gjitha vendet, edhe në Kosovë dhe në vendet e tjera të rajonit. Lidhja mes sistemit bankar dhe ekonomisë reale, në këtë disertacion do të studiohet duke parë lidhjen dhe ndikimin e rritjes së sektorëve të ndryshëm të ekonomisë reale në sektorët e ndërmjetësimit financiar që përbëjnë strukturën e sistemit financiar.

Siç pritej bazuar në arsyetimin ekonomik dhe në literaturë sektorët e ekonomisë reale kanë ndikim të rëndësishëm në strukturën e sistemit financiar i cila përbën tërësinë e ndërmjetësimt financiar. Llojet e ndryshme të institucioneve financiare paraqesin lidhje të rëndësishme me sektorët që kanë si synim të veprimtarisë së tyre dhe që janë në natyrën e financimit që ato ofrojnë. Kjo tregon për një sistem financiar me përfitueshmëri dhe rentabilitet në rritje dhe një strukturë financiare që ka nisur rrugën e konsolidimit.

Sistemi bankar ndikohet pozitivisht pothuajse nga të gjithë sektorët e ekonomisë pasi dominon sistemin financiar. Financimi bankar ka destinacion shumicën e bizneseve sot në Kosovë dhe kjo për arsye se sistemi financiar ende nuk është i konsoliduar në përcaktimin e qartë të funksionit të secilit nga pjesët e tij. Por zhvillimi i sektorëve të caktuar ekonomik dhe rritja e nevojave të tyre financiare më shumë se kapaciteti i sektorëve financiar që i mbulojnë në financimet e tyre, i dikton sistemit financiar një stukturë, me stabilitet të ulët siç është rasti i Kosovës. Pavarësisht lidhjes së rëndësishme të studiuar, duhet theksuar që financimi dhe ndërmjetësimi financiar mbeten ende shumë të ulta krahasuar me financimin e brendshëm mes aktorëve të ekonomisë reale. Gjithashtu, informaliteti i ekonomisë ka ndikim në këtë lidhje të ndërsjelltë mes dy sektorëve duke rritur edhe termin e gabimit të modeleve.

KAPITULLI II

NDËRMJETËSIMI FINANCIAR, POLITIKAT KREDITORE DHE NDIKIMI I TYRE NË RRITJEN EKONOMIKE

Sektori financiar siguron fonde për ekonominë reale. Duke vepruar si ndërmjetës financiar, institucionet financiare luajnë një rol kyç në sektorin real të ekonomisë duke transformuar asetet, duke lehtësuar menaxhimin e rrezikut, duke financuar tregtinë dhe duke mundësuar akumulimin e kapitalit (Sawyer, 2014). Kjo rrjedh nga fakti se sektori financiar mundëson rrjedhën e aktiveve financiare të kursimtarëve të fundit në detyrimet e përdoruesve të fundit të fondeve financiare, si brenda ashtu edhe ndërmjet ekonomive kombëtare (Walter, 2002). Në kapitullin e dytë nëpërmjet rishikimit të literaturës do të analizojmë gjetjet e autorëve të ndryshëm në lidhje me politikat kreditore të bankave komerciale dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e sektorit real, si dhe aspekte tjera të teorike, të cilat do të shërbejnë për diskutimin e problemeve dhe çështjeve të parashtruara në këtë disertacion.

2.1. Ndërmjetësimi financiar dhe rritja ekonomike

Autori *Boyreau-Debray (2010)* në studimin e tij analizon marrëdhëniet midis rritjes ekonomike dhe ndërmjetësimit financiar në Kinë duke aplikuar kornizën tradicionale empirike në një panel të të dhënave, ku përfshihet metoda e serive kohore. Një numër studimesh kanë analizuar modelet e rritjes ekonomike në provincat kineze, me fokus në rolin e hapjes ekonomike, investimeve të huaja direkte dhe infrastrukturës. Ky autor në studimin e tij paraqiti rolin e ndërmjetësimit financiar në rritjen ekonomike të provincave kineze, edhe pse autorët e tjerë shumë pak e kanë analizuar ndikimin e ndërmjetësimit financiar në zhvillimin ekonomik të këtij shteti, gjë që është e habitshme duke marrë parasysh rëndësinë në aspektin e ndikimeve të politikave ekonomike dhe sfidave të paraqitura nga rritja e konkurrencës në sektorin financiar që do të ndjekë pranimin e Kinës në Organizatën Botërore të Tregtisë. Hansen, McPherson dhe Waller (2000) tregojnë se edhe në një ekonomi të zhvilluar financiarisht si janë bankat lokale të Shteteve të Bashkuara ndikojnë në ecurinë e ekonomisë lokale (Hanson, 2000).

Për të matur ndikimin e ndërmjetësimit financiar në rritjen ekonomike të Kinës, autori Boyreau-Debray ka paraqitur si variabël të varur prodhimin e brendshëm bruto, ndërsa si variabla të pavarura, ose indikatorë të rëndësishëm që ndikojnë në rritjen ekonomike janë: raporti i totalit të depozitave të sistemit

bankar ndaj PBB-së, raporti i kredive totale ndaj prodhimit të brendshëm bruto, raporti i kredive me depozitat e sektorit bankar, koncetrimi i depozitave bankare (Indeksi Herfindahl), shkalla e investimeve (raporti i investimeve fikse ndaj PBB-së, investimet e huaja direkte, shkollimin e popullsisë dhe prodhimin jo-shtetëror).

Rezultatet e këtij studimi konsistojnë në faktin se për shkak të fragmentimit të tregut të kapitaleve, pabarazia në zhvillimin bankar është një faktor i rëndësishëm në ecurinë ekonomike vendore. Autori konkludon se zhvillimi financiar i Kinës, nuk kontribuon në ecurinë ekonomike vendase, siç tregohet nga pamjaftueshmëria e raportit të depozitave ndaj PBB-së. Rezultatet empirike të këtij studimi përcaktojnë ndikimin negativ të kredisë së bankave shtetërore në performancën financiare të bizneseve. Pra, kur kontrollohet madhësia e korporatave shtetërore në ekonominë vendore, ndikimi negativ i bankave shtetërore në rritjen ekonomike zvoglohet në masë të madhe. Ky studim sugjeron që përmirësimi i performancës së bankës shtetërore dhe rritja e shpërndarjes së burimeve financiare do të kërkonte reformimin e sektorit të korporatave shtetërore dhe përmirësimin e klimës ekonomike në nivel lokal (Boyreau-Debray, 2010).

Sektori financiar kontribuon në rritjen ekonomike nëpërmjet pesë kanaleve kryesore: (1) lehtësimin e tregtimit, mbrojtjes, diversifikimit dhe menaxhimin e rrezikut; (2) ndarjen e burimeve; (3) monitorimin e menaxherëve dhe ushtrimin e kontrollit në korporata; (4) mobilizimin e kursimeve; dhe (5) lehtësimin e shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve (Levine, 1997). Treguesi i parë, zakonisht i përdorur si raport që tregon nivelin e zhvillimit financiar, është herësi i detyrimeve të likuiditetit ndaj PBB-së, duke përfshirë valutën dhe depozitat me interes të bankave dhe ndërmjetësve të tjerë financiarë jobankar. Supozimi themelor është se cilësia e shërbimeve financiare është e lidhur pozitivisht me madhësinë e sektorit të ndërmjetësimit financiar.

Treguesi i dytë i ndërmjetësimit financiar është raporti i aktiveve të bankave komerciale me aktivet e bankave tregtare dhe të bankave qendrore. Ky raport mat shkallën në të cilën bankat komerciale kundrejt bankës qendrore ndajnë kursimet e shoqërisë dhe supozon në mënyrë implicite se bankat kryejnë më mirë se banka qendrore procesin e alokimit dhe shpërndarjes së burimeve financiare. Indikatori i tretë dhe i fundit i ndërmjetësimit financiar është raporti i kredisë së dhënë nga ndërmjetësuesit financiarë në sektorin privat ndaj PBB-së, në krahasim me qeveritë, agjencitë qeveritare dhe ndërmarrjet publike. Pra, kjo nënkupton se sistemet financiare që japin më shumë kredi për firmat private janë më të angazhuara në kërkimin e firmave, duke ushtruar kontroll, duke ofruar shërbime të menaxhimit të rrezikut, duke

mobilizuar kursime dhe duke lehtësuar transaksionet. Përderisa sistemet e tjera financiare që nuk janë shumë të fokusuara në kreditimin e sektorit real, thjesht japin kredi për qeverinë ose ndërmarrjet shtetërore (Beck, 2000).

Sektori financiar siguron fonde për ekonominë reale. Duke vepruar si ndërmjetës financiarë, institucionet financiare luajnë një rol kyç në sektorin real të ekonomisë duke transformuar asetet, duke lehtësuar menaxhimin e rrezikut, duke financuar tregtinë dhe duke mundësuar akumulimin e kapitalit (Saëyer 2014). Kjo rrjedh nga fakti se sektori financiar mundëson rrjedhën e aktiveve financiare të kursimtarëve të fundit në detyrimet e përdoruesve të fundit të fondeve financiare, si brenda ashtu edhe ndërmjet ekonomive kombëtare (Ëalter 2002).

Analiza e ndikimit të sektorit financiar në sektorin real të ekonomisë mund të bëhet në dy dimensione: pronësia shtetërore ose publike kundrejt pronësisë private dhe pronësia e huaj kundrejt asaj vendase. Edhe pse financimi i sektorit real të ekonomisë është zhvilluar në mbarë botën, pronësia qeveritare e institucioneve financiare mbetet mbizotëruese në shumë vende. Ka dy motive kryesore për praninë e vazhdueshme të shtetit në sektorin financiar. Këto janë të ashtuquajtura pikëpamje politike dhe zhvillimore. Sipas pikëpamjes politike, pronësia shtetërore e institucioneve financiare udhëhiqet nga motive politike.

Nga ana tjetër, mbështetësit e pikëpamjes zhvillimore theksojnë se pronësia shtetërore e institucioneve financiare i përgjigjet mangësive institucionale. Duke marrë parasysh financimin e nevojave të sektorit real, mund të supozohet se struktura e pronësisë së institucioneve shtetërore bën që bankat komerciale të japin kredi për klientët që do të përjashtoheshin nga ndërmarrjet më të mëdha private. Prania e bankave të interesuara mund të nxisë disa eksternalitete në sektorin bankar, duke rritur intensitetin e konkurrencës midis palëve të interesuara dhe aksionarëve dhe duke çuar në rritjen e nivelit të rrezikut bankar. Nëse analizohen ndikimet e pronësisë së huaj, shpesh supozohet se pronësia e huaj rezulton në një ndikim pozitiv në efikasitetin dhe stabilitetin e sektorit financiar.

Sidoqoftë, dominimi i pronësisë së huaj në sektorin financiar mund të ketë pasoja negative. Institucionet e huaja financiare mund të importojnë efekte negative nga vendet e tyre dhe përhapin goditje nga vendet e tjera në të cilat ata veprojnë. Pra, bankat me pronësi të huaj reagojnë jo vetëm ndaj ndryshimeve në ekonominë e vendit pritës ("faktori i tërheqjes"), por edhe ndaj ndryshimeve në vendin e origjinës të institucionit amë ("faktor shtytës").

Në Evropë, bankat komerciale dhe ndërmjetësit e tjerë financiarë kreditojnë ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet brenda intervalit 70-75% të financimit të borxhit. Në një model të tillë "bankar", në krahasim me modelin "bazuar në tregjet e kapitalit", dominojnë më shumë bankat universale, të cilat ofrojnë të gjitha llojet e shërbimeve financiare. Ky model mbizotëron në të gjitha vendet e e BE-së, përveç Mbretërisë së Bashkuar.

Megjithatë, duhet të theksohet se sektori bankar në shumë vende evropiane nuk është në përputhje me modelin e pastër "bankar", pasi vetëm disa institucione kreditore kryejnë të gjitha aktivitetet bankare. Pra, sektori bankar është i organizuar sipas modelit të diversifikuar, i definuar si një kombinim i shumë aktiviteteve bankare, duke u fokusuar në tregje financiare dhe tek klientët. Bankat e shumëllojshme mbështeten në raporte të forta të klientëve dhe burime më të qëndrueshme të financimit. Kjo nënkupton, se këto banka konsiderohen ofrues të qëndrueshëm të kredisë për sektorin real të ekonomisë, më pak të varur nga shumica e financimeve të tjera dhe më pak të prirur ndaj goditjeve të likuiditetit.

Sektori bankar i BE-së dominohet nga institucionet e brendshme kreditore, të cilat kontrollojnë më shumë se 70% të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Vetëm 30% e totalit të aktiveve të mbetura kontrollohen nga filialet jo-vendase dhe degët e institucioneve kreditore. Veçanërisht niveli i lartë i bankave me kapital të huaj është vërejtur në vendet e reja anëtare të BE-së, duke ngritur dilema në lidhje me nivelin e përqendrimit dhe konkurrencës. Në Hungari dhe Poloni pesë bankat më të mëdha në sektorin bankar të këtyre vendeve janë të gjitha të kontrolluara nga akterë të jashtëm.

Në Republikën Çeke, pesë bankat më të mëdha janë në pronësi të huaj. Si rezultat, shpërthimi i krizës financiare globale tregoi se sektorët bankarë të vendeve të reja anëtare të BE-së ishin të ndjeshme për shkak të niveleve të larta të bankave me pronësi të huaj. Politikëbërësit dhe Bankat Qendrore në këto vende ngritën shqetësime në lidhje me faktin se bankat me pronësi të huaj, pavarësisht interesit të tyre afatgjatë të deklaruar në rajon, do të kërkonin t'i reduktonin humbjet dhe të ndërprejnë aktivitetin e tyre në sektorët bankar të këtyre vendeve.

Trendi i rritjes së totalit të aktiveve të institucioneve kreditore u ndërpre në gjysmën e dytë të vitit 2008 dhe tendenca u ndal në shumë vende gjatë vitit 2009. Sipas studimit të realizuar nga autori Jurek (2017), i cili ka analizuar ritmin më të shpejtë të rritjes së aktiveve në vitin 2012 për vendet e BE-së, dhe kjo rritje me e shpejtë u regjistrua në Suedi, Poloni, Mbretërinë e Bashkuar dhe në Francë. Në fakt, Hungaria regjistroi rënien më të thellë në bazën e aktiveve. Në bazë të studimeve të këtij autori, mund të

vërehet se shkalla e financimit në sektorin bankar, e matur si një pjesë e aktiveve të saj në PBB-në, ka rënë në vendet si Gjermania dhe Franca që nga shpërthimi i krizës financiare globale.

Bankingu është vendimtar për çdo ekonomi tregu që lejon transferimin e fondeve nga kursimtarët tek huamarrësit. Ato sigurojnë shërbime financiare të domosdoshme për individët dhe firmat, lehtësimin e pagesave dhe transaksioneve financiare, duke mundësuar investime dhe duke ndihmuar bizneset në menaxhimin e rreziqeve financiare, duke ofruar shërbime përtej kredive të zakonshme, siç janë pagesat, menaxhimi i parasë, lizingu dhe faktoringu. Bankat gjithashtu ndërmjetësojnë në mes furnizuesve dhe përdoruesve të kapitalit në treg, duke ndërmarrë një transformim maturimi duke mbledhur depozitat afatshkurtra dhe dhënien e kredive afatgjata nëpërmjet transformimit të maturitetit. (Carletti & Hartmann & Spagnolo, 2002).

Në këtë mënyrë ato nxisin zhvillimin ekonomik, vlerësojnë kredibilitetin e huamarrësve dhe i mbikëqyrin ato për të siguruar që huamarrësit të përmbushin detyrimet e tyre. Në veçanti, bankat komerciale kontrollojnë asimetrinë e informacionit ndërmjet investitorëve dhe huamarrësve. Pra, këto institucione janë ndërmjetëse për të balancuar kërkesën dhe furnizimin e fondeve financiare, edhe pse sektori bankar evropian është relativisht i brendshëm në krahasim me sektorët e tjerë dhe është përqendruar në tregun e brendshëm (European Banking Federation 2007, 2012b).

2.2. Ndikimi i bankave komerciale në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë

Roli kritik i institucioneve financiare në drejtim të rritjes dhe zhvillimit të ekonomisë nuk mund të theksohet shumë. Për një rritje të qëndrueshme në çdo ekonomi të caktuar, burimet financiare duhet të mobilizohen në mënyrë efektive dhe efikase dhe të alokohen në mënyrë të tillë që të shfrytëzojnë sinergjitë midis burimeve njerëzore, materiale dhe menaxheriale për prodhim optimal ekonomik. Shumë studime të autorëve të ndryshëm kanë evidentuar se bankat nuk mund të vendosin gjithmonë norma të larta interesi. Bankat duhet të marrin në konsideratë problemet e përzgjedhjes negative dhe të riskut moral, meqenëse është shumë e vështirë të parashikohet lloji i huamarrësit në fillim të marrëdhënies kreditore (Stiglitz, 1981).

Ideja që zhvillimi i sektorit financiar stimulon rritjen ekonomike daton nga Adami Smith (1776), i cili vuri në dukje se "tregtia dhe industria ... u rritën në mënyrë të konsiderueshme" sapo u krijuan bankat e para në Skoci dhe "se bankat kanë kontribuar shumë mirë në këtë rritje ekonomike, nuk mund të dyshohet ". Po ashtu, Ëalter Bagehot (1873) dhe Joseph Schumpeter (1912) theksuan një lidhje

pozitive midis zhvillimit financiar dhe aktivitetit ekonomik. Duke u frymëzuar nga veprat e Goldsmith (1969), i cili ishte i pari që krijoi një korrelacion pozitiv midis sektorit bankar dhe PBB-së për kokë banori, si dhe McKinnon (1973) dhe Shaë (1973), një numër i madh studimesh empirike kanë hulumtuar marrëdhënien midis sektorit bankar dhe rritjes ekonomike (McKinnon, 1973).

Arcand et al. (2015) zbulon se raporti i financimit dhe rritjes ekonomike rezulton negativ për vendet me të ardhura të larta, me një vlerë prej 110% kredi private ndaj PBB-së dhe marrëdhëniet negative midis sektorit financiar dhe rritjes ekonomike janë të rëndësishme në nivelin 150% të kredisë private ndaj PBB-së. Nëse bankat i vendosin normat e interesit shumë të larta, ato mund të nxisin probleme të përzgjedhjes negative, sepse huamarrësit me rrezik të lartë janë të gatshëm të pranojnë këto norma të larta të interesit në kredi. Këta huamarrës pasi marri kredi, ekziston mundësia e një sjelljeje të rrezikshme morale ose të ashtuquajturat dëmi moral i huamarrësit, pasi kanë gjasa të mëdha të marrin projekte ose investime shumë të rrezikshme (Chodechai, 2004). Duke u bazuar në argumentet teorike të autorëve Stiglitz dhe Ëeiss, është e zakonshme që në disa raste nuk mund të zbulojmë se norma e interesit e vendosur nga bankat është në përpjesëtim me rrezikun e huamarrësve.

Obamuyi, Edun & Kayode (2010) pohojnë se ka lidhje të ngushtë midis kreditimit të bankave tregtare dhe prodhimit ekonomik. Kjo është për shkak se, zakonisht, kreditimi rrit më shumë investimet në mallra dhe në ofrimin e shërbimeve të cilat logjikisht do të rrisnin PBB-në e një vendi. Në të kundërtën, kreditimi i reduktuar i bankave komerciale do të reduktonte investimet në prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve dhe do të ndikonte në zvogëlimin e PBB-së. Ky raport përmbledh një marrëdhënie pozitive midis kreditimit të bankave komerciale dhe rritjes ekonomike. Përkundrazi, një studim i *Louzis, Vouldis & Metaxas (2010)* tregoi se kreditimi nuk ndikon në mënyrë automatike në rritjen ekonomike. Kontekstet brenda të cilave jepen kreditë janë një faktor kontribues për efektin e kreditimit në rritjen ekonomike. Ky raport ishte influencuar nga menaxhimi i kredive si nga bankat komerciale ashtu edhe nga huamarrësit.

Studimi i *Borio dhe Zhu (2007)*, pohon se sjellja pro-ciklike e vlerësimeve të probabilitetit të kredisë shpesh jep një masë të rrezikut të menjëhershëm në mjedisin e biznesit. Ata studiojnë ndikimin e mjedisit të biznesit në zgjerimin e kredisë dhe konstatojnë se humbja mund t'i atribuohet rreziqeve të paparashikuara të mjedisit të biznesit. Ndryshimet e paparashikuara në politikën monetare që ndikojnë gjithashtu në çmimet e aksioneve gjithashtu mund të ndikojnë në perceptimet e rrezikut dhe gatishmërinë e sektorit privat për të përballuar rreziqet, duke e bërë mjedisin e biznesit të rrezikojë të

jetë shumë i varur nga politika monetare e vendit. Politika monetare mund të ketë rezultate të forta për kreditë komerciale pasi që normat e interesit të bankave ka gjasa të jenë më të larta në mjediset e biznesit me nivel më të lartë të rrezikut. Bizneset e sektorit privat ka të ngjarë që gjithashtu të jenë më të rrezikuara ndaj huamarrjes nëse normat e interesit janë të larta pasi kjo mund të zvogëlojë limitet e fitimit (Kuttner, 2005).

Studimet nga autori Jiménez et al. (2006, 2007) gjithashtu studiojnë sjelljen e kreditimit të bankave evropiane dhe konstaton se bankat spanjolle japin kredi më të rrezikshme dhe reduktojnë standardet e kreditimit në nivele më të ulëta të normave të interesit. Gjithashtu, autori Altunbas et al. (2009a) në studimin e tyre zbulojnë se bankat janë në gjendje të ofrojnë norma më të mira interesi dhe kredi më të mëdha në mjedise më pak të rrezikshme me probabilitet minimal të vonesës. Këto studime gjejnë prova empirike se shtrëngimi i politikës monetare gjithashtu ka gjasa të ndikojë në rentabilitetin e bankave pasi kjo do të ndikojë në kurbën e yield-it bankar, nëpërmjet rritjes së normave të interesit që çon në uljen e kredisë dhe kthimin më të ulët të kapitalit të huazuar (Jimenez, 2008).

Teoria e shumëfishimit të huave - Në literaturë është gjetur se bankat duhet të jenë më pak të prirura për të shpërndarë huadhënien në prani të tregjeve të kapitalit. Si tregjet e kapitalit ashtu edhe fuzionimi i bizneseve rrisin kapacitetet kreditore të bankave, duke zvogëluar kështu nevojën e diversifikimit dhe monitorimit më të madh nëpërmjet kreditimit të aksioneve (Carletti, 2005).

Argumenti sinjalizues thotë se kompanitë me performancë të mirë duhet të ofrojnë më shumë kolateral në mënyrë që ato të mund të sinjalizojnë bankat se janë më pak huamarrës të tipit A (nivel i lartë i rrezikut kreditor) dhe më pas këta huamarrës janë të ngarkuar me norma më të ulta interesi (Chodechai, 2004).

Një **model i tregut kreditor (neoklasik)** përcakton se kushtet e kredive determinohen në treg. Nëse kolaterali dhe kufizimet e tjera mbeten konstante dhe norma e interesit është mekanizmi i vetëm i çmimeve. Me një kërkesë në rritje të kreditimit dhe me një furnizim të caktuar të konsumatorëve, norma e interesit rritet, dhe anasjelltas. Kështu besohet se sa më i lartë të jetë rreziku i dështimit të huamarrësit, aq më e lartë është norma e interesit (Szczesny, 2000).

Duke u bazuar në studimet e shumta në lidhje me ndikimin e bankave komerciale në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë, sipas pikëpamjes së Nëankëo (2000), *"kredia përbën aktivet më të mëdha me të ardhura më të larta në portofolin e shumicës së bankave. Kjo shpjegon pse bankat shpenzojnë burime*

të mëdha për të vlerësuar, monitoruar dhe menaxhuar cilësinë e kredisë ". Logjikisht, kjo praktikë ndikon në masë të madhe në sjelljen e kreditimit të bankave, pasi që ato janë të përfshira në burime të mëdha.

Autori Chodechai (2004), në studimet e tij të mëtejme identifikoi faktorët determinues që ndikojnë në normat e interesit, shkallën e vëllimit të huadhënies dhe vendosjen e kolateralit në vendimin e kredisë të bankave, që janë: *"Bankat duhet të jenë të kujdesshme në vendimet e tyre në lidhje me çmimin e huadhënies, pasi bankat nuk mund të ngarkojnë normat e kredisë që janë shumë të ulëta, sepse të ardhurat nga interesi nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar koston e depozitave, shpenzimet e përgjithshme dhe humbjen e të ardhurave nga disa huamarrës që nuk paguajnë. Për më tepër, ngarkimi i normave të larta të kredisë mund të krijojë gjithashtu një situatë të përzgjdhjës negative dhe probleme të rrezikut moral për huamarrësit".*

Një teori shumë e njohur mbi ndikimin e kreditimit bankar në zhvillimin ekonomik, është edhe teoria e një ekonomisti të njohur suedez i quajtur *Knut Ëicksell* në vitin 1901. Kjo teori është ndikuar në masë të madhe nga *teoria e sasisë së parasë*. Ëicksell e bazoi teorinë e tij duke krahasuar produktin margjinal të kapitalit me koston e huamarrjes së parave. Prandaj, teoria e Ëicksell mori qasje monetare për rritjen ekonomike.

Ëicksell (1901) argumentoi se nëse norma e interesit në kredi është nën normën e kthimit në kapital, sipërmarrësit do të merrnin hua me normën e parasë për të blerë mallra kapitale. Kjo do të çonte në rritjen e kërkesës për të gjitha llojet e burimeve dhe, nga ana tjetër, do të ndikojë edhe në çmimet e tyre. Në anën tjetër, nëse norma e interesit në kredi është mbi nivelin e kthimit në kapital, sipërmarrësit do të shisnin mallrat kapitale dhe do të mbanin më shumë mjete monetare. Kjo do të çonte në një kërkesë më të lartë për para dhe nga ana e kostos së huamarrjes. Ëicksell e lidhi normën e interesit me hendekun e prodhimit. Hendeku i prodhimit përfaqëson ndryshimin midis asaj që duhet të prodhohet dhe asaj që prodhohet (Ëeise, 2006).

Burnside dhe Dollar (2000) gjithashtu studiojnë efektin e politikës ekonomike mbi rritjen ekonomike dhe konstatojnë se kjo politikë mund të shërbejë si zëvendësues i mirë për ndihmën e huaj dhe ka pasur efekt të rëndësishëm në rritjen ekonomike. Marrëdhënia e kreditimit komercial dhe rritjes ekonomike është ajo në të cilën kreditimi do të ndikojë në rritje nëpërmjet politikës monetare specifike të vendit. Kjo politikë monetare do të ndikojë pozitivisht ndikim në zhvillimin e sektorin real, meqenëse rritja e

kredisë nga bankat ka gjasa të stimulojë rritjen e udhëhequr nga sektori real në ekonominë e një vendi (Burnside & Dollar, 2000).

Studimi i autorëve Nëakoby& Ananëude (2016) përgjithësisht pranoi faktin se intensifikimi i instrumenteve financiare dhe institucioneve do të reduktonte jashtëzakonisht kostot e transaksioneve dhe informacionit në një ekonomi e cila ndikon në normën e interesit në kursime, vendimet e investimeve dhe ndërmarrjet inovative - teknologjike. Kapaciteti i bankave komerciale për të siguruar financime (të ardhura të brendshme) potencialisht të pakufizuara jashtë kursimeve të ekonomive familjare dhe korporatave, siguron bazë për zgjerimin gjithnjë e më të gjerë të veprimtarive ndërmarrëse produktive, duke shkaktuar barriera të mëdha në procesin e rritjes ekonomike të një vendi (Nëakanma & Nnamdi & Omojefe, 2014).

Niveli i kredisë në një ekonomi ka kapacitetin e rritjes së konsumit, gjë që çon në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në rritjen e prodhimit të brendshëm bruto. Kur burimet prodhuese blihen nëpërmjet fondeve, nxitet zhvillimi ekonomik dhe rritja e të ardhurave kombëtare. Krijimi i kredisë nëpërmjet aktiviteteve të bankave komerciale ndihmon në rritjen e çmimit të aksioneve të zakonshme, pra një rritje në vlerën e firmave.

2.3. Zhvillimi i ndërmjetësimit financiar dhe efektet në performacën e sektorit real të ekonomisë

Duke u bazuar në analizimin e modeleve të shumta teorike shohim se në këto modele agjentët ekonomikë mund të formojnë ndërmjetës financiar për të reduktuar kostot e marrjes së informacionit dhe kryerjen e transaksioneve financiare. Më konkretisht, ndërmjetësit financiarë ndikojnë në uljen e kostove për kërkime në lidhje me investimet e mundshme, duke ushtruar rregulla strikte në kontrollin financiar të korporatave, menaxhimin e rrezikut dhe mobilizimin e kursimeve (Arellano, Manuel, and Bover, Olympia, 1995).

Teoria më tutje sugjeron që, duke ofruar këto shërbime për ekonominë, ndërmjetësit financiarë ndikojnë në vendimet e kursimeve dhe alokimit në mënyra që mund të ndryshojnë normat e rritjes afatgjatë. Teoria moderne ekonomike ofron një kornizë intelektuale për të kuptuar se si vendet me ndërmjetësues "më të mirë" financiarë janë më të specializuar në marrjen e informacionit, ushtrimin e kontrollit të korporatave, menaxhimin e rrezikut dhe mobilizimin e kursimeve. Ky faktor do të ndikojë

në zhvillimin ekonomik më të shpejtë për ato vende që kanë sistem më të qëndrueshëm financiar se vendet me sistemet më pak të zhvilluara financiare.

Bankat luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Në vazhdim do të paraqesim në disa pika kryesore rolin e caktuar të bankave si ndërmjetës financiar (Role of Financial Intermediaries in Economic Development, 2018).

- **Programi i vetëpunësimit:** Rritja e punësimit është një element shumë i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik. Ndërmjetësit financiarë, duke siguruar financim për fillimin e programeve të vetëpunësimit, po gjenerojnë më shumë prodhim dhe të ardhura në vende të ndryshme. Rasti konkret, p.sh. në Indi, pas shtetëzimit të bankave tregtare, një numër programesh janë iniciuar nga bankat për skemat e vetëpunësimit.

- **Programet e zhvillimit të ndërmarrësisë (EDPs):** janë zhvilluar me sukses nga banka të ndryshme. Fillimisht nëpërmjet skemës së Bankës Botërore, bankat e tjera po zhvillonin programe me mundësi punësimi në nivel lokal. Më vonë, *Qasja në Zonën e Shërbimit* u miratua në vitin 1978, me anë të së cilës disa banka të veçanta iu dhanë të drejtën bankave të tjera për aplikimin e programeve të ndryshme ekonomike për zhvillimin e këtyre zonave lokale.

- **Skema e integruar e zhvillimit rural:** Në këtë skemë, ndërmjetësit financiarë financonin komunitetin në mënyrë shoqërore dhe ekonomike, duke u dhënë atyre hua për aktivitete të ndryshme ekonomike. Një e treta e kredisë do të jetë një subvencion dhe dy të tretat e mbetura të kredisë do të mbajnë një normë më të ulët interesi në krahasim me skemën e subvencioneve. Në këtë mënyrë, bankat aplikuan programe të ndryshme ekonomike që synonin përmirësimin e kushteve ekonomike rurale.

- **Financimi i strehimit:** Si pjesë e përmirësimit të shtëpive të banimit, ndërmjetësit financiarë vazhdimisht po ofrojnë kredi për strehim. Këta ndërmjetës gjithashtu ofrojnë lehtësira të ndryshme financiare për ndërtimin e shtëpive të banimit, shërbime të tilla i ofrojnë agjencitë si p.sh. HUDCO (Housing and Urban Development Corporation). **Sektori prioritar:** Bankat komerciale duhet të ofrojnë një përqindje të caktuar të huadhënies së tyre ndaj sektorit prioritar i cili përbëhet nga bujqësia dhe aktivitetet e lidhura me të, si p.sh. industritë e vogla (një aktivitet biznesi ose prodhimi që kryhet në shtëpinë e një personi) etj.

- **Zhvillimi i zonës së prapambetur:** Me qëllim të parandalimit të pabarazive rajonale, ndërmjetësit financiarë japin kredi për industritë që kanë filluar aktivitetin e tyre në zonat e prapambetura. Qeveria ka miratuar disa lehtësime në formën e përfitimeve tatimore për industri të tilla dhe bankat ofrojnë kredi me kosto më të ulëta, në mënyrë që zonat e prapambetura të mund të tërheqin më shumë industri.

- **Prezantimi i sistemit elektronik:** Teknologjia informative është duke u përdorur nga ndërmjetësit financiarë për shumicën e aktiviteteve të tyre dhe tani këto institucione financiare janë në gjendje të lidhin degët e tyre nëpërmjet një rrjeti. Kjo ka rezultuar në transferimin më të shpejtë të fondeve në mes të qendrave dhe kjo ka ndihmuar klientët në realizimin e kontrolleve të tyre në një mënyrë të shpejtë.

Autori Fry (1995) në studimet e tij zbulon se efikasiteti i performancës së ndërmjetësve financiarë matet nëpërmjet kostove të ndërmjetësimit financiar për kanalizimin e fondeve nga huadhënësit origjinalë tek huamarrësit përfundimtarë. Ky autor konkludon se performanca e institucioneve financiare në shumë vende në zhvillim është joefikase për shkak të menaxhimit të dobët, ndërhyrjeve të qeverisë, delikuencës së lartë etj. Liberalizimi financiar dhe zhvillimi financiar do të rrisin efikasitetin e ndërmjetësve financiarë dhe do të ndihmojnë në nxitjen e zhvillimit ekonomik nëpërmjet ndërmjetësimit financiar. Në këtë studim ky autor konkludon se kapitali efektiv shënoi rritje të ndjeshme kur rriteshin normat reale të interesit në depozita (Fry, 1995).

Pagano (1993) shpjegon tre kanale nëpërmjet të cilave zhvillimi financiar mund të ndikojë në ecurinë ekonomike. Para së gjithash, ndërmjetësit financiarë përmirësojnë efikasitetin e investimeve. Së dyti, sistemet efikase financiare ulin kostot e transaksionit dhe si rezultat rritin kursimet. Së treti, zhvillimi i sektorit financiar mund të rrisë ose ulë kursimet (Pagano, 1993).

Duke shqyrtuar dhe monitoruar investimet më produktive, ndërmjetësit financiarë rrisin produktivitetin nëpërmjet ndarjes së rrezikut dhe minimizimit të rrezikut. Saint-Paul (1992) vëren se përmirësimi i produktivitetit mund të ndodhë si rezultat i specializimit të prodhuesve, pra ky specializim shoqërohet me një nivel të lartë të rrezikut, ku ndërmjetësit financiarë nëpërmjet teknikave të ndryshme zbusin rreziqet duke diversifikuar dhe ndarë këto rreziqe midis investitorëve (Acemoglu, 1997).

Harris (1988) në studimet e tij analizon rastin e reformave financiare koreane në vitin 1965, megjithatë, sipas këtiij autori, në këtë rast mund të krijohet një mekanizëm efikas për alokimin e

kredive, nëse liberalizimi financiar ndodh, por jo tërësisht i mjaftueshëm. Efikasiteti i ndarjes së kredisë në Kore gjatë periudhës 1972-1984 dëshmon se politika e liberalizimit financiar në vitet 1980 ka reduktuar ndjeshëm divergjencën e kostove të huamarrjes (Cho, 1988).

Benhabib dhe Spiegel (2000) gjithashtu konfirmojnë hipotezën se ndërmjetësit financiarë mbështesin rritjen ekonomike duke rritur produktivitetin e përgjithshëm të faktorëve. King dhe Levine (1993) argumentojnë se përveç rritjes së efikasitetit, institucionet financiare gjithashtu nxisin rritjen ekonomike nëpërmjet akumulimit të kapitalit. Zhvillimi i rrjeteve të shërbimeve financiare, tregjeve financiare dhe instrumenteve janë të domosdoshme për transformimin e kursimeve në investime për rritje ekonomike (Montiel, 1995).

Ruehl (1988) në studimet e tij argumenton se sistemi financiar shumë i rregulluar i karakterizuar nga normat e ulëta të interesit dhe racionimi i kredisë ende rezultojnë në "mrekullinë japoneze" për dy dekada me ritme të larta të rritjes ekonomike nga viti 1953-1973. Trazirat e sistemeve bankare aziatike, veçanërisht rënia e sistemit bankar korean, janë leksione të mira për të gjitha vendet e zhvilluara botërore. Vlerësimi i dobët i kredisë dhe menaxhimi i pafavorshëm i rrezikut në sistemin bankar korean, megjithatë, kërkon një sistem financiar shumë të rregulluar për të promovuar dhe ruajtur kujdesin dhe qëndrueshmërinë e ndërmjetësve financiarë (Ramos, 1997).

Duke aplikuar metodën GMM (Generalised method of moments) me të dhënat e panelit dinamik, autorët Petkovski dhe Kjosevski (2014) në studimin e tyre analizuan 16 ekonomi në tranzicion nga Europa Qendrore dhe Juglindore dhe konstatuan se sektori bankar ndikon në rritjen ekonomike, veçanërisht raporti i sasisë monetare (RQM) është pozitivisht i lidhur me rritjen ekonomike (Petkovski & Kjosevski, 2014).

2.4. Financimi i sektorit real

Pas krizës ekonomike dhe financiare, politikat ekonomike u fokusuan më shumë drejt reformave strukturore për të mbështetur procesin e rimëkëmbjes ekonomike, të drejtuar në nivel të Bashkimit Evropian nëpërmjet qeverisjes së përforcuar ekonomike. Financimi i sektorit real sigurohet më së miri nga bankat dhe jo nga tregjet e kapitalit, pasi bankat kanë depozita që mund të transformohen në huadhënie adekuate, si dhe në kontakt me komunitetet lokale. Për të lejuar që kreditimi të mbetet në nivele adekuate, aktivitetet e huadhënies bankare nuk duhet të penalizohen nga rregulloret e ardhshme kur ekonomia të rimëkëmbet.

Kërkesat e Basel III, në veçanti rregullat e likuiditetit, do të kufizonin kapacitetet kreditore të bankave të BE-së, duke goditur ndërmarrjet e sektorit real që mund të mos kenë qasje të lehtë në burime të tjera të financimit (Capital Markets & SMEs). Sipas disa raporteve të ndryshme hulumtuese, ka shenja inkurajuese që Evropa po shkon drejt rikthimit ekonomik por projektet e rritjes janë modeste dhe reformat e mëtejme mbeten të nevojshme për të rikthyer produktivitetin dhe për të arritur objektivat e Evropës 2020. Prioritetet për BE përfshijnë, ndër të tjera, rivendosjen e kreditimit normal për ekonominë dhe nxitjen e rritjes dhe konkurrencës për sot dhe nesër.

Së pari, duhet analizuar se sa burime prodhuese janë shpërndarë brenda sektorëve, me një fokus të veçantë në rolin e hyrjes dhe daljes në treg dhe ndikimin e mundshëm të kufizimeve kreditore si pengesë për alokimin e burimeve. Sipas Schumpeter, krijimi i firmave të reja inovative sfidon ndërmarrjet ekzistuese. Firmat më produktive zgjerojnë aksionet e tyre të tregut dhe tërheqin burime në formën e njerëzve, njohurive dhe kapitalit në kurriz të atyre që janë më pak produktivë. Investimet e nevojshme për të filluar dhe zgjeruar një biznes shpesh financohen nga fonde të jashtme. Kjo kërkon tregje financiare funksionale në kuptimin që burimet e reja janë të kanalizuara nga firmat më produktive (Canton, 2014).

Efikasiteti alokues (AE) është përcaktuar si shkalla në të cilën firmat më produktive gjithashtu kanë pjesën më të madhe të tregut. Figura 2.1. paraqet një masë të efikasitetit alokues, duke përdorur të dhëna sektoriale mbi produktivitetin e punës për klasa të ndryshme të madhësisë së firmave. Figura nxjerr në pah se efikasiteti alokues në sektorin e shërbimeve është më i ulët se ai i prodhimit, kjo shpjegohet për shkak të dallimeve në ekspozimin ndaj konkurrencës ndërkombëtare dhe rregullimin e tepërt të shërbimeve profesionale.

Sektorët përcaktohen sipas klasifikimit të Nace Rev. me përshkrimin e mëposhtëm: prodhimi (C), ndërtimi (F), transport dhe magazinim (H), akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit (I), informim dhe komunikim (J), aktivitetet e pasurive të paluajtshme (L), aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike (M) dhe aktivitetet administrative dhe mbështetëse të shërbimit (N). Dinamika e firmës ndikon në masën në të cilën burimet prodhuese janë alokuar drejtë përdorimit të tyre më efikas në ekonomi. Nga ana tjetër, përqindja e firmave të reja dhe e falimentimit të tyre lidhet me qasjen në kushtet e financimit.

Figura 2. 1. *Indeksi i efikasitetit alokues në vitin 2010 për vendet dhe sektorët e përzgjedhur*



Burimi: Erik Canton (2014) - Financing the real economy, www.ec.europa.eu

Në kushtet më të vështira të financimit, procesi i dinamikës së biznesit është në nivel të lartë përkeqsimi, në kuptimin që normat e falimentimit të kompanive rriten ndërkohë që përqindja e bizneseve fillestare zvogëlohet (Canton, 2014).

Figura 2.2 ilustron të dhënat nga studimi i Komisionit Evropian / Bankës Qendrore Evropiane mbi disponueshmërinë e kredive bankare. Figura përmban dy grafikë, në grafikun e parë është paraqitur raporti mes numrit të firmave të reja dhe disponueshmerisë së kredive, ndërsa në grafikun e dytë është paraqitur raporti mes normës së falimentimit të kompanive dhe disponueshmërisë së kredive bankare.

Figura 2. 2. *Dinamika e ndërmarrjeve në sektorin real dhe qasja e tyre në financa*



Burimi: SAFE survey and Eurostat (2009-2010), www.ec.europa.eu

Në bazë të të dhënave nga studimet e Komisionit Evropian dhe duke u bazuar në raportet e Bankës Qendrore Evropiane vërejmë që sa më e lartë të jetë norma e rritjës së firmave të reja (start-up) aq më shumë zvoglohet përkeqësimi i disponueshmërisë së kredive bankare. Ndërsa, efekti i kundërt ndodh kur me zvogëlimin e normës së falimentimit të kompanive, rritet përkeqësimi i disponueshmërisë së kredive bankare. Në bazë të këtyre rezultateve vërehet që vendet evropiane nëpërmjet politikave të tyre kreditore, duhet të fokusohen në dhënien e kredive bankare më të volitshme, që të ndikojnë në rritjen e normës së bizneseve të reja dhe zvoglimin e normës së falimentimit të kompanive të ndryshme.

2.5. Faktorët që ndikojnë në raportin mes bankave komerciale dhe sektorit real të ekonomisë

Në këtë pjesë do të analizohen indikatorët më të rëndësishëm që ndikojnë në raportin mes bankave komerciale dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Shqyrtimi i literaturës për këtë pjesë a bazohet në studimet e fundit të bëra në këtë fushë nga autorë të ndryshëm botërorë. Roli i kredisë bankare të ofroau nga bankat tregtare është shumë i rëndësishëm në zhvillimin e ndërmarrësisë, pra në zhvillimin e ndërmarrjeve të sektorit real të ekonomisë. Edhe pse është bërë një shtjellim literaturë mjaft i gjerë ende nuk ka ndonjë përkufizim të përgjithshëm të pranuar për ndërmarrësi (OECD, 1998; Van Praag, 1999; Bull dhe Willard, 1993).

Siç analizohet edhe nga autori Drucker (2005), përkufizimi i sipërmarrjes përhapet në shumë fusha të ndryshme studimore. Hébert dhe Link (1989) vërejnë se një sipërmarrës përfshin funksione të ndryshme. Një karakteristikë e madhe e ndërmarrjeve të sektorit real në mbarë botën është se ato janë të menaxhuara në përgjithësi nga pronarët e tyre ose si pronësi e vetme apo partneritet (Adamu, 2005). Kreditë bankare komerciale luajnë një rol vendimtar në zhvillimin e ekonomisë së një vendi. Shumë autorë theksojnë se kreditë bankare ndikojnë pozitivisht në nivelin e aktiviteteve ekonomike në çdo vend. Kjo ndikon në atë që çfarë duhetprodhuar, firmën që e prodhon atë, dhe sasinë që duhet prodhuar.

Banka Qendrore Evropiane thekson se kredia është parësore dhe përparësia duhet dhënë në mënyrë të barabartë qoftë për huatë ashtu edhe paradhëniet, duke përfshirë edhe datën ardhshme të shlyerjes. Një rol të rëndësishëm në politikat kreditore të bankave, pra në përcaktimin e bankave për të hartuar mënyrat e dhënies së kredive për biznesin e vogël,janë informacionet e sakta për komunitetin e biznesit. Banka Qendrore Evropiane jep udhëzime të kujdesshme administrative për bankat qendrore të vendeve anëtare në mënyrën se si duhet të menaxhohen kreditë dhe gjithashtu ofron një përkufizim të gjerë të

politikave kreditore, dhe kjo përfshin në përgjithsi të gjitha llojet e kredive, produktet dhe shërbimet bankare, overdraftet, faturat e zbritura, garancitë bankare, pranimet bankare, letrat komerciale dhe dëmshpërblimet financiare.

Aktualisht, ndërmarrjet e sektorit real të ekonomisë janë gjithnjë e më aktive në tregjet ndërkombëtare (Bonaccorsi, 1992), (Haahti, Antti, Hall dhe Donckels, 1998). Sipas Ayyagari, Beck dhe Demirguc-Kunt (2007), këto ndërmarrje përbëjnë pjesën më të madhe të sektorit privat në shumë vende të zhvilluara dhe në zhvillim. Kështu, sektori real është një burim i rëndësishëm i krijimit të vlerës së shtuar, punësimit dhe rritjes ekonomike (Roman & Rusu, 2012). Megjithatë, funksionimi i ndërmarrjeve të sektorit real nuk është i njëjtë në vendet e zhvilluara dhe në zhvillim (Beck, T. & Demirguc-Kunt, 2006).

Sfidat dhe mundësitë e këtyre ndërmarrjeve ndryshojnë në raport të njërit vend me vendin tjetër (Kombet e Bashkuara, Konferenca për tregti dhe zhvillim, 2001). (Essang, SM & Olajide, SO, 1974), kanë identifikuar se si një institucion financiar (banka), e cili mund të jetë në pronësi publike ose private, realizon profit më të madh nëpërmjet emetimit të kredive për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në ndjekje të këtij fitimi, bankat komerciale kryejnë një numër të madh të funksioneve. Një prej këtyre funksioneve është pranimi i depozitave nga publiku. Këto depozita kryesisht jepen si kredi për ndërmarrjet e sektorit real dhe kjo ndikon në rritjen e prodhimit dhe ofrimin e mundësive për gjenerimin e vendeve të reja të punës në ekonomitë e vendeve të ndryshme (Ajagbe & Brimah, 2013).

Ekziston një rrezik moral në mes huamarrësit (biznesit) dhe ofruesit të shërbimeve financiare (bankës) në disa nivele: ekzistenca e sistemeve të garantimit të kredive zvogëlon gatishmërinë e huamarrësve ndaj ofruesve të shërbimeve financiare në lidhje me detyrimet e tyre kreditore. Një rrezik i ngjashëm moral mund të ekzistojë për një ofrues të shërbimit financiar me garanci bankare, i cili shërben si mbulesë për portofolin e tij. Pra, ekzistenca e një sistemi të garancisë mund të reduktojë përpjekjet e ofruesit të shërbimeve financiare për të mbikëqyrur dhe zbatuar përfundimisht pagesat e kredisë nga huamarrësit e saj.

Në praktikë megjithatë, bankat gjatë procesit të kreditimit konsiderojnë humbjet që do të sjellë ky risk moral në reputacionin e tyre. Nga pikëpamja e huamarrësit, rritja masive në bazat e të dhënave të informacionit kreditor e bën gjithnjë e më të vështirë qasjen në marrjen e kredive në të ardhmen për klientët, pavarësisht nëse ato janë kredi të papaguara apo që kanë garanci bankare që do të mund t'iu shërbejnë si mbulesë (Zander, Miller, & Mhlanga, 2013).

Gibson (2008) vlerëson sfidat me të cilat përballen bankat komerciale në sigurimin e financimit adekuat për ndërmarrjet e sektorit real dhe kësaj here propozon strategjitë për rritjen e aksesit të këtyre ndërmarrjeve për rrezikun në kapital. Gjetjet e studimeve të realizuara nga Gibson në vitin 2008 tregojnë se kreditë ndikojnë tek kthimet e aksionarve, në krahasim me kapitalin e vet të pastër, të cilat zvogëlojnë rrezikun e investimeve dhe ndikojnë në rritjen të ardhurave të tyre aktuale. Ndërmjetësit financiarë (bankat) përmes riskut të investimeve në kapitalet e tyre mund të përfitojnë fondet e tyre duke përdorur instrumente të ndryshme financiare, të cilat pasqyrojnë objektivat e ndryshme të kthimit të investitorëve. Qeveritë e vendeve në zhvillim mund të inicojnë programe të stimujve të taksave për të rritur pjesëmarrjen e sektorit privat në rrezikun e kapitalit të ndërmarrjeve të sektorit real (Gibson, 2008).

Ndikimi i këtyre programeve është se duke rritur disponueshmërinë e financimit në aktivet bazë qëndrueshmëriae e sektorit real në vendet të cilat janë në zhvillim dhe kontributi në rritjen ekonomike të këtyre shteteve bëhet kritikr. Hoff (2007) shqyrtoi mjedisin e financimit për ndërmarrjet e sektorit real dhe identifikoi sfidat kryesore dhe zgjidhjet për financimin e këtij sektori. Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që luan sektori real në ndërtimin e vendit, shumë studime kanë vlerësuar performancën e tij nën perspektivën e politikave dhe programeve të ndryshme të miratuara për të stimuluar rritjen e sektorit real.

Aremu dhe Adeyemi (2011) shqyrtuan rolin e ndërmarrjeve të sektorit real si një strategji mbijetese për gjenerimin e punësimit në shumë vende të botës. Studimi vuri në dukje se ky sektor është forca kryesore lëvizëse në kuadër të krijimit të vendeve të reja të punës, uljen e varfërisë, krijimit të pasurisë, shpërndarjen e të ardhurave dhe reduktimin e pabarazive në të ardhurat e vendeve të ndryshme në nivel global dhe se shumica e ndërhyrjeve të qeverive nuk arritën të krijojnë transformim shumë të nevojshëm për shkak të koordinimit të dobët në monitorimin dhe mospërputhjen e politikave.

Ndërmarrjet e sektorit real kanë qenë baza e zhvillimit ekonomik veçanërisht në vendet në zhvillim. Ofrimi i vendeve të reja të punës në sektorin publik është i pamjaftueshëm. Për këtë arsye, është e nevojshme që ndërmarrjet e sektorit real për të rritur nivelin e punësimit të përkrahen edhe me politika kreditore të duhura, në mënyrë që këto politika kreditore, pra konkretisht standartet e këtyre politikave të jenë të favorshme për këtë sektor dhe të harmonizuara me strategjitë e zhvillimit të ndërmarrjeve në përgjithësi (Aremu & Adeyemi, 2011) .

Roli i bankave komerciale në zhvillimin e sektorit real është jetik për rritjen ekonomike të një vendi. Është i pranuar fakti se disponueshmëria e kapitalit financiar është parakusht për zhvillimin e shpejtë

ekonomik. Menaxhimi efikas i burimeve të pakta vlerësohet si lehtësim i madh që ka ndikim në financimin nga institucionet financiare. Prandaj, rëndësia e bankave është jetik dhe vital për suksesin financiar të firmave të biznesit. Faktorët të cilët ndikojnë që ndërmarrjet e sektorit real të ekonomisë të kenë në dispozicion burime të mëdha financiare varet nga performanca e tyre financiare dhe promovimi i mundësive për investime financiare. Këta janë faktorë të veçantë që karakterizojnë situatën e fazës së zhvillimit të ndërmarrjeve dhe që i bëjnë bankat komerciale mekanizma të rëndësishëm në zhvillimin e bizneseve.

Disa vende në zhvillim karakterizohen me nivel të ulët të të ardhurave për kokë të banorit. Gjithashtu, pabarazitë në shpërndarjen e të ardhurave, si dhe variacionet në prirje të kursimeve janë në nivele të ndryshme të të ardhurave. Shpeshherë lehtësimet të cilat paraqiten përshkak të defekteve që shfaqen në procesin e kreditimit, konsiderohen alternativat më të mira të ofruara nga bankat. Kërkesat për zhvillimin ekonomik për të siguruar përmirësim të përgjithshëm në mirëqenien e qytetarëve ka qenë preokupimi i çdo vendi në botë. Procesi përfshin një numër të madh të qasjeve. Një nga këto është miratimi i një strategjie të industrializimit në një moment kohor të rëndësishëm për nevojat ekzistuese të zhvillimit të bizneseve. Vendet në zhvillim janë shumë në presion për shkak të karakteristikave të tyre të përgjithshme dhe të dallueshme..

Është e rëndësishme të theksohet se zhvillimi i sektorit real luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe kryesisht aktivitetet e këtyre ndërmarrjeve financohen nëpërmjet burimeve formale dhe joformale. Përvojat e shumta në zhvillimin e shumë ndërmarrjeve të sektorit real në vende të ndryshme përmes kredive të ofruara nga bankat komerciale tregojnë se këto ndërmarrje kontribuojnë në arritjen e shumë objektivave të zhvillimit. Këto përfshijnë zgjerimin e prodhimit, gjenerimin e punësimit, madje edhe vend ndodhjen e industrive midis rajoneve të ndryshme brenda vendit, rishpërndarjen e të ardhurave, promovimin e sipërmarrjes dhe teknologjisë si dhe prodhimin e mallrave të ndërmjetme për të forcuar rrjedhjet industriale brenda dhe jashtë vendit (Nnanna, 2001).

Shkalla në të cilën mundësitë e ofruara nga këto ndërmarrje janë shfrytëzuar dhe kontributet e tyre për të maksimizuar fitimet në ndonjë ekonomi varet nga mjedisi i biznesit dhe mundësitë që iu krijohen bizneseve nëpërmjet ofrimit të infrastrukturës moderne si rrugë, telekomunikacion, energji etj, dhe ndjekja e politikave të duhura kreditore: si financimi i përshtatshem nëpërmjet kredive me norma të volitshme të interesit që nxisin dhe forcojnë rritjen e industrisë.

Megjithatë, rëndësia e ndërmarrjeve të sektorit real si një katalizator për rritjen dhe zhvillimin ekonomik kombëtar është vlerësuar me kohë dhe është padyshim arsye kryesore për promovimin e tyre në ekonomitë e zhvilluara. Për shembull, Komisioni i Hetimeve "Bolton" i themeluar në Britaninë e Madhe në vitin 1968, për të shqyrtuar rolin e ndërmarrjeve të këtij sektori në ekonominë britanike në mënyrë konkrete përshkruajnë dy role të rëndësishme të këtyre ndërmarrjeve të cilat janë: gjenerimi dhe zhvillimi i industrive të reja në ekonominë britanike dhe identifikimi i burimeve të konkurrencës dinamike të cilat ndikojnë në financimin strategjik të këtyre ndërmarrjeve, si psh. në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërmarrjet e sektorit real kanë luajtur një rol të rëndësishëm në tranzicionin e vendit nga ekonomia industriale në atë postindustriale, dhe me këtë proces të transformimit ekonomik, i është dhënë prioritet edhe përshtatshmërisë së politkave kreditore të bankave tregtare në raport me zhvillimin e sektorit të biznesit.

Dy konceptet themelore të financimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të këtij sektori, të cilat janë identifikuar nga studiues dhe hulumtues të ndryshëm, janë format formale dhe joformale të financimit (Gelinas, 1998), (Aruwa, 2004). Gjetjet e këtyre studimeve theksojnë se burimet formale më të njohura të financimit janë bankat komerciale, të cilat vlerësohen të jenë shtyllë e rëndësishme e financimit për zhvillimin e ndërmarrjeve në kuadër të burimeve formale të financimit. Burimet joformale të përbëra nga kursimet personale, huamarrjet nga miqtë dhe të afërmit si dhe kreditë e ndryshme joformale janë identifikuar gjithashtu si burime potenciale të financimit të ndërmarrjeve të sektorit real. Për të analizuar politikat e financimit të ndërmarrjeve të sektorit real dhe strategjitë për zhvillimin e tyre janë realizuar shumë kërkime shkencore (Boiko, 1998).

Banka Botërore (2001) në një studim shkencor të realizuar mbi qasjen e ndërmarrjeve të sektorit real në kreditë e institucioneve financiare gjetën se 85 përqind e firmave në shumicën e vendeve botërore kanë pasur marrëdhënie kreditore me bankat, dhe jo të gjitha këto firma kanë pasur qasje në kredi të jashtme. Schneider dhe Barthold (2002) dhe të tjerë hulumtues kanë konfirmuar vazhdimisht kontributin e rëndësishëm të ndërmarrjeve të sektorit real në zhvillimin makroekonomik të vendeve të ndryshme. Problemi i financimit dhe kreditimit të këtyre ndërmarrjeve ka ndikuar që shumë hulumtues të ndërmarrin projekte të ndryshme kërkimore shkencore, me anë të cilave kanë identifikuar problemet dhe vështirësitë e financimit të ndërmarrjeve të sektorit real në mbarë botën. Disa prej këtyre kërkimeve shkencore në këtë aspekt janë punimet e autorëve Arnold (1998), Dorn (1998), Inang & Ukpong (1992) dhe Aruëa (2004). Në gjetjet e këtyre kërkimeve shkencore ata kanë identifikuar katër problemet

kryesore në financimin dhe kreditimin e sektorit real: kostoja e kapitalit, risku, kushtet e papërshtatshme për kreditë bankare dhe mungesa e kapitalit aksionar.

Aruëa (2004) vë në dukje se bankat kanë treguar paaftësinë e tyre për të marrë përsipër dhe për të menaxhuar interesat e ndërmarrjeve të sektorit real, skemat e kursimeve informale dhe jo vetëm për të mbushur boshllëkun e krijuar, por ato gjithashtu përbëjnë një formë të re të akumulimit të kapitalit të bazuar në solidaritetin dhe bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve dhe bizneseve. Golis (1998) ka identifikuar mundësitë e financimit për kapitalin e ndërmarrjeve të sektorit real. Strategjia e financimit dhe kreditimit për këto ndërmarrje duhet të projektohet nga qeveritë federale dhe gjithashtu duhet bërë përpjekje për zgjerimin e spektrit të financimit për ndërmarrjet e sektorit real të ekonomisë.

2.6. Ndikimi i krijimit të rrjetit të ndërmarrjeve të sektorit real dhe qasja e tyre në procesin e kreditimit bankar

Qasja në burimet financiare është konsideruar të jetë tipar më i kufizuar për ndërmarrjet e sektorit real të ekonomisë. Shumë studiues përshkruajnë krijimin e rrjeteve si një faktor thelbësor për të hyrë në një kredi bankare dhe si ndërmarrjet e këtij sektori kërkojnë kredi për t'u zhvilluar dhe rritur. Aktualisht, ndërmarrjet e sektorit real janë gjithnjë e më aktive në tregjet ndërkombëtare (Bonaccorsi, 1992; Haahti, Helli dhe Donckels, 1998).

Një nga faktorët thelbësor për ndërmarrjet e sektorit real që ndikon në mënyrën e menaxhimit të biznesit dhe që ky biznes të mbijetojë në treg është faktori financiar. Financimi i këtyre ndërmarrjeve ka qenë një temë me interes të madh për shumë studiues, si dhe politikëbërës (Ayyagari et al, 2007;. Beck dhe Demirguc-Kunt, 2006). Sigurimi i burimeve financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të sektorit real është konsideruar të jetë një pengesë e madhe në krahasim me firmat më të mëdha të sektorit real (Schiffer & Weder, 2001) (Udell, 2011). Ka disa mënyra qëkëto ndërmarrje të sigurojnë burimet e tyre të nevojshme financiare dhe financimi përmes bankave është për shembull, një prej këtyre mundësive.

Çështja e financimit bankar është më sfiduese për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të sektorit real sesa për firmat e mëdha në mënyrë që të kenë qasje në kredi të përballueshme për një periudhe të arsyeshme (Valverde & Fernandez & Udell, 2009), (Tagoe, Nyarko & Anuwa-Amarh, 2008). Për ato ndërmarrje të vogla dhe të mesme që janë të gatshme për tu zgjeruar, kreditë bankare konsiderohen si një mundësi e rëndësishme për të përfituar nga aktiviteti i tyre (Riding dhe Haines, 2001).

Megjithatë, perceptimi i përgjithshëm është se bankat (sidomos ato të mëdha), nuk janë të interesuara për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sektorit real, për shkak se ato i shohin bizneset e vogla dhe të mesme si konsumatorë me rrezik të lartë (Le, Venkatesh & Nguyen, 2006). Kjo është për shkak se disa ndërmarrje të vogla dhe të mesme nuk janë në gjendje të paguajnë borxhin e tyre (Riding & Haines, 2007). Në anën tjetër, ndërmarrjet me reputacion të mirë në treg, sipas të dhënave kërkimore kanë një emër të mirë dhe janë më të besueshme. Këto kategori të ndërmarrjeve të sektorit real konsiderohen si institucione efektive të tregut dhe veprojnë në një infrastrukturë të mirë ligjore, të cilat përballen me më pak vështirësi në mënyrë që të marrin financime përmes kredive bankare. Megjithatë, për ato ndërmarrje të sektorit real të cilat nuk i kanë këto elemente, atëherë marrja e kredisë nga banka është shumë sfiduese (Dorin & Ligia, 2008).

Prandaj, krijimi i rrjeteve mund t'iu japë ndërmarrjeve të sektorit real një avantazh, në mënyrë që të hyjnë në një kredi bankare duke rritur legjitimitetin e firmave (Ngoc & Nguyen, 2009; Sirec & Bradac, 2009). Në të vërtetë, bankat nuk veprojnë në mënyrë të njëjtë në vendet e zhvilluara dhe në ato në zhvillim. Për shembull, në vendet në zhvillim, bankat nuk janë të gatshme të jenë të ekspozuara ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të këtij sektori (Beck dhe Demirguc-Kunt, 2006). Në këtë rast, është interesante të shihet se si krijimi i rrjeteve mund të ketë ndikim, në mënyrë që të sigurojë kredi të nevojshme për këto ndërmarrje nga bankat.

Financimi dhe kreditimi i ndërmarrjeve të sektorit real, i cili ka rol të rëndësishëm në mbarë botën, ka qenë subjekt me interes të madh(Beck, Demirguc-Kunt dhe Peria, 2008). Një sektor i shëndetshëm financiar dhe rritja ekonomike e sektorit real perceptohet të jetë thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe një avantazh i qëndrueshëm konkurrues në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar (Porter, 2006).

Megjithatë, mungesa e financimit adekuat paraqet një pengesë të madhe, prandaj ndërmarrjet e sektorit real kërkojnë fonde të mjaftueshme në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor për të përmbushur nevojat e tyre për financim. Kështu, nëse struktura financiare reduktohet, mbijetesa e këtyre ndërmarrjeve ka gjasa që të shkurtohet. Në ekonomitë më të zhvilluara dhe në ato në zhvillim, një numër i ndërmarrjeve të sektorit real duhet të hyjnë në një gamë të gjerë të burimeve financiare (Javed, Millman, & Matlay, 2006). Megjithatë, disa karakteristika të firmave të tilla si madhësia e firmës, faza e zhvillimit të tyre dhe sektori i aktivitetit të tyre, mund të ketë një efekt mbi marrjen e burimeve financiare (Agrebi, 2009).

Përdorimi i burimeve financiare mund të jetë një çështje e rëndësishme për ndërmarrjet e sektorit real, veçanërisht në vitet fillestare të operimit. Kështu, bankat konsiderohen si huadhënësit kryesorë për

këto ndërmarrje që të kthehet financimi i borxhit (Kang, 2001). Megjithatë, perceptimi i përgjithshëm në lidhje me ndërmarrjet e sektorit real është se bankat nuk janë të interesuara në financimin e këtyre ndërmarrjeve: qëllimi i sistemit aktual financiar dhe bankar për këto ndërmarrje është për të lehtësuar aksesin e tyre në burimet financiare dhe për të ulur koston e huamarrjes nga bankat dhe institucionet e tjera (Kang, 2001).

Sipas Beck, Demirguc-Kunt dhe Peria (2008) perceptimi se rentabiliteti është drejtuesi më i rëndësishëm për bankat, si në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, është për t'u përfshirë në kreditimin e ndërmarrjeve të sektorit real. Megjithatë, në bazë të llojeve të pronësisë bankare, lindin disa dallime. Për shembull, bankat private konsiderojnë rentabilitetin si faktor kryesor të kreditimit, por bankat të cilat janë në pronësi qeveritare tregojnë se konkurrenca ndërmjet segmenteve është një element i rëndësishëm i kreditimit. Ndërsa për bankat në vendet e zhvilluara konkurrenca në segmentin e ndërmarrjeve të sektorit real është konsideruar si pengesa kryesore.Për bankat në vendet në zhvillim ambienti makroekonomik është i lartë dhe vlerësohet si pengesë. Për më tepër, në shumicën e literaturës ekonomike dhe financiare, asimetria e informacionit midis bankave dhe firmave konsiderohet si një sfidë kryesore për ndërmarrjet e sektorit real për të hyrë në financimin përmes kredive bankare (Ebben & Johnson, 2006).

Koncepti i asimetrisë së informacionit u prezantua për herë të parë nga Akerlof (1970) në një kërkim shkencor që lidhet me asimetrinë e informacionit, mekanizmave tregtare dhe karakteristikave të pasurisë (Auronen, 2003). Asimetria e informacionit është krijuar nga motivimi i një firme për të fshehur disa të dhëna negative. Prandaj, asimetria e informacionit është një arsye kryesore për ekzistencën e ndërmjetësve financiarë të tilla si bankat. Ekziston një mundësi unike për bankat për të ulur asimetrinë e informacionit nëpërmjet marrëdhënieve të tyre me firmat (Bardong, Bartram, & Yadav, 2009).

Hulumtuesit e mëparshëm kanë përmendur përkufizime të ndryshme në lidhje me krijimin e rrjeteve të cilat përfshijnë rrjetet e biznesit, rrjetet sociale, rrjete formale, rrjetet joformale dhe kapitalin social. Në përgjithësi, çdo marrëdhënie e qëndrueshme ndërmjet një ndërmarrje dhe një banke e cila është reciprokisht e dobishme për të gjitha palët e përfshira është përcaktuar si krijim i rrjeteve (Hallen & Johanson, 2004).

Sipas Scalera & Zazzaro (2009) krijimi i rrjeteve për kredi bankare është një grup me lidhje të qëndrueshme të vendosura për transaksionet ekonomike me kosto efektive ndërmjet pjesëtarëve në këto rrjete, të bazuara në lidhjet formale dhe joformale me qëllime të përbashkëta. Rrjetet mund të rrisin

'legjitimitetin e firmës në mënyrë që të ketë akses në financat e jashtme (kreditë nga bankat). Rrjetet mund të ketë një rol të rëndësishëm në përhapjen e njohurive në lidhje me ekzistencën e një firme si dhe ndihmon që këto firma të mësojnë sjelljen e duhur dhe në këtë mënyrë të marrin mbështetjen e nevojshme nga ana e publikut të gjerë në lidhje me financimin ekstern.

Përveç kësaj, krijimi i rrjeteve mund të jetë një mënyrë e efektshme për ndërmarrjet e sektorit real për të hyrë në financim të jashtëm, duke përfshirë edhe kreditë bankare. Financime të tjera të borxhit të jashtëm që këto ndërmarrje mund të përdorin nëpërmjet krijimit të rrjeteve është kredia nga të afërmit dhe miqtë, kreditë tregtare dhe mbështetjet financiare nga qeveria, të cilat janë më të përshtatshme dhe të arritshme. Për këtë arsye, krijimi i rrjeteve siguron burime tjera të financimit sesa një kredi bankare, dhe mund të zvogëlojë nevojën për kredi bankare (Hussain, Millman & Matlay, 2006; McMillan & Woodruff, 2002; Ngoc & Nguyen, 2009).

Rrjetet promovojnë qasjen e firmave në kredi bankare duke siguruar informacion, njohuri dhe avantazh mbi legjitimitetin. Në anën tjetër, rrjetet mundësojnë qasje edhe në burime të tjera të financimit për firmat duke ulur nevojën për kredi bankare. Megjithatë, efekti neto është i ndryshëm në të gjithë llojet e ndryshme të rrjeteve që ndikon edhe në përshtatshmërinë e politikave kreditore të bankave komerciale dhe në zhvillimin e bizneseve përmes kreditimit (Ngoc & Nguyen, 2009)

Financimi konsiderohet si pengesa më e madhe për funksionimin e një firme midis elementeve të tjera të mjedisit të biznesit, ku besimi në institucionet e një vendi është një faktor i rëndësishëm nga ana e kërkesës e cila përcakton nëse firmat mund të kenë qasje në financat formale (Beck dhe Demirguc-Kunt, 2008).

2.7. Ekonomia e Kosovës – rritja reale e PBB-së dhe inflacioni

Ekonomia e Kosovës gjatë viteve të fundit (2005 – 2018) u karakterizua me lëvizje të ndryshme makroekonomike. Në këtë pjesë të rishikimit të literaturës do të ofrohet një analizë gjithëpërfshirëse e ndikimit të ndërmjetësimit financiar në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Së pari, do të ofrohen të dhëna për indikatorët kryesorë makroekonomik si: produkti i brendshëm bruto dhe inflacioni, pastaj do të elaborohet struktura e kredive dhe depozitave në sektorin bankar në Kosovë.

Në këtë pjesë të disertacionit do të ofrohen analiza krahasuese statistikore të ndara në tri periudha kohore. Së pari, do të analizohet rritja reale e produktit të brendshëm bruto dhe inflacionit në periudhën 2005 - 2018, strukturën e kredive dhe depozitave si dhe sjelljen e normave të interesit në kredi dhe

depozita. Të dhënat e kësaj analize krahasuese janë bazuar në raportet e stabilitetit financiar nga Banka Qendrore e Kosovës për përiudhën kohore 2005 - 2018, si dhe nga raportet e Agjensisë së Statistikave të Kosovës, Bankës Botërore, Ministrisë së Financave dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës.

2.7.1. Rritja reale e PBB-së në Kosovë (2005 - 2018)

Sipas vlerësimeve të Agjensisë së Statistikave të Kosovës vlera nominale e PBB-së për vitin 2017 ka arritur vlerën prej 6.3 miliardë euro. Pra, nëse kjo shumë nominale konvertohet në terma realë, atëherë nënkupton se gjatë vitit 2017 kemi pasur një rritje mesatare vjetore prej 2.7%. Edhe pse mjedisi makroekonomik rezulton të jetë i qëndrueshëm, rritja reale e PBB-së sipas vlerësimeve të BQK-së rezulton të ketë qënë 4%. Rritja e kërkesës agregate gjatë vitit 2018 është mbështetur kryesisht nga rritja e konsumit dhe e investimeve.

Gjatë kësaj periudhe kohore, faktorët që ndikuan më së shumti në rritjen e PBB-së ishin investimet e huaja direkte, pozicioni neto i eksporteve si dhe rënia e konsumit. Gjatë vitit 2018, aktiviteti kreditues i bankave ishte shumë dinamik dhe nëse ky trend krahasohet me pesë vitet e kaluara, atëherë mund të konkludojmë se sektori bankar në Kosovë shërbeu si katalizator i rëndësishëm i financimit të sektorit real në Kosovë.

Në figurën 2.3. është paraqitur trendi i PBB-së në Kosovë për periudhën kohore 2005 - 2018. Në bazë të figurës vërehet që prej vitit 2005 kemi pasur një trend të PBB-së nga 6% në 4.2% në vitin 2017. Gjatë kësaj periudhe kohore, ekonomia e Kosovës u shoqërua me rritje të investimeve private, të cilat u karakterizuan me rritje të kredive të reja investuese dhe IHD-ve në Kosovë. Sipas vlerësimeve nga qasja e shpenzimeve, aktiviteti ekonomik gjatë kësaj periudhe është mbështetur kryesisht nga sektori i shërbimeve dhe ndërtimit.

Rritja e kredive të sistemit bankar, shpenzimet qeveritare si dhe remitencat kanë inkurajuar nivelin e përgjithshëm të konsumit në vend (BQK, 2011). Kosova, si një ekonomi e vogël, po ashtu u ndikua nga efektet e krizës financiare 2007-2009, kryesisht kjo u reflektua në të hyrat nga jashtë, remitencat dhe IHD-të, të cilat u zvogëluan për 23.3%. Kjo rënie ndikoi edhe në rritjen ekonomike në Kosovë gjatë vitit 2010, që ishte 3.3%, rritje kjo e cila pavarsisht efekteve nga kriza financiare, konsiderohet në rritje e moderuar ekonomike (BQK, 2010).

Sipas kalkulimeve nëpërmjet analizës së trendit linear, vlera e trendit mesatar për PBB-në që përfshinë periudhen kohore 2005 – 2018 është 0.0397 ose 3.9%, që nënkupton mesatarja e rritjes ekonomike gjatë këtyre viteve ishte 3.97%.

Figura 2. 3. *Rritja reale e PBB-së në Kosovë (2005-2018)*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Rritja reale e PBB-së për vitin 2012 ishte 2.90%, e cila kryesisht u ndikua nga zhvillimet në sektorin e jashtëm, të cilat po ndikojnë negativisht në nivelin e eksporteve, investimeve të huaja direkte si dhe dërgesave të emigrantëve. Në vitin 2011 ekonomia e Kosovës është karakterizuar me rritje reale të PBB-së prej 4.8%, ku pjesëmarrjen më të madhe në kuadër të produktit të brendshëm bruto e ka konsumi, në vlerën prej 107% të PBB-së.

Në vitin 2013 rritja reale e PBB-së ishte 3.4%, ku kontribuesit kryesor në këtë rritje ishin konsumi, pasuar nga eksportet neto, ndërsa investimet pritet të kenë ndikim neutral në rritjen ekonomike. Konsumi është komponenti me pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të PBB-së, pjesëmarrje e cila vitin 2013 ishte 103.6% (BQK, 2013). Zhvillimet ekonomike në Kosovë gjatë vitit 2012, tregojnë që aktiviteti ekonomik në Kosovë është zgjeruar me një ritëm të ngadalshëm në krahasim me viti paraprak.

Gjatë vitit 2014, rritja ekonomike në Kosovë ishte 1.40%, ku një rënie e tillë e PBB-së në krahasim me vitin paraprak vlerësohet të jetë rezultat i rënies së investimeve dhe neto eksporteve, të cilat kanë ndikuar negativisht. Investimet gjatë këtij viti kanë rënie reale prej 6.4% krahasuar me vitin 2013. Duke u bazuar në të dhënat e BQK-së për vitin 2014, kjo vlerë e PBB-së është ndikuar pikërisht nga kjo rënie e investimeve e cila vjen si pasojë e rënies së konsiderueshme të investimeve publike, të cilat janë shkaktuar nga vonesat në konsolidimin e institucioneve në vend. Në terma real, ndikim tjetër në rritjen ekonomike (1.40%) ka pasur edhe neto eksporti i cili ka thelluar deficitin për 2.2% në vitin 2014 duke kontribuar negativisht në rritjen ekonomike (BQK, 2014).

Rritja reale e PBB-së në Kosovë gjatë vitit 2015 ishte 4.10%, kjo rritje vlerësohet të jetë gjeneruar kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme (konsumit dhe investimeve), ndërsa eksportet neto

vazhduan të kontribuojnë negativisht në rritjen ekonomike. Norma më e lartë e rritjes reale të importit të mallrave dhe shërbimeve krahasuar me eksportin ka pasur ndikim që eksportet neto të ndikojnë negativisht në rritjen ekonomike të Kosovës (BQK, 2015).

Gjatë vitit 2016, rritja reale e PBB-së ishte 4.10%. Kjo rritje u shoqërua me përforcimin e investimeve (14.6%) dhe rritjen e konsumit (4.5%). Në këtë periudhë ekonomia e Kosovës u vlerësua me një thellim të konsiderueshëm të deficitit tregtar (16.4%) (BQK, 2016). Pra, gjatë këtij viti rritja reale e ekonomisë së Kosovës është mbështetur kryesisht nga rritja në aktivitetin e ndërtimtarisë, sektorin e hotelierisë, transportit dhe tregtisë. Ndërsa rënie të aktivitetit gjatë këtij viti ka shënuar industria përpunuese, afarizmi me pasuri të patundshme dhe administrimi publik.

2.7.2. Ecuria e inflacionit në Kosovë (2005-2018)

Në vazhdim të kësaj analize krahasuese do të ofrojmë të dhëna për indeksin e çmimit në Kosovë si dhe ndryshimin vjetor për periudhën kohore 2005 - 2018. Në vitin 2010 indeksi i çmimit të konsumatorit në Kosovë arriti vlerën në 3.5%. Ndikimin më të madh në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në vitin 2010 e kishin çmimet e produkteve ushqimore dhe të shërbimeve të transportit personal, të ndikuara nga çmimet e karburanteve në tregjet ndërkombëtare. Në përgjithësi, ecuria e çmimeve në ekonominë e Kosovës kryesisht diktohet nga lëvizjet e çmimeve në sektorin e jashtëm (BQK, 2010).

Në vitin 2011 ekonomia e Kosovës u shoqërua me presione inflacioniste të cilat u shfaqën nga viti 2010 dhe vazhduan të ndikojnë në zhvillimet makroekonomike në Kosovë. Indeksi i çmimit të konsumatorëve në vitin 2011 ishte 7.3% sipas të dhënave të Bankës Botërore, që paraqet një normë relativisht shumë të lartë të inflacionit krahasuar me vitin 2010 që ishte 3.5%. Kjo rritje e çmimeve në vitin 2011 është shkaktuar kryesisht nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, në veçanti rritja e çmimeve të drithërave dhe karburanteve (BQK, 2011).

Viti 2012 shoqërohet me një normë shumë të ulët të inflacionit (2.5%) krahasuar me vitin 2011. Zbutja e presioneve inflacioniste gjatë këtij viti kryesisht i atribouhet rënies së kërkesës si dhe zhvillimeve të përgjithshme në tregjet globale. Sipas të dhënave nga raportet e zhvillimeve makroenomike, në vitin 2012 çmimet e produkteve si buka dhe drithërat, perimet si dhe vajrat kanë pasur ndikimin kryesor në zbutjen e inflacionit në Kosovë (BQK, 2012).

Niveli i inflacionit në Kosovë në vitin 2013 ishte 1.8%, ku komponentët kryesore që ndikuan në këtë nivel të inflacionit ishin produktet ushqimore, pijet dhe duhani si dhe efekt më të lehtë kishte çmimi i energjisë elektrike (BQK, 2013).

Figura 2. 4. *Ecuria e Inflacionit në Kosovë (2005-2018)*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Rënia e çmimeve në tregjet ndërkombëtare në vitin 2014 u reflektua edhe në ekonominë e Kosovës. Norma mesatare e inflacionit në Kosovë gjatë këtij viti ishte 0.4%. Gjatë kësaj periudhe me rënie të çmimeve u karakterizuan kryesisht mallrat e importuara, pra produktet ushqimore dhe pijet jo-alkoholike (BQK, 2014). Shkalla e inflacionit e shprehur nëpërmjet indeksit të çmimit të konsumatorit në vitin 2015 ishte -0.5%. Kontributin kryesor në rënien e çmimeve në vitin 2015 e kishin kategoria e çmimeve të transportit, kategoria e orendive dhe veshëmbathjeve si dhe shëndetësia dhe arsimi (BQK, 2015).

Viti 2016 në ekonominë e Kosovës vazhdon të karakterizohet me presione të lehta deflacioniste (-0.02%). Niveli i inflacionit në Kosovë në vitin 2016 ishte 0.3%. Kjo normë e inflacionit po ndikohet nga rritja e çmimeve shëndetësore dhe shërbimeve të transportit. Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2017 ishte 1.5% (BQK, 2016). Rritja e inflacionit u ndikua kryesisht nga përmirësimi i aktivitetit ekonomik dhe rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare (BQK, 2017). Gjatë vitit 2018 ngadalësimi i rritjes së çmimit së çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare ndikoi në një rritje më të ngadalësuar të çmimeve në Kosovë (BQK, 2018).

2.8. Struktura e depozitave në sektorin bankar në Kosovë (2005-2018)

Aktiviteti i sektorit bankar që nga fillimi i funksionimit të tij vazhdon të financohet kryesisht nga burime vendore të financimit, gjë e cila ka ndikuar që sektori bankar të ketë ndjeshmëri të ulët ndaj ndryshimit të kushteve të financimit në sektorin e jashtëm gjatë krizës financiare. Edhe pse në sektorin bankar në Kosovë vërehet një dominim i burimeve vendore të financimit në strukturën e detyrimeve,

vitet e fundit është identifikuar një tendencë e rritjes së shfrytëzimit të financimit nga jashtë, që do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve të bankave për të zgjeruar kredidhënien.

Në vitin 2010 depozitat arritën vlerën 1.8 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.8%. Depozitat në sektorin bankar në Kosovë në vitin 2010 u treguan më pak të ndjeshme ndaj efekteve të krizës financiare për shkak se sektori bankar dominohet nga depozitat e gjeneruara brenda vendit. Shuma e depozitave të mbledhura nga ekonomitë familjare në vitin 2010 arriti vlerën në 1.13 miliard euro (65% e totalit të depozitave), ndërsa vlera e depozitave të ndërmarrjeve arriti vlerën në 306.2 milion euro ose 17.5% e totalit të depozitave (BQK, 2010).

Vlera totale e depozitave të mbledhura në vitin 2011 ishte 1.9 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.8%. Ngadalësimi i rritjes së depozitave që nga viti 2008 ishte si pasojë e zvogëlimit të depozitave të qeverisë në bankat komerciale. Vlera e depozitave të ekonomive familjare në vitin 2011 ishte 1.4 miliard euro ose 69.2%, ndërsa shuma totale e depozitave të ndërmarrjeve arriti në vlerën 380 milion euro ose 19% e totalit të depozitave (BQK, 2011).

Viti 2012 karakterizohet me një rritje vjetore të depozitave në krahasim me vitin paraprak. Vlera totale e depozitave në vitin 2012 arriti në 2.1 miliard euro. Ky ngadalësim i rritjes së gjithsej depozitave në sektorin bankar në Kosovë është i natyrshëm për shkak se në vitet e para të funksionimit të sistemit bankar kemi pasur një fluks më të madh të kursimeve të cilat janë mbajtur jashtë sistemit bankar dhe pastaj janë përfshirë si depozita të bankave komerciale (BQK, 2012).

Tabela 2. 1. *Struktua e depozitave në përqindje në sistemin bankar në Kosovë (2005-2018)*

Viti	Ekonomitë Familjare	Ndërmarrjet	Jo-rezidentët	Qeveria
2005	54 %	44 %	1.80 %	0.20 %
2006	56.70 %	37 %	5.90 %	1 %
2007	63.90 %	32.30 %	3.30 %	0.50 %
2008	58.80 %	32.20 %	6.50 %	2.50 %
2009	60 %	31.40 %	6.10 %	2.50 %
2010	65 %	17.50 %	4.30 %	6 %
2011	69.20 %	19 %	5.40 %	6.40 %
2012	72.10 %	23 %	3.60 %	1.30 %
2013	74.80 %	15.60 %	4.10 %	5.50 %
2014	74.20 %	20.80 %	5.40 %	1.60 %
2015	74 %	25.90 %	3.60 %	1.50 %
2016	74.40 %	20.80 %	3.80 %	1 %
2017	73.10 %	22.10 %	3.70 %	1.10 %
2018	69.40%	27%	3.10%	0.48%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Shuma totale e depozitave në vitin 2013 ishte 2.2 miliard euro, përkatësisht rritje vjetore prej 4.4%. Kjo rritje e zvogëluar vjen si shkak i rënies së depozitave të ndërmarrjeve private dhe publike, si dhe ritmit të ngadalësuar të rritjes së depozitave të ekonomive familjare. Depozitat e ekonomive familjare arritën vlerën prej 1.6 miliard euro ose me një pjesëmarrje prej 74.8% në totalin e depozitave. Ndërsa depozitat e ndërmarrjeve kishin një vlerë prej 449.4% milionë euro ose 15.6% pjesëmarrje në vlerën totale të depozitave.

Rritja e lehtë e depozitave të ekonomive familjare gjatë vitit 2013 mund t'i atribouhet rritjes së remitencave, kompensimi i punëtorëve nga jashtë si dhe rritja e lehtë e normave të interesit në depozita nga bankat komerciale (BQK, 2013). Vlera gjithsej e depozitave në sektorin bankar në vitin 2014 ishte 2.42 miliard euro, me një rritje vjetore prej 10%. Gjatë vitit 2014 kemi pasur një trend më të madh të rritjes së depozitave, përkundër faktit që kemi pasur rënie të ndjeshme të normave të interesit në depozita. Kjo situatë reflekton që sistemi bankar në Kosovë të ketë stabilitet të lartë të depozitave, duke marrë pjesë me 79.1% të totalit të detyrimeve të këtij sektori (BQK, 2014).

Viti 2015 u shoqërua me një nivel të depozitave në vlerën prej 2.57 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.3%. Sipas afatit të maturimit, struktura e depozitave ka pësuar ndryshime të theksuara në krahasim me dy vitet paraprake. Depozitat e afatizuara dominonin strukturën e depozitave në vitin 2015, me një pjesëmarrje prej 50.1% në gjithsej depozitat (BQK, 2015).

Figura 2. 5. *Paraqitja grafike e strukturës së depozitave në sektorin bankar në Kosovë (2005-2018)*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në vitin 2016 depozitat në sektorin bankar në Kosovë arritën vlerën në 2.69 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.6%. Edhe gjatë viti 2016, depozitat e ekonomive familjare vazhdojnë të jenë burimi më i qëndrueshëm i financimit në raport me kanalet e tjera të financimit. Struktura e detyrimeve

të sektorit bankar në vitin 2017 dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 78.7% të gjithsej detyrimeve. Vlera totale e këtyre depozitave arriti në 2.89 miliard euro, me një rritje vjetore 7.2%. Depozitat e ekonomive familjare gjatë vitit 2017 kanë shënuar rritje vjetore prej 5.4%, ndërsa depozitat e ndërmarrjeve kanë shënuar rritje të përshpejtuar vjetore prej 14.1% (BQK, 2017).

Kursimet e ekonomive familjare, në formë të depozitave afatizuara dhe të transferueshme kanë shënuar rritje gjatë vitit 2018. Kjo rritje e depozitave ka ardhur si rezultat i ngritjes graduale të normës së interesit në depozita e cila ka pasur efekte në zvogëlimin e kostos oportune të mbajtjës së kursimeve dhe afatizimit të mjeteve. Në vitin 2018 depozitat u rritën për 8.7% më shumë se në vitin 2017, dhe arritën nivelin prej 3.36 miliardë euro (BQK 2018).

Vlera e trendit mesatar për shumën e depozitave në sistemin bankar në Kosovë (2005 – 2018) është 1,911.66 ose 1.9 miliard €, vlerë kjo që tregon se bankat komerciale në Kosovë gjatë kësaj periudhe kohore kanë shuma të mëdha të depozitave që mund shërbejnë si burime të rëndësishme për dhënien e kredive bankare.

2.9. Struktura e kredive në sektorin bankar në Kosovë (2005 - 2018)

Sektori bankar në Kosovë nga viti 2005 deri në vitin 2009 u karakterizua me hyrje të reja të bankave komerciale p.sh. në vitin 2007, Banka Qendrore licencoi dy banka komerciale të operojnë në Kosovë (BKT dhe Komercijalna Banka), ndërsa në vitin 2008 u licencuan TEB Banka dhe NLB Prishtina. Hyrja e bankave të reja komerciale në Kosovë e ndryshoi edhe strukturën e kredive në sektorin bankar në Kosovë.

Aktivet e sektorit bankar të Kosovës dominohen nga kreditë e lëshuara nga bankat komerciale. Në vazhdim do të analizojmë strukturën e kredive në përqindje për periudhën kohore 2005 - 2017 si dhe shpërndarjen sektoriale të kredive sipas viteve. Në vitin 2010, kreditë e dhëna nga bankat komerciale në Kosovë arritën vlerën prej 1.4 miliard euro dhe kanë shënuar rritje vjetore prej 9.6%. Sipas të dhënave në figurën 2.8. portofolion e kredive në vitin 2010 e dominojnë kreditë e dhëna për ndërmarrjet (74.9%), ndërsa kreditë për ekonomitë familjare arrijnë vlerën deri në 29.1%.

Tabela 2. 2. *Struktua e kredive në përqindje në sistemin bankar në Kosovë (2005-2017)*

Viti	Kreditë për ndërmarrje	Kreditë për ekonomitë familjare
2005	74.20%	25.80%
2006	76.80%	23.20%
2007	77.40%	22.60%

2008	76.80%	23.20%
2009	75.70%	24.30%
2010	70.90%	29.10%
2011	69%	29.70%
2012	67%	30.70%
2013	67.70%	30.80%
2014	67.30%	31.40%
2015	66.70%	33%
2016	64.80%	35%
2017	64%	35.80%
2018	63.58%	36.42%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Nëse i krahasojmë këto të dhëna me vitin paraprak, mund të themi se kreditë për ekonomitë familjare kanë shënuar rënie prej 4.8%. Gjatë kësaj periudhe është vërejtur një hezitim i bankave për të zgjeruar në masë të madhe kreditimin e ndërmarrjeve, që pasqyron pasigurinë e bankave rreth performancës së këtij sektori (BQK, 2010). Aktiviteti kredidhënës i bankave komerciale vazhdon të jetë një ndër burimet kryesore për financimin e konsumit dhe investimeve në vend. Në vitin 2011 kreditë e lëshuara nga bankat komerciale arritën vlerën deri në 1.6 miliard euro ose 34.3% të PBB-së.

Kreditë e lëshuara për ndërmarrjet kanë shënuar rritje vjetore prej 13.5%, ndërsa kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare ngadalësuan trendin e rritjes gjatë vitit 2011, duke shënuar rritje vjetore prej 16.9% (BQK, 2011). Edhe përkundër pasigurisë në tregjet financiare globale, përceptimet e bankave komerciale në Kosovë për një ambient ekonomik më stabil kanë ndikuar në rritjen e mëtutjeshme të kredidhënies. Vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga bankat komerciale në Kosovë në vitin 2012 ishte 1.77 miliard euro (36.2% e PBB-së).

Figura 2. 6. *Struktua e kredive në përqindje në sistemin bankar në Kosovë (2005-2018)*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Gjatë këtij viti kemi pasur një rritje shumë të vogël në krahasim me vitin e kaluar dhe kjo kryesisht vjen si rezultat i kredive për ndërmarrjet (14.1% në vitin 2011 dhe 5.2% në vitin 2012). Duke u bazuar në raportet hulumtuese të Bankës Qendrore, gjatë këtij viti bankat kanë raportuar rritje të kërkesës për kredi nga NVM-të dhe rënie të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet e mëdha. Bankat komerciale edhe përkundër rritjes së kërkesës për kredi nga NVM-të, ato vazhduan t'i shtërngojnë kriteret dhe standardet në procesin e kredidhënies (BQK, 2012).

Në vitin 2013 shuma e kredive totale të lëshuara nga bankat komerciale në Kosovë arriti vlerën në 1.83 miliard euro. Rritja vjetore e kredive gjatë këtij viti ishte 2.8%, që paraqet normën më të ulët të rritjes së kredive që nga fillimi i funksionimit të sistemit bankar në Kosovë. Gjatë këtij viti bankat komerciale ngadalësuan procesin e kreditimit për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare, për shkak se sektori bankar u karakterizua me nivel të kënaqshëm të likuiditetit dhe gjendje të mirë të mjaftueshmërisë së kapitalit rregullativ.

Kreditë për ekonomitë familjare kanë shënuar rritje vjetore prej 4.4%, ndërsa kreditë për ndërmarrjet kanë pasur rritje më të vogël vjetore në krahasim me vitin paraprak (3.1%) (BQK, 2013). Viti 2014 u karakterizua me rikuperim në sistemin e kreditimit në Kosovë. Në këtë vit vlera totale e kredive arriti deri në shumën 1.89 miliard euro, që paraqet rritje vjetore të kredive për 3.5%. Edhe gjatë këtij viti kemi lehtësim të kreditimit për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare, për shkak të likuiditetit dhe presioneve nga konkurrenca në sistemin bankar në Kosovë.

Kreditë për NVM-të gjatë vitit 2014 përfaqësojnë rreth 67.3% të gjithsej kredive, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare përfaqsojnë rreth 31.4% të portfolios kreditore (BQK, 2014). Në vitin 2015 kreditë mbeten kategoria më e rëndësishme e aseteve të sektorit bankar me një pjesëmarrje prej 61.3% në shumën totale të aseteve të sektorit bankar. Vlera totale e kredive në vitin 2015 ishte 2.01 miliard euro, që paraqet rritje vjetore prej 6.1%. Arsyet kryesore, që gjatë këtij viti kemi pasur rritje të aktivitetit kreditues, ishte rritja e kërkesës së bizneseve për zgjerim të kapaciteteve të tyre operuese dhe rritja e nivelit të konsumit nga familjet kosovare (BQK, 2015).

Pjesa më e madhe e kredive në sektorin bankar edhe në vitin 2016 dominohet nga kreditë për ndërmarrjet (64.8%), ndërsa kreditë për ekonomitë familjare ishin me pjesëmarrje 35% të portfolios kreditore. Vlera totale e kredive arriti në vlerën 2.17 miliard euro, që paraqet rritje vjetore 8.4%. Gjatë këtij viti vërehet që bankat komerciale kanë shtërnguar kriteret e kreditimit duke aplikuar norma më të larta të interesit, rritje të kërkesave për kolateral dhe zvogëlim të afatit të maturimit në kreditë e ofruara (BQK, 2016). Viti 2017 për sektorin bankar në Kosovë u karakterizua me rritjen më të lartë të aktivitetit kreditues në gjashtë vitet e fundit për 10%.

Ulja e normave të interesit dhe përmirësimi i kualitetit të portfolios kreditore kanë ndikuar në zgjerimin e aktivitetit kreditues. Po ashtu, edhe krijimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, i cili ofron siguri kolaterali për kreditë e dhëna nga bankat komerciale për NVM-të që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit. Pjesa më e madhe e kredive edhe në vitin 2017, dominohet nga kreditë për NVM-të 64%, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare përfaqsojnë 35.8% (BQK, 2017).

Trendi mesatar i kredive për ndërmarrjet e sektorit real në Kosovë (2005 – 2018) është 1,527.52 ose 1.52 miliard €, gjë e cila tregon se gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur rritje të vazhdueshme të shumës së kredive në sektorin real të ekonomisë.

2.10. Normat e interesit në kredi dhe në depozita në sektorin bankar në Kosovë dhe analizë krahasuese me vendet e Ballkanit Përendimor

Normat e interesit në kredi dhe depozita në sektorin bankar të Kosovës kanë treguar trend të vazhdueshëm rënieje. Diferenca ndërmjet normave të interesit në vitet e fundit është zvogëluar dhe kjo diferencë mund t'i atribouhet rënies së vazhdueshme të shkallës së koncentrimit në sistemin bankar. Nga kjo gjë që mund të konkludojmë se konkurrenca në sistemin bankar të Kosovës po shënon rritje (BQK, 2009). Nga viti 2005 deri në vitin 2009 normat e interesit në kredi ishin shumë të larta dhe arrinin vlerën prej 15%, ndërsa normat e interesit në depozita ishin deri në vlerën 4.5%.

Tabela 2. 3. *Normat e interesit në kredi dhe depozita në sistemin bankar në Kosovë (2005-2018)*

Viti	Norma e Interesit në Kredi	Norma e Interesit në Depozita
2005	14.93%	2.50%
2006	14.84%	2.53%
2007	14.68%	3.11%
2008	13.80%	4.13%
2009	14.40%	4.21%
2010	14.30%	4.00%
2011	14.30%	3.40%
2012	13.70%	3.40%
2013	12.80%	3.50%
2014	10.60%	0.60%
2015	7.60%	0.80%
2016	7.20%	1%
2017	6.80%	1.10%
2018	5.99%	1.47%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Norma mesatare e interesit në kredi ka ndjekur trend stabil, duke qëndruar në nivelin 14.3% në vitin 2010. Kreditë për ndërmarrje nga viti 2005 deri në vitin 2010, kryesisht kishin norma më të larta të

interesit se sa kreditë për ekonomitë familjare. Arsyet kryesore janë qasja më konservative e bankave komerciale ndaj bizneseve si dhe problabiliteti më i lartë i këtyre bizneseve që të dështojnë në projektet e ndërmarra, për shkak të troditjeve të ndryshme që ndodhin në nivelin makroekonomik (BQK, 2010). Në vitin 2010 normat e interesit në depozita kanë shënuar rënie në krahasim me vitin paraprak. Norma mesatare e interesit në vitin 2010 ishte 4.0% dhe zvogëlimi i normave të interesit mund të jetë rezultat e rënies së procesit të kredidhënies nga sektori financiar.

Në vitin 2011, normat e interesit u karakterizuan me tendencë të lehtë të rënies si për normat e interesit në kredi, ashtu edhe për normat e interesit në depozita. Normat e interesit në kreditë e ekonomive familjare zbritën në 12.3%, ndërkaq norma e interesit për kreditë e ndërmarrjeve zbriti në 15.6%. Normat e interesit për kreditë konsumuese gjatë këtij viti ka shënuar rritje duke arritur në vlerën 13.9% (BQK, 2011).

Gjatë vitit 2012 norma mesatare e interesit në kredi u zvoglua nga 14.3% në 13.7%, ndërsa norma e interesit në depozita mbeti e pandryshuar krahasuar me vitin paraprak. Faktorë të cilët ndikojnë në normat e interesit në sistemin bankar në Kosovë janë: kushtet e tregut, efikasiteti operativ, faktorët institucional dhe rregullimi bankar. Gjithashtu, struktura e kostos së ndërmjetësimit financiar ka pësuar ndryshime gjatë periudhës 2005 - 2011, kjo vërehet tek zvogëlimi i kostove operacionale duke tejkaluar në këtë mënyrë kostot e rrezikut (BQK, 2012).

Figura 2. 7. *Paraqitja grafike e normës së interesit të kredive dhe depozitave në sektorin bankar në Kosovë (2005-2018)*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Gjatë vitit 2013 normat e interesit në kredi u zvogëluan nga 13.7% në 12.8%, ndërsa normat e interesit në depozita u rritën nga 3.4% në 3.5%. Gjatë këtij viti kreditë për qëllime investive u

karakterizuan me norma më të ulta të interesit në krahasim me kreditë e tjera të biznesit. Sektori i bujqësisë edhe gjatë vitit 2013 kishte normë shumë të lartë të interesit në kredi (18.4%). Ndërsa normat e interesit në kredi për sektorin e shërbimeve arriti vlerën deri në 12.8% (BQK, 2013).

Viti 2014 në sektorin bankar në Kosovë u karakterizua me rënie të ndjeshme të normave të interesit në kredi, por sidomos në depozita. Norma e interesit në kredi u zvoglua nga 3.5% në 0.6%. Një rënie kaq e theksuar e normave të interesit në depozita u ndikua nga oferta e kënaqshme e depozitave. Krahasuar me vendet e rajonit, normat e interesit në kredi në Kosovë në vitin 2015 kanë shënuar rënie më të theksuar duke arritur një mesatare të përafërt me vendet e rajonit. Gjatë këtij viti normat e interesit në kredi janë zvogëluar nga 10.6% në 7.6%, ndërsa normat e interesit në depozita janë rritë nga 0.6% në 0.8%. Nëse krahasojmë me vendet e rajonit normat e interesit në depozita janë dukshëm më të ulta në Kosovë (BQK, 2015).

Gjatë vitit 2016, normat e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve zbritën në 6.8% nga 7.4%. Të gjitha kategoritë e kredive të reja ndaj ndërmarrjeve u karakterizuan me rënie të normave të interesit. Norma mesatare e interesit për kreditë investuese u zvogëlua nga 7.1% në 6.7%, ndërsa norma mesatare e interesit për kreditë jo-investuese zbriti nga 8% në 6.8% (BQK, 2016). Rënia e normave të interesit të sektorit bankar u ndikua nga rënia e normës mesatare të interesit si në kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu edhe ndaj ekonomive familjare. Normat e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në vitin 2017 zbritën në 6.6%, ndërsa në kreditë jo-investuese zbritën në 6.3% (BQK, 2017).

Norma e interesit në kredi në vitin 2018 janë zvogëluar për 0.81% në krahasim me vitin paraprak. Kjo rënie e normave të interesit në kredi ka ardhur si rezultat i presioneve të vazhdueshme konkurruese, përmirësimit të cilësisë së portfolios kreditore, progresi në reformat strukturore për zvogëlimin e rreziqeve në realizimin e kolateralit si dhe qasjes së mirë në financim (BQK, 2018).

Tabela 2. 4. *Norma e interesit në depozita në vendet e Ballkanit Përendimor (2005-2018)*

Viti	Kosova	Shqipëria	Bosine & Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
2005	2.50%	5.09%	3.56%	5.50%	4.99%	15.44%
2006	2.53%	5.23%	3.69%	4.71%	5.40%	11.00%
2007	3.11%	5.66%	3.56%	5.03%	3.35%	7.50%
2008	4.13%	6.80%	3.49%	6.19%	4.10%	15.25%
2009	4.21%	6.77%	3.60%	7.77%	3.86%	7.00%
2010	4.00%	6.42%	3.16%	7.47%	3.26%	9.00%
2011	3.40%	5.86%	2.80%	6.09%	3.25%	7.25%
2012	3.40%	5.42%	3.18%	5.17%	3.26%	8.75%
2013	3.50%	4.16%	3.01%	4.44%	2.91%	7.00%

2014	0.60%	1.91%	2.66%	3.71%	2.13%	5.50%
2015	0.80%	1.39%	2.06%	2.90%	1.45%	2.50%
2016	1%	0.83%	1.58%	2.50%	1.06%	2.50%
2017	1.10%	0.77%	1.21%	2.22%	1.02%	2.00%
2018	1.47%	0.80%	1.00%	2.00%	1.00%	1.98%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Siç vërehet në tabelën e mësipërme Kosova në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Përendimor gjatë periudhës kohore 2005 – 2018 ka aplikuar norma më të ulëta të interesit në depozita. Norma mesatare e interesit në depozita në Kosovë gjatë kësaj periudhe kohore (2005 – 2018) është 2.55%, ndërsa vendet e tjera të Ballkanit Përendimor kanë këto norma mesatare të interesit në depozita: Shqipëria (4.08%), Bosnia & Hercegovina (2.75%), Maqedonia e Veriut (4.69%), Mali i Zi (2.93%) dhe Serbia (7.33%).

Në bazë të këtyre të dhënave mund të vërehet se vendi i cili ka normat më të larta të interesit në depozita është Serbia, e cila në vitin 2005 kishte normë interesi në depozita deri në 15.44%. Një nga karakteristikat kryesore të kësaj analize krahasuese, siç mund të vërehet është ulja e vazhdueshme e normave të interesit në depozita pothuajse në të gjitha vendet e Ballkanit Përendimor.

Figura 2. 8. *Paraqitja grafike e normës së interesit në depozita për vendet e Ballkanit Përendimor (2005-2018)*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Ulja e vazhdueshme e normave të interesit në depozita shkakton edhe rënie në burimet e financimit të kredive për bankat komerciale. Në tabelën 2.5 janë të paraqitura të dhënat për normat e interesit në kredi për sektorin bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sipas të dhënave të analizës krahasuese, mund të vërehet që gjatë kësaj periudhe kohore të gjitha vendet e Ballkanit Përendimor karakterizohen me rënie të vazhdueshme të normave të interesit në kredi. Kosova, gjatë kësaj periudhe kohore vlerësohet të jetë vendi më normat më të larta të interesit në kredi, por edhe vendi më normat më të ulëta

të interesit në depozita. Rënia e vazhdueshme e normave të interesit në kredi, ka shkaktuar që Kosova në vitet e fundit të përafrohet me mesataren e vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor. Norma mesatare e interesit në kredi, për Kosovën gjatë kësaj periudhe kohore është 11.85%.

Tabela 2. 5. *Norma e interesit në kredi në vendet e Ballkanit Përendimor (2005-2018)*

Viti	Kosova	Shqipëria	Bosine & Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
2005	14.93%	13.07%	9.61%	12.51%	12.11%	3.50%
2006	14.84%	12.93%	8.01%	11.55%	9.94%	5.12%
2007	14.68%	14.09%	7.17%	10.50%	9.09%	4.39%
2008	13.80%	13.01%	6.97%	10.23%	9.40%	6.03%
2009	14.40%	12.66%	7.93%	11.16%	9.38%	6.87%
2010	14.30%	12.82%	7.88%	10.69%	9.63%	6.59%
2011	14.30%	12.43%	7.43%	9.60%	9.73%	11.73%
2012	13.70%	10.88%	7.32%	9.06%	9.47%	9.98%
2013	12.80%	9.82%	7.03%	8.48%	9.36%	9.28%
2014	10.60%	8.65%	6.64%	7.76%	9.22%	6.90%
2015	7.60%	8.72%	5.78%	7.45%	8.53%	6.50%
2016	7%	9.65%	5.23%	7.01%	7.45%	5.50%
2017	6.80%	6.59%	4.37%	6.60%	6.81%	5.00%
2018	5.99%	5.90%	3.80%	6.10%	6.40%	5.00%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Norma mesatare e interesit në kredi për vendet e tjera të Ballkanit Përendimor është si vijon: Shqipëria (10.80%), Bosnia & Hercegovina (6.80%), Maqedonia (9.19%), Mali i Zi (9.04%) dhe Serbia (6.60%). Sipas këtyre statistikave mund të konkludojmë se përsa i përket normës mesatare të interesit në kredi për periudhën kohore 2005 – 2018, Kosova ka normën më të lartë të interesit në rajon. Ndërsa, ashtu sikurse në rastin e depozitave ku Serbia kishte normat më të larta të interesit në depozita, edhe në rastin e kredive, ky vend vlerësohet të ketë kosto më të ulët të financimit për ndërmarrjet e sektorit real, pasi ka normat më të ulëta të interesit në kredi në krahasim me vendet e tjera të rajonit.

Rënia e theksuar e normave të interesit në kredi në sektorin bankar në Kosovë gjatë tri viteve të fundit ka ndikuar në përafrimin me normat të cilat ofrohen si në kredi, ashtu edhe në depozita me vendet e tjera të rajonit. Si rezultat i kësaj analize krahasuese, mund të vërejme se në të gjitha vendet e Ballkanit Përendimor gjatë periudhës së analizuar, kemi pasur një trend rënës të normave të interesit në kredi, por edhe në depozita.

Në vitin 2005, diferenca në mes normës së interesit në kredi dhe depozita në Kosovë ishte 12.43%, ndërsa në vitin 2017 është zvogëluar në 5.7%. Nëse kjo diferencë krahasohet me vendet e tjera të Ballkanit Përendimor atëherë Kosova qëndron më mirë se Shqipëria (5.82%) dhe Mali i Zi (5.79%).

Ndërsa vendet si Bosnia & Hercegovina (3.16%), Maqedonia (4.38%) dhe Serbia (3%) kanë një diferencë më të ulët në mes normave të interesit në kredi dhe në depozita.

Figura 2. 9. *Paraqitja grafike e normës së interesit në kredi për vendet e Ballkanit Përendimor (2005-2018)*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Për rastin e Kosovës, edhe pse kemi pasur rënie të theksuar të normave të interesit në kredi sidomos gjatë katër viteve të fundit, gjë e cila ka shkaktuar edhe zvoglimin e margjinës së interesit, në anën tjetër bankat gjatë kësaj periudhe kohore kanë rritur të hyrat nga jo-interesi. Si rezultat i zvogëlimit të normave të interesit në kredi, të hyrat nga interesi prej vitit 2014 deri në vitin 2017, janë zvogluar 78.6% në 72.6%, ndërsa të hyrat nga jo-interesi janë rritur nga 19.9% në 27%.

KAPITULLI III

KREDITË JO-PERFORMUESE DHE MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR

Në kapitullin e tretë do të diskutohet për ndikimin e menaxhimit të kredive jo-performuese në rritjen e kreditimit ndaj sektorit real. Ky kapitull do të paraqesë, në aspektin e rishikimit të literaturës, lidhjen ndërmjet kredive jo-performuese dhe menaxhimin e riskut kreditor si dhe efektet e këtij menaxhimi në kreditimin e sektorit real.

Menaxhimi i rrezikut njihet në botën e sotme të biznesit si një pjesë integrale e praktikës së mirë të menaxhimit. Ai përfshin aplikimin sistematik të politikave, procedurave, proceseve dhe praktikave të menaxhimit në detyrat e identifikimit, analizimit, vlerësimit, monitorimit dhe menaxhimit të rreziqeve. Institucionet financiare janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të ndryshme në ndjekje të objektivave të tyre biznesore, natyra dhe kompleksiteti i të cilave ka ndryshuar me shpejtësi me kalimin e kohës (Haneef, 2012).

Në studimin e tij, autori Haneef (2012) thekson që dështimi për të menaxhuar në mënyrë adekuate rreziqet i ekspozon institucionet financiare ndaj efekteve të pafavorshme në performancën e tyre financiare, duke përfshirë reduktimin e përfitimit dhe problemet e likuiditetit, duke i bërë ato në fund të fundit të pasuksesshme në arritjen e objektivave të tyre strategjike të biznesit. Shumë hulumtime mbi shkakun e dështimeve të bankave zbulojnë se cilësia e aktiveve është një parashikues statistikor i rëndësishëm i paaftësisë paguese (Barr & Siems, 1994, Demirguc-Kunt dhe Detragiache, 1998), dhe se institucionet financiare që dështojnë gjithmonë kanë nivele të larta të kredive që nuk i kanë dhënë pas dështimit.

Është argumentuar se kreditë jo-performuese janë një nga shkaqet kryesore të problemeve të stagnimit ekonomik. Çdo kredi jo-performuese në sektorin financiar shihet si një imazh humbjeje i pasqyruar i zhvillimit të ndërmarrjes (Biabani, 2012). Prandaj, politikat e menaxhimit me efikasitet të kredive jo-performuese janë një kusht i domosdoshëm për të përmirësuar gjendjen ekonomike të një vendi. Nëse kreditë jo-performuese nuk shlyhen dhe vazhdimisht rriten në sektorin financiar të një vendi, burimet financiare mbyllen në sektorë jofitimprurës dhe pengojnë rritjen ekonomike duke dëmtuar efikasitetin ekonomik.

Rreziku kreditor nënkupton mundësinë që një huamarrës ose pala tjetër në marrëdhëniet kreditore nuk përmbush detyrimet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Ekziston gjithmonë probabiliteti që

huamarrësi i një banke nuk do të paguajë kredinë e tij/saj si detyrim duke rezultuar në ekspozim ndaj rrezikut kreditor ose humbje financiare që ndryshe është e njohur si kredi me probleme. Këto humbje mund të marrin formën e humbjeve nga ndryshimet në vlerën e portofolios që rrjedhin nga përkeqësimi aktual ose i perceptuar i cilësisë së kredisë që është i reduktuar nga selektimi advers (Stulz, 2006).

Komiteti i Bazelit përcakton rrezikun e kredisë si potencial që një huamarrës ose një palë e bankës do të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të saj në përputhje me kushtet e miratuara. Menaxhimi i rrezikut të kredisë është një qasje e strukturuar për menaxhimin e pasigurive nëpërmjet vlerësimit të rrezikut, zhvillimin e strategjive për menaxhimin e tij dhe zbutjen e rrezikut duke përdorur burimet menaxheriale. Strategjitë përfshijnë transferimin tek një palë tjetër, duke shmangur rrezikun, duke reduktuar efektet negative të rrezikut dhe duke pranuar disa ose të gjitha pasojat e një rreziku të veçantë (Basel Committee on Banking Supervision, 2000).

Procesi i menaxhimit të rrezikut është një proces i realizuar në dy hapa. Hapi i parë është identifikimi i burimit të rrezikut, i cili është identifikimi i variablave kryesorë që shkaktojnë rrezikun. Hapi i dytë është hartimi i metodave për të përcaktuar rrezikun duke përdorur modele matematikore për të kuptuar profilin e rrezikut. Është thelbësore që bankat të kenë një kuadër gjithëpërfshirës të menaxhimit të rrezikut pasi rritja e qëndrueshme varet në mënyrë kritike nga zhvillimi i një kuadri gjithëpërfshirës i menaxhimit të rrezikut (Greuning & Iqbal, 2007).

Rreziku i kredisë është arsyeja më e shpeshtë e dështimeve bankare, duke shkaktuar pothuajse tek të gjitha autoritetet rregullatore të përshkruajnë standarde minimale për menaxhimin e rrezikut të kredisë. Autoritet rregullative mendojnë se baza e menaxhimit të shëndoshë të rrezikut të kredisë është identifikimi i rreziqeve ekzistuese dhe potenciale në aktivitetet kreditore. Masat për të luftuar këto rreziqe zakonisht përfshijnë politika të përcaktuara qartë të cilatshprehin filozofinë e menaxhimit të rrezikut të kredisë së bankës dhe parametrat brenda të cilave rreziku i kredisë është i kontrolluar. Masat specifike të menaxhimit të rrezikut të kredisë zakonisht përfshijnë tre lloje të politikave.

Një grup i politikave përfshin ato që synojnë të kufizojnë ose zvogëlojnë rrezikun e kredisë, siç janë politikat për përqendrimin dhe ekspozimet e mëdha, diversifikimin adekuat, kreditimin e palëve të ndërlidhura ose ekspozimet e tepërta (Greuning & Bratanovic, 2003). Kthimi në formën e fitimeve të pashpërndara është zakonisht një nga burimet kryesore të rritjes së kapitalit. Një sistem bankar i shëndoshë është i përbërë nga banka fitimprurëse dhe mjaft të kapitalizuara. Përfitueshmëria është një tregues i pozicionit konkurrues të bankës në tregjet bankare dhe një tregues i cilësisë së menaxhimit të saj. Kjo lejon një bankë të mbajë një profil të caktuar rreziku dhe siguron mbrojtje kundër problemeve afatshkurtra.

Në studimin e tyre autorët McNaughton & Dietz (1997) pohuan që rritja e kredive jo-performuese të Citibank çoi në përkeqësimin e aseteve në një nga institucionet më mirë të menaxhuara në botë. Sipas këtyre autorëve, presioni për të realizuar fitime të larta çoi në prirje të bankës për të dalë nga standardet e kreditimit të dokumentuara gjatë viteve 1980 (McNaughton & Dietz, 1997).

Provizioni i kredive jo-performuese është një mekanizëm mbi humbjet e pritshme të kredive që nuk shlyhen deri në fund të maturimit. Studimet e fundit praktikisht kanë treguar se raporti i lartë i kredive jo-performuese kërkon shuma të mëdha të provizioneve për humbje nga këto kredi (Hasan & Ëall, 2004).

Kreditimi i bizneseve dhe realizimi i investimeve janë dukuri të cilat çdo herë janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të ndryshme financiare. Bizneset të cilat vazhdimisht i aplikojnë kreditë si burime kryesore të financimit të jashtëm janë të ekspozuara ndaj këtyre llojeve kryesore të rreziqeve financiare: rreziku kreditor, rreziku i likuiditetit, rreziku i financimit, rreziku i investimeve etj. Rreziku i likuiditetit është rreziku kur bankat nuk kanë fonde të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet që kanë ndaj depozituesve. Situata mund të jetë një rrezik për bankat që janë përgjegjëse për pagimin e huadhënësve dhe investitorëve. Për huadhënësit dhe investitorët, nëse likuiditeti i bankave nuk përmirësohet, gjasat për të marrë paratë do të zvogëlohen (CPA Australia, 2009).

Në këtë kapitull është shumë e përshtatshme të rishikojmë rëndësinë e menaxhimit të kredive jo-performuese, sepse politikat e menaxhimit me efikasitet të kredive jo-performuese kanë ndikim në rritjen e kreditimit të sektorit real. Menaxhimi i rrezikut të kredisë në sektorin bankar është një proces i formimit dhe zbatimit të politikave për arritjen e objektivave. Objektivat e kredive joperformuese përqendrohen në mbrojtjen e zgjerimit të kredive me probleme, duke pasur tendecë në identifikimin e alternativave për reduktimin e këtyre kredive. Identifikimi i shkaqeve dhe pasojave të kredive me probleme është një element kritik dhe parakusht i domosdoshëm për të trajtuar fenomenin e kredive jo-performuese.

Woo (2000) ka renditur objektivat më të rëndësishme për menaxhimin e kredive jo-performuese siç janë: lehtësimi i ristrukturimit financiar; menaxhimi i suksesshëm i kredive jo-performuese duhet të synojë ruajtjen e likuiditetit dhe aftësisë paguese për institucionet financiare, rivendosjen e besimit dhe vlerësimin e kredisë si dhe rritjen e disiplinës së tregut kreditor (Woo, 2000).

Ahmed (2006) ka realizuar një hulumtim për të studiuar raportin në mes kredive jo-performuese, faktorëve makroekonomikë dhe faktorëve financiarë në kontekstin e bankave private tregtare në Bangladesh. Analiza empirike vlerëson se si kreditë jo-performuese të bankave ndikohen nga tre grupe kryesore të faktorëve ekonomikë dhe financiarë, e të cilat janë: kushtet e kredisë, preferencat e rrezikut

të shkaktuara nga madhësia e bankës dhe goditjet makroekonomike. Ky autor në studimin e tij zgjodhi 15 banka. Rezultatet tregojnë mbështetje për hipotezat se madhësia e bankës dhe afati i maturimit të kredisë kanë ndikim negativ në kredinë jo-performuese. Variablat e tjerë të analizuara në këtë studim nuk kanë ndonjë ndikim domethënës në kredinë me probleme (Ahmed, 2006).

3.1. Menaxhimi i riskut kreditor dhe ndërlidhja e tij me kreditë jo-performuese

Bankat janë ndërmjetës në tregun e kapitalit, që funksionojnë për të lehtësuar transaksionet në treg. Çështjet problematike në funksionimin e bankave do ta ngarkojnë sistemin bankar në të cilën kreditë jo-performuese janë një nga çështjet kryesore të debateve shkencore dhe akademike. Menaxhimi i rrezikut të kredisë përbën një pjesë kyçe të strategjisë së përgjithshme të menaxhimit të rrezikut të një kompanie. Menaxhimi i dobët i riskut të kredisë është problemiparësor i shumë dështimeve të biznesit. Për shembull, shumë ndërmarrje të vogla dhe të mesme nuk kanë as burimet dhe as ekspertizën për të operuar në një sistem të shëndoshë për menaxhimin e kredive (Richardson, 2002).

Qëllimi i menaxhimit të rrezikut kreditor është që të maksimizohet norma e kthimit të rregulluar nga rreziku i bankës duke ruajtur ekspozimin e rrezikut kreditor brenda parametrave të pranueshëm. Bankat kanë nevojë p të menaxhuar rrezikun kreditor për të gjithë portfolion e tyre investues, si dhe rrezikun kreditor për transaksionet individuale. Bankat gjithashtu duhet të marrin në konsideratë marrëdhëniet midis rrezikut të kredisë dhe rreziqeve të tjera. Menaxhimi efektiv i rrezikut të kredisë është një komponent kritik i një qasjeje gjithëpërfshirëse në procesin e menaxhimit të riskut kreditor dhe është thelbësor për suksesin afatgjatë të çdo banke komerciale (Hull, 2015).

Teknikat kryesore për matjen e riskut kreditor përfshijnë: vlerësimin e kredive, zhvillimin e një politike kreditore, vlerësimin e ekspozimit të kredisë dhe përcaktimin e primit të rrezikut kreditor. Rreziku kreditor është i rëndësishëm për të gjitha institucionet financiare duke përfshirë edhe bankat komerciale, sepse burimet e aplikuara lehtësojnë borxhet e këtyre institucioneve financiare (bankave) ndaj aksionarëve të tyre edhe nëse paratë nuk kanë rrjedha pozitive, potenciali i dhënies së kredisë dhe kthimi i kapitalit të aksionarëve zvogëlohet (Jamaat & Asgari, 2010).

Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të kredisë është që ky lloj rreziku të mbahet në nivel të pranueshëm të ekspozimit për të maksimizuar kthimin nga ky rrezik. Prandaj, përgjegjësitë në bankë duhet të përcaktohen në mënyrë precize, me qëllim që të sigurohet se politikat dhe procedurat e bankës në menaxhimin e rrezikut të administrohen në mënyrë efektive.

Teoria e informacionit asimetrik na tregon se mund të jetë një pozicion i vështirë për bankën të dallojë huamarrësit e mirë nga huamarrësit e këqinj, të cilët mund të rezultojnë në probleme të zgjedhjës së keqe (selektimit advers) dhe të rrezikut moral. Kjo teori shpjegon se në treg, pala që posedon më shumë informata për një artikull të veçantë e që duhet të shitet nëpërmjet një transaksioni është në një pozicion më të mirë sesa pala tjetër për të negociuar në lidhje me transaksionin në fjalë (Auronen, 2003).

Studimet e asimetrisë së informacionit përqendrohen në bankën si huadhënës, klientin si huamarrës dhe në marrëdhëniet bankare ndërmjet të dyja palëve. Në huadhënien bankare, në thelb mund të dallohen huatë e bazuara në transaksione (kreditimi duke u bazuar në pasqyrat financiare, huadhënien e bazuar në aktive, vlerësimi i kredisë, etj.) dhe marrëdhëniet kreditore (Lehmann & Neuberger, 2001).

Sipas teorisë së agjencisë, problemi kryesor i agjencisë mund të reduktohet nëpërmjet një monitorimi më të mirë, siç është krijimi i stimujve më të përshtatshëm për menaxherët. Çështjet e kostos së agjencisë për menaxhimin e rrezikut të korporatave kanë treguar se këto kosto ndikojnë në qëndrimet menaxheriale ndaj marrjes së rrezikut dhe funksionimin e hexhingut. Kjo teori gjithashtu shpjegon një mospërputhje të mundshme të interesit midis aksionarëve dhe zotëruesve të borxhit për shkak të asimetrisë së informacionit, gjë që mund të rezultojë në ndërmarrje më të madh të rrezikut ose mos përfshirje në ndonjë projekt investues me vlerë aktuale neto pozitive (Smith & Stulz, 1985).

Kreditë jo-performuese (KJP-të) janë kredi me vonesë ose në afërsi të mosveprimit. Shumë kredi bëhen jo-performuese pasi janë në vonesë për 90 ditë, por kjo mund të varet nga kushtet e kontratës. Një kredi është jo-performuese kur pagesat e interesit dhe të principalit kanë kaluar më shumë se 90 ditë ose të paktën 90 ditë të pagesave të interesit janë kapitalizuar (International Monetary Fund, 2005).

Literatura identifikon dy grupe faktorësh për të shpjeguar evolucionin e KJP-ve me kalimin e kohës. Një grup fokusohet në ngjarje të jashtme të tilla si kushtet e përgjithshme makroekonomike, të cilat mund të ndikojnë në aftësinë e huamarrësve për të shlyer kreditë e tyre, ndërsa grupi i dytë i faktorëve fokusohet më shumë në ndryshueshmërinë e KJP-ve nëpër banka (Klein, 2013).

Sipas autorëve Berger dhe DeYoung në vitin 1997 që studiuan lidhjet midis KJP-ve, efikasitetit të kostos dhe kapitalizimit në bankat komerciale të SHBA-ve për periudhën 1985-1994, gjetën një shkaktar të dyanshëm midis efikasitetit të kostos dhe KJP-ve. Këta autorë në studimin e tyre shpjeguan kauzalitetin nga kreditë jo-performuese në efikasitetin e kostos, të nxitura kryesisht nga përkeqësimi i kushteve makroekonomike. Në veçanti, kjo hipotezë argumenton se efikasiteti i ulët i kostos është një sinjal i praktikave të dobëta të menaxhimit, duke nënkuptuar kështu që si rezultat të kredive të këqija, monitorimit dhe kontrollit, kreditë jo-performuese ka të ngjarë të rriten (Berger & DeYoung, 1997).

Një nga studimet më të hershme që ka shqyrtuar marrëdhënien midis kredive jo-performuese dhe menaxhimit të rrezikut të kredisë është studimi i realizuar në vitin 1987 nga autorët Keeton dhe Morris. Këta autorë shqyrtuan humbjet nga 2,470 bankat tregtare të siguruara në Shtetet e Bashkuara (SHBA) gjatë viteve 1979-1985. Në studimin e tyre u analizua se bankat komerciale me oreks më të madh të rrezikut kanë tendencë të regjistrojnë humbje më të larta (Keeton & Morris, 1987).

Disa studime të mëvonshme, për shembull studimi i autorit Haneef (2012) arriti në përfundim se kreditë jo-performuese po rriten për shkak të mungesës së menaxhimit të rrezikut që kërcënon rentabilitetin e bankave komerciale.

Sipas autorëve Ekrami dhe Rahnama (2009) shuma e lartë e KJP-ve paraqet rrezik të lartë kreditor për gjithë sistemin bankar dhe kjo ndikon që bankat të ekspozohen edhe ndaj rreziqeve të tregut dhe rreziqeve të likuiditetit. Edhe pse bankat po përpiqen të kontrollojnë rreziqet brenda organizatës përqindja e lartë e këtij rreziku dhe pasojat e tij për të ardhmen nuk mund të shpërfillen. Kredia jo-performuese krijohet për shkak të kritereve të dobëta të analizave të kredive, politikave joefektive, pranimit të riskut në nivel të pakufizuar dhe treguesve të tjerë funksionalë (Morton, 2003).

3.2. Ndikimi i menaxhimit të kredive jo-performuese në profitabilitetin e sektorit bankar

Profitabiliteti i sektorit bankar është një subjekt që ka marrë shumë vëmendje në vitet e fundit dhe tani ekziston një literaturë e gjerë që ka shqyrtuar rolin e luajtur nga menaxhimi i burimeve në përcaktimin e rentabilitetit të bankës. Treguesit e përdorur për matjen e rentabilitetit janë të shumta dhe përfshijnë Kthimin e Aseteve, Kthimin e Kapitalit dhe Margjinën e Interesit Neto.

Ahmed (2003) identifikoi tre indikatorët, gjegjësisht: marigjinën nga interesi neto (NIM), kthimin e aktiveve (ROA) dhe kthimin e kapitalit (ROE) që do të aplikohen në masë të madhe në literaturë për të matur profitabilitetin e bankave komerciale. Përfitueshmëria nënkupton një situatë ku të ardhurat e krijuara gjatë një periudhë e caktuar tejkalon shpenzimet e bëra gjatë të njëjtës periudhë kohore për të vetmin qëllim të krijimit të të ardhurave (Sanni, 2009).

Berger et al. (1997) në studimin e tij analizoi ndikimin e menaxhimit të kredive jo-performuese në profitabilitetin e bankave komerciale. Kreditë jo-performuese mund të trajtohen si rezultate të padëshirueshme ose shpenzime për një bankë huadhënëse, të cilat ulin performancën e bankës (Chang, 1999).

Sipas Kroszner (2002), kreditë jo-performuese janë të lidhura ngushtë me krizat bankare. Në një studim në vitin 2003, autori Batra vuri në dukje se kreditë jo-performuese përveç ndikimit mbi rentabilitetin, likuiditetin dhe funksionin konkurrues, këto kredi gjithashtu ndikojnë edhe në sjelljen e bankave në lidhje me alokimin e fondeve drejt ofrimit të kredisë dhe zgjerimin e aktivitetit kreditor. Bankat komerciale mund të kenë prirje drejt investimeve më të rrezikshme për të shmangur dhe zvogëluar riskun kreditor, gjë që nuk është e favorshme për rritjen e ekonomisë.

Michael et al. (2006), theksoi se kreditë jo-performuese ndikojnë në efiçencën operacionale të portfolios kreditore, e cila ndikon në pozicionin e rentabilitetit, likuiditetit dhe aftësisë paguese të bankave (Michael, Vasanthi, & Selvaraju, 2006). Sipas rregullores dhe mbikëqyrjes bankare të Turqisë (2005), rreziku mund të definohet si: "*Mundësia e uljes së përfitimit ekonomik për shkak të një humbje monetare ose një shpenzimi të paparashikuar në lidhje me një transaksion"* (Haneef, Riaz, & Ramzan, 2012).

Profitabiliteti i bankave mund të pasqyrojë gjithashtu sjelljen e menaxherëve të riskut. Bankat komerciale me profitabilitet të lartë janë më pak të nxitura nga krijimi i të ardhurave dhe më pak të kufizuara për t'u ekspozuar ndaj riskut kreditor. Në të njëjtën kohë, bankat komerciale joefikase kanë më shumë gjasa të përjetojnë një nivel të lartë të kredive jo-performuese. Menaxhimi i dobët i kredive nënkupton monitorim të dobët të kostove operacionale dhe cilësisë së kredive, të cilat do të përfshijnë nivele të larta të humbjeve kapitale (Haneef, Riaz, & Ramzan, 2012).

Autori Godlewski (2004) në studimin e tij mbi ndikimndikimin e kredive jo-performuese në rentabilitetin e bankave komerciale, ka përdorur raportin Kthimi nga Aktivet (ROA) si një ndër treguesit kryesor për të matur performancën e bankave komerciale. Sipas këtij studimi raporti i kredive jo-performuese ka ndikim negativ në rentabilitetin e bankës (Godlewski, 2004).

Garcia-Marco dhe Robles-Fernandez (2007) kanë gjetur se politikat e maksimizimit të fitimit do të shoqërohen çdo herë nga niveli më i lartë i rrezikut. Pranimi dhe menaxhimi i rrezikut financiar është i pandarë në biznesin e bankave si ndërmjetës financiar. Menaxhimi i rrezikut siç perceptohet zakonisht nuk nënkupton minimizimin e rrezikut, por qëllimi i menaxhimit të rrezikut është të optimizojë shpërblimin e riskut. Pavarësisht nga fakti se bankat komerciale janë të angazhuara në veprimtari ku marrin përsipër rrezikun kreditor, duhet të identifikohet që një institucion financiar i tillë nuk duhet të absorbojë rrezikun kreditor që mund të transferohet tek pjesëmarrësit e tjerë.

Disa studiues (Prakash dhe Poudel, 2012, Roman dhe Tomuleasa, 2013, Samuel dhe të tjerët 2012, Kithinji, 2010) të cilët kanë analizuar ndikimin e menaxhimit të rrezikut kreditor në performancën financiare të bankave kanë dalë me rezultate dhe konkluzione të ndryshme.

Poudel (2012) në studimin e tij mbi ndikimin e normave të interesit dhe kostove për kreditë bankare në Nepal arriti në përfundim se menaxhimi i rrezikut kreditor i matur sipas normës së parazgjedhur është vendimtar për ecurinë e aktivitetit të bankës, pasi kjo normë kontribuon ndjeshëm në përfitimin e bankës.

Po ashtu, studimi nga autorët Roman & Tomuleasa (2013) mbi ndikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm mbi rentabilitetin e bankave komerciale në vendet e BE-së, zbuloi se rritja e kredive jo-perfomuese kishte një ndikim negativ në rentabilitetin e bankave. Gjithashtu edhe në studimin e autorit Kargi (2011) mbi marrëdhënien midis rrezikut kreditor dhe rentabilitetit të bankave tregtare nigeriane, zbuloi një marrëdhënie negative midis rrezikut kreditor dhe rentabilitetit të bankave komerciale në Nigeri.

Karim, (2010) në studimin e tij shqyrtoi marrëdhënien midis kredive jo-performuese dhe efikasitetit bankar në Malajzi dhe Singapor, rezultatet e këtij studimi identifikuan se një incidencë më e lartë e kredive jo-performuese zvogëlon efikasitetin e kostove të bankave, duke ndikuar negativisht në përfitimin e këtyre institucioneve financiare. Në studimin e tyre mbi raportin e rrezikut kreditor ndaj performancës së bankës, të matura nga kthimi i aktivit, autorët Kaaya & Pastory (2013) gjetën një korrelacion negativ midis rreziqeve të kredisë dhe përfitimit të bankës.

3.3. Faktorët makrokonomik që përcaktojnë nivelin e kredive jo-performuese

Bankat janë një ndër pjesëmarrësit më të rëndësishëm në sistemin financiar të një vendi dhe luajnë një rol kryesor në ekonominë globale. Prandaj, nëse sistemi financiar nuk funksionon si duhet, problemet e këtij sistemi kanë një ndikimndikim të fortë në të gjithë ekonominë globale. Për këtë arsye, politikëbërësit, rregullatorët, akademikët dhe studiuesit e tjerë i kushtojnë vëmendje të madhe stabilitetit financiar të një një vendi (Rodriguez-Moreno & Pena, 2013). Aktiviteti i bankave komerciale ndikohet vazhdimisht nga faktorë të ndryshëm që shkaktojnë lloje të ndryshme rreziqesh financiare. Pra, menaxhimi i rrezikut financiar është një shqetësim i madh për të gjitha bankat.

Sipas Al-Jarrah (2012) burimet e institucioneve financiare që përballen me rreziqe financiare mund të ndahen në dy kategori kryesore: sistematike dhe jo-sistematike. Faktorët e rrezikut sistematik kanë një ndikimndikim të fortë në të gjitha institucionet financiare në tregun financiar dhe burimet e rrezikut sistematik lidhen me variabla që janë jashtë kontrollit të bankës. Burimet e rrezikut jo-sistematik ndryshojnë dhe lidhen pjesërisht me variablat specifike të bankës. Një nga problemet aktuale me bankat është rritja e kredive jo-performuese (KJP). Shkaqet e këtij mosfunksionimi mund të lidhen me faktorët

sistematikë dhe jo-sistematik, si pabarazitë makroekonomike dhe eksternalitetet e tjera negative, ekspozimet e lidhura me humbjet, flluska e aseteve, cilësia e menaxhimit të rrezikut kreditor etj.

Praktika bashkëkohore e menaxhimit të rrezikut kreditor thekson dhe promovon përdorimin e modeleve të vlerësimit të rrezikut kreditor për klasa të ndryshme të aktiveve të portofolis së kredisë bankare për automatizimin e procesit të miratimit të kredisë. Duke përdorur automatizimin e procesit kredidhënës, kostot e stafit të bankës janë zvogëluar, procesi i miratimit të kredisë është thjeshtësuar dhe përshpejtuar si dhe është arritur më shumë kontroll mbi procesin e vendimmarrjes së miratimit të kredive (Nikolic, Joksimovic, & Stojanovski, 2013).

Në qoftë se një bankë komerciale financon huamarrësit potencial me një nivel të ulët rreziku, mundësia e rritjes së kredive jo-performuese është rrjedhimisht e ulët. Megjithatë ekziston probabiliteti që niveli i rrezikut kreditor të një debitori në të ardhmen mund të ndryshojë dhe shpesh lidhet me ngjarje të forta sistematike që ndikojnë negativisht në tregjet financiare dhe ekonominë në përgjithësi (Patro & Sun, 2013).

Fiordelisi dhe Marques-Ibanez (2013) kanë gjetur se rreziku sistematik është dukshëm më i lartë në sektorin bankar sesa në sektorët e tjerë të industrisë. Vartësitë në sektorin bankar janë kryesisht të nxitura nga faktorë të përbashkët, ndërsa në sektorë të tjerë ata përgjithësisht udhëhiqen nga faktorë individual. Gjithashtu, duke pasur të dhëna të sakta për vlerësimin e rrezikut kreditor, banka mund të kërkojë që të kontrollojë afatet e saj kohore në lidhje me ndryshimet e kushteve ekonomike që mund të rezultojnë në një konsistencë më të ulët (Moges, Dejaeger, & Baesens, 2013).

Në studimin e tij autori Westenmann (2003) tregoi se rritja e vazhdueshme e kredisë jo-performuese ishte një nga arsyet e përkeqësimit të kredive në Gjermani pas zgjerimit shumë të shpejtë të huadhënies nga ana e institucioneve financiare. Në një studim tjetër të realizuar nga Shingjergji (2013) rezultati empirik tregoi se rritja e PBB-së, normës së interesit dhe kursit të këmbimit valutor kanë ndikuar pozitivisht në raportin e kredive jo-performuese, ndërkohë që inflacioni ka një raport negativ me raportin e kredive jo-performuese në sektorin bankar në Shqipëri.

Trendi rritës i kredive jo-performuese ka qenë gjithmonë shqetësimi kryesor i drejtuesve të bankave, rregullatorëve dhe krijuesve të politikave për shkak të efektit të tyre negativ në ekonominë e një vendi. Për shembull, kreditë jo-performuese zvogëlojnë profitabilitetin e bankave, çojnë në kriza financiare dhe ndikojnë në nivelin e investimeve vendase. Autorët që analizojnë ndikimin e faktorëve ekonomikë përqëndrohen si në ngjarjet e jashtme ashtu edhe në kushtet e përgjithshme makroekonomike, të cilat mund të ndikojnë në aftësinë e huamarrësve për të shlyer kreditë e tyre dhe ndryshueshmërinë e KJP-ve ndërmjet bankave (Mazreku, Morina, Misiri, Spiteri, & Grima, 2018).

Turan dhe Koskija (2014) shqyrtojnë rritjen e vazhdueshme të KJP-ve në Shqipëri që rezultojnë nga problemet e shkaktuara nga kriza ekonomike dhe ulja e të ardhurave të emigrantëve. Këta autorë në studimin e tyre aplikuan të dhëna tremujore për periudhën 2003-2013 dhe një test multivariate të kointegrimit për të zbuluar se KJP dhe PBB-ja reale, papunësia, inflacioni, norma e interesit të kredisë dhe remitancat janë bashkë-integruar në planin afatgjatë, por jo në mënyrë të fortë.

Turan (2016) në një studim të mëvonshëm në lidhje me treguesit makroekonomikë mbi kreditë jo-performuese në sektorin bankar në Shqiperi gjatë periudhës 2007 - 2014, konstaton se kreditë jo-performuese kanë një korrelacion negativ me remitancat dhe shkallën e papunësisë.

Në procesin e vlerësimit të rrezikut të kredisë, zakonisht rreziku i një kredie përcaktohet kryesisht nga faktorët individualë që lidhen me një huamarrës potencial të kredisë dhe një numër më të vogël të faktorëve makroekonomikë që përdoren për ta shpjeguar atë. Në mjedise me një rrezik më të ulët makroekonomik, pesha e rrezikut idiosinkratik është më i lartë, prandaj roli i treguesve financiarë në procesin në vendimmarrjes kreditore është shumë i rëndësishëm. Kur gjendja financiare e shumë debitorëve është e pranueshme dhe faktorët makroekonomikë nuk konsiderohen të mjaftueshëm, atëherë kjo shkakton zgjerim të shpejtë të kredive nga ana e bankave komerciale (Mileris, 2014). Figura e mëposhtme tregon se nivelet aktuale të kredive jo-performuese në Bashkimin Evropian nuk janë mesatarisht në nivele shumë të larta.

Figura 3. 1. *Zhvillimi i raportit të kredive jo-performuese në vendet e Bashkimit Evropian*



Burimi: World Development Indicators, IMF http://european-economy.eu

Raporti mesatar i kredive jo-performuese (jo i peshuar) në një mostër prej mbi 130 shtetesh është rreth 7.5%, pak mbi mesataren prej 7.1% në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE) si dhe në Bashkimin Evropian (BE) është peshuar me vlerën 5.5%. Këto mesatare janë vlera shumë më të

vogla se vlera 12%, e cila ishte vlerë rekorde e arritur në vitin 1999 pas krizave fiannciare meksikane, aziatike dhe ruse.

Kero (2013) në studimin e tij ka treguar se zgjerimi i shpejtë i kredive bankare nga intistucionet financiare kredidhënëse janë disa nga treguesit më të mirë të një krize fnanciare në tregjet fnanciare dhe ato mund të ulin në mënyrë të konsiderueshme stabilitetin financiar. Studimet e kohëve të fundit kanë dhënë dëshmi empirike se rreziku makroekonomik është thelbësor për të kuptuar rrezikun kreditor dhe vendimet e strukturës së kapitalit.

Duke përdorur analizën e regresionit të shumëfishtë linear, Clichici dhe Colesnicova (2014) kanë vërejtur se kreditë jo-performuese bankare në Republikën e Moldavisë janë të prekura nga struktura të ndryshme të sektorit bankar, zgjedhjet e tyre politike dhe gjithashtu nga mjedisi makroekonomik. Këta autorë nëpërmjet studimit të tyre vërejten se rritja e kredive jo-performuese shkakton ulje të PBB-së, eksporteve dhe remitancave si dhe rritje të papunësisë. Megjithatë, këta autorë në hulumtimin e tyre nuk arriten të gjejnë një korrelacion midis kredive jo-performuese dhe borxhit privat.

Autorët Rossi, Schwaiger dhe Winkler(2005) në studimin e tyre analizuan një mostër prej 278 bankash në nëntë vende në tranzicion, midis periudhës 1995-2002, duke përdorur teknikat e Granger-Kauzalitetit për të testuar marrëdhëniet midis cilësisë së kredisë, efikasitetit të kostos dhe kapitalit bankar. Këta autorë zbuluan se rritjet e kredive jo-performuese zakonisht pasohen nga ulja e efikasitetit të kostos. Kjo ndodh pasi bankat rrisin shpenzimet për monitorimin, përpunimin dhe / ose shitjen e këtyre kredive, duke u bërë më të efektshëm në menaxhimin e pjesës së portofolios ekzistuese të kredive jo-performuese. Nga ana tjetër, ulja e efikasitetit të kostos zakonisht ndiqet nga rritja e KJP-ve, për shkak të praktikave të këqija të menaxhimit, siç janë shpenzimet e tepruara, praktikat e marrjes së rrezikut dhe monitorimit. Për më tepër ky studim thekson se raportet e ulta të kapitalit bankar mund të inkurajojnë menaxhmentin të marrë më shumë rreziqe në portfolion e tyre dhe në të njejtën kohë duke rritur nivelin e kredive jo-performuese.

Fofcack (2005) gjeti një kauzalitet të fortë midis kredive jo-performuese dhe rritjes ekonomike, vlerësimit të kursit real të këmbimit, normës reale të interesit, marzhës neto të interesit dhe kredive ndërbankare. Ai përdori modelet dinamike për të dhënat panel të disa vendeve afrikane. Espinoza dhe Prasad (2010) treguan se rritja më e ulët ekonomike dhe normat e larta të interesit çuan në rritje të kredive jo-performuese. Duke përdorur të dhënat e paneleve dinamike gjatë viteve 1995-2008 të rreth 80 bankave në vendet e Gjirit Persik (Arabia Saudite, Bahreini, Omani, Kuvajti, Katari dhe Emiratat e Bashkuara Arabe), studimi gjeti një marrëdhënie pozitive midis rritjes së kreditimit dhe kredive jo-performuese.

Blavy dhe Suoto (2009) në studimin e tyre kanë gjetur variabla makrofinanciare vendore dhe të jashtme që lidhen ngushtë me stabilitetin financiar në sistemin bankar meksikan. Në nivelin total, luhatshmëria e jashtme e lartë e normave të interesit u shoqërua me një probabilitet të pritur të lartë. Pesola (2001) analizoi të dhënat panel nga viti 1980 deri në vitin 2002 për të treguar se borxhi i lartë i konsumatorëve, i kombinuar me goditje të papritura makroekonomike ndaj të ardhurave dhe normave reale të interesit, shkaktojnë shqetësime të mëdha në sektorin bankar.

Keeton dhe Morris (1987) përqendrohen në konceptin e rrezikut moral, duke gjetur se bankat komerciale, me nivel të ulët të raportit të kapitalit ndaj aktiveve, inkurajohen të ndërmarrin rrezik më të lartë në portofolin e tyre të kredisë. Si pasojë e kësaj, niveli i kredive jo-performuese është rritur. Kjo marrëdhënie negative midis raportit të kapitalit dhe KJP-ve është gjithashtu një gjetje empirike nga autorët Berger dhe DeYoung (1997) dhe Salas dhe Saurina (2002).

Studimet empirike në lidhje me faktorët që përcaktojnë nivelin e kredive jo-performuese tregojnë se rritja reale e PBB-së zakonisht përkthehet në nivele më të larta të të ardhurave, duke përmirësuar kapacitetin financiar të huamarrësve. Megjithatë, nga ana tjetër, kur ekonomia është nën kushtet normale ose në recesion, niveli i kredive jo-performuese mund të rritet për shkak të rritjes së papunësisë, me huamarrësit që përballen me vështirësi të mëdha për të shlyer borxhin e tyre (Thalassinos & Stamatopoulos, 2015).

3.4. Ndikimi i menaxhimit të kredive jo-performuese në rritjen ekonomike

Bankat mbledhin mjete financiare nga njësitë ekonomike me fonde të tepërta dhe janë të detyruara t'i transferojnë këto fonde në njësinë ekonomike që ka nevojë për fonde. Këto banka komerciale kryejnë këtë detyrë brenda kuadrit të veprimtarisë së tyre, efikasitetit dhe parimeve të kostos oportune. Për këto arsye, ato janë institucionet më kritike të ekonomisë në kuptim të autoritetit dhe përgjegjësisë (Erdoğdu, 2015).

Raporti më i lartë i kredive jo-performuese i bën bankat më të kujdesshme gjatë procesit të kredidhënies. Rritja e kredive jo-performuese ndikon negativisht jo vetëm në sektorin bankar, por edhe në ekonominë kombëtare. Nëse efektet më pak të dëmshme të këtyre kredive jo-performuese nuk mund të tejkalohen, ato shkaktojnë kriza të reja financiare. Kreditë jo-performuese ndikojnë në rritjen e normave të interesit për kreditë bankare, të cilat negativisht ndikojnë në përfitimin e bankave dhe në këtë rast shpie në rritje të kostove dhe inflacionit (Balgova, Nies, & Plekhanov, 2016). Këto kredi gjithashtu dëmtojnë bizneset e tjera, pra llojet e kredive të përdorura nga bizneset shkaktojnë kosto

direkte dhe indirekte. Shpenzimet e përllogaritura shkaktojnë falimentimin e kompanisë, nxisin shitjet e humbura, rriten kostot e kredisë dhe ulin rentabilitetin (Erdoğdu, 2016).

Shumë studime shkencore (Gonzales-Hermosillo, 1997; Lu & Whidbee, 2013; Barr, Seiford, & Siems, 1994) theksojnë se shuma e lartë e kredive jo-performuese shpreh një parashikues të rëndësishëm të dështimit të bankës. Kur bankat shmangin dështimin, kreditë jo-performuese ndikojnë negativisht në strukturën dhe efikasitetin e kostos së bankës dhe gatishmërinë e tyre për të dhënë hua.

Leon dhe Tracey (2011) në studimin e tyre specifikojnë më tej një model ku bankat japin më pak kredi kur raporti i kredive jo-performuese rritet mbi një nivel të caktuar. Duke parë të dhënat panel për dy vendet e Karaibeve, këta autorë zbulojnë se rritja e raportit të kredive jo-performuese i bënë bankat më të rrezikuara ndaj kreditimit të tyre dhe konkludojnë se "efikasiteti i sektorit bankar mund të rrezikohet shumë nga kreditë jo-performuese". Kreditimi i bankave, nga ana tjetër, është vendimtar për funksionimin e mirë ekonomik të një vendi. Kredia nuk është e nevojshme vetëm për zgjerimin e biznesit, por edhe për shpenzimet operacionale ditore (kapitali qarkullues).

Amador, Gómez-González dhe Pabón (2013) kanë studiuar lidhjen midis rritjes jonormale të kredisë dhe marrjes së rrezikut të bankave duke përdorur informacion mbi bilancet kontabël të bankave komerciale në Kolumbi në periudhën kohore 1990 - 2011. Këta autorë në studimin e tyre përdorën të dhëna nga gjashtëdhjetë e katër institucione financiare, të siguruara nga Banka Qendrore e Kolumbisë dhe testuan rritjen jonormale të kredisë në profitabilitetin e bankave komerciale. Përveç kësaj, ata testuan efektin e rritjes jonormale të kredisë në stabilitetin financiar të bankave (aftësinë paguese, kreditë jo-performuese dhe qëndrueshmërinë financiare), duke përdorur të dhëna serike mbi institucionet financiare kolumbiane në mes viteve 1990 dhe 2011. Rezultatet e tyre tregojnë se rritja jonormale e kredisë gjatë një periudhe të qëndrueshme çoi në zvogëlimin e raporteve të kapitalit të bankave dhe në rritjen e raportit të kredive jo-performuese ndaj totalit të kredive.

Në studimin e tyre të vitit 2009, autorët Khemraj dhe Pasha synonin të analizonin reagimin e kredive jo-performuese ndaj faktorëve makroekonomikë dhe specifik bankar në Guajanë duke përdorur analizën e regresionit. Rezultatet e analizës së tyre të korrelacionit tregojnë se kreditë jo-performuese dhe raporti i kredive ndaj aktiveve janë të lidhura pozitivisht, duke nënkuptuar se bankat që marrin rreziqe më të mëdha kanë tendencë të kenë një sasi më të madhe të kredive jo-performuese. Rezultatet ekonometrike të këtij studimi evidentojnë se rritja e PBB-së dhe madhësia e bankës janë të lidhura negativisht me kreditë jo-performuese, pasi që bankat më të mëdha nuk kanë pasur nivel më të ulët të kredive jo-performuese (Khemraj & Pasha, 2009).

Sipas Jayaratne & Strahan (1996) në studimin e tyre analizuan Shtetet e Bashkuara të Amerikës (50 shtete) në periudhën kohore 1972 dhe 1992. Në këtë studim shkencor u zbulua se ekziston një lidhje lineare midis rritjes së cilësisë së kredisë bankare dhe rritjes ekonomike. Laërence (1995) tregoi se huamarrësit me të ardhura më të ulëta kanë shkallë më të lartë të vonesave për shkak të rritjes së rrezikut të papunësinë dhe humbjen e aftësisë paguese. Rritja e shkallës së papunësisë mund të ndikojë negativisht në fuqinë blerëse të tanishme dhe të ardhshme të ekonomive familjare dhe rrjedhimisht të rrisë barrën e borxhit.

Nga ana tjetër, rritja e papunësisë do të pasqyrohet kryesisht në rënie të prodhimit si rezultat i rënies së kërkesës efektive (që rezulton me ulje të ritmeve të rritjes). Kjo mund të rezultojë në rënie në të ardhurat e bizneseve dhe shkakton një rënie në aftësinë e tyre paguese për të përmbushur detyrimet e tyre të borxhit. Prandaj, në periudhat e rritjes së lartë ekonomike dhe normat e ulëta të papunësisë, huamarrësit janë më në gjendje të mbështesin borxhin, rrjedhimisht duke rezultuar në rënien e kredive jo-performuese (Bofondi & Ropele, 2011).

Autorët Espinoza & Prasad (2010) në studimin e tyre zbuluan se raporti i bankave u përkeqësua kur normat e interesit u rritën dhe rritja ekonomike e naftës u ngadalësua, ku madhësia e bankave luajti një rol të rëndësishëm, pasi bankat më të mëdha, si dhe ato me shpenzime më të ulta kishin një shkallë më të ulët të kredive jo-performuese. Ata gjithashtu arritën në konkludim se rritja e lartë e kredive në periudhat e mëparshme mund të çojë në rritjen e niveleve të pagesave në të ardhmen. Në kushtet e efekteve reaguese, autorët vunë në dukje se ekziston një efekt i fortë, por afatgjatë, nga kreditë jo-performuese në rritjen ekonomike.

Në figurën 3.2 është paraqitur raporti mesatar i kredive jo-performuese dhe niveli i këtyre kredive si përqindje e produktit të brendshëm bruto për 100 vende të botës, duke përfshirë periudhën kohore (1997-2014). Rritja e kredive jo-performuese është një tipar kryesor i krizave financiare. Recesioni i fundit global nuk ishte përjashtim - vetëm brenda BE-së, vëllimi i kredive jo-performuese në raport me PBB-në në shumë vende të botës ishte dyfishuar në mes viteve 2009-2014.

Sipas studimit të realizuar në vitin 2016, nga autorja Maria Balgova, rritja e borxhit të keq gjatë kohëve të vështirësive financiare është problematike, por e parashikueshme. Ajo që e bën situatën aktuale të ndryshme është këmbëngulja e fortë e kredive jo-performuese. Pas krizës aziatike të viteve 1997-98, raporti mesatar i kredive jo-performuese ra me shpejtësi të madhe, ndërsa gjatë viteve 2000 dhe pas krizës financiare 2008-2009, raporti mesatar i kredive jo-performuese ka qenë në rritje të vazhdueshme.

Figura 3. 2. *Raporti mesatar i KJP-ve dhe kreditë jo-performuese si përqindje e PBB-së*



Burimi: (Balgova & Plekhanov, The economic impact of reducing non-performing loans, 2016)

Hou dhe Dickinson (2007) pohuan se efekti i kredive jo-performuese në ekonomi është se burimet janë të lidhur në sektorët joproduktiv duke penguar rritjen ekonomike dhe efikasitetin ekonomik, i cili pastaj ndikon negativisht në sjelljen e kreditimit të sistemit bankar. Ky rezultat në fund të fundit mund të çojë në kriza të kredive, një situatë ku institucionet financiare kufizojnë kreditimin nën nivelin mesatar të identifikuar për një kusht të dhënë në treg (Gertler & Kiyotaki, 2010).

Hou dhe Dickinson nëpërmjet studimit të tyre përcaktojnë se aftësia për të dhënë kredi për sektorin real varet nga ndryshimet e kredive jo-performuese në raport me variablat e tjera. Ky skenar nënvizon rolin kritik të ndryshimeve në kreditë jo-performuese që ndikojnë në efikasitetin alokues të sistemit financiar. Gjithashtu, pengimi i rritjes së kredisë është kanali me të cilin niveli i KJP-ve ndikon negativisht në rritjen ekonomike (Impavido, Klingen, & Sun, 2012).

Demirgüç-Kunt & Detragiache (1998) kanë ekzaminuar variablat makroekonomikë para dhe pas krizës financiare në 36 vende. Këta autorë gjetën se rritja e prodhimit në krizën financiare ka shkaktuar një rënie prej 4%. Keeton (1999) analizoi rritjen e vëllimit të kredisë dhe efektet e shlyerjes së borxheve duke përdorur modelin e regresionit auto-vektor dhe të dhënat panel që përfshijnë periudhën kohore 1982 dhe 1996. Në studimin e kryer në Shtetet e Bashkuara, shlyerja e borxheve ishte definuar si dështimi për të shlyer në periudhën e pagesës prej 90 ditësh.

Salas & Saurina (2002) në studimin e tyre në lidhje me kreditë jo-performuese kanë marrë variablat makroekonomike dhe mikroekonomike si ndryshore kontrolluese për të shpjeguar nivelin e këtyre kredive në një studim që ka të bëjë me bankat tregtare në Spanjë (për periudhën 1985-1997). Këta autorë vlerësojnë efekt statistikisht të parëndësishëm të efikasitetit të mbetur në kreditë jo-performuese

(ndoshta si pasojë e kundërveprimit të efekteve të "keq menaxhimit") dhe ndikim negativ të aftësisë paguese ndaj kredive jo-performuese që është në përputhje me hipotezën e rrezikut moral.

Në studim i realizuar në vitin 2010 në Indi, nga autorët Dash dhe Kabras kishte për qëllim përcaktimin e shkaqeve të kredive jo-performuese duke përdorur analizën e regresionit. Faktorët makroekonomikë të përdorur në model ishin rritja e PBB-së reale, inflacioni vjetor dhe norma reale efektive e këmbimit, si dhe variablat specifikë të bankave, duke përfshirë normën reale të interesit, madhësinë e bankës, rritjen vjetore të kredisë dhe raportin e kredive ndaj totalit të aktiveve. Rezultatet e modelit të tyre nëpërmjet analizës së regresionit (efektit fiks) treguan se bankat që marrin më shumë rreziqe kanë të ngjarë të kenë nivele më të larta të kredive jo-performuese, madhësia e bankës nuk është e rëndësishme si përcaktuese e KJP-ve, dhe rritja e PBB-së është negativisht e lidhur me KJP-të (Dash & Kabra, 2010).

Podpiera & Weill (2008) shqyrtoi marrëdhënien midis efektivitetit të kostos dhe kredive të sektorit bankar në Republikën Çeke për periudhën 1994-2005. Ata ofruan dëshmi të forta mbështetëse për hipotezën e keqmenaxhimit dhe kanë pohuar nevojën që autoritetet rregullatore në vendet në zhvillim të përqëndrohen në performancën menaxheriale në mënyrë që të rrisin stabilitetin e sistemit financiar duke ulur kreditë jo-performuese. Në sistemin bankar amerikan goditjet financiare nuk janë vetëm variabla financiarë, por edhe variabla makroekonomikë (Mimir, 2013).

Problemet në tregjet financiare maten nëpërmjet rritjes së financimit nëpërmjet obligacioneve. U zbulua se reagimi i parë i bankave ndaj problemeve financiare në tregjet financiare është refuzimi i aplikacioneve për kredi dhe reduktimi i shumës së kredisë në bilancet e tyre. Rënia ciklike e kredive të biznesit pas një vonese të caktuar shfaqet si një tipar kyç i luhatjeve në tregjet financiare (Gilchrist & Zakrajsek, 2011).

Autorët Bock & Demyanets (2012) në studimin e tyre u fokusuan në shqyrtimin se si rritja e kredisë dhe cilësia e aktiveve në tregjet në zhvillim (EMS) janë të ndikuar nga faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Këta autorë klasifikuan variablat që mund të ndikojnë në cilësinë e aktiveve të bankave, të tilla si rritja e PBB-së, kushtet tregtare, kursi i këmbimit, flukset e kapitalit, çmimet e kapitalit dhe normat e interesit.

Rezultatet e regresionit linear shumë faktorial tregojnë se përcaktuesit kryesorë të cilësisë së kredisë janë portofolio dhe flukset e kapitalit, ndërsa rritja ekonomike, kushtet tregtare dhe kurset e këmbimit janë të lidhura negativisht me raportin total të kredive jo-performuese, ndërkohë që rritja e kredisë ndikon pozitivisht në raportin e kredive jo-performuese, pohim ky që është në kundërshtim me studimet e mëparshme.

3.5. Kreditë jo-performuese në vendet e Bashkimit Evropian

Në kuadër të politikave kreditore të Bankave Qendrore Evropiane, kreditë jo-performuese janë një ndër çështjet që po bëjnë presion mbi sektorin bankar evropian dhe shihen si një nga arsyet kryesore të përfitimit të ulët të bankave evropiane, megjithëse niveli i kredive jo-performuese është në nivel të ndryshëm në zonën evropiane.

Meqenëse niveli i kredive jo-performuese ishte në nivele të ulëta ose të menaxhueshme përpara krizës financiare, Këshilli Evropian, Komisioni Evropian, Banka Qendrore Evropiane (BQE) dhe Autoriteti Bankar Evropian (EBA) kanë ndërmarrë të gjitha veprimet për të adresuar këtë çështje dhe për të përmirësuar situatën e krijuar nga kreditë jo-performuese.

Figura 3. 3. *Raporti i kredive jo-performuese në vendet e Bashkimit Evropian (2008-2017)*



Burimi: World Bank (www.ceicdata.com)

Niveli i kredive jo-performuese në vendet e Bashkimit Evropian nga viti 2008 deri në vitin 2012, ka pasur rritje të vazhdueshme nga vlera 2.8% në 7.48%, dhe kjo rritje e ndjeshme e kredive jo-performuese vjen si rezultat i krizës financiare 2007-2009, ku në disa vende anëtare të Bashkimit Evropian shumë institucioneve financiare kanë falimentuar. Në periudhën kohore 2012 – 2017, vërehet rënie e vazhdueshme e kredive jo-performuese nga vlera 7.48% në 3.7%. Pas krizës financiare, kuadri rregullator për bankat ka ndryshuar ndjeshëm.

Bashkimi Evropian ka marrë rolin udhëheqës në zbatimin e reformave të reja financiare në nivelin global të G20 dhe në Komitetin e Bazelit me qëllim të përforcimit të stabilitetit financiar, uljes së rrezikut në sektorin bankar dhe shmangies se taksapaguesve që duhet të kontribuojnë financiarisht për kostot e bankave që falimentojnë (European Commission Report, 2018).

Rezervat e larta të kredive jo-performuese në disa banka evropiane, po reduktohen në vazhdimësi. Raporti mesatar i kredive jo-performuese është ulur për një të tretën që nga viti 2014 dhe është në trend të vazhdueshëm të rënies. Rezervat e larta të këtyre kredive mund të peshojnë në performancën afatshkurtër dhe afatgjatë të bankës nëpërmjet dy kanaleve kryesore. Së pari, kreditë jo-performuese kërkojnë nivele më të larta të provizionimit. Rezerva e kredisë redukton profitabilitetin e bankës dhe redukton kapitalin rregullator të bankës.

Në rastet më ekstreme, kontabilizimi i nevojshëm për kredive jo-performuese mund të vërë në pikëpyetje qëndrueshmërinë financiare të një banke dhe të shkaktojë ndikime të mundshme për stabilitetin e saj financiar. Së dyti, kreditë jo-performuese lidhin sasi të konsiderueshme të burimeve të një banke, qoftë njerëzore ashtu edhe financiare. Kjo zvogëlon kapacitetin e bankës për të dhënë hua, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të cilat mbështeten në huadhënien e bankave komerciale në një masë më të madhe sesa kompanitë më të mëdha, duke ndikuar kështu në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. Për këto arsye, Komisioni Evropian për një kohë të gjatë ka theksuar urgjencën e marrjes së masave të nevojshme për të adresuar rreziqet që lidhen me kreditë jo-performuese (European Commission Report, 2018).

Në figurën 3.4 janë paraqitur vlerat mesatare të kredive jo-performuese si përqindje e kredive totale. Të dhënat janë marrë nga Raportet e Bankës Qendrore Evropiane për vitin 2016.

Figura 3. 4. *Vlera mesatare (e lartë/e ulët) për kreditë jo-performuese në bankat e mëdha evropiane*

Burimi: (European Central Bank Report, 2018) www.kpmg.com/ecb

Duke u bazuar në të dhënat e figurës së mësiperme, mund të vërehet që deri në vitin 2016, Greqia dhe Qipro janë dy vende të cilat kanë shkallë më të lartë të kredive jo-performuese (mbi vlerën 40%), ndërsa Spanja edhe pse është njëri prej vendeve që ka pasur recesion ekonomike sidomos pas krizës financiare

2007-2009, sistemi bankar i këtij vendi është mjaft i qëndrueshëm dhe në kuadër të këtyre nëntë vendeve të paraqitura në figurë 3.4 është vendi me shkallën më të ulët të kredive jo-performuese (6.4%).

Duke u bazuar në raportet e Bankës Qendrore Evropiane, të dhënat për kreditë jo-performuese janë të ndarë në katër sektorë: sektorin publik, sektorin financiar, korporatat jo-financiare dhe sektori i ekonomive familjare. Në Greqi, niveli i kredive jo-performuese në sektorin financiar, deri në vitin 2016 arrin vlerën 60%, ndërsa në sektorin e korporatave jo-financiare vlera e këtyre kredive me probleme është në nivelin mbi 50%.

Siç shihet në figurën 3.5, vendi i dytë që ka shkallë më të lartë të kredive jo-performuese është Qipro, ku sektori i korporatave jo-financiare arrin vlerën mbi 60%. Në shumicën e vendeve, niveli i kredive jo-performuese dominon në këtë sektor si p.sh. në Slloveni, Bullgari, Itali, Hungari dhe në Spanjë. Ndërsa në vendet si Portugalia dhe Irlanda, niveli më i lartë i kredive jo-performuese është në sektorin financiar.

Kreditë jo-performuese janë një indikator që ndikon negativisht në përfitueshmërinë e bankave komerciale. Këto kredi konsumojnë kapital, kërkojnë kohë dhe vëmendje të menaxhimit që tërheq vëmendjen nga aktivitetet bazë të bankës, rrisin koston e funksionimit të bankës dhe zvogëlojnë qëndrueshmërinë financiare të bankës. Për rrjedhojë, bankat duhet të jenë më agresive në menaxhimin e kredive jo-performuese, edhe nëse banka ka kosto operacionale ose kristalizon humbjet në shitje. Kjo megjithatë mund të kërkojë një rikapitalizim të bankës, e cila shpesh kufizon një bankë nga ndërmarrja e veprimeve adekuate (European Central Bank Report, 2018).

Figura 3. 5. *Kreditë jo-performuese të ndara sipas sektorit në disa vende të Bashkimit Evropian*



Burimi: (European Central Bank Report, 2018) www.kpmg.com/ecb

Studimet e fundit tregojnë se bankat vazhdojnë të zvogëlojnë praninë e tyre fizike në të gjithë Evropën, pasi që shpërdarja e degëve në regjione të ndryshme është në trendin rënës. Klientët gjithnjë e më shumë ndërveprojnë me bankat nëpërmjet kanaleve digjitale në vend të rrjetit të degëve. Numri i

përgjithshëm i institucioneve kreditore në Bashkimin Evropian ra me 5% në vitin 2017. Rënia e vitit të kaluar u drejtua nga Gjermania, Italia, Hungaria dhe Austria. Numri i institucioneve kreditore u rrit në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Suedi gjatë vitit 2017.

Kriza globale financiare kishte një absorbim të fortë të kredive jo-performuese në bilancet e bankave duke lënë politikëbërësit në mbarë botën të brengosur nga kjo sfidë. Kjo prirje është përkeqësuar për disa vende nga kriza e Eurozonës, veçanërisht në Evropën Jugore, duke rezultuar në nivel të lartë të kredive jo-performuese në BE (7.5% në vitin 2012). Megjithatë, lakoret e raportit të kredive jo-performuese tregojnë rënie të ndjeshme në të gjithë Bashkimin Evropian, të cilat mund t'i atribuohen rritjes së aktiviteteve të shitjes së huave të bankave në vitet e fundit. Në fakt, që nga viti 2017, raporti për BE ishte pak më poshtë mesatares botërore prej 3.74%, në 3.7%, gjë që sugjeron që kreditë jo-performuese nuk janë më një problem specifik evropian (European Banking Federation, 2018).

Në figurën 3.6 është paraqitur grafikisht analiza krahasuese për raportin e kredive jo-performuese mes vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendëve tjera të botës. Siç shihet nga viti 2010 deri në vitin 2012, vlera mesatare e raportit të kredive jo-performuese është shumë e lartë se e vendeve tjera të botës.

Figura 3. 6. *Kreditë jo-performuese të ndara sipas sektorit në disa vende të Bashkimit Evropian*



Burimi: (European Banking Federation, 2018) https://www.ebf.eu/facts-and-figures/non-performing-loans/

Kjo vlerë në vitin 2012 arrin vlerën deri në 7.5%, përderisa mesatarja e këtij raporti për vendet e tjera botërore ishte mbi vlerën 3.5%. Në përgjithësi nga gjithë kjo analizë krahasuese, mund të vërejmë që vendet e Bashkimit Evropian që nga viti 2010 deri në vitin 2016 kanë pasur nivel më të lartë të raportit të kredive jo-performuese në krahasim me vendet e tjera botërore. Kjo rënie e këtij raporti është

vjen si rezultat i rritjës së aktivitetit të shitjes së kredive bankare nga ana e bankave komerciale evropiane.

3.6. Reduktimi i kredive jo-perfomuese dhe efektet ekonomike

Shumë studime të autorëve të ndryshëm kanë analizuar procesin se si duhet menaxhuar me sukses kreditë jo-performuese dhe nëpërmjet këtij menaxhimi të ndikojnë në reduktimin e këtyre kredive. Identifikimi i problemit është hapi i parë në procesin e menaxhimit të kredive jo-performuese. Bankat duhet të vlerësojnë në mënyrë transparente dhe të besueshme cilësinë e aktiveve në bilancet e tyre dhe pastaj të krijojnë dispozitat e nevojshme për të mbuluar humbjet e pritshme.

Si një nga nënproduktet e kredive jo-performuese është dëmtimi i tregut, ku sigurimi i udhëzimeve të besueshme për agjentët e tregut është një pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Mbështetja në përpjekjet vullnetare të bankave për të zgjidhur problemin e kredive jo-performuese mund të mos jetë e mjaftueshme, sidomos kur barra ndaj këtyre kredive rritet gjithnjë e më shumë (Balgova, Nies, & Plekhanov, 2016). Krijimi i një kuadri të mirë ligjor për ristrukturimin e korporatave dhe identifikimi në kohë i kredive jo-performuese është vendimtar, veçanërisht kur mungon kapaciteti gjyqësor për t'u marrë me rastet e KJP-ve (Laeven & Laryea, 2009).

Autori Woo (2000) dokumenton programin e trajtimit të borxhit të përdorur nga qeveritë e Koresë, Tajlandës, Indonezisë dhe Malajzisë në vitet 1990. Këto qeveri kishin një rol qendror dhe formal në rregullimin ose likuidimin e kredive jo-performuese dhe pastaj ndërmorën masa për t'u marrë me pasojat e krizës financiare aziatike. Autoritetet gjithashtu mund të inkurajojnë një treg finanicar sekondar për kreditë jo-performuese. Një mundësi është që qeveria të krijojë një "bankë të aseteve me probleme" që lejon bankat komerciale të transferojnë kreditë jo-performuese në bilancet e tyre në njësi të specializuar. Kjo si alternativë u aplikua, për shembull, në Suedi në fillim të viteve 1990 dhe nga qeveria e Meksikës pas krizës bankare të vitit 1995 (Krueger & Tornell, 1999).

Kohët e fundit, në vitin 2016, qeveria italiane arriti një marrëveshje me BE duke e lejuar atë të lidhë një garanci qeveritare që arrite vlerën prej 350 milion € të kredive jo-performuese. Garanci të tilla ndihmojnë për të tejkaluar diferencën midis çmimit të kërkuar të kredive jo-performuese dhe blerësve potencial, të cilët do të jenë të gatshëm të paguajnë, një hendek që shpesh mbetet i madh në rastet kur zbatimi i dobët i kontratës kreditore krijon asimetri të lartë të informacionit (Garrido, Kopp, & Ëeber, 2016).

Për të kontrolluar nivelin e kredive jo-performuese, zbatimi i një kornize mirë të dizajnuar të menaxhimit të rrezikut kreditor është konsideruar si një domosdoshmëri për praktikat e mira të një

banke komerciale. Për të vendosur nëse do të miratojë aplikimin e kredisë, bankat duhet të vlerësojnë rrezikshmërinë e kredisë, të vendosin një pritje të përshtatshme të rrezikut kreditor, të hartojnë masa për të parandaluar këtë rrezik, si dhe të merren me ngjarjet eventuale të humbjes dhe të vlerësojnë aftësinë e tyre për të absorbuar humbjet kur ndodhin kreditë jo-performuese. Vendosja e një kuadri të tillë në praktikë pritet të rrisë efiçiencën operacionale. Nëse kuadri i menaxhimit të rrezikut nuk funksionon, është i nevojshëm një plan për reduktimin e kredive jo-performuese (Yang, 2017).

Institucionet financiare që përballen krizat në përgjithësi kanë shfaqur praktika të pasigurta dhe të paqëndrueshme të menaxhimit të kredive. Si rezultat, cilësia e portofolios së huave është përkeqësuar ndjeshëm, duke shkaktuar një rritje të kredive jo-performuese dhe zvogëlim të konsiderueshëm të profitit në sistemet bankare. Për shkak të vëllimit të tyre në rritje dhe ndikimit të tyre në ekonominë në tërësi, kreditë jo-performuese kanë qenë një temë gjithnjë e më e nxehtë në skenën ndërkombëtare financiare (Scardovi, 2016).

Erdinç dhe Gurov (2016) shqyrtojnë çështjen nëse zbatimi i teknikave të avancuara të menaxhimit të rrezikut kreditor në përputhje me qasjet e bazuara në vlerësime të brendshme në Marrëveshjen e Bazelit ulin raportin e kredive jo-performuese. Stijepović (2014) rekomandon një projekt të quajtur "*Qasja e Podgoricës"* për vlerësimin sasior të rikuperimit të kredive jo-performuese, të cilat mund të kthehen ose të reduktohen nëpërmjet një procesi ristrukturimi. Kjo qasje synon forcimin e stimujve të propozuar nga autoritetet financiare në mënyrë që niveli i kredive jo-performuese të reduktohet nëpërmjet zbatimit të tyre të suksesshëm.

3.7. Niveli i kredive jo-performuese në vendet e Ballkanit Përendimor

Nga të gjitha vendet e rajonit, në vitin 2017 Serbia dhe Shqipëria ka regjistruar vlerën më të lartë të kredive jo-performuese me 15.6%, përderisa Mali i Zi ka regjistruar 15.3% nga bruto totali i kredive në fund të vitit 2017. Pas këtyre tri shteteve, radhiten Bosnia & Herzegovina me 11.5%, Maqedonia me 6.1% dhe Kosova me 3.9%.

Në Kosovë kreditë përbëhen kryesisht nga depozitat si burim kryesor i financimit të tyre. Sa i përket nivelit të kredive jo-performuese për vendet e Ballkanit Përendimor, ato paraqesin një pasqyrë të përzier, por sidoqoftë ekziston tendeca e rritjes së këtyre kredive në të gjitha këto shtete.

Tabela 3. 1. *Niveli i kredive jo-performuese në vendet e Ballkanit Përendimor*

Të dhënat	**Viti**								
Shteti	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**
Shqipëria	14%	18.80%	22.50%	23.50%	22.80%	20.90%	18.30%	15.60%	11.08%

Bosnia & Herzegovina	11.40%	11.80%	13.50%	15.10%	14%	14.10%	11.80%	11.50%	8.77%
Kosova	4.50%	5.90%	6.50%	7.80%	8.20%	7.20%	5.30%	3.90%	2.7%
Maqedonia	9.00%	9.50%	10.10%	10.90%	10.80%	11%	6.30%	6.10%	5.03%
Serbia	16.90%	20%	18.60%	21.40%	21.50%	22.80%	17.40%	15.60%	6.40%
Mali i Zi	21%	15.50%	17.60%	18.40%	16.80%	16.70%	15.30%	15.10%	6.90%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në shumicën e vendeve, kjo normë e kredive jo-performuese paraqet kosto të larta për bankat në formën e provizioneve, rrezik më të lartë kreditor, rentabilitet më të ulët dhe norma më të larta të interesit në kredi (Shoqata e Bankave të Kosovës, 2016).

Në vitin 2014 Shqipëria është vendi që ka normën më të lartë të kredive jo-performuese (22.8%), pastaj Serbia me 21.5%, Mali i Zi me 16.8%, Bosnia & Herzegovina me 14%, Maqedonia 10.8% dhe Kosovas 8.2%.

Figura 3. 7. *Paraqitja grafike e nivelit të kredive jo-performuese në mes Kosovës dhe vendeve tjera*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Një nga masat parandaluese që bankat komerciale i ndërmarrin për t'u mbrojtur nga rreziku kreditor janë provizionet për humbjet nga kreditë. Në fund të vitit 2017 bankat komerciale në Kosovë kanë ndarë deri në 115.1% për të mbuluar humbjet e mundshme nga kreditë jo-performuuese. Kjo nënkupton se bankat komerciale kanë performancë të mirë financiare dhe mbulojnë shpenzime që mund të shkaktohen si rezultat i kredive jo-perfomuese (Shoqata e Bankave të Kosovës, 2016).

3.8. Rreziku kreditor në sistemin bankar në Kosovë

Industria bankare në Kosovë në aspektin e meanxhimit të cilësisë së portfolios kreditore ka qenë shumë e kujdesshme duke bërë kështu që normat e këtyre kredive të jenë shumë të ulëta në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Në periudhën kohore 2005-2009, sektori bankar i Kosovës u karakterizua me

pjesëmarrje të ulët të kredive jo-performuese në totalin e kredive. Bazuar në të dhënat e Shoqatës së Bankave të Kosovës, përqindja e kredive jo-performuese në Kosovë në vitin 2005 ishte 2%, ndërsa në vitin 2009 arriti në vlerën 4.3%. Gjatë vitit 2010 bankat komerciale vazhduan të jenë më shumë konsvervative në aspektin e menaxhimit të riskut kreditor si rezultat e krizës financiare. Në vitin 2010 niveli i kredive jo-performuese ndaj totalit të kredive u rrit nga 4.3% në 7.5%.

Gjatë periudhës 2008-2010 norma mesatare e rritjes vjetore të kredive jo-performuese ishte 26.8%, përderisa norma mesatare e rritjes mesatare të nivelit të përgjithshëm të kredisë ishte 22%. Struktura e kredive jo-performuese në vitin 2010 dominohet kryesisht nga kreditë e klasifikuara si të humbura, të cilat përfaqësonin 61% të gjithsej kredive me probleme. Përkeqësimi i cilësisë së kredive është vërejtur tek kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare, por edhe tek kreditë për biznese.

Një ndër shkaktarët që ka ndikuar në përkeqësimin e portfolios kreditore është shtërngimi i kritereve për sektorin e NVM-ve. Në vitin 2010 kreditë jo-performuese ishin prezente në të gjitha sektorët e ekonomisë, por dominojnë kreditë e sektorit të ndërtimtarisë (1.5%) dhe kreditë e sektorit të prodhimtarisë (9.7%). Kreditë me probleme në sektorin e ndërtimtarisë shfaqen si rezultatat i rënies së blerjes së banesave në Kosovë, ndërsa zvogëlimi i kërkesës për eksportet kosovare mund të ketë ndikuar në rënien e aftësisë paguese të industrisë prodhuese në shlyrjën e kredive (BQK, 2010).

Figura 3. 8. *Raporti i kredive jo-performuese në sektorin bankar në Kosovë (2005-2018)*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në vitin 2011 vërehet një përkeqësim i lehtë në cilësinë e portfolios kreditore, përkundër faktit që rritja ekonomike e vendit vazhdoi të jetë pozitive. Pjesëmarrja e kredive jo-performuese në portfolion kreditore të sistemit bankar arriti në 5.9% nga 4.5% sa ishte në vitin 2010. Vështirësitë e shumta nëpër të cilat ka kaluar Eurozona, gjatë vitit 2011 ndikuan edhe në sektorin real të ekonomisë së Kosovës, prandaj nevojitet kujdes më i shtuar sa i përket respektimit të standardeve të kreditimit. Struktura e

kredive jo-performuese edhe në vitin 2011 vazhdon të dominohet nga kreditë e klasifikuara si të humbura (59.5%), kurse kreditë e klasifikuara si të dyshimta përbëjnë 40.5% të gjithsej kredive jo-performuese. Përsa i përket sektorëve ekonomik, përkeqësimi i cilësisë së portfolios kreditore është më e theksuar në sektorin e tregtisë (6.4%) dhe sektori i shërbimeve (5.4%) (BQK, 2011). Rritja më e ngadalshme e ekonomisë së Kosovës gjatë vitit 2012 ndikoi në rritjen vjetore të kredive, por edhe në nivelin e kredive jo-performuese në sistemin bankar në Kosovë.

Raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive në vitin 2012 arriti në 6.5% nga 5.9% sa ishte vlera e tij në vitin paraprak. Kjo rritje e kredive jo-performuese në vitin 2012 nuk ka të bëjë vetëm me dobësimin e aftësisë paguese të kredimarrësve, por edhe me ngadalësimin e rritjes së kredive në përgjithësi (BQK, 2012). Viti 2013 karakterizohet me një rritje në nivelin e kredive jo-performuese, nga 6.5% në 7.8%. Kjo rritje e kredive me probleme kryesisht i atribuohet efektit të bazës së shkaktuar nga shtrënigimi i kreditimit nga bankat komerciale. Në këtë vit, pothuajse të gjithë sektorët shënuan rënie të cilësisë së portfolios kreditore. Sektori i prodhimtarisë kishte rënie më të madhe të cilësisë së portfolios kreditore, ku vlera e kredive jo-performuese në këtë sektor arrin vlerën në 15.7% ndaj totalit të kredive të lëshuara për këtë sektor (BQK, 2013).

Rreziku kreditor ka shënuar rritje në vitin 2014, ku niveli i kredive jo-performuese arriti vlerën në 8.2% nga 7.8%, aq sa ishte niveli i kredive jo-performuese në vitin 2013. Sektori më i ekspozuar ndaj riskut kreditor gjatë vitit 2014 ishte sektori i ndërmarrjeve, në kuadër të të cilit energjia dhe prodhimtaria shënuan normën më të lartë të kredive jo-performuese. Rritja e ekspozimit ndaj riskut kreditor është shkaktuar nëpërmjet migrimit gradual të kredive nga kategoritë me cilësi të mirë drejtë atyre me cilësi më të dobët (BQK, 2014).

Në vitin 2015 raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive zbriti në 7.2% nga 8.2% në vitin 2014. Këto kredi gjatë këtij viti kanë shënuar rënie vjetore për 9.6 milionë euro që është përmirësim i theksuar nëse i krahasojmë me rritjen vjetore prej 12.9 milion euro të shënuar gjatë vitit 2014. Edhe nëse analizohet portfolio kreditore e ndërmarrjeve, sektori i energjisë dhe prodhimtarisë bartin norma më të larta të kredive jo-performuese (BQK, 2015).

Viti 2016 në aspektin e nivelit të KJP-ve vlerësohet shumë mirë, duke shënuar rënie të metutjeshme, nga 7.2% në 5.3%. Në përmirësimin e cilësisë së portfolios kreditore, efekte pozitive kishte edhe funksionalizimi i përmbaruesëve privatë të cilët kanë lehtësuar procesin e zbatimit të kontratave kreditore. Të gjithë sektorët në kuadër të kredive ndaj bizneseve u karakterizuan ngapërmirësimi i cilësisë së portfolios kreditore (BQK, 2016).

Në vitin 2017, kreditë jo-performuese zbritën në nivelin më të ulët që nga fundi i vitit 2010. Ky raport arriti në vlerën 3.9% nga 5.3% sa ishte vlera e tij në vitin 2016. Kjo rënie e këtyre kredive reflektohet edhe nga rritja vjetore e kreditimit prej 10%, ashtu edhe nga përmirësimi i kualitetit të portfolios kreditore. Krahas përmirësimit të përgjithshëm të portfolios kreditore, kemi pasur përmirësim edhe në nivelin e mbulimit të kredive jo-performuese me provizione për humbjet nga kreditë, i cili u ngrit në vitin 2017 në 136.6% (BQK, 2017).

Gjatë vitit 2018 cilësia e portfolios kreditore në nivel të sektorit banker gjatë ka vazhduar përmirësimin, e mbështetur nga rënia kredive jo performuese të segmentit të ndërmarrjeve. Vetëm gjatë këtij viti vlera e kredive të shlyera ishte 8.3 milionë euro, që në terma absolut ka ndikuar në zvogëlimin e gjithsej kredive jo performuese për 10.6% (BQK, 2018).

3.9. Përqëndrimi i riskut kreditor në bankat komerciale në Kosovë (2010-2018)

Analiza e përqëndrimit të rrezikut të kredisë mundëson identifikimin e rreziqeve të mundshme për sistemin bankar që mund të rrjedhin nga ekspozimet e mëdha kreditore kundrejt një numri të caktuar të kredimarrësve. Këto konsiderohen kredi që mund të kërcënojnë stabilitetin e sistemit bankar në rast të dështimit të tyre. Sipas rregulloreve të BQK-së, kreditë të cilat tejkalojnë 10% të kapitalit të klasit të parë klasifikohen si ekspozime të mëdha. Në vitin 2010 shuma e kredive që konsideroheshin si ekspozime të mëdha u rrit në 88.4 milion euro, ndërsa numri i ekspozimeve të mëdha arriti në 45 nga 20 sa ishte në vitin 2009 (BQK, 2010).

Figura 3. 9. *Raporti ndërmjet gjithsej ekspozimet e mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë (2009 -2018)*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në vitin 2011 shuma e ekspozimeve të mëdha arriti në 131.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 49%. Rritja e shumës së ekspozimeve të mëdha dhe zvogëlimi i numrit të këtyre ekspozimeve refletojnë në rritjen e shkallës së përqëndrimit kreditor në sistemtin bankar në Kosovë (BQK, 2011). Ekspozimet e mëdha të bankave komerciale në vitin 2012 arritën në vlerën 182.7 milion euro që paraqet një rritje vjetore prej 38.7%.

Edhe pse gjatë këtij viti vërehet se kemi pasur rritje të përqëndrimit të rrezikut kreditor, që nënkupton se me këtë periudhë është shënuar rritje e numrit të ekspozimeve të mëdha. Viti 2013 për sistemin bankar në Kosovë konsiderohet të jetë një ndër vitet ku bankat komerciale kanë përjetuar ekspozime të mëdha në raport me kapitalin e klasit të parë. Vlera e këtyre ekspozimeve arriti në 218,88 milion euro, që përben rritje vjetore prej 17.6%. Zvogëlimi i vlerës së kapitalit të klasit të parë ka ndikuar në reduktimin e pragut ku një ekspozim fillon të klasifikohet si ekspozim i madh (BQK, 2013).

Sektori bankar në Kosovë gjatë vitit 2014 ka vazhduar trendin rritës të përqëndrimit të rrezikut të kredisë, ku vlera gjithsej e ekspozimeve të mëdha arriti në 124% të vlerës së kapitalit të klasit të parë. Në vitin 2015 shkalla e përqëndrimit të rrezikut kreditor u zvogëlua nga 124% në 81.2%. Kjo rënie në masë të madhe është e harmonizuar me rritjen për 30.2% të kapitalit të klasit të parë. Vlera totale e ekspozimeve të mëdha ndaj riskut kreditor arriti në 277.4 milion euro që paraqet rënie prej 14.7% (BQK, 2015).

Në vitin 2016 sektori bankar i Kosovës u shoqërua me rënie të mëtejshme të përqëndrimit të riskut kreditor, nga vlera 81.2% në 61.9%. Përveç rënies së vlerës së përgjithshme të ekspozimeve të mëdha kreditore, kishte rënie edhe në numrin e përgjithshëm të ekspozimeve nga 51 në 35 ekspozime. Vlera mesatare e këtyre ekspozimeve arriti deri në 6.7 milionë euro. Shkalla e përqëndrimit kreditor në vitin 2017 ka ndërruar trendin rënës të dy viteve të fundit duke u rritur në 70.9%. Ky nivel i riskut kreditor vjen si rezultat i rritjës së theksuar të vlerës së ekspozimeve të mëdha kreditore prej 58%, ndërsa kapitali i klasit të parë u rrit për 13.5% (BQK, 2017).

Gjatë vitit 2018 ekspozimi ndaj rrezikut kreditor ka shënuar rënie që është ndikuar nga përmirësimi i cilësisë në të gjithë sektorët si dhe nga rritja e mbulueshmërisë me provizione. Vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha arriti në 5.3 milionë euro nga 6.2 milionë euro si rezultat i efektit të rënies së vlerës së ekspozimeve të mëdha (BQK, 2018).

KAPITULLI IV

FONDET PËR GARANCI KREDITORE, RËNDËSIA E TYRE NË KREDITIMIN E SEKTORIT REAL DHE MENAXHIMIN E RREZIKUT KREDITOR

Fondet për garanci kreditore janë të përhapura në të dy llojet e ekonomive, edhe në ekonomitë e zhvilluara dhe ato në zhvillim, pasi ato konsiderohen si instrument aktivë për përmirësimin e qasjes në asetet financiare për aktivitete sipërmarrëse. Këto fonde për garanci kreditore janë financuar shpesh nga institucionet publike dhe zbatimi i tyre është reflektuar shpesh në kuadër të rekomandimeve në politikat e organizatave ndërkombëtare (OECD dhe Komisionit Evropian në vitin 2011). Popullariteti i fondeve të garancisë kreditore është rritur për shkak të shumë iniciativave të cilat janë fuqizuar në politika të tilla, ku kapaciteti i tyre për të lëvizur kapitalin privat, si dhe mundësinë e mbulimit të një pjesë të madhe të fondit publik në fund të programit është shumë i madh.

Pavarësisht popullaritetit të tyre, teoria ekonomike nuk përcakton përfundimisht efektin e fondeve për garanci kreditore në financimin e sektorit real. Efektet aktuale të këtyre programeve janë trajtuar në studime të ndryshme empirike, por ka shumë pak prova në dispozicion deri më tani. Në këtë kapitull janë bërë përpjekje të plotësohet ky boshllëk, duke vlerësuar efektin e krijimit të fondeve për garanci kreditore në financimin e sektorit real nëpërmjet kreditimit si dhe ndikimin e këtyre fondeve në procesin e menaxhimit të rrezikut kreditor.

Duke u bazuar në gjetjet e studimeve të fundit, në lidhje me fondet për garanci kreditore, është identifikuar se këto fonde nuk kanë pasur ndikim në vëllimin e kredive, duke rritur shumën e borxhit afat-gjatë dhe pastaj duke ndikuar në uljen e normës së interesit të paguar nga firmat. Të gjitha ndryshoret e tjera në nivel të firmës ishin të pandjeshme, në veçanti, këto studime nuk ishin në gjendje të gjejnë ndikim të rëndësishëm mbi zërat e ndjeshëm të bilancit, duke sugjeruar që përmirësimi i strukturës financiare nuk ka pasur efekt të drejtpërdrejtë "të vërtetë", të paktën edhe në periudha afatshkurtra (Beck, T. Klapper, L. and Mendoza, J., 2008).

Ngadalësimi i rritjes ekonomike në shekullin e fundit, sfidat e reja të globalizimit, çrregullimi i industrisë financiare dhe kriza e fundit financiare kanë ndikuar në ripërtëritjen e interesave për politikat industriale në Evropë (Benavente, J. M., Galetovic, A. and Sanhueza, R., 2006).

Politikat industriale shpesh janë të bazuara në kombinim të subvencioneve, e cila mund të marrë format e mëposhtme: grante, të përcaktuara si pagesa monetare që marrin formën e një shumë të

përgjithshme, të cilat janë në proporcion me sasinë e investimit ose me kostot që përballen firmat në një projekt të caktuar, stimujt e taksave, duke marrë formën e taksave përjashtimore / reduktimet të cilat definohen edhe si kredi tatimore; kreditë e subvencionuara dhe kreditë publike, që synojnë kryesisht uljen e normës së interesit të paguar nga firmat (edhe pse janë një lloj i stimulimit, gjithashtu këto kredi mund të marrin formën e shtyrjes së pagesave dhe që vlerësohen më të favorshme për kreditimin e sektorit real). Garancinë, në rastin në të cilin autoriteti publik merr përsipër rrezikun e paaftësisë paguese të një huamarrësi, duke lejuar ndryshe firmat për të hyrë në kredi të kufizuara për të marrë financime me një kosto më të ulët (Angrist, J. and Pischke, J. 2008).

Për më tepër, arsyetimi për ofrimin e subvencioneve financiare për ndërmarrjet e sektorit real, qëndron pas konsensusit të përgjithshëm mbi rëndësinë e rolit të këtyre ndërmarrjeve në ekonomitë e vendeve të ndryshme dhe në vështirësitë që këto firma hasin në marrjen e kredive (Komisioni Evropian, 2011). Kjo e fundit varet nga kostot e larta të kreditimit në shkallë më të ulët të zhvillimit ekonomik, mungesa e kolateralit, besueshmërisë më të ulët, auditimeve të rralla të pasqyrave financiare, informacionit asimetrik dhestrukturës me përgjegjësi të kufizuar nga shumica e ndërmarrjeve të sektorit real (Beck, Klapper dhe Mendoza, 2008).

Fondet për garanci kreditore synojnë të kompensojnë situata të tilla, siç janë: përmirësimi i qasjeve në kredi dhe kushtet e kredive nga ndërmarrjet e sektorit real. Nga ana tjetër, argumenti kryesor më i fortë kundër subvencioneve, që ngrihet mbi efektet e tyre të mundshme çrregulluese, është fakti se politikat e tilla kreditore kanë tendencë të zëvendësojnë tregjet financiare më shumë sesa të identifikojnë problemet themelore që shkaktojnë kufizime për kreditë e destinuara për sektorin real të ekonomisë (Meza, 2002).

Në rastin e fondeve për garanci kreditore të ndërmarrjeve, efekti çrregullues është konsideruar më i vogël se format e tjera të ndihmave, ndërsa kritikat më serioze konsistojnë në nxitjen e mundshme të rrezikut moral, si nga firmat ashtu edhe nga bankat, edhe pse ky aspekt akoma është duke u diskutuar. Për më tepër, përparësi tjetër e fondeve për garanci kreditore janë kostot e ulëta fillestare, dhe fakti se humbjet e mëdha janë të shkaktuara vetëm në rastin e falimentimeve të shumëfishta të bankave (Beck, Demirguc-Kunt & Maksimovic, 2008).

Përgjithësisht, mund të dallojmë dy tipologji kryesore të fondeve për garanci kreditore: (1) shoqatat e ndërsjella të garancive (p.sh., Confidi në Itali), dhe shoqëritë private të themeluara nga huamarrësit potencialë me qasje të kufizuar në kreditë bankare që ndajnë rrezikun e tyre të borxhit. Megjithatë, këto shoqëri i nënshtrohen problemit të përzgjedhjes negative, si firmat që marrin në konsideratë bashkimin apo fuzionimin me firma të tjera, i konsiderojnë fondet për garanci kreditore të përshtatshme për t'u

mbrojtur nga firmat më të rrezikshme. (2) Fondet publike për garanci kreditore janë fonde të financuara nga autoritetet rajonale ose kombëtare, të drejtuara nga njësitë administrative të qeverisë (p.sh. agjencitë e zhvillimit, ministritë, banka qendrore ose bankat në pronësi publike), ose nga një organizatë e veçantë e cila ligjerisht është agjenci e garantimit të kredive.

Burimet zakonisht marrin formën e ndarjeve buxhetore periodike, d.m.th. subvencionet e vazhdueshme ose të një fondi të caktuar. Fondet publike për granaci kreditore ende përfaqësojnë shumicën e vendeve me të ardhura të ulta, ndërsa garancitë e ndërsjellta janë përdorur më shumë në vendet me të ardhura më të larta (Beck, Demirguc-Kunt & Maksimovic, 2008).

Në aspektin teorik, efekti i futjes së një fondi për garanci kreditore është i paqartë. Në rastin e firmave të paafta për të përmbushur kërkesat për kolateral të kërkuar nga banka, fondet për garanci kreditore mund të rezultojnë në dhënien e më shumë kredive për firma. Për më tepër, duke zvogëluar asimetrinë e informacionit mes një firme dhe një banke, prania e një garancie mund të çojë në norma të ulëta të interesit të paguar nga huamarrësit, duke reduktuar rrezikun moral dhe problemet e përzgjedhjes negative.

Meyer dhe Nagarajan (1996) kanë argumentuar se fondet për garanci kreditore mund të çojnë në një proces mësimi ose leksioni, ku bankat kanë zbuluar se huamarrësit që përfitojnë nga garancia nuk janë aq të rrezikshëm dhe fitimprurës ashtu si pritej fillimisht dhe në këtë mënyrë bankat ofrohen të gatshme t'ju japin kredi këtyre huamarrësve edhe në të ardhmen, pa garanci (Meyer & Nagarajan, 1996).

Në një pikëpamje të ngjashme janë mendimet e (Riding, A., Madill, J. and Haines, G., 2007). Në anën tjetër, fondi për garanci kreditore mund edhe të çojë në një sjellje me rrezik mes dy sipërmarrësve dhe bankës. Në veçanti, nëse fondi për garanci kreditore zbaton përgjegjësi të kufizuara ndërmarrëse (dmth, në qoftë se bankat mund të mbështeten vetëm në fondin për garanci kreditore), atëherë firmat mund të jenë të gatshme të miratojnë strategji me rrezik më të lartë në krahasim me ato të miratuara në rrethana normale (Lelarge, C., Sraer, D. and Thesmar, D., 2008). Duke u bazuar në aspektin bankar, në qoftë se pjesa e kredisë që mbulohet nga garancia është shumë e madhe, nxitja për të ndërmarrë ndonjë veprim të ashpër mund të jetë më e vogël (Benavente, J. M., Galetovic & Sanhueza, 2006).

Një shtrembërim i mundshëm është fakti që bankat mund të jenë të detyruara të emitojnë kredi me vrull më të madh, në mënyrë që të mbështetin garancitë kreditore dhe duke ndërmarrë më pak përpjekje për të mbledhur pjesën e papaguar të kredisë. Vogel dhe Adams (1997) theksojnë se dy burimet e zëvendësimit që do të zvogëlojnë efektin e garancive në kredi dhe që do të rezultojë në mbivlerësim financiar, realizohet në qoftë se analiza është kryer në nivel të bankave. I pari është zëvendësimi i portfolios: kur huadhënësit mund të ripërcaktojnë qëllimin e kredive ekzistuese për t'u kualifikuar si

huamarrës të mundshëm për garanci të kredisë, ose ata mund të përdorin "zhvendosjen e kolonave", duke lëvizur kreditë jo performuese dhe me probleme në portofolin e garantuar. Një mundësi e dytë është zëvendësimi i huadhënësve: ndërmarrjet për dallim nga bankat e tjera veprojnë sipas një skeme garancie. Analiza në nivel të firmës, megjithatë, është më pak e ndërlikuar (Vogel, R. and Adams, D., 1997).

Evidencat empirike në lidhje me efektivitetin e fondeve për garanci kreditore janë të pakta dhe të përziera. Hancock & Peek dhe Wilcox (2007) të përqëndruar në ndikimin e garancive të kredive të siguruara në SHBA nga Administrata e Bizneseve të Vogla, kanë identifikuar se disbursimi i garancive ka rezultuar në rritje të prodhimit të firmave dhe rritjen e punësimit në vend. Prandaj, edhe nga këto studime, vërehet rëndësia e skemës së garantimit të kredive dhe aplikimit të skemave të tilla në politikat kreditore të bankave komerciale.

Lelarge et al. (2008) kanë studiuar programin e garancisë kreditore Sofaris (e njohur edhe si Garancia O.S.E), i realizuar në Francë. Këta autorë gjetën se përshtatshmëria e politikave kreditore mban një diferencë intensive, ndërkohë që nuk ka efekte në diferencë të gjerë. Përveç kësaj, programi i tillë duket se ka shkaktuar më shumë rrezik, që është marrë nga firmat që realizojnë profite më të larta (Lelarge, C., Sraer, D. and Thesmar, D., 2008).

Kang dhe Heshmati (2008) kanë studiuar ndikimin e skemës së garantimit të kredive të zbatuara në Korenë e Jugut, duke u fokusuar në shitje të lartë, produktivitet dhe punësim. Ata gjetën prova të dobëta në favor të garancive kreditore, efektiviteti i të cilave ishte reduktuar, ndër të tjera, nga fakti se ata janë kryesisht të punësuar për të mbështetur firmat që kufizoheshin financiarisht.

Zecchini dhe Ventura (2009) kanë studiuar efektivitetin e një skeme garancie të financuar nga fondet publike për NVM-të në Itali. Këta autorë identifikuan se garancia kreditore rezultoi në sasi më të mëdha të kredive bankare për firmat, megjithatë ky efekt është mjaft i vogël. Garancitë kreditore të cilat janë publike gjithashtu kanë ndikuar në uljen e shpenzimeve që mbulohen nga firmat.

Megjithatë, ata vënë re se skemat e garantimit të kredive nuk kanë domosdoshmërisht synime për të favorizuar firmat financiarisht: nuk kishte shqyrtime dhe analiza për të vlerësuar nëse një hua e propozuar nga një bankë do të ishte dhënë edhe në mungesë të një garancie. Për këtë arsye, modeli i garancive kreditore mund të reflektojë në thelb vendimet e huadhënies bankare më shumë se nevojat e mundshme të ndërmarrjeve (Zecchini & Ventura, 2009).

Columba, Gambacorta dhe Mistrulli (2009) shpjeguan ndikimin e institucioneve të përbashkëta të garancisë në Itali (Confidi) dhe treguan se firmat e vogla lidhur me këto skema të garantimit të kredive paguajnë norma të ulta të interesit të ngarkuara në kontratat e kredisë, të cilat nuk janë të mbështetur me

garanci të përbashkëta në lidhje me firma të ngjashme. Rezultatet e tyre janë në përputhje me pikëpamjen se institucionet e përbashkta të garancive kreditore janë më të specializuara në monitorimin e huamarrësve se sa bankat.

Në një punim shkencor të kohëve të fundit, Mistrulli dhe Vacca (2011) gjejnë se institucionet e përbashkëta të garancive kreditore luajnë rol në shmangien e një shpërbërjeje të kredive që rrjedh prej firmave gjatë periudhës së ndonjë krize financiare. Në anën tjetër, përkeqësimi në cilësinë e kredisë gjatë krizës ka qenë shumë intensiv për klientët me garanci kreditore (Mistrulli & Vacca, 2011).

4.1. Një studim i shkurtër i literaturës

Ekziston një numër i madh i studimeve të cilat kanë trajtuar rëndësinë e skemave për garantimin e kredive, duke reflektuar interesim sa më të madh të qeverive të vendeve të ndryshme për të mbështetur qasjen e NVM-ve në financa. Të gjitha studimet e mëhershme në lidhje me skemat e garancive kreditore mund të klasifikohen në tri fusha të gjera. E para përbëhet nga anketat dhe sondazhet e ndryshme që përshkruajnë tiparet kryesore të skemave të garancisë (p.sh. Beck, T. Klapper, L. and Menadoza, J., 2008 dhe Bennett, Doran, & Billington, 2005).

E dyta përbëhet nga studimet individuale, duke përfshirë përpjekjet për të vlerësuar skemat e garancive kreditore (p.sh. Riding, A., Madill, J. and Haines, G., 2007 dhe Cowan, Drexler, & Yañez, 2009). Së fundi, një kategori e tretë e studimeve fokusohet në praktikat më të mira dhe çështjet e projektimit, duke u mbështetur në përvojën ndërkombëtare (p.sh. Deelen & Molenaar, 2004 dhe Green, 2003).

Banka Botërore në vitin 2008 ka zhvilluar një anketim mbi rëndësinë e skemave të garancive kreditore. Qëllimi i këtij anketimi ishte të jepej një pasqyrë e tipareve kryesore të fondeve për garancitë kreditore në mbarë botën, të tilla si kriteret e përshtatshmërisë, raportet e mbulimit, tarifat dhe raportet financiare të performancës nga aktivitetet operative dhe financiare. Mostra e këtij hulumtimi përbëhej nga 76 fonde për garanci kreditore që operonin në 46 vende të zhvilluara dhe në zhvillim.

Sipas këtij sondazhi, rezultatet tregojnë se ka dallime të mëdha në tiparet organizative dhe rregullat e fondeve për garanci kreditore në nivel global. Vlen të theksohet, se këto dallime nuk lidhen sistematikisht me zhvillimin financiar dhe ekonomik. Një nga gjetjet më interesante të këtij sondazhi është se disa vende të ndryshme në fondet e tyre për garanci kreditore përdorin çmime të bazuara në rrezik ose mekanizma të menaxhimit të riskut (Beck, Klapper & Menadoza, 2008).

Studimet e fundit empirike tregojnë që skemat e garancive kreditore kanë kontribuar pozitivisht në qasjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në financa. Edhe pse matja e ndikimit të këtyre fondeve mbetet një sfidë për shumë hulumtues, disa studime të kohëve të fundit kanë arritur në përfundimin se këto fonde kanë pasur ndikimndikimndikim pozitiv në qasjen e bizneseve në financa, që përndryshe nëse këto fonde nuk implementohen ateherë qasja e këtyre bizneseve në financa do të jetë shumë e kufizuar.

Për shembull, në Kanada, sipas një studimi të realizuar nga autorët Riding, Madill dhe Haines (2007) vlerësojnë se 75% e fondeve për garanci kreditore janë përdorur nga firmat që nuk do të ishin në gjendje të merrnin ndonjë kredi bankare. Sipas një studimi të realizuar në Kili në vitin 2006 nga autorët Larrain dhe Quiroz konstatojnë se fondet e garancisë kreditore rritin probabilitetin e firmave të vogla për të marrë një hua me 14%. Në të njëjtën kohë, këto fonde mund të shtojnë një vlerë të kufizuar dhe të vlerësohen të kushtueshme kur ato nuk janë të dizajnuara mirë (Larraín & Quiroz, 2006).

Studimi i realizuar nga autorët Bennett, Doran, & Billington në vitin 2005 identifikuan faktorët kryesorë të cilët përcaktojnë suksesin e fondeve për garanci kreditore në përmirësimin e qasjes së bizneseve në financa. Këta autorë në studimin e tyre klasifikuan faktorët e suksesit dhe të dështimit të fondeve për garanci kreditore në nivelin makroekonomik dhe mikroekonomik. Fondet për garanci kreditore shërbejnë si përshpejtues për zhvillimin e sektorit financiar. Me fjalë të tjera, këto fonde nuk janë kusht i domosdoshëm për zhvillimin e sektorit financiar.

Në fakt, në ato vende ku është më e madhe nevoja për zhvillimin e sektorit financiar, fondet për garanci kreditore kanë më pak të ngjarë të jenë të suksesshëm në promovimin e këtij zhvillimi. Një fond për garanci kreditore siguronmjetin për të përshpejtuar zvogëlimin e bankave në tregjet e paregjistruara, por nuk është në gjendje të tejkalojë mangësitë serioze në strukturën e tregjeve financiare për të arritur zhvillimin e sektorit financiar (Bennett, Doran, & Billington, 2005).

Sipas Honohan (2008) kriteret e përshtatshme, tarifat e ulta dhe raportet e mbulimit të kamatës mund të rezultojnë në sigurimin e garancive për ndërmarrjet që do të kishin kapacitet financiar për të marrë ndonjë kredi bankare. Fondet për garanci kreditore në mbarë botën variojnë nga tiparet themelore të performancës së tyre, por ka tendencë në rritje për të identifikuar praktikat e mira të funksionimit të tyre. Dështimi i disa fondeve të garancisë kreditore në vitet 1980 çoi në një debat intensiv mbi rolin e tyre (Levitsky, 1997).

Objektivi kryesor i një fondi për garanci kreditore është që të ndihmojë ndërmarrjet e sektorit real të cilat kanë nivel më të lartë të besueshmerisë, por nuk kanë kolateral të mjaftueshëm për të marrë një kredi me një normë fleksibile të interesit për të përmirësuar projektet investuese. Një skemë e

suksesshme e garancive kreditore duhet të jetë në gjendje të ndihmojë bizneset më të rrezikshme të fitojnë fonde duke reduktuar ekspozimin ndaj rrezikut kreditor dhe duke kufizuar kostot e transaksionit si dhe duke garantuar pagesën në rast vonese. Megjithatë, pyetja është nëse kërkesat e tilla mund të përkthehen në një fond për garanci kreditore që nuk është vetëm e qëndrueshëm (p.sh. skemat e Confdi të Italisë ose skema e SBLA-së në Kanada) por gjithashtu krijon shtesë fnanciare dhe ekonomike (Lapachi & Ormotsadze, 2012). Egzistojnë katër lloje kryesore të fondeve të garancisë janë (Green, 2003) si në vijim:

1. *Fondet e Garancisë Publike:* këto fonde janë krijuar nga politikat publike. Zakonisht ato përfshijnë subvencione të ndryshme shtetërore, që menaxhohen nga një organizatë private. Pra,në rast se huazohet kredia, garancia paguhet direkt nga buxheti i qeverisë. Kjo i jep këtij fondi kredibilitet më të lartë brenda sektorit bankar.

2. *Fondet e Garancisë së Korporatave:* këto fonde përgjithësisht financohen dhe operohen nga sektori privat, p.sh. bankat dhe shoqëritë tregtare. Fondet për garanci të korporatave administrohen nga menaxherët e korporatave dhe në përgjithësi këto korporata përfitojnë nga përfshirja e drejtpërdrejtë e sektorit bankar.

3. *Fondet ndërkombëtare për garanci kreditore:* këto fonde zakonisht janë iniciativa qeveritare të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, p.sh. ILO, UNIDO ose Fondi Evropian i Investimeve. Shpesh, skema të tilla kombinojnë fondin për garanci kreditore me një asistencë teknike për firmat.

4. *Fondet reciproke të garancive kreditore:* këto fonde janë organizata private dhe të pavarura të formuara dhe të administruara nga huamarrësit me qasje të kufizuar në kredi bankare.

Figueiredo dhe Gasper (2010) identifikojnë tre modele kryesore për fondet e garancive kreditore: model i përzier me subjektet e garancisë private dhe garancisë publike (një lloj partneriteti publik-privat) - shumë i shpeshtë në vendet e vjetra anëtare të BE-së; fondi i garancisë publike - gjithashtu shumë i shpeshtë kryesisht në shtetet e reja anëtare të BE-së (p.sh. Invega ltd, Lituani) dhe fondi i garancisë plotësisht private (reciproke) - jo shumë e shpeshtë (p.sh. SOCAMA) (Lapachi & Ormotsadze, 2012).

4.2. Karakteristikat operacionale të fondeve për garanci kreditore

Një numër i madh i publikimeve shkencore merren me procedurat operative të fondeve për garanci kreditore (Green 2003, Deelen dhe Molenaar, 2004, Komisioni Evropian, 2006). Duke iu referuar këtyre publikimeve, në vazhdim do të japim një pasqyrë të disa karakteristikave kyçe operacionale të fondeve për garanci kreditore. Kompanitë që garantojnë këto fonde luajnë dy role: njëra kundrejt NVM-ve dhe tjetra kundrejt palës financiare (Komisioni Evropian, 2006). Së pari, në lidhje me NVM-të, fondet për garanci kreditore (Jonsson, 2009):

- lehtësojnë qasjen në burimet financiare të jashtme pa i zvogëluar përgjegjësitë financiare të huamarrësit; kjo qasje në financa mund të jetë një katalizator për fillimin dhe zgjerimin e një biznesi;
- shërbejnë si garanci në bazë të një analize të shëndoshë dhe gjithëpërfshirëse të rreziqeve sasiore dhe cilësore (përvoja, trajnimi dhe kompetenca);
- pasurimi i analizës së rreziqeve me njohuritë e marra nga afërsia e tyre me këto biznese, siç janë informacioni rreth konkurrencës dinamike, zhvillimet e hovshme në teknologji ose marketing; si rrjedhojë stimulohet ndërmarrësia dhe në këtë mënyrë fondet për garanci kreditore kontribuojnë në krijimin e vendeve të punës, krijojnë një strukturë të përshtatshme financiare dhe kushte tërheqëse për kredi;
- ofrojnë mbështetje për biznese duke dhënë këshilla dhe mbikëqyrje në drejtim të menaxhimit financiar të korporatës.

Sipas literaturës, hartuesit e fondeve për garanci kreditore duhet të shqyrtojnë aspektet e mëposhtme: kriteret e përshtatshmërisë, shkalla e mbulimit, tarifat, llojet e kredive, normat e mbulimit, mekanizmat e menaxhimit të rrezikut, palët e interesit, rregulloret etj (Lapachi & Ormotsadze, 2012).

Kriteret e përshtatshmërisë dallojnë shumë në vende dhe rajone të ndryshme. Shumica e fondeve të garancisë kreditore targetojnë të gjitha bizneset në përgjithësi dhe nuk kufizojnë sektorët apo llojet e kredive. Disa vende (Kili, Kanada, Franca, Kolumbia, India, Hungaria, Koreja dhe Malajzia) u lejojnë bizneseve fillestare të aplikojnë për garanci kreditore. Këto fonde nuk imponojnë kufizime për sektorët (përveç një kufizimi të përgjithshëm mbi bujqësinë në rastin e Kanadasë), ose llojin e kredisë (përsëri, me përjashtim të Kanadasë, e cila nuk garanton kredi për kapitalin punues) (Saadani, Arvai, & Rocha, 2010).

Graham (2004) rekomandon që, në mënyrë që të maksimizohet rëndësia e fondit për garanci kreditore dhe ndikimi i tij në produktivitetin e firmave angleze, kriteri i përshtatshmërisë duhet të kufizohet tek bizneset fillestare dhe në fazën start-up. Risku kreditor duhet të diversifikohet midis huadhënësit, huamarrësit dhe garantuesit. Garantuesi duhet të pranojë rrezik të mjaftueshëm për të bindur bankat që të marrin pjesë në skemë. Normat e mbulimit duhet të jenë mjaft të larta për të inkurajuar pjesëmarrjen e huadhënësit dhe ende mjaft të ulta për të kufizuar rrezikun moral.

Përvojat sugjerojnë se normat e mbulimit në përgjithësi duhet të jenë midis 60 dhe 80 përqind. Nga 76 skema, shkalla mesatare e mbulimit është 80 për qind. Mbulimi me 100% ekziston në 40% të 46 vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim duke përfshirë Kanadanë, Japoninë dhe Luksemburgun (Aizenman & Ötker-Robe, 2013).

Një kredi e suksesshme (dhe kështu një garanci e suksesshme) varet nga huamarrësi në qoftëse ripagesat realizohen sipas marrëveshjes. Kështu, është e rëndësishme që huamarrësi të jetë mesatarisht i ekspozuar ndaj rrezikut. Është praktikë e përgjithshme që bankat të kërkojnë nga huamarrësit të kontribuojnë së paku 20% të kostos totale të projektit - përveç kolateralit të huamarrësit (Deelen & Molenaar, 2004).

Raporti i mbulimit të kamatës mund të jetë instrument i rëndësishëm i minimizimit të rrezikut, p.sh. për garancitë individuale, pjesa e rrezikut të mbuluar nga fondi i garancisë kreditore zakonisht varion nga 60 deri në 80% të pjesës së pasiguruar të kredisë. Sipas një skeme individuale, fondi i garancisë kreditore mund të pranojë shkallë relativisht të lartë rreziku, sepse ai i shqyrton të gjithë huamarrësit individualisht (Deelen & Molenaar, 2004).

Tarifat duhet të jenë mjaft të larta për të mbuluar kostot administrative, por mjaft të ulta për të siguruar pjesëmarrjen e duhur të huadhënësit dhe huamarrësit. Përqindja dhe mënyra e aplikimit të tarifave ndryshojnë në fonde të ndryshme të garancisë kreditore. Ka fonde ku kërkohet një tarifë regjistrimi për përpunimin e aplikacionit. Në vendet në zhvillim, tarifa është zakonisht rreth 1% e shumës së kredisë. Fonde të tjera zakonisht imponojnë një tarifë vjetore ose një hua që varion nga 1 në 2% (Levitsky, 1997).

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura strukturat e tarifave për fondet e garancisë kreditore të aplikuara në vende të ndryshme. Tarifa e vendosur nga fondi i garancisë kreditore mund të lidhet me shpërndarjen e rrezikut midis bankës dhe fondit të garancisë. Sa më i lartë mbulimi, aq më i madh është rreziku moral, pasi huamarrësit humbin nxitjen e tyre për të shlyer kredinë, sepse këta huamarrës mendojnë se këto kredi do të mbulohen nga fondi i garancisë kreditore (Deelen & Molenaar, 2004).

Tabela 4. 1. *Struktura e tarifave për fondet e garancisë kreditore*

Shpërndarja e rrezikut (% e mbulesës nga fondi për garanci kreditore)	Tarifa e garancisë si % e shumës së garantuar të kredisë	Shtesa për kredi 3 deri në 5 vjet	Shtesa për kredi 5 deri në 8 vjet
< 20%	0.80%	0.10%	0.25%
21 - 40%	1.20%	0.25%	0.50%
41 – 50%	1.50%	0.50%	0.75%
51- 60%	2.00%	1.00%	1.50%
61 – 70%	2.50%	1.50%	2.50%
71 – 80%	3.00%	1.50%	2.50%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori duke u bazuar në studimi nga Deelen & Molenaar (2004)

Norma e parazgjedhur është një tregues i rëndësishëm i qëndrueshmërisë së fondit për garanci kreditore. Levistky konsideron se një skemë e qëndrueshme duhet të synojë të ketë një normë të parazgjedhur në mes të 2 dhe 3%. Fondet e krijuara rishtazi në vendet në zhvillim mund të konsiderojnë normë më të lartë të parazgjedhur (dmth. mbi 5%) në vitet e para të funksionimit të tyre (Lapachi & Ormotsadze, 2012).

4.3. Performanca e fondeve për garanci kreditore

Performanca e fondeve për garanci kreditore është një çështje shumë e rëndësishme në funksionimin e skemave të tilla, pasi që shumica e fondeve të garancisë kreditore janë zbatuar në mënyrë që të kapërcehen kufizimet financiare të huamarrësve. Për të vlerësuar efektivitetin e një kredie është e nevojshme të vlerësohen rrethanat e tjera faktike, pra, çfarë do të bënte huamarrësi në qoftë se nuk do të kishte në dispozicion kredinë. Procesi për të vlerësuar efektivitetin e një kredie përfshin krahasimin e situatës aktuale të huamarrësve me disa të dhëna të mëparshme bazë dhe atribuimin e një pjese të ndryshimeve të vërejtura në huamarrje. Nga ana tjetër, performanca e huamarrësve krahasohet me huamarrësit potencial dhe çdo përmirësim i vërejtur i atribuohet huamarrjes (Meyer & Nagarajan, 1996).

Indikatorët kryesorë të performancës së fondeve për garanci kreditore janë monitorimet e vazhdueshme në mes garantuesit, huamarrësit dhe huadhënësit. Duke iu referuar këtyre indikatorëve, efektiviteti i garantuesit mund të monitorohet. Disa nga treguesit përkatës të performancës së fondeve për garanci kreditore janë: kostot e transaksionit për garancitë e lëshuara, norma e rimëkëmbjes, numri mesatar i ditëve për të lëshuar garanci kreditore, numri mesatar i ditëve për të paguar një kërkesë, numri dhe vlera e garancive të lëshuara etj.

Qëndrueshmëria financiare e garantuesit do të varet nga kapaciteti i garantuesit për të mbuluar kostot e saj (kryesisht nga kostot operacionale dhe standardet tjera) ose nëpërmjet pagesave të tarifave për

klientët e saj, subvencionet direkte nga agjencitë donatore ose të ardhurat nga investimi i vetë fondit të garancisë kreditore (Jonsson, 2009).

Përqindja e të gjitha kredive bankare ndaj bizneseve që janë subjekt i garancive kreditore paraqesin ndikim të të rëndësishëm të këtyre fondeve në financimin e sektorit real. Shkalla e levës financiare është një tregues i mirë se sa të suksesshme janë fondet për garanci kreditore dhe sa këto fonde kanë ndikuar në rritjen e qasjes në financa dhe menaxhimin e riskut kreditor. Sidoqoftë, një shkallë e lartë e levës financiare e cila karakterizohet me shumë të lartë të fondeve për garanci kreditore mundet teorikisht të kontribuojë dhe të kërcënojë qëndrueshmërinë e këtij fondi.

Përvoja ka treguar se fondet për garanci kreditore të vendosura në vendet e industrializuara me sektorë të qëndrueshëm financiarë mund të arrijnë një levë deri në 26 herë të vlerës së fondit. Në vendet në zhvillim, të cilat karakterizohen me mjedise makroekonomike të paqëndrueshme, është e këshillueshme që të përvetësohet një qëndrim më konservativ, ku vlera e shkallës së levës financiare preferohet të jetë deri në dhjetë herë më e madhe se vlera e fondit (Green, 2003).

Për të vlerësuar performancën financiare të fondeve për garanci kreditore, një koncept mjaft i rëndësishem në këtë aspekt është ndikimi i huamarrësve në krijimin e shtesave financiare për këto fonde. Pra, këtu duhet theksuar se edhe pse kuptimi i shtesave financiare shpesh është i kufizuar në numrin e kredive shtesë, ky koncept mbulon gjithashtu kushtet e kredisë, p.sh. kreditë më të mëdha dhe afatgjata, uljen e kërkesave për kolateral si dhe normat e interesit në kredi. Një dimension tjetër mjaft i rëndësishëm i performancës së huadhënësve është sjellja dhe qëndrimi i tyre ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ky element ka ndikim signifikant në performancën e fondeve për garanci kreditore.

4.4. Fondet për garanci kreditore në vendet e BE-së

Fondet për garanci kreditore janë një instrument i politikës publike që aplikohet në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian për të adresuar hendekun e financimit të ndërmarrjeve të sektorit real. Hendeku në ofertën kreditore për ndërmarrjet e këtij sektori në përgjithësi është shkaktuar nga prania e asimetrisë së informacionit në tregjet e financimit të jashtëm.

Në kuadër të instrumenteve të ndryshme të politikës kreditore për të zbutur ndikimin negativ të krizës së fundit financiare në ofrimin e financimit të jashtëm për NVM-të, fondet për garanci kreditore kanë një numër përparësish dhe mund të çojnë në përmirësime të rëndësishme të mirëqenies. Disa studime empirike kanë gjetur dëshmi se përdorimi i këtyre fondeve sjell shtesë ekonomike dhe financiare. Fondet për garanci kreditore luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e bizneseve për qasje më të lehtë në financa (ECB, 2016).

Sipas sondazheve të Bankës Investuese Evropiane në vitin 2017, në shumicën e vendeve të BE-së, fondet për garanci kreditore zakonisht janë në pronësi publike, jo-fitimprurëse, janë aktive vetëm në vendin e tyre, synojnë zbutjen e pengesave kolaterale, ofrojnë garanci për bankat dhe institucionet e tjera ndërmjetësuese, dhe menaxhojnë rreziqet e tyre nëpërmjet qeverisë. Fondet për garanci kreditore janë shtyllë e rëndësishme e ndërmjetësimit financiar në vendet e Bashkimit Evropian.

Në vitin 2015, kontratat e garantuara prej 2.03 milion garancish në Bashkimin Evropian përfaqësuan një vlerë totale prej 68 miliardë eurosh. Për sa i përket shumave totale të aktiviteteve të garancisë, vendet kryesore janë Italia (33.6 miliardë euro), Franca (16.7 miliardë euro), Gjermania (5.6 miliardë euro) dhe Spanja (4.1 miliardë euro). Italia gjithashtu përbën gjysmën e numrit të përgjithshëm të garancive të papaguara (1.05 milion), pasuar nga Franca (705 000) dhe Portugalia (89 000). Në tabelën 3.1. është paraqitur vëllimi i papaguar i garancive kreditore si përqindje e PBB-së (Chatzouz, Gereben, Lang, & Torfs, 2017).

Figura 4. 1. *Vëllimi i papaguar i garancive kreditore si përqindje e PBB-së*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në disa vende të Bashkimit Evropian ekzistojnë fonde për garanci kreditore të cilat janë të specializuara dhe këto fonde përqendrohen vetëm në sigurimin e garancisë së kredisë dhe subjekteve jo të specializuara, por gjithashtu ofrojnë produkte të tjera financiare. Duke u bazuar në hulumtimin e realizuar nga Banka Qendrore Evropiane në vitin 2017 mbi rëndësinë e fondeve për garanci kreditore në financimin e ndërmarrjeve të sektorit real, 56% e të anketuarve plotësisht specializohen në sigurimin e garancioneve kreditore, ndërsa 44% e mbetur po ofrojnë edhe shërbime të tjera, të cilat mund të jenë grante, hua, financim i kapitalit, subvencione dhe konsulencë për ndërmarrjet e sektorit real.

Ofruesit e fondeve për garanci kreditore në vendet anëtare të BE-së zakonisht janë në pronësi publike, por janë të themeluar ligjërisht si subjekte private. Rreth dy të tretat e këtyre fondeve raportohet të jenë në pronësi publike. Fondet për garanci kreditore që janë tërësisht në pronësi private veprojnë vetëm në Itali dhe Francë. Katër fonde të tjera janë me pronësi të përzier. Sa i përket statusit ligjor, afro 40% e fondeve për garanci kreditore janë themeluar ligjërisht si korporata private, ndërsa vetëm 12% prej tyre ose 2 fonde janë themeluar si korporata publike (Chatzouz, Gereben, Lang, & Torfs, 2017).

Figura 4. 2. *Pronësia, struktura ligjore dhe statusi tatimor i Fondeve për Granci Kreditore në vendet e BE-së*



Burimi: European Investment Bank, (Chatzouz, Gereben, Lang, & Torfs, 2017).

Shumica e fondeve për garanci kreditore janë pjesërisht ose tërësisht të përjashtuara nga taksat. Vetëm pesë fonde të tilla tatohen si korporata normale. Kjo është në përputhje me faktin se shumica dërrmuese e tyre janë në pronësi publike dhe shërbejnë për një qëllim të politikës publike. Dy fonde që ishin në pronësi private janë të liruara nga tatimi. Në Francë dhe Itali - vendet në të cilat janë të pranishme disa fonde për garanci kreditore në pronësi private veprojnë sipas kushteve preferenciale të taksave (EBCI, 2014).

Fondet për garanci kreditore në vendet e BE-së janë të zhvilluara mirë, por aktiviteti i tyre shpërndahet në mënyrë të pabarabartë në të gjitha vendet. Në lidhje me madhësinë e ekonomisë, veprimtaria e fondeve për garanci kreditore është me performancë më të mirë në Itali dhe në Portugali. Aktiviteti në të gjitha vendet e tjera të Evropës Perëndimore mbetet shumë prapa. Vlen të theksohet se Greqia konsiderohet një prej vendeve anëtare të BE-së që ka mangësi në aspektin e zhvillimit të fondeve për garanci kreditore dhe Greqia është një vend në të cilin NVM-të përballen me vështirësi të theksuara në qasjen në financa (Kraemer-Eis, Lang, & Gvetadze, 2014).

Qëllimi kryesor i fondeve për garanci kreditore është të lehtësojë kufizimet e kolateralit duke ofruar garanci për bankat dhe ndërmjetësit e tjerë financiar. Shumica e bankave të Evropës Perëndimore kanë

përdorur garancitë kreditore për të mbështetur aktivitetin e tyre të kreditimit të ndërmarrjeve të sektorit real. Megjithatë, mbulimi i portfoliove bankare nga garancitë kreditore të këtyre ndërmarrjeve tregon një ndryshueshmëri të madhe midis institucioneve kreditore.

Këto fonde janë aplikuar në mënyrë intensive nga qeveritë e vendeve të ndryshme për të luftuar pasojat negative të krizës në financimin e jashtëm të ndërmarrjeve të sektorit real. Për këtë qëllim, shumë prej këtyre fondeve për garanci kreditore kanë pasur një rritje të kapitalit, qoftë të përhershëm apo të përkohshëm, dhe kjo rritje e kapitalit u përdor për të mbështetur huadhënien e cila ishte e destinuar për financimin e investimeve dhe kapitalit punues. Garancitë kreditore luajtën një rol shumë të rëndësishëm në menaxhimin e krizave në ato vende që ishin më të prekura nga trazirat financiare (Chatzouz, Gereben, Lang, & Torfs, 2017).

4.5. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Ndërmarrjet e sektorit real, e sidomos bizneset e reja në Kosovë përballen me shumë vështirësi në qasjen në mjetet financiare nëpërmjet bankave komerciale. Normat e interesit për kredi, në vitin 2014 ishin 10.6%, ndërsa në vitin 2015 ishin rreth 10%, të cilat vlerësohet të jenë shumë të larta për këto biznese. Kjo normë e interesit është një ndër më të lartat në rajon (GAP, 2015).

Duke u bazuar në të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës, mbi 50% e portfolios së kredive në sektorin bankar në Kosovë i takon sektorit të tregtisë. Ndërsa, sektori i bujqësisë si pjesë e sektorit të prodhues, përbën vetëm 3.6% të kredive, kurse raporti i kredive ndaj depozitave totale në bankat e Kosovës është 78.1%. Pra, kjo tregon se bankat komerciale në Kosovë janë mjaft likuide dhe madje kanë edhe likuiditet të pashfrytëzuar (BQK, 2014).

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është themeluar me ligj. Ligji për themelimin e Fondit ishte iniciativë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, mbështetur nga USAID-i në Kosovë, nëpërmjet programit EMPOWER përkrahje për kredi. Ky ligj është miratuar në Kuvendin e Kosovës me 8 janar 2016 dhe ka hyrë në fuqi me 23 janar 2016 (SHBK, 2016).

Ky fond është institucion vendor, i pavarur, i qëndrueshëm që u ofron garanci kreditore institucioneve financiare, për të mbuluar deri në 50% të rrezikut kreditor për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është krijuar për të lehtësuar qasjen në financa për këto biznese, duke mundësuar kështu krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e prodhimtarisë vendore, rritjen e vlerave, përmirësimin e bilancit tregtar si dhe avancimin e mundësive për sektorët ekonomik në Kosovë (SHBK, Periodiku Bankar, 2016).

Ky fond ofron garanci kreditore për të gjitha institucionet e regjistruara financiare për kredi të caktuara të NVM-ve. Të gjitha parimet e garancive kreditore janë të përcaktuara në Ligjin për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Ky fond mund të lëshojë garanci kreditore apo produkte edhe shërbime të tjera të miratuara në përputhje me këtë ligj dhe me aprovim të Bordit të Drejtorëve. Të gjitha institucionet financiare të licencuara nga BQK-ja mund të aplikojnë për regjistrim në FKGK, dhe pastaj ky fond do të vlerësojë këto institucione financiare bazuar në metodologjinë e BQK-së për vlerësimin e rrezikut, faktorëve të tjerë institucional dhe riskun e portfolios kreditore (Ligji 05/L-057, 2016).

Në vazhdim të këtij kapitulli do të elaborohen disa nga parimet dhe kriteret e paraqitura në ligjin për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Për kualifikimin e një kredie për garanci kreditore, duhen plotësuar kriteret minimale siç janë; kredia duhet të jetë për një biznes të kualifikuar, kredia duhet të jetë për financime të reja, për qëllime të ligjshme, kredia nuk mund të tejkalojë vlerën maksimale të kryegjesë së specifikuar në marrëveshjen e garancisë si dhe kjo kredi duhet të përmbushë edhe të gjitha kriteret dhe afatet e specifikuara sipas marrëveshjes për garanci kreditore.

Institucioni financiar i cili regjistrohet në këtë fond paguan tarifën e garancisë në kohën kur kredia i nënshtrohet garancisë kreditore si dhe çdo vit pas kësaj për shumën e mbetur të papaguar të principalit të kredisë së garantuar (Ligji 05/L-057, 2016). FKGK-ja synon të ndërtojë një partneritet me të gjitha institucionet financiare, të cilat veprojnë në tregun lokal, duke përfshirë bankat, institucionet financiare jobankare dhe institucionet mikrofinanciare. Procesi i regjistrimit të bankave në këtë fond ka filluar në prill të vitit 2016, ndërsa në fillim të majit të vitit 2016, bankat kishin filluar t'i dorëzojnë dokumentet e tyre për regjistrim. Bankat e regjistruara në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore në fund të 2016-s ishin: Banka për Biznes, NLB Banka, Raiffeisen Bank, Banka Ekonomike, ProCredit Bank, TEB SHA dhe Banka Kombëtare tregtare (FKGK, 2016).

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore siguron të ardhura nga depozitat dhe investimet e aseteve të FKGK-së si dhe arkëton tarifa të ngarkuara për garanci kreditore. Ky fond të gjitha këto të ardhura dhe tarifa i përdor për të mbuluar shpenzimet e veta operacionale dhe kostot e pagesës së shumave të pagueshme mbi garancitë kreditore. Burimet e financimit të këtij fondi janë: kapitali i fondit i dhuruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe donatorët (në formë të granteve), tarifat e garancisë që paguhen nga institucionet e tjera financiare që janë të regjistruara në këtë fond, interesi dhe të ardhurat e investimeve nga depozitimet dhe investimet e kapitalit të fondit, kontribute tjera kapitale si dhe huamarrja.

Në raste të veçanta, FKGK-ja mund të kërkojë financim emergjent, pra ky financim kërkohet atehere kur bordi i drejtorëve vlerëson se ky fond nuk ka burime të mjaftueshme financiare për përmbushjen e objektivave të veta. Prandaj në planin financiar, për financime emergjente të këtij fondi, parashihen të ndërmerren këta hapa vijues: rritja e tarifave që i ngarkohen institucioneve financiare të cilat janë të regjistruara në këtë fond, marrjen e granteve ose donacioneve, huamarrjen e fondeve si dhe përvetësimin e kapitalit shtesë, që krijon interes shtesë apo të ardhura investimi shtesë (Ligji 05/L-057, 2016).

Organet e FKGK-së janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues. Bordi i drejtorëve përbëhet nga shtatë anëtarë: një përfaqësues nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, një përfaqësues nga Ministria e Financave, drejtori menaxhues i FKGK-së si dhe katër anëtarë të tjerë të pavarur të zgjedhur nga donatorët. Drejtori menaxhues i FKGK-së duhet të ketë ekspertizë në banka dhe financa. Kapitali minimal i këtij fondi duhet të jetë 300.000 €, i cili kapital kërkohet të mbahet minimumi në këtë shumë nga FKGK-ja (Ligji 05/L-057, 2016).

4.6. Performanca e FKGK-së, struktura e kapitalit dhe investimet

Kapitali i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore përbëhet nga kapitali i dhuruar ose nga fondet që i jepen FKGK-së nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga donatorët ndërkombëtarë. Në vitin 2016 vlera e kapitalit të dhuruar ishte 7,345,141 €, ndërsa gjatë vitit 2017 kjo vlerë ishte dyfishuar në 15,790,921 €. Ky institucion multiplikon kapitalin e saj pesë herë, ndërsa kapitalin e dedikuar për Agro dritaren e multiplikon dy herë. Ky kufizim ndikon që Fondi Kosovar për Garanci Kreditore të ketë kapital të mjaftueshëm për t'i absorbuar të gjitha humbjet e mundshme të cilat mund të rezultojnë nga aktiviteti i saj (FKGK, 2017).

Tabela 4. 2. *Shuma e donatorëve dhe fondet e dhuruara për kapitalin e FKGK-së*

Donatorët	Fondet e dhuruara 2016	Fondet e dhuruara 2017	Gjithsej	%
Qeveria e Republikës së Kosovës	2,000,000	1,000,000	3,000,000	19%
USAID	5,345,141	445,780	5,790,921	37%
Banka Zhvillimore Gjermane	-	7,000,000	7,000,000	44%
Gjithsej	7,345,141	8,445,780	15,790,921	100%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Gjatë vitit 2017 fondi ka arritur kapacitetin të garantojë afër 64 milion euro dhe duke marrë parasysh që mbulueshmëria maksimale është 50% e kredisë së lëshuar nga banka komerciale e regjistruar në këtë fond. Kjo vlerë nënkupton se 128 milion euro kredi potenciale të lëshuara në tregun bankar në Kosovë,

duke ndikuar në këtë mënyrë në lehtësimin e qasjes në financa dhe zhvillimin e bizneseve në vendin tonë.

Në tabelën 4.2 janë paraqitur shumat e donatorëve dhe fondet e dhuruara për kapitalin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Duke u bazuar në këtë tabelë mund të shohim se Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2016 ka dhuruar 2 milion euro për kapitalin e këtij institucioni, ndërsa Agjensia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ka dhuruar gjatë këtij viti 5,345,141 €, duke u bërë kështu një ndër akterët kryesor që ka kontribuar më së shumti në konsolidimin e këtij fondit garantues.

Ndërsa gjatë vitit 2017, Qeveria e Republikës së Kosovës ka kontribouar në kapitalin e këtij fondi me 1 milion euro, USAID me 445,780 €, ndërsa Banka Zhvillimore Gjermane me 7 milion euro. Pra, në vitin 2017, Banka Zhvillimore Gjermane vlerësohet të jetë donatori kryesor që ka ndikuar në rritjen e aftësisë garantuese të FKGK-së (44%).

Figura 4. 3. *Pjesëmarrja e donatorëve të FKGK-së në përqindje*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Rritja e shumës së garancive të lëshuara, si një ndër dy burimet kryesore të financimit të këtij fondi, ndikon po ashtu në të hyrat dhe në qëndrueshmërinë financiare të këtij institucioni. Rritja e kapitalit të dhuruar ka ndikim në dy burimet kryesore të financimit të këtij institucioni. Një burim tjetër shumë i rëndësishëm kryesor i financimit të këtij fondi janë të ardhurat nga investimet e kapitali të FKGK-së. Gjatë vitit 2017, fondi ka investuar 8,500,000 € në institucione financiare të regjistruara në këtë fond, kryesisht me maturitet njëvjeçar. Fondet e pranuara si kapital i dhuruar nga Banka Zhvillimore Gjermane në fund të vitit 2017, janë investuar në fillim të vitit 2018 në këto institucione financiare, duke ndikuar në rritjen e bashkëpunimit në sferën e investimeve (FKGK, 2017).

Të ardhurat nga investimet dhe nga tarifat e garancive, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore i përdor për t'i mbuluar shpenzimet e veta operative dhe kostot e pagesës së humbjeve mbi garancitë kreditore. Pothuajse, çdo tepricë e mbledhur e tarifave që tejkalon shpenzimet operative dhe humbjet eventuale

kreditore mbahet nga fondi për qëllime të funksionimit të tij dhe nuk diversikohet jashtë portfolios në asnjë formë, duke përfshirë edhe dividendin (FKGK, 2016).

Në vitin 2017, FKGK-ja ka nënshkruar edhe një marrëveshje me një donator tjetër ndërkombëtarë, që është Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), me ndërmjetësim nga Ambasada Suedeze në Kosovë, në vlerë prej 10 milion euro. Kjo marrëveshje e cila siguron një mbulesë të mirë të rrezikut për portfolion e garancive kreditore të FKGK-së, reflekton besueshmëri të madhe të këtij institucioni në sistemin bankar në Kosovë.

4.7. Ndikimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në financimin e ndërmarrjeve të sektorit real në Kosovë

Për të kuptuar më mirë ndikimin ekonomik dhe nevojën e krijimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, fillimisht po analizojmë disa nga problematikat kryesore të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë dhe pastaj një analizë gjithëpërfshirëse për efektet e këtij fondi që financimin e bizneseve në Kosovë. Parashtrohet pyetja: Përse financimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme është çdoherë në qendër të vëmendjes?

Në qoftëse analizojmë gjendjen reale dhe praktike në ekonomitë e vendeve të ndryshme, vërejmë që jo të gjitha bizneset e vogla dhe të mesme rriten duke u shndërruar në ndërmarrje të mëdha multinacionale dhe që kanë ndikim në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Janë vetëm disa prej këtyre bizneseve që kanë fatin të shënojnë progres ekonomik, ndërsa pjesa dërrmuese prej këtyre ndërmarrjeve ballafaqohen me sfida të ndryshme për mbijetesë në treg.

Kudo në botë, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përbëjnë numrin më të madh të bizneseve, ku kontributi i tyre individual është shumë i vogël, ndërsa kontributi i tyre i përbashkët është shumë i madh, sepse pothuajse mbi 80% e popullisë në botë janë të punësuar pikërisht në sektorin e ndërmarrjve të vogla dhe të mesme. Prandaj, politikat vendimmarrëse konsiderojnë se qasja në financa është një nga përcaktuesit më të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi.

Nxitja e sektorit bankar, si themel për financimin e këtyre bizneseve mbetet një ndër çështjet kryesore dhe më sfiduese në politikat kreditore të bankave komerciale. Rreziqet dhe kostot shtesë që lidhen me financimin e këtyre bizneseve janë të njohura nga studime dhe analiza të ndryshme ekonomike. Por, institucionet financiare të cilat lëshojnë kredi për këto biznese, nuk e kanë shqetësim vetëm riskun e kredidhënies, por edhe kostot e larta të mbikqyrjes, të cilat për nga numri i kredive të lëshuara mund të jenë të shumta, edhe pse bëhet fjalë për shuma të ulta (SHBK, The Kosovo Banker, 2016).

Në studime dhe analiza të ndryshme ekonomike janë bërë vlerësime të ndryshme se cilat janë polikat adekuate të cilat duhet të ndërmerren nga qeveria, në mënyrë që të iu ndihmojë bizneseve në zhvillimin dhe progresin e tyre ekonomik si dhe të kontribuojnë në rritjen e punësimit në vend. Këto politika duhet të jenë të orientuara në krijimin e kushteve të favorshme që këto biznese të kenë qasje më të lehtë në finaca. Prandaj, prezentimi i skemave të garancive kreditore, ka për qëllim që t'ju lehtësojë bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme qasjen në financa.

Kosova me krijimin e këtij fondi do të ndikojë në zvogëlimin e rrezikut të kredidhënies (hipoteza e tretë e këtij studimi), si dhe fondi do të nxisë institucionet financiare të japin më shumë kredi për NMVM-të, të rrisin shumat e kredive, të zgjerojnë produktet dhe shërbimet për këto biznese, si dhe të përmirësojnë kushtet e kredive. Pengesat që ky fond ''u mundëson bizneseve kosovare të tejkalojnë janë: mungesa e kolateralit, regjstri i kufizuar kreditor apo historia kreditore.

Shtueshmëria është parimi kryesor i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Para vitit 2015, të gjitha bankat dhe institucionet e tjera financiare nuk do të lëshonin kredi për këto biznese pa garancinë e dhënë, kurse tani ka shtueshmëri që i mundëson klientit të ri rritje ekonomike. Ky fond nëpërmjet garancive kreditore dhe funksionit të shtueshmërisë ka nxitur dhënien e kredive të reja, parasë në ekonomi si dhe krijimin e vendeve të punës. Qëllimi i krijimit të fondit është që t'i mundësojë disa kategorive të cënueshme (grave, pakicave, bujqve, sipërmarrësve dhe të rinjve) mundësi më të mira për zhvillim dhe rritje të biznesit (SHBK, The Kosovo Banker, 2016).

Parametrat për bizneset mikro, të vogla dhe të mesme të kualifikuara për financim nën garanci janë: bizneset me më pak se 250 punëtorë, bizneset që janë të kualifikueshme, por që nuk e kanë kolateralin e mjaftueshëm apo historinë kreditore, bizneset që kërkojnë financim afatgjatë, bizneset që mund të rrisin prodhimtarinë vendore dhe të zvoglojnë importet si dhe të rrisin eksportet, grupet më pak të favorizuara ekonomike si dhe ato biznese të cilat kanë potenciale për të krijuar vende të reja të punës. Vetëm kreditë e reja mund të kualifikohen për garanci.

Lëshimi i garancive për mbulimin e rifinancimit apo ristrukturimin e kredive normalisht nuk lejohen, pasi që ky fond është i fokusuar të ndihmojë nëpërmjet financimit bizneset mikro, të vogla dhe të mesme, dhe jo të ndihmojë institucionet financiare me kreditë e tyre jo-performuese. Lloje të kredive të cilat mund të mbulohen me garanci kreditore nga FKGK-ja janë: kreditë afatgjata, investuese (për blerje të makinerisë, pajisjeve, teknologjisë dhe pronës së paluajtshme në lidhje me operacionet afariste) si dhe kreditë për qëllime të kapitalit punues (FKGK, 2017).

4.8. Zhvillimi i portfolios kreditore dhe statistikat e garancive kreditore në Kosovë

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka filluar të pranojë kredi për garanci nga institucionet financiare në fund të vitit 2016. Aktiviteti i këtij fondi gjatë vitit 2017 u zgjerua, duke përfshirë të gjitha bankat e rëndësishme në marrëveshje të garancisë. Portofolio e garancive kreditore në vitin 2017 karakterizohet me rritje dhe me cilësi të lartë. FKGK-ja gjatë vitit 2017 ndërmjetësoi në kredidhënien me vlerë 25.5 milion eurosh për 700 biznese mikro, të vogla dhe të mesme, të mbështetur nga një shumë garancie prej 12.3 milion eurosh, duke arritur shumë kumulative të kredive të miratuara në vlerë prej 30 milion euro për 785 NMVM, të mbështetur nga një shumë garancie prej 14.4 milion eurosh (FKGK, 2017).

Në vazhdim do të ofrojmë disa të dhëna statistikore në lidhje shumën e aprovuar të kredive, shumën e disbursuar të kredive, gjithsej kreditë e mbetura, shumën e aprovuar të garancive dhe gjithsej garancitë e mbetura dhe numrin e kredive për gjatë periudhës Shtator 2016 – Dhjetor 2018. Gjatë vitit 2016, vlera totale e kredive të aprovuara arriti në vlerën 4,505,500 €. Nga muaji shtator i vitit 2016 deri në dhjetor të vitit 2016, shuma e kredive të aprovuara në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore u rrit nga shuma 405,000 € në 4,505,500 €, ndërsa shuma e kredive të disbursuara arriti deri në vlerën 4,353,526 €.

Tabela 4. 3. *Statistikat e kredive dhe garancive kreditore të FKGK-së për periudhën Shtator 2016 – Dhjetor 2016*

Përshkrimi	Shtator 2016	Tetor 2016	Nëntor 2016	Dhjetor 2016
Kreditë e aprovuara	405,000	2,001,000	3,594,000	4,505,500
Kreditë e disbursuara	405,000	1,849,000	3,442,000	4,353,500
Kreditë e mbetura	393,896	1,810,037	3,160,799	3,859,526
Garancitë e aprovuara	187,500	1,002,000	1,723,500	2,133,950
Garancitë e mbetura	182,500	859,092	1,509,385	1,848,846

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën 3.3 mund të shohim që shuma e garancive të aprovuara në shtator të vitit 2016 ishte 187,500 €, shumë kjo e cila në fund të këtij viti u rrit në vlerën 2,133,950 €. Një ndër arsyet kryesore e cila ndikoj në rritjen e ndjeshme të shumës së aprovuar të garancive kreditore nga FKGK-ja ishte e shumës së fondit të dhuruar nga donatorët ndërkombëtarë, sidomos nga USAID-i dhe Banka Zhvillimore Gjermane.

Shuma e aprovuar e garancive vetëm për këtë periudhë katër mujore u rrit për vlerën 1,946,450 €. Viti 2016 edhe pse konsiderohet të jetë viti i parë fillestar i funksionomit të këtij fondi, për një periudhë të shkurtër kohore, ka arritur të krijojë një nivel të lartë të besueshmërisë tek industria bankare në

Kosovë. Gjatë këtij viti numri total i kredive të garantuara arriti në 86 kredi nga të gjitha institucionet financiare të regjistruara në këtë fond.

Figura 4. 4. *Paraqitja grafike e statistikave për kreditë dhe garancitë e aprovuara nga FKGK-ja – viti 2016*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Sipas të dhënave të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore për vitin 2016, nga 86 kredi të garantuara, 34 kredi janë nga regjioni i Prishtinës, 17 kredi nga regjioni i Prizrenit, 9 kredi nga Peja, nga 8 kredi nga regjioni i Gakovës dhe Gjilanit, 7 nga Ferizaji dhe 3 kredi nga regjioni i Mitrovicës. Të gjitha këto kredi për t'u garantuar nga FKGK-ja i kanë plotësuar të gjitha parametrat e përcaktura në bazë të ligjit me nr. 05/L – 057 për themelimin e këtij fondi.

Për sa i përket shumës së aprovuar të kredive nga FKGK-ja, nëse marrim për bazë kriterin regjional, për vitin 2016, regjioni i Prishtinës dominon me 1,729,000 €, pasuar nga regjioni i Prizrenit me 1,307,000 €, Mitrovica me 365,000 €, Ferizaj me 343,000 €, Peja me 297,500 €, Gjilani me 264,000 € dhe Gjakova me 200,000 € vlerë të kredive të aprovuara nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore.

Tabela 4. 4. *Shpërdarja e kredive dhe garancive kreditore të FKGK-së sipas rajoneve për vitin 2016*

Kreditë sipas rajoneve	Shuma e aprovuar e kredive	Shuma e aprovuar e garancive
Ferizaj	343,000 €	171,500 €
Gjakovë	200,000 €	100,000 €
Gjilan	264,000 €	127,000 €
Mitrovicë	365,000 €	182,500 €
Pejë	297,500 €	148,750 €
Prishtinë	1,729,000 €	801,000 €
Prizren	1,307,000 €	603,200 €

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Sipas figurës 3.5 mund të shohim që vlera më e madhe e garancive kreditore të FKGK-së sipas rajonit, është në Prishtinë (801,000 €), ndërsa shuma më e vogël e aprovuar e garancive kreditore ishte

në regjionin e Gjakovës në vlerë prej 100,000 €. Pra, vlen të theksohet se ky fond mbulon vetëm 50% të shumës totale të kredive të aprovuara nga ky institucion.

Figura 4. 5. *Paraqitja grafike e shpërdarjes së kredive të FKGK-së sipas rajoneve për vitin 2016*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Nëse marrim parasysh kreditë sipas sektorit, për vitin 2016, dominon sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë (33%) të shumës totale të kredive të aprovuara nga ky fond, pastaj 26% në sektorin e prodhimtarisë, 14% në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë dhe 28% në sektorë të tjerë. Në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë janë aprovuar kredi në vlerën 1,479,000 € dhe janë aprovuar garanci kreditore në vlerën 675,200 €.

Ky fond në sektorin e prodhimtarisë ka aprovuar kredi në vlerë prej 1,164,000 € dhe në këtë sektor janë garantuar 527,500 €. Vlen të theksohet se sektori i prodhimtarisë është një prej sektorëve që duhet të përkrahet më shumë edhe nga FKGK-ja, në mënyrë që t'ju lehtësojë këtyre bizneseve qasje më të madhe në kreditë e dhëna nga sektori bankar në Kosovë.

Gjatë këtij viti, shuma e kredive të aprovuara për sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë arrin deri në vlerën 615,000 €, ndërsa shuma e aprovuar e garancive kreditore në këtë sektor ishte deri në vlerën 307,500 €. Pjesa më e madhe e shumës së garancive kreditore të aprovuara nga FKGK-ja për vitin 2016, janë të destinuara për prodhimtari dhe pajisje bujqësore (583,000 €), blerje të pajisje dhe makinerive (571,000 €), ndërtim dhe renovim (556,250 €) dhe të tjera (423,000 €).

Në vitin 2017 shuma e aprovuar e kredive nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore arriti deri në vlerën 30,018,326 €, ku nëse e krahasojmë me periudhën e njejtë të vitit paraprak, atëherë kemi rritje të shumës së kredive të aprovuara për vlerën 25,512,826 €. Një rritje e tillë e këtij fondi, është si rezultatet i rritjes së vazhdueshme të fondeve të dhuruara nga donatorët e ndryshëm ndërkombëtarë.

Në tabelën 3.4. janë të paraqitura të dhënat tremujore për shumën e aprovuar të kredive, kreditë aktive, shumën e aprovuar të garancive dhe gjithsej garancitë aktive.

Tabela 4. 5. *Statistikat e kredive dhe garancive kreditore të FKGK-së për vitin 2017*

Përshkrimi	Mars 2017	Qershor 2017	Shtator 2017	Dhjetor 2017
Kreditë e aprovuara	7,513,500 €	14,103,300 €	19,404,600 €	30,018,326 €
Kreditë aktive	6,800,571 €	12,005,742 €	15,623,288 €	24,216,834 €
Garancitë e aprovuara	3,593,740 €	6,806,570 €	9,341,370 €	14,443,018 €
Garancitë aktive	3,265,159 €	5,798,604 €	7,509,931 €	11,657,826 €

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Gjatë këtij viti shuma e aprovuar e garancive arriti deri në vlerën 14,443,018 €, ndërsa vlera e gjithsej garancive aktive arriti deri në 11,657,826 €. Numri total i kredive të garantuara nga FKGK-ja gjatë vitit 2017 ishte 785 kredi, ku 70 kredi i përkasin sektorit të bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë, 134 kredi në sektorin e prodhimtarisë, 319 kredi në tregtinë me shumicë dhe pakicë, 30 kredi në sektorin e ndërtimtarisë dhe 232 kredi të tjera i përkasin sektorëve të tjerë. Pjesa më e madhe kredive të këtij fondi janë të destinuara për kapitalin punues të këtyre firmave që janë huamarrës të bankave komerciale të cilat janë të regjistruara si pjesëmarrëse aktive në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore.

Figura 4. 6. *Paraqitja grafike e statistikave për kreditë dhe garancitë e aprovuara nga FKGK-ja – viti 2017*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Nëse marrim parasysh kriterin rajonal për sa i përket shpërndarjes së kredive të FKGK-së, atëherë regjioni i Prishtinës dominon edhe këtë vit me 324 kredi të aprovuara, të cilat arrin vlerën 12,861,526 € dhe me një shumë të garancive të aprovuara në vlerë prej 6,172,943 €. Sipas këtyre statistikave regjioni i Prizrenit është i dyti në rangim për sa i përket numrit dhe shumës së kredive të aprovuara për garanci kreditore nga FKGK-ja. Numri i kredive në këtë regjion arrin në vlerën 131 kredi ose 5,457,000 € dhe 2,639,640 € është vlera e shumës së garancive kreditore në regjionin e Prizrenit për vitin 2017.

Tabela 4. 6. *Shpërdarja e kredive dhe garancive kreditore të FKGK-së sipas rajoneve për vitin 2017*

Kreditë sipas rajoneve	Shuma e aprovuar e kredive	Shuma e aprovuar e garancive
Ferizaj	2,345,000 €	1,120,500 €
Gjakovë	1,682,000 €	825,000 €
Gjilan	2,267,100 €	1,094,950 €
Mitrovicë	2,733,200 €	1,291,350 €
Pejë	2,672,500 €	1,298,635 €
Prishtinë	12,861,526 €	6,172,943 €
Prizren	5,457,000 €	2,639,640 €

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Sipas të dhënave nga përfituesit e këtyre skemave për garanci kreditore, të ndarë në sektorë të ndryshëm për vitin 2017 numri i paraparë i punëtorëve që do të punësohen në këta sektorë, të cilët janë përkrahur me garanci kreditore nga ky fond, ishte 5,365 puntorë. Pra, gjatë vitit 2017, gjithsej në këta sektorë janë punësuar 4,164 punëtorë, dhe atë më së shumti në sektorin e shërbimeve (1,164 punëtorë) dhe në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë (1,123 punëtorë).

Gjatë këtij viti, FKGK-ja ka përkrahur më së shumti me garanci kreditore sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë (5,892,080 €), pastaj sektorin e shërbimeve me 3,854,150 €, sektorin e prodhimtarisë me 2,797,140 €, bujqësinë, pylltarinë dhe peshkatarinë me 1,245,735 € dhe sektorin e ndërtimtarisë me 653,913 €. Shpërndarja e portofolios së FKGK-së në sektorë të ndryshëm ka vazhduar për të ndjekur trendin e njejtë, i cili dominon në ekonominë e vendit.

Figura 4. 7. *Shpërndarja e kredive sipas sektorit nga FKGK-ja për vitin 2017*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Meqenëse sektori i bujqësisë ka vazhduar të ketë pjesëmarrje të ulët, diku 4% në gjithsej sektorin bankar, kjo pjesëmarrje në portfolion totale të FKGK-së ishte 9%. Duke pasur parasysh që objektivi kryesor i këtij fondi është stimulimi i sektorëve që krijojnë vlerë të shtuar për ekonominë mbetet që të punohet edhe më shumë në fuqizimin e ndërmarrjeve prodhuese dhe të agrobizneseve, ndërmarrje të cilat janë forca lëvizëse të ekonomisë dhe kontribuues në rritje të punësimit dhe në ngritjen e mirëqënies sociale në përgjithësi (FKGK, 2017).

Përafërsisht 27% e kredive të aprovuara në 2017 ishin investuar në pajisje (makineri të prodhimit, pajisje bujqësore, pajisje të tjera), 23% në tokë, në ndërtim ose në rinovim, 37% për kapital punues dhe 13% në të tjera. Investimet në asete fikse (pajisje dhe ndërtim, renovim dhe tokë), të cilat janë gjeneruese të të ardhurave, dominuan potfolion e garantuar gjatë vitit 2017.

Po ashtu, investimet në kapital punues të rëndësishme për të zgjeruar biznesin kishin pjesëmarrje domëthënëse në portfolion e garantuar. Krijimi i vendeve të reja të punës si një ndër objektivat kryesore të themelimit të këtij fondi, 700 kredi për bizneset mikro, të vogla dhe të mesme gjatë vitit 2017 parashikuan 944 vende të reja pune. Këto vende të reja të punës vijnë kryesisht nga sektorët tregti dhe shërbime rreth 68% (FKGK, 2017).

Figura 4. 8. *Destinimi i kredive të FKGK-ja për vitin 2017*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Një pjesë e madhe e portofolios kreditore të FKGK-së destinohet për përkrahjen e grave në biznes. Gratë sot participojnë me një shkallë të ulët të kredimarrjes formale në raport me burrat, duke qenë të detyrurara që një pjesë të financimit për bizneset e tyre ta marrin nga financimet joformale. Kjo ndërlidhet me mungesën e kolateralit, duke qenë që vetëm 15% e tyre kanë pronë të regjistruar në emër të vet. Gjatë vitit 2017 nga 700 kredi për NMVM-të, 11% janë lëshuar për gra pronare në biznes.

Shuma totale e kredive të miratara për vitin 2018 nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore arrin vlerën deri në 87,159,138 €. Nëse shumën e kredive të aprovuara të këtij fondi, e krahasojmë me periudhën e njejtë të vitit paraprak, ateherë vërejmë një rritje për vlerën 57,140,812 €. Gjatë vitit 2018, mund të vërejmë një trend pozitiv të rritjes edhe të gjithsej kredive aktive, shumës së miratuar të garancive kreditore, gjithsej garancive aktive si dhe numrit total të kredive të aprovuara nga ky fond.

Në dhjetor të vitit 2018, numri total i kredive të garantuara arriti në vlerën 2,262 kredi, ku pjesa më e madhe e këtyre kredive janë shpërndarë në regjionin e Prishtinës (1300 kredi), këto kredi kryesisht janë alokuar në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë (886 kredi) dhe destinimi kryesor i tyre është kapitali punues i bizneseve (844 kredi).

Tabela 4. 7. *Statistikat e kredive dhe garancive kreditore të FKGK-së për vitin 2018*

Përshkrimi	Mars 2018	Qershor 2018	Shtator 2018	Dhjetor 2018
Kreditë e aprovuara	42,310,430 €	54,531,956 €	66,407,656 €	87,159,138 €
Kreditë aktive	32,300,868 €	40,676,195 €	47,282,788 €	61,299,244 €
Garancitë e aprovuara	20,326,670 €	26,021,483 €	31,695,333 €	41,665,724 €
Garancitë aktive	15,512,003 €	19,363,911 €	22,509,564 €	29,334,911 €

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Duke u bazuar në tabelën 4.7 mund të konkludojmë që shuma totale e aprovuar e garancive kreditore në dhjetor të vitit 2018 arrin në vlerën 41,665,724 €. Nëse merret parasysh shpërndarja e kredive sipas rajoneve dhe duke iu referuar shumës së aprovuar të garancive kreditore, edhe gjatë vitit 2018 dominon rajoni i Prishtinës me 23,356,706 €. Në figurën 4.9 janë paraqitur në përqindje shpërndarja e kredive të aprovuara për garanci kreditore nga FKGK-ja për vitin 2018.

Figura 4. 9. *Shpërndarja e kredive sipas rajoneve të FKGK-ja për vitin 2018*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në regjionin e Prizrenit gjatë këtij viti janë miratuar 12,131,000 € dhe janë aprovuar garanci kreditore në vlerë prej 5,902,420 €. Vlen të theksohet se regjioni i Prizrenit mbetet rajoni i dytë në rangim përsa i përket shumës totale të kredive të garantuara nga FKGK-ja. Në regjionin e Pejës janë miratuar 176 kredi ose 7,096,326 € dhe shuma totale e garancive kreditore ka arritur në vlerën 3,439,948 €. Të gjitha shumat e aprovuara të garancive kreditore kanë ndihmuar gjatë këtyre viteve të fundit, një numër të madh të bizneseve për të marrë kredi duke pasur parasysh faktin se këto biznese në të kaluarën kanë pasur vështirësi të mëdha për të marrë kredi në bankat komerciale në Kosovë. Një ndër qëllimet kryesore të këtij fondi, është rritja e kreditimit për bizneset kryesisht në sektorin e prodhimtarisë dhe bujqësisë. Në vitin 2018 shuma e miratuar e garancive kreditore në sektorin e prodhimtarisë arriti në vlerën 7,617,640 € ose 18% e portfolios totale të kredive të garantuara nga FKGK-ja. Në këtë sektorë,

nga numri total i garancive kreditore që janë miratuar, ka ndikuar në punësimin e 2,106 personave gjatë vitit 2018 në ndërmarrjet e sektorit të prodhimtarisë.

Figura 4. 10. *Shpërndarja e kredive dhe garancive kreditore sipas sektorëve kryesore ekonomik – Viti 2018*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë numri total i kredive të garantuara nga FKGK-ja ka arritur në 160 kredi dhe shuma totale e këtyre garancive të aprovuara ka arritur në vlerën 2,882,498 €. Efektet e këtyre garancive kreditore, kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e kreditimit të këtij sektori nga bankat komerciale, madje nëse e krahasojmë numrin total të kredive të miratuara në këtë sektor me periudhën e njejtë të vitit paraprak, atëherë mund të vërejmë se kemi rritje nga 70 kredi në 160 kredi të garantuara për vitin 2018. Si rezultat i kësaj, në këtë sektor për vitin 2018 janë punësuar 425 punëtorë nga 627 sa ishin të paraparë të punësohen nga këto firma të cilat kanë marrë kredi bujqësore dhe janë pjesë e fondit për garanci kreditore.

Duke u bazuar në statistikat e kredive të FKGK-së vërehet se sektori i tregtisë me pakicë dhe shumicë është një ndër sektorët më shumën më të madhe të kredive të garantuara nga ky fond. Vlera totale e garancive kreditore për vitin 2018 në këtë sektor ka arritur në 17,079,871 €, dhe nga 4,536 punëtorë sa ishin të paraparë të punësohen në këtë sektor, për këtë vit janë punësuar 3,376 prej tyre. NdikimNdikimi i garancive kreditore në mirëqënien ekonomike dhe zhvillimin e sektorit real në Kosovë është shumë i madh, gjithmonë duke u bazuar në statistikat zyrtare të cilat janë prezentuar edhe gjatë këtij kapitulli. Gjatë vitit 2018 portfolio e kredive të FKGK-së kryesisht ishte e destinuar për kapitalin punues (33%), për pajisje (28%), për ndërtim, renovim dhe tokë 26% dhe të tjera (13%). Efektet e krijimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në rritjen e kreditimit dhe zvogëlimin e riskut kreditor,

do të analizohen në kapitullin e fundit të këtij disertacioni, ku nëpërmjet të dhënave statistikore dhe analizave empirike do të vërtetojmë hipotezën e parashtruar.

4.9. Menaxhimi i riskut kreditor dhe performanca sipas kualitetit kreditor të FKGK-së

Menaxhimi i riskut kreditor i është përshtatur veprimtarisë së Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, i cili nënkupton që ky fond nuk merret direkt me kredimarrësin, por që FKGK-ja bën garantimin e pjesshëm të kredive të mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të lëshuara nga institucionet financiare të regjistruara në këtë fond. Duke u nisur nga fakti se FKGK-ja nuk merret direkt me kredimarrësin, ky institucion ka zhvilluar mekanizmat dhe instrumentet e nevojshme ex-ante dhe ex-post për të siguruar përmbushjen e kritereve të saj. Prandaj, një vëmendje e madhe i është kushtuar përcaktimit të kritereve për regjistrimin e institucioneve financiare si pjesëmarrese të këtij fondi, ndarjes së limiteve dhe kritereve kualifikuese të kredive.

Figura 4. 11. *Performanca e FKGK-së sipas kualitetit kreditor – Viti 2017*



	Jan-17	Shk-17	Mars-17	Prill-17	Maj-17	Qer-17	Korr-17	Gusht-17	Shtat-17	Tet-17	Nënt-17	Dhjet-17
Totali (mil euro)	2,163	2,569	3,191	3,596	4,613	5,799	6,480	6,760	7,510	8,522	10,188	11,658
Standarde	99.8%	98.6%	98.9%	98.5%	97.5%	98.0%	98.7%	99.3%	99.3%	99.4%	99.3%	99.4%
Nën-vezhgim	0.0%	0.0%	0.0%	0.6%	1.4%	0.5%	0.5%	0.0%	0.0%	0.1%	0.2%	0.1%
Nën-standarde	0.2%	1.2%	0.9%	0.8%	1.0%	1.1%	0.4%	1.4%	0.4%	0.3%	0.3%	0.4%
Dyshimtë	0.0%	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%	0.4%	0.4%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Humbje	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.3%	0.3%	0.2%	0.2%	0.2%

Burimi: (FKGK, 2017)

Të gjitha këto kushte të cilat janë ndërmarrë nga ana e fondit, ndikojnë në masë të madhe në menaxhimin e riskut kreditor dhe përcaktimin e performancës duke u bazuar në kualitetin kreditor të FKGK-së. Kjo nënkupton se fondi gjatë procesit të regjistrimit të institucioneve financiare dhe të ndarjes së limiteve, bëhet vlerësim rigoroz, në mënyrë që të krijohen mekanizmat adekuat për kontrollimin dhe

monitorimin e kredive dhe të IF-ve (FKGK, 2017). Gjatë vitit 2017 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore shqyrtoi dhe miratoi kërkesën për regjistrimin e një institucioni financiar si dhe rivlerësoi limitet e disa institucioneve financiare të regjistruara më herët.

Me qëllim të mbulimit të humbjeve që mund të paraqiten nga garancitë e thirrura, FKGK-ja gjatë vitit 2017 vazhdoi provizionimin e garancive sipas IFRS 9 (Standardit Ndërkombëtar për Raportim Financiar 9). Ky fond realizon zhvlerësimin e garancive në tri faza dhe çelësi për ndryshim është klasifikim kreditor i klientit, të dhëna të cilat pranohen në baza mujore nga institucionet financiare të regjistruara (FKGK, 2017).

Sipas të dhënave të publikuara në raportet vjetore financiare të FKGK-së, mbulueshmëria e kredive jo-performuese në dhjetor të vitit 2017 ishte 341%, përderisa mbulueshmëria në sektorin bankar ishte 150%, pra, ky fakt dëshmon se FKGK-ja ka ndërtuar një qasje me konservative në aspektin e provizionimit në krahasim me sektorin bankar në Kosovë. Në vitin 2017 portfolio kreditore ka pasur rritje të konsiderueshme duke mbajtur një nivel të kënaqshëm të kredive jo-performuese dhe pa ndonjë kërkesë nga bankat për pagesën e kredive të humbura.

Në dhjetor të vitit 2017, kreditë jo-performuese në portfolion e garancive kreditore ishte 0.22%, ndërsa niveli i kredive delikuente ishte 0.42%. Vlen të theksohet, se edhe pse ky fond ka kualitet të mirë të portfolios kreditore, ka vazhduar me krijimin e rezervave të provizionimit sipas modelit të humbjeve të pritura. Sipas këtij modeli, mbulueshmëria e gjithsej portfolios së garantuar ishte 0.76%, ndërsa mbulueshmëria e kredive jo-performuese ishte 341% (FKGK, 2017).

KAPITULLI V

REFORMAT INSTITUCIONALE, PËRMIRËSIMI I KLIMËS SË BIZNESIT DHE KREDITIMI I SEKTORIT REAL TË EKONOMISË

Në këtë kapitull do të analizohen reformat institucionale në funksion të përmirësimit të biznes klimës dhe efetet e zbatimit të këtyre reformave institucionale në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë. Procesi i tranzicionit ekonomik dhe politik në vendet e Ballkanit Përendimor, duke përfshirë edhe Kosovën, ka ndikuar që këto vende me ndihmën e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore dhe institucioneve tjera ndërkombëtare të ndërmarrin reforma të ndryshme institucionale dhe strukturore të cilat kanë ndihmuar në zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve. Nëpërmjet këtij kapitulli do të ofrohet një kornizë teorike e rishikimit të literaturës duke u bazuar në studimet e autorëve të tjerë në lidhje me reformat institucionale dhe ndikimin e tyre në rritjen e kreditimit të sektorit real. Gjithashtu nëpërmjet një analize krahasuese do të analizojmë reformat institucionale në funksion të përmirësimit të klimës biznesore në Kosovë, duke u bazuar në kriteret dhe vlerësimet e realizuara nga Banka Botërore.

Për të realizuar këtë analizë krahasuese me rastin e Kosovës, ne do të bazohemi në raportet vjetore të Bankës Botërore "Doing Business" për periudhën kohore 2010 – 2018, ku do të analizojmë 11 kriteret ose reformat e përcaktuara nga Banka Botërore, kritere këto të cilat kanë ndikim të madh në reformimin e ekonomisë së një vendi, por edhe në rastin tonë edhe në rritjen e kreditimit të sektorit bankar ndaj sektorit real të ekonomisë së Kosovës. Të gjitha këto të dhëna do të ndihmojnë në vërtetimin e validitetit të hipotezës së katërt të këtij studimi. Objektivi kryesor i këtij kapitulli është ofrimi i disa argumenteve të tjera shtesë lidhur me korrelacionin pozitiv në mes të zbatimit të reformave institucionale dhe kreditimit të sektorit real në ekonominë e Kosovës.

Tranzicioni politik dhe ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor në dy dekadat e fundit është shoqëruar me procese të vështira ekonomike dhe politike. Meqënese edhe Kosova është pjesë e vendeve të Ballkanit Përendimor, gjatë këtij procesi të ndërlikuar, qeveria e Kosovës me ndihmën e FMN-së dhe Bankës Botërore ka zbatuar politikat ekonomike që synonin arritjen e stabilizimit makroekonomik, transformimin dhe privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe reformimin e sistemit ekonomik dhe institucioneve publike (Osmani, 2015).

Kohët e fundit, hartuesit e politikave ekonomike dhe organizatat shumëkombëshe janë përqendruar gjithnjë e më shumë në një mjedis biznesi të shëndoshë si një strategji për zhvillimin ekonomik të një vendi. Është e vështirë të përcaktohet saktësisht "klima e biznesit", ose mjedisi i biznesit, por Stern (2002) vëren se është mjedisi politik dhe institucional i pranishëm dhe i pritur, që do të ndikojë në kreditimin e sektorit real në një vend të caktuar. Me fjalë të tjera, mjedisi i biznesit mbulon çfarëdo mjedisi të jashtëm që ndikon në kthimet dhe rreziqet me të cilat ballafaqohen të gjitha bizneset. Ky përkufizim i përgjithshëm përfshin tre kategori të gjera (Xu, 2010):

1. Kategoria e parë përfshin aspekte makroekonomike siç janë politikat fiskale, monetare dhe të kursit të këmbimit, gjë që ndikon qartë në kreditimin e sektorit real - për shembull, normat e larta tatimore do të ulnin kthimin, ndërkohë që inflacioni do të rriste ndryshueshmërinë e kthimeve dhe të gjitha këta faktorë do të ndikojnë rritjen e ekspozimit ndaj riskut kreditor.

2. Kategoria e dytë përfshin qeverisjen, institucionet dhe stabilitetin politik.

3. Kategoria e fundit përfshin infrastrukturën e nevojshme për investime produktive, siç janë transporti, energjia elektrike dhe komunikimet.

Në dy dekadat e fundit, çështja e reformave institucionale dhe ndikimit të tyre në zhvillimin e sektorit real është bërë më e spikatur. Vendet në zhvillim janë të varfëra sepse institucionet e tyre aktuale ofrojnë një bazë të dobët në drejtim të stimujve që nxisin rritjen ekonomike. Ky argument ngre çështjen jo vetëm të llojit të institucioneve ata duhet të hartojnë, por edhe më të rëndësishmet se si ata mund të zhvillojnë institucione të tilla (Chang, 2005).

Një çështje shumë e rëndësishme në aspektin e zbatimit të reformave institucionale për të krijuar një mjedis biznesi të përshtatshëm për bankat komerciale dhe për biznesit është edhe përshtatshmëria e modeleve nga vende të ndryshme për riformimin e sektorëve të ndryshëm ekonomik. Si e tillë, nëse një vend zgjedh të miratojë reformat formale të një vendi tjetër, do të ketë karakteristika shumë të ndryshme të performancës në krahasim me vendin tjetër, nëse të dyja reformat joformale dhe karakteristikat e zbatimit janë të ndryshme. Kjo nënkupton që transferimi i rregullave dhe parimeve për reforimim institucional nga vendet e industrializuara me ekonomi të zhvilluar në vendet me ekonomi në tranzicion, nuk është kusht i mjaftueshëm për të gjeneruar rritje ekonomike të vendit (North, 1992).

Efektet e mjedisit të biznesit shpesh ndryshojnë sipas konteksteve specifike dhe në këtë aspekt shpesh ka vështirësi specifike për vendin (Kremer, 1993). Për të arritur qëllimin e studimit të këtij kapitulli, është e dobishme të merren në konsideratë tre lloje të marrëdhënieve ndërmjet qeverisë dhe bizneseve si dhe mjedisit shoqëror për të arritur rezultatet e dëshiruara sociale: disiplina e tregut, proceset gjyqësore private dhe zbatimi publik nëpërmjet rregullimit (Shleifer, 2005).

- ***Disiplina e tregut*** reflekton konkurrencën e tregut midis firmave që nuk varen nga rregullat gjyqësore ose qeveritare dhe kjo disiplinë është strategjia më e mirë kur është e mjaftueshme për të kontrolluar çrregullimin dhe për të shmangur parregullsitë e ndryshme, si nëpërmjet mekanizmit të reputacionit apo falimentimit të firmave joefikase. Shumica e firmave të reja që hyjnë në industri janë biznese të vogla, të cilat nuk mund të mbijetojnë kur ato provojnë të jenë joefikase në përmbushjen e nevojave të klientëve me kosto sa më të ulët. Pra, nuk ka argumente për të rregulluar cilësitë e ndërmarrësit (Xu, 2010).

- Një tjetër mundësi për të ndikuar në sjellet e bizneseve në raport me qeverinë është nëpërmjet sistemit ligjor, siç është ***përdorimi i proceseve gjyqësore dhe gjykatave***. Gjykatat kanë përparësinë e gjyqtarëve potencialisht apolitikë ose gjyqtarëve me përvojë në trajtimin e rasteve të specializuara ekonomike. Por gjykatat gjithashtu sjellin disavantazhe: gjyqtarët mund të korruptohen nëpërmjet ryshfetit, mund të ndikohen nga politika kur ata emërohen nga qeveria dhe dhe gjatë proceseve gjyqësore mund të ketë kontekste të ndryshme për shkak të mungesës së informacioneve për të marrë vendime të drejta. Pra, në shumë vende në zhvillim, procedurat formale dhe të gjata pengojnë efektivitetin e zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve të ndryshme (Loayza, Oviedo, & Serven, 2005).

- ***Rregullimi publik*** mund të zgjidhë pjesërisht çështjet problematike në mes qeverisë dhe bizneseve. Përparësitë janë se rregullatorët mund të jenë ekspertë dhe mund të vendosin rregulla më të mira dhe se qeveria mund të ofrojë stimuj për të siguruar rezultate sociale të dëshirueshme. Disavantazhet janë se industritë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë që paraqesin interesa të përqendruara (në krahasim me konsumatorët) mund të ndikojnë tek rregullatorët për të ruajtur fuqinë monopole dhe për të parandaluar hyrjen e firmave të reja në këto industri, në mënyrë që të mbrojnë interesat e tyre vetanake (Peltzman, 1976).

Disiplina e tregut, proceset gjyqësore dhe rregullimi publik janë tri reforma shumë të rëndësishme institucionale të cilat ndikojnë në masë të madhe në politikat kreditore të bankave komerciale, sidomos

gjatë procesit të kredidhënies ndaj sektorit real të ekonomisë. Duke u nisur nga fakti, se edhe sistemi bankar në çdo vend është një prej sektorëve më të rregullar, të gjitha reformat institucionale që vendosen nga qeveria e një vendi, kanë një ndikim mjaft të madh në zbatimin e politikave kreditore nga ana e bankave komerciale në raport me sektorin real të ekonomisë.

5.1. Korniza konceptuale e reformave institucionale

Studime të ndryshme janë realizuar në fushën e reformave institucionale dhe ndikimit të tyre në përmirësimin e qasjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në financa. Prandaj, autorët Berger & Udell (2006) nëpërmjet studimit të tyre kanë argumentuar se reformat institucionale ndikojnë në përmirësimin e qasjes së bizneseve në financat e sektorit bankar. Ata japin argumente që ekzistojnë një zinxhir i shkaktarëve në mes politikave qeveritare dhe strukturave financire në njërën anë, si dhe qasjes së ndërmarrjeve në financimin nëpërmjet kredive të dhëna nga sektori bankar. Sipas hulumtimit të realizuar nga këta autorë, disa aspekte të infrastrukturës së financimit të ndërmarrjeve të sektorit real mund të adresohen nga qeveria për të krijuar një kuadër të përshtatshëm institucional për qasje më të mirë në financimin e jashtëm për ndërmarrjet. Në këtë drejtim, reformat institucionale duhet të adresojnë çështjet që lidhen me disa aspekte të mjedisit financues, si: mjedisi informativ, mjedisi ligjor, gjyqësor dhe i falimentimit, mjedisi social, mjedisi tatimor dhe mjedisi rregullator (Kokorović, 2014).

Sipas Kerr & Nanda (2009) faktori më i rëndësishëm që rregullon aftësinë e ndërmarrjeve të sektorit real për të ngritur kapital të mjaftueshëm për projektet e tyre është zhvillimi i tregjeve të kapitalit në vend. Këta autorë nëpërmjet studimit të tyre zbuluan se tregjet financiare më të zhvilluara (të matura nga numri i institucioneve të ndryshme financiare) ofrojnë mundësi të shumta financimi për kompanitë. Tregjet financiare të zhvilluara karakterizohen nga ekzistenca e shumëllojshmërisë së instrumenteve financiare, të cilat ndihmojnë institucionet financiare për të reduktuar rreziqet që lidhen me kreditimin e kompanive jofinanciare.

Sipas autorit Beck (2007), në studimin e tij duke trajtuar aspektin e kufizimeve financiare të ndërmarrjeve të sektorit real, gjen se roli i qeverisë në procesin e reformimit të mjedisit institucional, ofrimit të kuadrit rregullator dhe nxitjes së konkurrencës është shumë i rëndësishëm. Ky autor beson se është e rëndësishme të kuptohen më mirë praktikat e huadhënies së ndërmarrjeve nga institucionet financiare dhe të identifikohen praktikat më të mira, por gjithashtu është e rëndësishme të identifikohen se si këto praktika varen nga mjedisi i biznesit në të cilin funksionojnë institucionet financiare.

Compas & Horváth (2012) në kontekstin e përcaktuesve të rritjes makroekonomike dhe rritjes së financimit të ndërmarrjeve nga sektori bankar dallojnë tri fusha të reformave institucionale: (i) liberalizimin e brendshëm, (ii) liberalizimin e jashtëm dhe (iii) privatizimin. Dy të parat synojnë krijimin e kushteve themelore të konkurrencës së tregut, si për bizneset ekzistuese dhe ato të reja ashtu edhe për integrimin me tregjet botërore. Nga ana tjetër, privatizimi siguron që ka mjaft diversitet midis agjentëve ekonomikë për pasur një konkurrencë të drejtë në mes firmave në industri të caktuara. Kjo është në kontrast me një ekonomi të dominuar nga firmat shtetërore, ku është më pak e qartë se ku mund të vijë konkurrenca aktuale. Studimet e tjera argumentojnë se këto tre grupe reformash institucionale duhet të plotësohen edhe me dy fusha tjera shtesë: (iv) rregullimi i hyrjes së firmave të reja në industri të caktuara dhe (v) financimi.

Theksi mbi të parën mund të analizohet tek punimi shkencor i autorit Djankov (2002). Fokusi kryesor i këtij studimi lidhet me faktin se konkurrenca efektive vjen kryesisht nga ndërmarrjet e reja, duke rritur performancën dhe duke theksuar kështu rëndësinë e barrierave të ulëta formale të hyrjes. Nga ana tjetër, qasja në financa ndikon në atë se sa shpejt ndërmarrjet e reja (dhe çdo ndërmarrje tjetër me projekte të shtuara me vlerë të lartë) mund t'i kthejnë planet e tyre në praktikë. Prandaj, një sektor financiar i pazhvilluar pengon rritjen ekonomike dhe performancën, edhe në nivel mikro, reformat e tregut përmirësojnë monitorimin e firmave nga ana e bankave komerciale, duke reduktuar kështu kreditimin e tepërt dhe duke inkurajuar rritjen e produktivitetit. Nga ana tjetër, cilësia e sektorit financiar lidhet direkt me cilësinë e reformave institucionale në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit (Barth, 2008).

Sipas studimeve të fundit në lidhje me ndikimin e reformave institucionale në përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe ndikimit të tyre në zhvillimin ekonomik të një vendi dhe rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë është edhe infrastruktura. Krijuesit e politikave makroekonomike dhe ekonomistët e zhvillimit shpesh e shohin infrastrukturën (p.sh.rruga, fuqia, komunikimi dhe doganat) si të domosdoshme për zhvillimin ekonomik. Infrastruktura e mirë lejon që firmat të kenë kosto më të ulta të transportit dhe komunikimit dhe për këtë arsye të ulin kostot totale për të konkurruar me rivalët e tyre dhe për të eksportuar. Për shkak të një infrastrukture të mirë, një shtrirje më e madhe e tregut gjithashtu lehtëson një hapësirë më të madhe për specializim, e cila zvogëlon më tej kostot e prodhimit të njësisë (Xu, 2010).

Ky faktor ndikon në mënyrë indirekte tek performanca e bizneseve, sepse një infrastrukturë e mirë iu lejon firmave të kenë kosto më të ulëta dhe mundësi më të madhe që të jenë eksportues në shumë vende të tjera të rajonit. Sipas studimeve të Bankës Botërore, infrastrukura është një prej faktorëve mjaft të rëndësishem që ndikon në performancën e firmave, duke përfshirë produktivitetin total të faktorëve, pagat, fitimit, financimin e kompanisë, normat e rritjës së prodhimit, punësimin dhe realizimin e investimeve kapitale.

Dëshmitë empirike nga studimet tjera sugjerojnë se vendet të cilat kanë një zbatim më të ulët të të drejtave të pronësisë kanë tendencë të kenë investime më të ulëta agregate, qasje të kufizuar të firmave në financa dhe rritje më të ngadalshme ekonomike (Acemouglu, Johnson, & Robinson, 2001). Megjithatë, mbështetja që duhet të bëhet për marrëdhëniet pozitive midis të drejtave pronësore dhe performancës ekonomike do të ishte e dobishme për zhvillimin e sektorit privat të biznesit dhe rritjen e mundësive që këto firma të kenë qasje më të lehtë në financimin e aktivitetit të tyre. Studimet e fundit mbi rëndësinë e të drejtave të pronësisë në nivel të firmave sidomos në vendet në tranzicion sugjerojnë se këto të drejta mund të varen nga faza e tranzicionit.

Në fazat e hershme të tranzicionit, të drejtat pronësore kanë një ndikimndikim të madh të financat e firmave, një korrelacion i tillë është gjetur në studimin e tyre nga autorët Johnson, McMillan & Woodruff 2002), të cilët përdorin një mostër të firmave nga Polonia, Rumania, Rusia, Sllovakia dhe Ukraina për të studiuar rëndësinë relative të të drejtave pronësore dhe ndikimin e tyre në financa. Mostra përbëhet nga firma relativisht të vogla, por fitimprurëse (me 7 deri në 270 punonjës). Fitimet pas tatimit mbi shitjet, duke filluar nga 5.7% në Sllovaki, në 21% në Rusi, janë të larta për shkak të tregjeve joefikase, pengesave hyrëse dhe pasojave të tjera ekonomike që rezultojnë nga procesi i tranzicionit.

Një reformë tjetër institucionale shumë e rëndësishme që ndikon në përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë është edhe rregullimi i tregut të punës. Duke iu referuar rregullave të përcaktuara nga qeveria për të kontrolluar se si kompanitë e menaxhojnë punën, rregulloret e punës janë më të fuqishme në aspektin e zbatimit kur firmat kanë më pak liri veprimi në zgjedhjen dhe përshtatjen e lirë të sasisë, cilësisë dhe pagave të punës. Llojet e veçanta të rregullores së punës përfshijnë mbrojtjen e punësimit nëpërmjet pagesave të kryera, njoftimin paraprak të shkarkimit, autorizimin administrativ dhe negocimin paraprak me sindikatat (Cahuc & Zylberberg, 2004). Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) ka një indeks për fleksibilitetin e tregut

të punës, sipas të cilit Kanadaja, Anglia dhe Shtetet e Bashkuara janë më fleksible sesa Franca, Gjermania dhe vendet e Evropës Jugore (Italia, Portugalia dhe Spanja).

Studimi i efekteve për rregulloret e tregut të punës në nivel kombëtar shpesh është i papërfunduar, pjesërisht për shkak se të dhënat mbi rregullimin e tregut të punës janë të disponueshme vetëm për një numër të kufizuar të vendeve të zhvilluara (Nickell, 1997). Shumë studime të tjera janë realizuar nga autorë të tjerë, për të analizuar ndikimin e rregullimit të tregut të punës në përmirësimin e klimës së biznesit, sidomos për sektorin privat të bizneseve. Lidhur me këtë, rregulloret jo të përshtatshme të punës janë karakteristikë e firmave të vogla dhe janë prezente sidomos tek ato vende që kanë një shkallë të lartë të informalitet.

Një studim i realizuar në Indi në vitin 2009 duke përdorur të dhënat e Bankës Botërore për mjedisin e investimeve, sidomos në sektorin e shitjes me pakicë, identifikon se rregulloret e papërshtatme të punës janë shumë prezente në firmat e vogla. Pra, kryesisht ky sektor nuk i zbaton në masë të madhe rregullat e tregut të punës dhe për shkak të kësaj dukurie kemi një shkallë të lartë të informalitetit në sektorin e ndërmarrjeve të vogla (Amin, 2009).

5.2. Përvoja e BE-së në përmirësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet e sektorit real

Bankat komerciale, unionet kreditore dhe kooperativat kanë siguruar tradicionalisht pjesën më të madhe të kreditimit për ndërmarrjet e sektorit real. Një sondazh i fundit i 91 bankave në 45 ekonomi zbuloi se bankat e perceptojnë segmentin e këtyre ndërmarrjeve mjaft fitimprurës, por paqëndrueshmëria makroekonomike në ekonomitë në zhvillim dhe konkurrenca në segmentin e ndërmarrjeve të sektorit real në ekonomitë e zhvilluara u identifikuan si pengesat kryesore për ta duke ofruar financim për këto ndërmarrje.

Bankat komerciale në përgjithësi japin një përqindje më të ulët të kredive për investime ndaj ndërnarrjeve të sektorit real dhe i ngarkojnë ato me tarifa dhe norma më të larta, veçanërisht në vendet në zhvillim (Ayyagar, Juarros, Martinez, & Singh, 2016). Mungesa e informacionit të kredisë është një faktor që kontribuon në kufizimet me të cilat ballafaqohen këto ndërmarrje, duke vlerësuar se aftësia e tyre kreditore paraqet sfidë unike. Nëse bëjmë një krahasim me firmat më të mëdha, një ndërmarrje e vogël e ka shumë më të vështirë për të zhvilluar një histori kreditore, pasi ato kanë më pak qasje ndaj burimeve financiare, si bankat dhe institucionet e tjera financiare, të dhënat e të cilave zakonisht

përdoren në gjenerimin e raporteve kreditore. Në të njëjtën kohë, ndërmarrjet e sektorit real në përgjithësi nuk kanë qasje në aktivet fikse, si toka apo ndërtesa, të cilat zakonisht kërkohen nga bankat si kolateral për të siguruar kredi (World Bank Group, 2018).

Si rezultat i hulumtimeve të realizuara nga Komisioni Evropian, u hartua një plan veprimi për të përmirësuar qasjen në financa për ndërmarrjet e sektorit real në vitin 2011. Bazuar në informacionin mbi problemet që hasin këto ndërmarrje të BE-së, prioritetet kyçe për të lehtësuar qasjen në financa për këto ndërmarrje në dekadën e ardhshme u përcaktuan në këtë plan veprimi. Është përcaktuar që Komisioni Evropian do të veprojë në tre drejtimet e mëposhtme (Kokorović, 2014):

1. Së pari, Komisoni Evropian do të përdorë rregulloret për t'i bërë ndërmarrjet më të dukshme për investitorët dhe tregjet më tërheqëse dhe më të kapshme për ndërmarrjet e sektorit real.

2. Së dyti, ky komision synon të vazhdojë përdorimin e buxhetit të Bashkimit Evropian për lehtësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet e sektorit real, në mënyrë që të adresojë dështimet kryesore të tregut.

3. Së fundi, Komisioni Evropian do të përdorë rolin e tij koordinues, duke bashkëpunuar në veçanti me shtetet anëtare të BE-së, për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të zhvilluar strategji midis veprimeve të ndërmarra në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së.

Një nga reformat institucionale të sistemit bankar që ndihmon në qasjen e firmave të vogla në burimet financiare është raportimi i kredive. Sipas studimeve të fundit të realizuar nga Banka Botërore nëpërmjet raporteve të të bërit biznes, raportimi i kredive vlerësohet të jetë një faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në rritjen e kreditimit të bizneseve në mbarë botën. Një reformë e tillë ndihmon institucionet financiare kredidhënëse në identifikimin e firmave që kanë histori të mirë kreditore dhe gjithashtu nëpërmjet kreditimit të këtyre bizneseve mund të ketë probabilitet më të madh në rritjen e produktivitetit dhe rritjen e punësimit në sektorin real.

Disponueshmëria e këtyre të dhënave mund të ndihmojë huadhënësit potencialë për të vlerësuar sjelljen e mëparshme të huamarrësit dhe për të dhënë kredi për firmat e vogla. Një studim i kohëve të fundit tregon se raportimi i kredive shoqërohet me përmirësimin e disponueshmërisë së kredisë dhe kostove më të ulëta të kredisë, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që veprojnë në ekonomitë me mjedise të dobëta ligjore (World Bank Group, 2018). Në figurën 5.1 janë paraqitur të dhënat e Bankës Botërore për raportet e kredive në nivel global.

Figura 5. 1. *Raportimi i kredive duke u bazuar në historinë e ripagimit nga kompanitë financiare*



Burimi: Report by World Bank Group (2018) - Improving Access to Finance for SMEs

Duke u bazuar në figurën 5.1. mund të vërejmë globalisht, që 113 nga 190 ekonomitë e mbulura nga të dhënat e të bërit biznes të Bankës Botërore, kanë të paktën raporte kreditore në lidhje me historinë kreditore të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Këto të dhëna të raportuara kanë ndihmuar në masë të madhe institucionet financiare kredidhënëse për të vlerësuar sjelljen e bizneseve në raport me destinimin e kredive të marra nga sektori financiar.

Në vendet e Evropës vërehet që bankat komerciale kanë nivel më të lartë të raportimit kreditor për ndërmarrjet e sektorit real, pra mbi 95% e këtyre bankave gjenerojnë raporte të kredive për këto ndërmarrje. Këto reforma të ndërmarra nga institucionet financiare ndihmojnë në masë të madhe lehtësimin e financimit të ndërmarrjeve të sektorit real nëpërmjet kredive, edhe në ato vende që nuk ka shumë institucione financiare të zhvilluara.

Vendet anëtare të OECD-së, Amerikës Veriore dhe Amerikës Latine, kanë një nivel të kënaqshëm të raportimit të kredive nga ana e bankave komerciale. Por, duke u bazuar në të dhënat e raportuara nga Banka Botërore, mund të konkludojmë që disa vende të Azisë Jugore dhe Afrikës nuk kanë nivel të lartë të raportimit të kredive, që nënkupton se kjo reformë institucionale nuk është implementuar me sukses nga ana e bankave komerciale, prandaj ndërmarrjet e sektorit real të këtyre vendeve nuk kanë një përkrahje shumë të madhe nga ana e sektorit bankar në financimin e projekteve të tyre të ardhshme.

5.3. Reformat institucionale dhe elementet strukturore të të bërit biznes – Rasti i Kosovës (2010 – 2018)

Banka Botërore nëpërmjet raporteve Doing Business ofron të dhëna të mjatueshme për reformat institucionale që ndërmerren nga të gjitha vendet e botës në funksion të përmirësimit të biznes klimës dhe zhvillimit ekonomik global. Në kuadër të 190 shteteve, për të cilat raporton Banka Botërore çdo vit mbi progresin e reformave institucionale dhe ndikimin e tyre në mjedisin e biznesit, edhe Kosova bën pjesë në kuadër të këtyre vendeve. Pra, Banka Botërore që nga viti 2010 vazhdimisht raporton edhe mbi ekonominë e Kosovës dhe progresin e arritur në vend.

Qëllimi kryesor i këtij kapitulli është që të ofrojë një analizë krahasuese për zbatimin e reformave institucionale në Kosovë për periudhën kohore 2010 – 2018, duke u bazuar në të dhënat e raporteve të Bankës Botërëre. Të gjitha këto analiza krahasuese do të na shërbejnë në funksion të mbledhjës së informacioneve të shumta si edhepër vërtetimin e hipotezës së katërt të këtij disertacioni të doktoratës që ndërlidhet me zbatimin e reformave institucionale dhe ndikimin e tyre në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë së Kosovës.

Kryesisht, nëpërmjet raporteve të të bërit biznes, Banka Botërore raporton për 11 kriteret të cilat duhet të plotësohen nga të gjitha vendet e botës, në mënyrë që të përmirësohet klima e biznesit, duke iu mundësuar ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme një qasje më të lehtë në financa, fitime më të larta, investime më të mëdha, produktivitet më të lartë si dhe në përgjithësi progres më të madh ekonomik për sektorin real. Indikatorët e të bërit biznes janë: fillimi i një bizesi, marrja e lejes së ndërtimit, furnizimin me energji elektrike, regjistrimi i pronës, qasja në kredi, mbrojtja e investitorëve, pagesa e tatimeve, tregtimi përtej kufijeve, zbatimi i kontratave, zgjidhja e paaftësisë paguese dhe rregullimi i tregut të punës.

Raporti i parë i të bërit biznes, është publikuar për herë të parë në vitin 2003 dhe mbulonte 5 grupe treguesish dhe 133 ekonomi. Raporti i vitit 2018 mbulon 11 grupe treguesish dhe 190 ekonomi. Të gjithë indikatorët e këtyre raporteve marrin si mostër qytetin më të madh në vend në të cilin gjindet numri më i madh i bizneseve. Por, prej vitit 2013, Banka Botërore në ato shtete që kanë një numër të popullsisë mbi 100 milion banorë, në mostrën e këtyre vendeve merr parasysh edhe qytetet e dyta më të mëdha për nga numri i popullsisë dhe numri i bizneseve. Në tabelën e mëposhtme do të paraqesim në

elementët strukturorë të 11 fushave të metodologjisë standarde të matjes së atraktivitetit të mjedisit të biznesit në 190 vende të botës.

Tabela 5. 1. *Elementet strukturore të të bërit biznes dhe përshkrimi i reformave institucionale*

Elementet strukturore të të bërit biznes	Përshkrimi i reformave institucionale
1. Fillimi i një biznesi	Procedurat, koha, kostoja dhe kapitali minimal i paguar për të filluar një kompani me përgjegjësi të kufizuar.
2. Marrja e lejës së ndërtimit	Procedurat, koha dhe kostoja për të përfunduar të gjitha formalitetet për të ndërtuar një depo, kontrolli i cilësisë dhe mekanizmat e sigurisë në sistemin e lejeve të ndërtimit.
3. Furnizimi me energji elektrike	Procedurat, koha dhe kostoja për t'u lidhur me rrjetin elektrik, besueshmëria e furnizimit me energji elektrike dhe transparenca e tarifave.
4. Regjistrimi i pronës	Procedurat, koha dhe kostoja për të transferuar një pronë dhe cilësia e sistemit të administrimit të tokës.
5. Marrja e kredive bankare	Ligjet e kolateralit të lëvizshëm dhe sistemet e informacionit të kreditit.
6. Mbrotja e investitorëve	Të drejtat e aksionarëve të vegjël në transaksionet me palët e lidhura dhe në qeverisjen e korporatave.
7. Pagesa e tatimeve	Pagesat, koha dhe shkalla e përgjithshme e tatimit për një firmë që të jetë në përputhje me të gjitha rregulloret tatimore, si dhe proceset pas depozitimit.
8. Tregtia përtej kufijve	Koha dhe kosto për të eksportuar produktin e avantazheve krahasuese dhe importimin e auto pjesëve.
9. Zbatimi i kontratave	Koha dhe kostoja për të zgjidhur mosmarrëveshjet tregtare dhe cilësinë e proceseve gjyqësore.
10. Zgjidhja e paaftësisë paguese	Koha, kostoja, rezultati dhe norma e rimëkëmbjes për një falimentim komercial dhe forca e kuadrit ligjor për paaftësinë paguese.
11. Rregullimi i tregut të punës	Fleksibiliteti në rregullimin e punësimit dhe aspektet e cilësisë së punës.

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në kuadër të shumë indikatorëve të vlerësuar nga Doing Business, dy janë elemente kyçe strukturore: kompleksiteti i legjislacionit dhe kostoja e të bërit biznesi si dhe forcimi i institucioneve ligjore në funksion të të bërit së biznesit. Doing Business, integron 11 fusha biznesi që shfaqin kompleksitetin dhe koston e proceseve rregullatore dhe fushën e forcimit të institucioneve ligjore në funksion të përmirësimit të mjedisit të biznesit (Osmani, 2015). Në vazhdim të këtij kapitulli do të

ofrojmë të dhënat për 11 fushat e të bërit biznes për rastin e Kosovës, që përfshijnë periudhën kohore 2010 – 2018.

5.3.1. Fillimi i një biznesi

Ky indikator mat kërkesën minimale të kapitalit të paguar, numrin e procedurave, kohën dhe koston për një ndërmarrje të vogël dhe të mesme me përgjegjësi të kufizuar për të filluar dhe për të vepruar zyrtarisht me biznesin e saj. Në mënyrë që të dhënat të jenë të krahasueshme për 190 ekonomitë e përfshira në raportet e të bërit biznes, Banka Botërore përdor një biznes të standardizuar që është 100% në pronësi të brendshme, ka kapital fillestar të barabartë me 10 herë të ardhura për kokë banori, angazhohet në aktivitete të përgjithshme industriale ose komerciale dhe punëson 10 deri në 50 njerëz në muaj pas fillimit të operacioneve (World Bank Group, Doing Business, 2018).

Regjistrimi formal i kompanive ka shumë përfitime të menjëhershme për kompanitë si dhe për pronarët dhe punonjësit e biznesit. Burimet financiare grumbullohen pasi disa aksionerë bashkojnë forcat për të filluar një biznes. Kompanitë e regjistruara zyrtarisht kanë qasje në shërbime dhe institucione nga gjykatat deri tek bankat, si dhe në tregje të reja. Punonjësit e tyre mund të përfitojnë nga mbrojtja e parashikuar nga ligji. Një përfitim shtesë vjen nga kompanitë me përgjegjësi të kufizuar (World Bank Group, Doing Business, 2017).

Kur ndërmarrjet e reja hartojnë një plan biznesi dhe përpiqen të fillojnë biznesin e tyre, pengesat e para me të cilat ata përballen janë procedurat e nevojshme për të inkorporuar dhe regjistruar firmën e re para se të veprojnë ligjërisht. Në shumë ekonomi ndryshojnë ligjet se si e rregullojnë hyrjen e bizneseve të reja në industri. Në disa, procesi është i drejtpërdrejtë dhe i përballueshëm.

Në figurën 5.2 do të paraqitet rangimi i Kosovës për sa i përket procedurave, kohës, kostos dhe kapitalit minimal të paguar për të filluar një kompani me përgjegjësi të kufizuar. Në kuadër të procedurave të nevojshme për fillimin e një biznesi përfshihen: marrja e çertifikatës së biznesit pranë Agjensionit për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, numri i regjistrimit të TVSH-së, marrja e vulës së kompanisë si dhe regjistrimi i punëtorëve në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Administratratën Tatimore të Kosovës.

Figura 5. 2. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business - Fillimi i një biznesi*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në tabelën 5.2 janë të paraqitura të gjitha të dhënat për proceduren, kohën, koston dhe kapitalin minimal të kërkuar për të filluar një biznes në Kosovë. Sipas të dhënave të vitit 2018, Kosova konsiderohet në mesin e dhjetë vendeve më atraktive në botë për të hapur një biznes të ri. Duke filluar prej vitit 2010 deri në vitin 2018 Kosova ka shënuar progres pozitiv në drejtim të reformimit të kushteve dhe procedurave të kërkuara për fillimin e një biznesi. Sipas këtyre indikatorëve, Kosova ka një rangim më të mirë se disa vende të rajonit si p.sh. Shqipëria (46), Sllovenia (49), Republika Çeke (81), Bullgaria (82) dhe Kroacia (95). Kosova gjatë këtyre viteve ka ndërmarrë hapa që t'i thjeshtoë e procedurat për fillimin e biznesit, duke i bërë këto më të shpejta, duke futur teknologjinë dhe duke ulur ose eliminuar kërkesat minimale të kapitalit. Prej vitit 2010 deri në vitin 2018, Kosova ka shënuar rritje në renditjen botërore, për 154 vende.

Tabela 5. 2. *Analizë krahasuese e indikatorëve për fillimin e një biznesi në Kosovë (2010 – 2018)*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Procedura (numër)	9	10	10	9	6	5	5	3	3
Koha (nr. i ditëve)	52	58	58	52	30	11	11	6	5.5
Kostoja (% e të ardhurave për kokë banori)	43.3	28.7	26.7	23	22.1	1.2	1.1	1.1	1
Kapitali minimal ((% e të ardhurave për kokë banori)	169.5	112.4	104.6	0	0	0	0	0	0

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën 4.2 mund të vërejmë që Kosova ka shënuar përmirësime të vazhdueshme në elementet strukturore të cilat kërkohen për fillimin e një biznesi. Sa i përket numrit të procedurave, nga 9 procedura sa janë kërkuar për t'u hapur një biznes, ato janë thjeshtuar tej mase deri në 3 procedura, duke krijuar fleksibilitet më të madh në hapjen e bizneseve të reja në Kosovë. Në vitin 2010 për të regjistruar një firmë, procedura ka zgjatur 52 ditë, ndërsa pas tetë viteve kjo procedurë është reduktuar në 5.5 ditë.

Figura 5. 3. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Fillimi i një biznesi*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Nëse marrim parasysh koston totale të hapjes së biznesit, nga viti 2010 deri në vitin 2018 kemi pasur rënie të kostos, nga 43.3% në 1%. Një rënie kaq e madhe e kostos, si përqindje e të ardhurave për kokë banori, vjen si rezultat i thjeshtimit të procedurave për hapjen e një biznesi të ri. Në figurën 5.3 është paraqitur grafikisht renditja e Kosovës në krahasim me disa vende të rajonit.

Siç shihet nga figura e mësipërme Kosova qëndron më mirë përsa i përket rangimit të saj për fillimin e një biznesi në raport me vendet e tjera të rajonit. Në vitin 2011 në Kosovë, procedurat për fillimin e biznesit u bënë më të vështira duke zëvendësuar numri tatimor të kërkuar paraprakisht me një "numër fiskal", i cili merr më shumë kohë për t'u lëshuar dhe kërkon që administrata tatimore të kryejë së pari inspektimin e lokaleve afariste. Në vitin 2013 u bënë shumë reforma institucionale në mënyrë që biznesi

të fillonte më lehtë duke eliminuar kërkesën minimale të kapitalit dhe tarifën e regjistrimit të biznesit dhe duke riorganizuar procesin e regjistrimit të biznesit.

5.3.2. Marrja e lejes së ndërtimit

Rregullimi i ndërtimit është një ndër çështjet mjaft kritike për mbrojtjen e popullsisë së një vendi. Por, ky rregullim duhet të jetë efikas, për të shmangur kufizimet e tepruara në një sektor që luan rol të rëndësishëm në çdo ekonomi. Në ato vende, ku përputhshmëria me rregulloret e ndërtimit është tepër e kushtueshme në kohë dhe në para, shumë ndërtues zgjedhin vetë mënyrën se si do të realizojnë projektet e tyre ndërtimore. Kompanitë e ndërtimit mund të paguajnë ryshfete për të kaluar më lehtë procesin e inspektimit ose thjesht të ndërtojnë ilegalisht, duke çuar në ndërtime të rrezikshme që e vënë në pikëpyetje sigurinë publike. Në ato vende ku pajtueshmëria me ligje është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë dhe e lirë, të gjithë akterët e përfshirë në këtë proces kanë një pozitë më të mirë (World Bank Group, Doing Business, 2017).

Figura 5. 4. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Marrja e lejës së ndërtimit*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në këtë kriter Banka Botërore nëpërmjet raporteve të të bërit biznes analizon të gjitha procedurat e kërkuara për një biznes në industrinë e ndërtimit për të ndërtuar një depo, kohën dhe koston për të përfunduar çdo procedurë. Përveç kësaj, indeksi i kontrollit të cilësisë së ndërtesës vlerëson cilësinë e rregulloreve të ndërtimit, fuqinë e kontrollit të cilësisë dhe mekanizmave të sigurisë, rregullat e përgjegjësisë dhe sigurimit si dhe kërkesat profesionale të çertifikimit (World Bank Group, Doing Business, 2014).

Kosova në rangimin botëror, sipas vlerësimeve të Bankës Botërore listohet në pozitën 122 nga 190 vende të përfshira në vlerësimin e kësaj banke në raportet e të bërit biznes për vitin 2018. Prej vitit 2010 deri në vitin 2018, Kosova ka shënuar progres për 54 pozita më lart në kuadër të 190 ekonomive botërore. Ky vlerësim tregon se Kosova ka ndërmarrë reforma të vazhdueshme institucionale në fushën e rregullimit ndërtimor.

Indikatorët të cilët merren parasysh për vlerësimin e rregullimit ndërtimor janë: procedurat e nevojshme për të ndërtuar ligjërisht një depo ose një objekt, koha për të përfunduar të gjitha procedurat e kërkruara, kostoja e kërkuar e cila merret si përqindje e vlerës së magazinës dhe indeksi i kontrollit të cilësisë së ndërtimit. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitur elementët strukturorë të reformave institucionale në funksion të marrjes së lejes së ndërtimit, që përfshin periudhën kohore 2010 – 2018.

Tabela 5. 3. *Analizë krahasuese e indikatorëve për marrjen e lejës së ndërtimit në Kosovë (2010 – 2018)*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Procedura (numër)	21	21	17	16	15	15	15	15	15
Koha (nr. i ditëve)	320	320	301	156	151	152	152	152	152
Kostoja (% e të ardhurave për kokë banori)	1291	856,5	775,8	2986	514,7	6,7	6,4	6,1	5,8

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Nëse marrim parasysh kriterin procedural tek marrja e lejes së ndërtimit, shihet që Kosova gjatë këtyre viteve të fundit ka thjeshtuar procedurat nga 21 sa ishin në vitin 2010 në 15 procedura të tilla. Procedurat e nevojshme për të marrë lejen e ndërtimit në Kosovë në vitin 2018, përfshijnë një periudhë kohore 152 ditore dhe me një kosto prej 5.8% ose e shprehur në vlerë monetare 1167.45 €. Nëse këtë periudhë kohore e krahasojmë me vitin 2010, atëherë vërehet që në Kosovë gjatë këtyre viteve jo vetëm që kemi pasur reduktim të procedurave për marrjen e lejës së ndërtimit, por edhe shkurtim të kohës së nevojshme për marrjen e kësaj leje. Prej vitit 2010 deri në vitin 2018, kostoja totale e këtij procesi u zvogëlua në masë të vogël, nga vlera 1291 € në 1167.45 €.

Koston më të lartë gjatë procesit të marrjes së lejes së ndërtimit, e ka pagesa e taksës komunale në bankat komerciale, që përfshin një shumë prej 8,454 €. Procedura e cila përfshin periudhën më të madhe kohore gjatë marrjes së lejes së ndërtimit është realizimi i inspektimit përfundimtar. Për t'u realizuar ky inspektim nevojiten 39 ditë dhe kjo procedurë nuk është e ngarkuar me kosto financiare. Nëse e krahasojmë Kosovën me vendet e tjera të rajonit, kriteri i rregullimit ndërtimor nuk është në nivel të

kënaqshëm. Meqënese Kosova renditet në pozitën 122 në vitin 2018, vetëm Bosnia & Herzegovina dhe Kroacia ka një rangim më të ulët në nivel botëror në krahasim me Kosovën.

Figura 5. 5. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Marrja e lejës së ndërtimit*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në kuadër të vendeve të rajonit, për vitin 2018 sipas të dhënave të Bankës Botërore, Serbia dhe Maqedonia janë dy vende të cilat kanë renditje më të mirë në krahasim me vendet e tjera të rajonit sa i përket rregullimit ndërtimor. Pra, këto vende kanë procedura më të thjeshta dhe kanë bërë një progres më të madh në këtë aspekt në krahasim me vendet e tjera të rajonit, e sidomos me Kosovën. Në vitin 2014 Kosova e bëri më të lehtë marrjen e lejeve të ndërtimit duke eliminuar kërkesën për validimin e projektit kryesor të ndërtimit, duke eliminuar tarifat për miratim teknik nga komuna dhe uljen e tarifës së lejes së ndërtimit, ndërsa në vitin 2015 e lehtësua edhe më shumë ky proces duke krijuar një skemë të re të inspektimit në faza dhe në thelb uljen e tarifës së lejes së ndërtimit.

5.3.3. Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike të besueshme dhe të përballueshme është jetike për bizneset. Për të luftuar furnizimin e dobët me energji elektrike, shumë firma në ekonomitë në zhvillim duhet të mbështeten në vetë furnizim, shpesh me një kosto të lartë të ndaluar. Nëse energjia elektrike është e disponueshme ose jo, hapi i parë për një klient është gjithmonë për të fituar qasje sa më të lehtë në burimet e energjisë elektrike. Ky kriter vlerësohet duke përfshirë të gjitha procedurat e kërkuara për një biznes lokal për të siguruar një qasje të përhershme të energjisë elektrike dhe furnizim për një objekt të standardizuar, si dhe kohën dhe koston për përfundimin e tyre. Këto procedura përfshijnë aplikime dhe

kontrata me kompanitë e energjisë elektrike, largimet nga agjencitë e tjera dhe punimet e jashtme dhe përfundimtare të kësaj qasje (World Bank Group, Doing Business, 2013).

Indikatorët të cilët analizohen në këtë proces janë: procedurat për të marrë qasje në energji elektrike, koha e nevojshme për të përfunduar këto procedura, kostoja e kërkuar si përqindje e të ardhurave për kokë banori, besueshmëria dhe transparenca e furnizimit me energji elektrike si dhe çmimi i elektricitetit. Sipas vlërësimeve të të bërit biznes Kosova, nga viti 2012 deri në vitin 2018, ka përmirësuar mesatarisht pozitën e saj në rangimin botëror, nga numri 124 sa ishte në vitin 2012, ka shënuar progres në numrin 106 në vitin 2018.

Sipas të dhënave të Bankës Botërore, marrja e energjisë elektrike për një biznes të ri në Kosovë kërkon të plotësojë 6 procedura brenda 36 ditëve me kosto prej 219.1%. Në vitin 2012, marrja e energjisë elektrike kërkonte 7 procedura, për 60 ditë dhe kushtonte 1016.8% e të ardhurave për kokë banori. Në listën e vendeve të cilat kanë rekord sa i përket numrit të procedurave dhe kohës së nevojshme për të siguruar qasje në energjinë elektrike janë Emiratet e Bashkuara Arabe, të cilat këtë proces e realizojnë nëpërmjet 2 procedurave brenda afat kohor dhjetë ditorë.

Figura 5. 6. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Furnizimi me energji elektrike*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Dorëzimi i aplikacionit në KEDS për t'u qasur në rrjetin elektrik dhe marrja e udhëzimeve tjera teknike është e ngarkuar me një kosto prej 2,280 € dhe kjo procedurë zgjatë përafërsisht 14 ditë. Në tabelën 4.4 janë paraqitur elementet strukturore të cilat ndikojnë në qasjen e firmave për furnizim me energji elektrike. Të dhënat janë marrë nga raportet e të bërit biznes, që përfshijnë periudhën kohore 2012 – 2018. Mund të vërehet nga tabela e mëposhtme që periudha kohore e nevojshme për t'u qasur në rrjetin elektrik është reduktuar nga 60 ditë sa ishte në vitin 2012 në 36 ditë në vitin 2018.

Tabela 5. 4. *Analizë krahasuese e indikatorëve për furnizimin me energji elektrike në Kosovë (2012 – 2018)*

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Procedura (numër)	7	7	7	7	7	7	6
Koha (nr. i ditëve)	60	48	48	46	46	36	36
Kostoja (% e të ardhurave për kokë banori)	1016.8	915.4	881.1	822.5	788.5	253.1	219.1

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Gjatë viteve të fundit, edhe pse nuk kemi pasur shumë thjeshtim të procedurave për marrjen e energjisë elektrike, vlen të theksohet se gjatë kësaj kohe kemi pasur rënie të dukshme të kostos për realizimin e çdo procedure të paraparë sipas kritereve të përcaktuara nga Banka Botërore. Procedura e cila shkakton koston më të madhe (rreth5000 €) gjatë kësaj faze është përfundimi i punëve të jashtme nga kontraktori privat elektrik,. Prej vitit 2012 deri në vitin 2018, në Kosovë janë reduktuar në masë të madhe këto kosto, nga 1016.8% në 219.1% e të ardhurave për kokë banori.

Figura 5. 7. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Furnizimi me energji elektrike*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Duke u bazuar në këto të dhëna Kosova ka përmirësime më të mira në këtë fushë se sa Bullgaria, Shqipëria, Bosnia & Hercegovina dhe Mali i Zi. Në kuadër të vendeve të rajonit, Maqedonia dhe Kroacia kanë shënuar progresin më të madh në lehtësimin e procedurave, shkurtimin e kohës dhe reduktimin e kostos për furnizim me energji elektrike. Siç shihet edhe nga figura 5.7, në kuadër të vendeve të rajonit Shqipëria, Bullgaria, Mali i Zi dhe Bosnia & Hercegovina janë vende të cilat në një të

ardhmen e afërt duhet të ndërmarrin hapa konkretë që të thjeshtojnë procedurën e furnizimit me energji elektrike për sektorin e bizneseve. Në këtë aspekt edhe Kosova duhet të bëjë shumë reforma të tjera, sepse energjia elektrike është një prej indikatorëve që ndikon jo vetëm në përmirësimin e klimës së biznesit, por edhe në zhvillimin e gjithëmbarshëm ekonomik të vendit.

5.3.4. Regjistrimi i pronës

Një tjetër kriter mjaft të rëndësishëm, që ndikon edhe në qasjen në financa, është regjistrimi i pronës. Sigurimi i të drejtave formale të pronësisë është thelbësore edhe në procesin e kredidhëniesdhe gjithashtu ndikon në masë të madhe edhe në përmirësimin e klimës së biznesit. Menaxhimi efektiv i tokës është pjesë e këtyre reformave institucionale. ‚Nëse transferimi formal i pronës është shumë i kushtueshëm ose i komplikuar, titujt formal mund të vlerësohen përsëri joformalisht. Prandaj, në ato raste ku prona është e administruar në mënyrë joformale, ka pak shanse për t'u pranuar si kolateral për kreditë, duke kufizuar qasjen në financa (World Bank Group, Doing Business, 2015).

Banka Botërore nëpërmjet raporteve të të bërit biznes regjistron renditjen e plotë të procedurave të nevojshme për një biznes për blerjen e pronës nga një kompani tjetër dhe transferimin e titullit të pronësisë në emrin e blerësit. Transaksioni konsiderohet i plotë kur është i kundërt ndaj palëve të treta dhe kur blerësi mund ta përdorë pronën si kolateral për një hua bankare. Sipas të dhënave në raportet e të bërit biznes, në vitin 2018 Kosova rënditet në pozitën 34, në kuadër të 190 ekonomive tjera të cilat janë vlerësuar sa i përket procedurave, kohës, kostos dhe cilësisë së regjistrimit të pronës.

Figura 5. 8. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Regjistrimi i pronës*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në Kosovë janë të përcaktuara 6 procedura për regjistrimin e pronës e të cilat marrin një periudhë kohore prej 27 ditësh. Ky proces ka një kosto prej 0.3% të vlerës së pronës. Kosova prej vitit 2010 deri në vitin 2018 ka shënuar përmirësime të vazhdueshme në aspektin e procedurave, kohës dhe kostos për regjistrimin e pronës. Në vitin 2010 Kosova ishte ranguar në pozitën 68, me 8 procedura të nevojshme për regjistrimin e pronës dhe ky proces kishte një kosto deri në 1% të vlerës së pronës. Prej vitit 2010 deri në vitin 2018, vërehet një reduktim i periudhës kohore dhe kostos për realizimin e kësaj procedure. Në figurën 5.8 është paraqitur grafikisht renditja e Kosovës në nivelin global për sa i përket procedurave, kohës, kostos dhe cilësisë së shërbimeve për regjistrimin e pronës, për periudhën kohore 2010 – 2018.

Siç mund të vërehet në figurën e mësipërme, Kosova në vitet e fundit ka shënuar progres të vazhdueshëm në përmirësimin e procedurave, kohës dhe kostos në lidhje me regjistrimin e pronës. Rritja e efektivitetit në aspektin e regjistrimit të pronës në Kosovë do të ndihmojë në nxitjen e transferimit të tokës, në inkurajimin e investimeve si dhe në dhëniene bizneseve qasje në tregjet formale të kredive. Por, një pjesë e madhe e pronës në ekonomitë në zhvillim nuk është e regjistruar zyrtarisht. Titujt joformalë nuk mund të përdoren si siguri në marrjen e kredive, gjë që kufizon mundësitë e financimit për bizneset.

Shumë qeveri në vende të ndryshme kanë ndërmarrë iniciativa për programe të ndryshme të cilat do të ndihmojnë në regjistrimin e pronës për subjekte të ndryshme ekonomike. Sa më e vështirë dhe më e kushtueshme është procedura që të transferohet zyrtarisht pasuria, aq më i madh është shansi që titujt e formalizuar do të kthehen shpejt në mënyrë joformale. Prandaj, eliminimi i pengesave të panevojshme për regjistrimin dhe transferimin e pronës në Kosovë është një element shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të këtij vendi (World Bank Group, Doing Business, 2010).

Tabela 5. 5. *Analizë krahasuese e indikatorëve për regjistrimin e pronës në Kosovë (2010 – 2018)*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Procedura (numër)	8	8	8	8	7	6	6	6	6
Koha (nr. i ditëve)	33	33	33	33	28	27	27	27	27
Kostoja (% e vlerës së pronës)	1%	0.6%	0.6%	0.6%	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Regjistrimi efikas i pasurisë ndikon në masë të madhe në zvogëlimin e kostove të transaksioneve, ndihmon formalizimin e titujve të pronësisë, ndikon në rritjen e sigurisë më të madhe të përceptuar nga të drejtat pronësore dhe në uljen e korrupsionit. Të gjithë këta elementë të shkaktuar nga procedurat efektive dhe të lehta të regjistrimit të pronës janë indikatorë të rëndësishëm në përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe ndikojnë në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë. Në tabelën 5.5 janë të paraqitura të dhënat në lidhje me procedurat, kohën e nevojshme për realizimin e secilës procedurë dhe koston e këtij procesi që vlerësohet si përqindje e vlerës së pronës.

Shuma e vlerës së pronës e cila është llogaritur në raportin e të bërit biznes për vitin 2018 është 166,811.80 €, dhe për këtë vit procedura e regjistrimit të pronës arrin deri në 0.3% të vlerës së pronës, pra kostoja e regjistrimit të pronës në Kosovë për vitin 2018 është 500.43 €. Vlen të theksohet se kostoja më e vogël e regjistrimit të pronës, ndikon në uljen e kostos së transaksioneve për bizneset, duke iu lejuar atyre një qasje më të lehtë në kreditë e bankave komerciale.

Figura 5. 9. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Regjistrimi i pronës*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Nëse e krahasojmë Kosovën me vendet e tjera të rajonit, për reformat e ndërmarra në procedurat e regjistrimit të pronës, vendi ynë qëndron shumë më mirë në krahasim me këto vende. Në vitin 2018, sipas të dhënave të Bankës Botërore, vlerësohet të jetë një ndër vendet që ka menaxhuar me efektivitet të madh procedurat, kohën dhe koston për regjistrimin e pronës, në krahasim me vendet e tjera të rajonit të cilat kanë një renditje më të ulët se sa Kosova.

Shteti i cili nuk ka shënuar përmirësime të vazhdueshme dhe ka probleme të shumta në transferimin dhe regjistrimin e pronës është Shqipëria, e cila për vitin 2018 renditet në pozitën 103 në kuadër të 190 vendeve të listuara në raportin e të bërit biznes të Bankës Botërore. Në vitin 2014 Kosova e bëri më të lehtë transferimin e pronës duke futur një sistem të ri noterësh dhe duke kombinuar procedurat për hartimin dhe legalizimin e marrëveshjeve të shitjes dhe blerjes dhe në vitin 2015 prapë e bëri më të vështirë transferimin e pronës duke e rritur tarifën për regjistrimin e transaksioneve të pronës.

5.3.5. Qasja në kredi

Njëri prej kritereve që ka rëndësi të madhe në përmirësimin e klimës së biznesit është qasja në kredi e bizneseve të vogla dhe të mesme. Kornizat kryesore që mund të lehtësojnë qasjen në kredi dhe përmirësojnë ndarjen e saj janë: sistemet e informacionit të kredisë dhe ligjet e kolateralit dhe të falimentimit. Sistemet e informacionit të kredive i mundësojnë huadhënësit për të analizuar historinë financiare të një huamarrësi potencial (pozitiv ose negativ) gjatë vlerësimit të rrezikut dhe lejojnë huamarrësit të krijojnë histori të mirë kreditore që do të lehtësonte qasjen e tyre në kredi. Ligjet e kolateralit u mundësojnë bizneseve të përdorin asetet e tyre, sidomos pronën e luajtshme, si siguri për të gjeneruar kapital, ndërkohë që të drejtat e kreditorëve janë shoqëruar me raporte më të larta të kredisë së sektorit privat ndaj PBB -së (World Bank Group, Doing Business, 2018).

Bizneset vazhdimisht janë të kufizuara sa i përket qasjes në kredi, prandaj kjo çështje mbetet si një ndër barrierat më të mëdha për funksionimin dhe rritjen e tyre. Raporti Doing Business ndërton dy grupe treguesish se sa mirë funksionojnë tregjet kreditore: regjistri i kredive dhe tjetri në të drejtat ligjore të huamarrësve dhe huadhënësve.

Nëpërmjet regjistrit kreditor, institucionet që mbledhin dhe shpërndajnë informacion mbi kredinë për huamarrësit, mund të rrisin në masë të madhe qasjen në kredi. Duke ndarë informacionin kreditor, ata ndihmojnë huadhënësit të vlerësojnë rrezikun dhe shpërndajnë kredi në mënyrë më efikase. Pra, qasja në kredi është njëri nga indikatorët mjaft të rëndësishëm që ndikon në mjedisin e biznesit dhe zhvillimin e sektorit real në Kosovë.

Figura 5. 10. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Qasja në kredi*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Duke u bazuar në të dhënat e Bankës Botërore, Kosova nga viti 2010 deri në vitin 2018 ka shënuar progres të kënaqshëm në aspektin e reformave të ndërmarra për qasjen në kredi. Në vitin 2010 Kosova renditej në pozitën 43 nga 190 ekonomi të vlerësuara për qasjen në kredi, ndërsa në vitin 2018, reformat e ndërmarra nga institucionet financiare dhe Banka Qëndrore e Kosovës, ndikuan që Kosova të avancojë në këtë aspekt, duke u ranguar në pozitën e 12-të.

Për të vlerësuar efikasitetin e reformave të ndërmarra në procedurat e dhënies së kredive, Banka Botërore vlerëson katër indikatorë të rëndësishëm të qasjes në kredi e ato janë: indeksi i fuqisë për të drejtat ligjore, indeksi i informacionit të kredisë, mbulimi i regjistrit kreditor dhe mbulimi i byrosë kreditore.

Indeksi i fuqisë për të drejtat ligjore matet nëpërmjet dy faktorëve: të drejtat e huamarrësve dhe huadhënësve nëpërmjet ligjeve të kolateralit (0-10) dhe mbrojtja e të drejtave të kreditorëve të siguruar nëpërmjet ligjeve të falimentimit (0-2). Indeksi i informacionit kreditor mat fushëveprimin dhe qasjen e informacionit kreditor të shpërndarë nga zyrat kreditore dhe regjistrat e kredive (0-8). Mbulimi i regjistrit kreditor tregon për numrin e individëve dhe firmave të renditura në këtë regjistër si përqindje e rritjës së popullsisë.

Tabela 5. 6. *Analizë krahasuese e indikatorëve për qasjen në kredi në Kosovë (2010 – 2018)*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Indeksi i fuqisë për të drejtat ligjore	8	8	8	8	8	8	8	9	11
Indeksi i informacionit kreditor	3	4	5	5	5	6	6	6	6
Mbulimi i regjistrit kreditor (%)	18.9%	16.9%	20.5%	22.2%	22.1%	22.8%	95.2%	38.1%	40.5%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën 4.6 mund të vërejmë që indikatorët të cilët masin qasjen në kredi kanë një nivel të mirë të performacës. Të drejtat e huamarrësve dhe huadhënësve nëpërmjet ligjeve të kolateralit dhe mbrojtja e të drejtave të kreditorëve të siguruar nëpërmjet ligjeve të falimentimit arrijnë të vlerësohen me 11 pikë, nga 12 pikë sa janë të mundshme në këtë vlerësim.

Nga viti 2010, vlerësimi ishte me 8 pikë, ndërsa në vitin 2018 vlera e këtij koeficienti është rritur në 11 pikë. Të vetmin kriter të cilin nuk e ka përmbushur sistemi bankar në Kosovë në reformat e ndërmarra për qasjen në kredi, është regjistri modern i kolateralit në të cilin regjistrimet, ndryshimet, anulimet dhe kërkimet mund të kryhen online nga ndonjë palë e tretë e interesuar. Pra, këtë regjistër online me kërkesa të tilla ende nuk e kanë të implementuar institucionet financiare në Kosovë.

Figura 5. 11. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Qasja në kredi*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Indeksi i informacionit kreditor në vitin 2018 është vlerësuar me 6 pikë, nga 8 pikë të mundshme të cilat bëhen për këtë indeks. Pra, për këtë indeks, mbetet të punohet me shumë në shpërndarjen e të dhënave nga shitësit ose kompanitë e shërbimeve, dhe jo vetëm nga bankat dhe institucionet e tjera financiare si dhe ofertat e zyrës së regjistrit kreditor duhet të jenë më shumë vlerë e shtuar për bankat komerciale dhe institucionet e tjera financiare, duke i ndihmuar ato të vlerësojnë aftësinë kreditore të huamarrësve potencial.

Sipas të dhënave të Doing Business, Kosova, në krahasim me vendet e tjera të rajonit, ka bërë më shumë reforma institucionale në funksion të lehtësimit të qasjes në kredi. Në kuadër të vendeve të rajonit, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi kanë një performancë më të mirë sa i përket lehtësimit të qasjes në kredi, duke u ranguar në pozitën numër 12 në kuadër të 190 ekonomive që marrin pjesë në vlerësimin e Bankës Botërore. Kroacia është shteti i cili në kuadër të vendeve të rajonit ka renditje më të ulët në krahasim me vendet e tjera, sa i përket qasjes në kredi.

5.3.6. Mbrojtja e investitorëve

Mbrojtja e investitorëve është një çështje shumë e rëndësishme për aftësinë e kompanive për të rritur kapitalin, për të ristukturuar dhe për të diversifikuar kapitalin. Rregulloret efektive përcaktojnë saktësisht transaksionet me palët e ndërlidhura me to, nxisin kërkesa të qarta dhe efikase për dhënien e informacioneve shpjeguese, kërkojnë pjesëmarrjen e aksionarëve në vendimet e mëdha të kompanisë dhe vendosin standarde të detajuara të llogaridhënies për brendin e kompanisë (World Bank Group, Doing Business, 2016).

Kompanitë rriten me rritjen e kapitalit, qoftë nëpërmjet një huaje bankare ose duke tërhequr investitorë të kapitalit. Shitja e aksioneve lejon kompanitë të zgjerohen pa pasur nevojë të ofrojnë kolateral dhe të paguajnë kreditë bankare. Megjithatë, investitorët shqetësohen për mjetet e tyre financiare dhe kërkojnë ligje që i mbrojnë ato. Një studim zbulon se prania e mbrojtjes ligjore dhe rregullatore për investitorët shpjegon deri në 73% të vendimit për të investuar (World Bank Group, Doing Business, 2011).

Sipas të dhënave të Bankës Botërore, Kosova nga viti 2010 deri në vitin 2018 rangohet në pozitën numër 89, në kuadër të 190 ekonomive të përfshira në vlerësimin e të bërit biznes. Në vitin 2010, Kosova ishte një nga vendet me perfomancën më të dobët sa i përket mbrojtës së investitorëve, duke u renditur në pozitën 172. Indikatorët të cilët vlerësohen nga Doing Business për mbrojtjen e investitorëve

janë: indeksi i mbrojtjës së investitorëve të vegjël, shkalla e indeksit për rregullimin e konflikteve të interesit dhe shkalla e indeksit të qeverisjës së aksionarëve.

Figura 5. 12. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Mbrotja e investitorëve*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Indeksi i mbrojtjes së investitorëve është matës i thjeshtë për shkallën e rregullimit të konfliktit të interesit dhe shtrirjes së indekseve të qeverisjes së aksionarëve. Ky indeks vlerësohet prej 0 deri në 10 pikë. Në vitin 2010 ky indeks kishte një vlerë prej 2.7, ndërsa në vitin 2018 nga vlera 2.7 ka arritur në vlerën 5.1. Shkalla e indeksit për rregullimin e konflikteve të interesit mat shkallën e zbulimit, të përgjegjësisë së drejtorit dhe lehtësisë së treguesve të aksionarëve. Në vitin 2018 ky indeks është vlerësuar me 5.3 pikë. Në këtë vlerësim janë marrë parasysh përfshirja legjitime e aksionarëve në transaksionet blerës – shitës si dhe dhënia e informacioneve shpjeguese për transaksionin dhe konfliktin e interesit. Gjatë vlerësimit të indeksit për rregullimin e konfliktit të interesit nuk janë marrë parasysh përfshirja e një akteri të jashtëm për të shqyrtuar kushtet e transaksionit para se të ndodhë ai.

Shkalla e indeksit të qeverisjes së aksionarëve mat shkallën e të drejtave të aksionarëve, shtrirjes së pronësisë dhe kontrollit si dhe shkallën e indekseve të transparencës korporative. Në vitin 2010 Kosova ishte vlerësuar me 3 pikë, ndërsa në vitin 2018 vlerësimi i këtij indeksi ka arritur në 5.3 pikë. Në tabelën 5.7. janë paraqitur të gjitha të dhënat për vlerën e tri indekseve të cilat tregojnë shkallën e reformave të ndërmarra në fushën e mbrojtjës së investitorëve.

Tabela 5. 7. *Analizë krahasuese e indikatorëve për mbrotjën e investitorëve në Kosovë (2010 – 2018)*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Indeksi i mbrojtjës së investitorëve	2.7	2.7	2.7	5	5	5.3	5.8	5.8	5.1
Shkalla e indeksit për rregullimin e konfliktit të interesit	2.1	2	2	6	6	6.2	5.3	5.3	5.3
Shkalla e indeksit të qeverisjës së aksionarëve	3	3	3	3	3	5.8	6.3	6.3	5.3

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në drejtim të parimeve të cilat janë marrë parasysh nga Doing Business për indeksin e qeverisjes së aksionarëve, pjesa më e madhe e indikatorëve janë vlerësuar pozitivisht si p.sh. shitja e 51% e aseteve të blerësit kërkon miratimin e aksionarëve, aksionarët që përfaqësojnë 10% të kapitalit aksionar të blerësit mund të bëjnë thirrje për një mbledhje të aksionarëve dhe shumë elemente të tjera të qeverisjes korporative janë përfillur duke ndikuar në masë të madhe në përmirësimin e klimës së biznesit dhe rritjen e mundësive që kompanitë e ndryshme të rrisin kapitalin dhe të kenë më shumë asete në dispozion për kolateral, në mënyrë që të lehtësohet edhe qasja në financa.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në figurën 5.13, vërejmë që Kosova në krahasim me vendet e tjera të rajonit ka rangim më të ulët në reformat të cilat janë ndërmarrë në funksion të mbrojtës së investitorëve. Shtetet të cilat kanë rangimin më të mirë në mbrojtjen e investitorëve janë Maqedonia (7) dhe Shqipëria (20).

Figura 5. 13. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Mbrojtja e investitorëve*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Kosova përforcoi mbrojtjen e investitorëve duke paraqitur një kërkesë për miratimin e aksionarëve nga transaksionet e palëve të ndërlidhura, duke kërkuar një zbulim më të madh të këtyre transaksioneve në raportin vjetor dhe duke bërë më të lehtë padinë e drejtorëve kur këto transaksione janë paragjykuese (World Bank Group, Doing Business, 2016).

5.3.7. Pagesa e tatimeve

Në kuadër të indikatorëve të cilët ndikojnë në përmirësimin e klimës së biznesit janë edhe reformat e sistemit fiskal në Kosovë. Pagesa e tatimeve është esenciale dhe niveli i normave tatimore duhet të zgjidhet me kujdes dhe të shmanget kompleksiteti i panevojshëm i rregullave tatimore. Bizneset që renditen më mirë në lehtësinë e pagesës së tatimeve tentojnë të perceptojnë se normat tatimore ashtu edhe administrimi i taksave janë më pak pengesë për biznesin, sipas hulumtimeve të Bankës Botërore (World Bank Group, Doing Business, 2016).

Duke u bazuar në raportet Doing Business, pagesa e taksave vlerësohet sipas këtyre indikatorëve: pagesa e tatimeve dhe taksave që përfshin numrin total të tatimeve dhe kontributeve të paguara (tatimi në konsum, tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi në fitim etj), koha e kërkuar për pagesën e tatimeve që përfshin kohën e nevojshme për mbledhja e informacionit, llogaritjen e tatimit të pagueshëm, përfundimi i kthimit të taksave, paraqitja në administratën tatimore, rregullimi i pagesës ose mbajtja në burim, përgatitja e librave të veçantë të kontabilitetit tatimor etj. Indikatori i fundit që merret parasysh në vlerësimin e pagesës së tatimeve është llogaritja e tatimeve gjithsej dhe përqindja e kontributeve që përfshin fitimin ose tatimin në të ardhurat e korporatave, kontributet sociale, kontributetet e punës, tatimet mbi transferimin e pronës, dividenda si dhe taksa të tjera.

Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, Kosova ka ndërmarrë reforma të shumta në sistemin tatimor për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të ndikuar që sektori privat i biznesit të ketë një qasje më të lehtë në kreditë e bankave komerciale. Një barrë më e lehtë tatimore për ndërmarrjet e sektorit real nënkupton një lehtësi më të madhe për këto biznese për të pasur qasje në kreditë e sektorit bankar. Në vitin 2010 Kosova ishte renditur në pozitën numër 50, në mesin e 190 vendeve të përfshira në këtë rangim për sa i përket lehtësisë në pagesën e tatimeve. Gjatë viteve të fundit, edhe pse qeveria e Kosovës ka ndërmarrë reforma të ndryshme tatimore në funksion të lehtësimit të të bërit biznes në Kosovë, prapë mund të theksojmë që sistemi tatimor në Kosovë ka nevojë edhe për reforma të tjera të cilat mund të ndihmojnë në zhvillimin e sektorit real në Kosovë.

Figura 5. 14. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Pagesa e tatimeve*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në vitin 2018, sipas të dhënave të paraqitura në figurën e mësiperme, vërehet që Kosova në kuadër të 190 ekonomive botërore, rënditet në pozitën numër 45 për lehtësinë e pagesës së tatimeve dhe taksave. Nëse marrim parasysh numrin total të pagesave për tatime dhe taksa në sistemin tatimor në Kosovë, nga viti 2010 deri në vitin 2018, kemi pasur një reduktim të numrit të pagesave për tatime dhe taksa nga 33 në 10 pagesa.

Pra, aktualisht në Kosovë kemi pagesat për tatimet mbi të ardhurat e korporatave, sigurimin social, tatimi në pronë, taksat e automjeteve dhe tatimi mbi vlerën e shtuar. Tatimi mbi të ardhurat e korporatave është një tatim i cili është i tatueshëm në fitim, ka normën e tatimit 10% dhe ky lloj tatimi kërkon 5 pagesa të cilat duhet të realizohen dhe marrin kohë 29 orë brenda vitit fiskal. Në vitin 2018 sipas të dhënave në raportet Doing Business, vlera e gjithsej tatimit mbi të ardhurat e korporatave si përqindje e fitimit është 9.33%.

Në tabelën 5.8. do të paraqiten të gjitha vlerësimet e realizuara nga Banka Botërore për pagesën, kohën dhe gjithsej tatimet dhe shkallën e kontributeve si përqindje e fitimit, që janë indikatorë nëpërmjet të cilave është matur lehtësia e pagesës së tatimeve dhe taksave në Kosovë, për periudhën kohore 2010 – 2018.

Tabela 5. 8. *Analizë krahasuese e indikatorëve për pagesën e tatimeve në Kosovë (2010 – 2018)*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018

Pagesa (numër për vit)	33	33	33	33	33	33	32	10	10
Koha (orë në vit)	163	163	164	164	162	155	155	155	155
Gjithsej tatimi dhe shkalla e kontributeve (% e fitimit)	21.2%	10.2%	10.2%	11.2%	11.1%	15.3%	15.2%	15.2%	15.2%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Përqindja e fitimit në shumën totale të tatimeve dhe kontributeve është zvogëluar nga 21.2% sa ishte në vitin 2010 në 15.2% në vitin 2018. Pjesëmarrjen më të madhe si përqindje të fitimit në shumën totale të tatimeve dhe kontributeve e ka tatimi mbi vlerën e shtuar 9.33%, sigurimi social 5.64%, tatimi në pronë 0.17%, taksat në automjete 0.05% dhe taksa ekologjike 0.02%. Në qoftëse e analizojmë lehtësinë e pagesës së tatimeve dhe taksave në Kosovë në krahasim me vendet e tjera të rajonit, atëherë bizneset kosovare kanë më shumë lehtësira në pagesën e tatimeve dhe taksave në krahasim me bizneset në vendet e tjera të rajonit.

Figura 5. 15. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Pagesa e tatimeve*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në kuadër të vendeve të rajonit, shtetet të cilat kanë reformuar më së shumti sistemin tatimor dhe kanë krijuar lehtësira në pagesat e tatimeve janë Maqedonia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Ndërsa vendet të cilat nuk kanë krijuar edhe shumë lehtësira në pagesen e tatimeve në krahasim me vendet e cekura më lartë, janë Kroacia, Bullgaria, Shqipëria dhe Bosnia & Herzegovina.

Në vitin 2016 Kosova bëri pagesën e tatimeve më të lehta për kompanitë duke hequr tarifën vjetore të licencës së biznesit dhe në vitin 2017 e lehtësoi edhe më tutje pagesën e tatimeve dhe taksave duke futur një sistem online për depozitimin dhe pagesën e kontributeve të TVSH-së dhe sigurimeve shoqërore si dhe bëri pagesën e taksave më pak të kushtueshme duke lejuar më shumë lloje të shpenzimeve të zbriten për llogaritjen e tatimit në të ardhurat e korporatave.

5.3.8. Tregtimi përtej kufijve

Në botën e sotme të globalizuar, lehtësimi i tregtimit ndërmjet ekonomive të ndryshme është gjithnjë e më e rëndësishme për biznesin. Kërkesat e dokumenteve të tepërta, procedurat e rënda doganore, operacionet joefikase të porteve dhe infrastruktura e papërshtatshme, të gjitha çojnë në kosto shtesë dhe vonesa për eksportuesit dhe importuesit, duke e penguar potencialin tregtar.

Por, lehtësimet tregtare janë faktorë të cilët në mënyrë indirekte ndikojnë edhe në qasjen më të lehtë të bizneseve në kreditë e bankave komerciae, p.sh. një firmë e cila mund të jetë një ndërmarrje prodhuese, nëse ka nevojë për mjete financiare që ta financojë aktivitetin e saj prodhues, atëherë ajo aplikon për ndonjë kredi bankare. Gjatë fazës së analizimit të kredisë, njëra nga çështjet mjaft të rëndësishme që analizohet është kostoja e transaksioneve të huamarrësit potencial. Pra, firma e cila ka aplikuar për kredi është firmë prodhuese dhe eksporton si dhe nëse ka lehtësira tregtare, ateherë kjo ndikon në mënyrë indirkte edhe në uljen e kostove për firmën dhe rritjen e aftësisë finaciare të firmës në shlyerjen e kredisë bankare. Në përgjithësi, lehtësimet tregtare ndikojnë në reduktimin e tarifave për bizneset të cilat eksportojnë.

Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, Kosova në vitin 2018, në kuadër të 190 ekonomive botërore, pozicionohet në numrin 48, duke u vlerësuar si një prej vendeve mjaft atraktive për të eksportuar, por që ka krijuar edhe lehtësira të mëdha tregtare, të cilat patjeter që do të ndikojnë në përmirësimin e klimës së biznesit dhe zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi.

Në raportet Doing Business, lehtësimet tregtare vlerësohen sipas këtyre indikatorëve: koha dhe kostoja për të eksportuar në pajtueshmëri me kufijtë dhe në përputhshmëri me dokumentacion, si dhe koha dhe kostoja për të importuar në pajtueshmëri me kufijtë dhe në përputhshmeri me dokumentacion e kërkuar. Siç shihet edhe nga të dhënat e paraqitura në figurën 5.16. Kosova ka shënuar progres të madh në aspektin e reformimit të politikave tregtare dhe lehtësimit tregtar për ato biznese të cilat ekpsortojnë jashtë Kosovës.

Figura 5. 16. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Lehtësimet tregtare*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Banka Botërore, nëpërmjet raporteve Doing Business deri në vitin 2015 ka vlerësuar lehtësimet tregtare nëpërmjet indikatorëve të përgjithshëm siç janë: numri i dokumentave të nevojshme për të eksportuar dhe për të importuar, koha e nenvojshme për të eksportuar dhe importuar si dhe kostoja e kërkuar. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura në formë të përmbledhur të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me vlerësimet e Bankës Botërore për indikatorët të cilët masin lehtësimin tregtar në Kosovë deri në vitin 2015.

Tabela 5. 9. *Analizë krahasuese e indikatorëve për matjen e lehtësimeve tregtare në Kosovë (2010 – 2015)*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Dokumentat për të eksportuar (nr.)	8	8	8	8	8	8
Koha për të eksportuar (orë)	17	17	17	15	15	15
Kostoja për të eksportuar (€)	2270	2230	2270	1775	1775	1695
Dokumentat për të importuar (nr.)	8	8	8	8	7	7
Koha për të importuar (orë)	16	16	16	15	15	15
Kostoja për të importuar (€)	2330	2280	2280	1810	1810	1730

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Sipas vlerësimeve të Doing Business për vitin 2018, koha e nevojshme për të eksportuar në pajtueshmëri me kufijtë është 28 orë me një kosto prej 137 €, ndërsa koha e nevojshme për të eksportuar në përputhje me dokumentacionin është 38 orë me një kosto prej 127 €. Vërehet që për nga aspekti kohor, kemi lehtësime tregtare për të eksportuar nëse bazohemi në pajtueshmeri me kufijtë.

Ndërsa, koha e nevojshme për të importuar në pajtueshmëri me kufijtë është 16 orë me një kosto prej 128 €, kurse koha e nevojshme për të importuar në përputhje me dokumentacion e kërkuar është 6 orë

me një kosto në vlerë prej 42 €. Sipas këtyre vlerësimeve të Bankës Botërore, lehtësimet më të mëdha tregtare për të importuar janë të bazuara më shumë në kriteret të cilat kërkohen në bazë të dokumentacionit dhe jo sipas pikave kufitare.

Figura 5. 17. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Lehtëstimet tregtare*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Sipas të dhënave të paraqitura në figurën e mësiperme, shihet që Kosova në krahasim me vendet e tjera të rajonit nuk është e ranguar mirë për nivelin e reformave të ndërmarra në fushën e tregtisë si dhe lehtësimeve tregtare. Nëse e krahasojmë këtë rangim me atë të vitit 2010, kemi progres të madh gjatë këtyre viteve, por statistikat e vendeve të tjera tregojnë që Kosova ende duhet krijojë edhe më shumë lehtësira tregtare, në mënyrë që të ndikojë në përmirësimin e klimës së biznesit dhe të ketë ndikimndikim në mënyrë indirekte në uljen e kostove për ndërmarrjet të cilat eksportojnë dhe që konsiderohen si huamarrëse potencial për bankat komerciale në Kosovë.

Vlen të theksohet se Kroacia është vendi i parë në botë, sa i përket lehtësimeve tregtare, duke ju mundësuar shumë biznese vendore, por edhe bizneseve të huaja të eksportojnë me kosto më të ulët dhe me tarifa më të ulëta. Në vitin 2017, Kosova reduktoi kohën dhe koston e përputhshmërisë së dokumenteve dhe kohën e përputhjes së kufirit për eksport duke përmirësuar sistemin e automatizuar të menaxhimit të të dhënave të doganave dhe duke riorganizuar proceset e zhdoganimit.

5.3.9. Zbatimi i kontratave

Njëri nga kriteret për të përmirësuar mjedisin e biznesit për sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është zbatimi i kontratave. Zgjidhja efektive e kontesteve tregtare ka shumë përfitime për sektorin e biznesit. Gjykatat janë thelbësore për sipërmarrësit sepse interpretojnë rregullat e tregut dhe mbrojnë të drejtat ekonomike. Gjykatat efikase dhe transparente nxisin marrëdhënie të reja biznesi sepse ndërmarrjet e dinë se mund të mbështeten në gjykata nëse një klient i ri nuk paguan. Seancat gjyqësore

të shpejta janë shumë të rëndësishme për ndërmarrjet e vogla, të cilat mund të mos kenë burime të mjfatueshme financiare për të qëndruar në biznes, për derisa presin rezultatin e një mosmarrëveshje të gjatë gjyqësore (World Bank Group, Doing Business, 2017).

Zbatimi i kontratave ka një rëndësi të madhe edhe në kreditimin e bizneseve nga ana e bankave komerciale në Kosovë. Njëri nga parimet më kryesore që merret parasysh gjatë procesit të menaxhimit të riskut kreditor dhe analizës kosto – benefit për humarrësit me të cilët banka ka marrëdhënie kreditore, janë shpenzimet e mundshme të transaksioneve dhe kontrollit, të cilat lindin si rezultat i mosshlyerjes së detyrimeve nga ana e huamarrësit. Këto shpenzime të transaksioneve dhe të kontrollit, kryesisht vinë si rezultat i seancave gjyqësore në mes bankës dhe huamarrësit, prandaj është shumë e rëndësishme që gjatë kësaj faze të kemi një zbatim efektiv të kontratave të cilat do të lejojnë që procesi i menaxhimit të kredive jo-performuese të përfundohet me kosto sa më të ulëta të transaksioneve.

Figura 5. 18. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Zbatimi i kontratave*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Banka Botërore nëpërmjet raporteve të Doing Business vlerëson shkallën e zbatimit të kontratave dhe lehtësirave të krijuara për bizneset në procese e shumëta juridike të cilat ato marrin pjesë. Për të bërë matjen e lehtësisë së krijuar në fushën e zbatimit të kontratave, janë marrë parasysh këta indikatorë: koha dhe kostoja e kërkuar pët të zbatuar një kontratë nëpërmjet gjykatave dhe indeksi i cilësisë së proceseve juridike. Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, Kosova në vitin 2010 ishte renditur në pozitën 157 nga 190 ekonomi të vlerësuara në raportet e të bërit biznes sa i përket zbatimit të kontratave

nëpërmjet gjykatave. Ndërsa, në vitin 2018 Kosova ka shënuar një progres në këtë aspekt, duke e përmirësuar rangimin e saj nga 157 në 49.

Koha e nevojshme për të zbatuar një kontratë nëpërmjet gjykatës për të gjitha bizneset në Kosovë është 330 ditë, me një kosto prej 34.4% të vlerës totale të kërkesës. Në vlerësimin e kohës së nevojshme për të zbatuar një kontratë janë marrë parasysh paraqitja dhe shërbimi, gjykimi dhe zbatimi i gjykimit, ndërsa në vlerësimin e kostos hynë pagesat e avokatit, tarifat gjyqësore dhe tarifat e zbatimit.

Në vitin 2018, indeksi i cilësisë së proceseve juridike është vlerësuar me 9.5 pikë nga 18 pikë të mundshme të këtij indeksi. Për vlerësimin e cilësisë së proceseve juridike janë marrë parasysh këta faktorë: strukturat dhe procedurat gjyqësore, menaxhimi i rasteve, automatizimi i i gjykatave dhe zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve. Në kuadër të këtyre faktorëve që janë marrë si indikatorë të mundshëm që masin indeksin e cilësisë së procedurave gjyqësore, ndikimin më të madh e ka pasur reformimi i strukturës dhe procedurave gjyqësore.

Zbatimi efektiv i këtyre kontratave ka ndikim mjaft të madh në politikat kreditore të bankave komerciale në raport me bizneset e vogla dhe të mesme. Reformimi i duhur institucional i këtyre procedurave ndihmon bankat në uljen e kostove të transaksioneve dhe zgjidhjen më të shpejtë të çështjeve që kanë të bëjnë me kreditë jo-performuese. Nëse e analizojmë rastin e Kosovës në raport me vendet e tjera në lidhje me efektivitetin e zbatimit të kontratave nëpërmjet gjykatave, Kosova ka një rangim më të mirë se sa Shqipëria (120) dhe Bosnia & Herzegovina (71), ndërsa Bullgaria (40), Maqedonia (37) dhe Kroacia (23) kanë pasur më shumë sukses në krahasim me vendet e tjera të rajonit në reformimin e sistemit gjyqësor dhe krjimit të lehtësirave për bizneset dhe institucionet e tjera financiare në fushën e zbatimit të kontratave.

5.3.10. Zgjidhja e paaftësisë paguese

Një sistem i fortë i zgjidhjes së problemeve në lidhje me falimentimin funksionon si një filtër, duke siguruar mbijetesën e kompanive që janë ekonomikisht efikase dhe duke rialokuar burimet e tyre joefikase. Procedurat e shpejta dhe të lira të falimentimit rezultojnë në kthimin e shpejtë të bizneseve në operacion normal dhe rritjen e kthimit ndaj kreditorëve.

Duke sqaruar pritjet e kreditorëve dhe debitorëve rreth rezultatit të procedurave të falimentimit, sistemet e mira të funksionimit të procedurave të falimentimit mund të lehtësojnë qasjen në financa, të

ruajnë biznese më të qëndrueshme dhe të rritin ekonominë në mënyrë të qëndrueshme (World Bank Group, Doing Business, 2015).

Në vendet ku ligjet e falimentimit janë joefikase, kjo është një pengesë e fortë për investime. Qasja në kredi zvogëlohet, bankat komerciale hezitojnë të ofrojnë kredi për bizneset dhe risku financiar rritet, sepse kreditorët nuk mund të rimarrin kreditë jo-performuese. Ndërsa, ligjet efikase të falimentimit mund të inkurajojnë sipërmarrësit. Liria për të dështuar, dhe për ta bërë këtë nëpërmjet një procesi efikas, i të njerëzit dhe kapitalin në përdorimin më efektiv të tyre. Rezultati është biznese më produktive dhe më shumë vende pune (World Bank Group, Doing Business, 2010).

Në nivel global, Kosova për vitin 2018 rënditet në pozitën numër 49 sa i përket lehtësirave të krijuara në zgjidhjen e paaftësisë paguese dhe efektit të krijuar nga zbatimi i ligjeve dhe procedurave të falimentimit. Të dhënat e vitit 2010 në raportet e të bërit biznes, na tregojnë që Kosova ishte ranguar mjaft lartë në nivel global (28), sa i përket funksionimit të ligjeve të falimentimit dhe krijimit të lehtësirave për bizneset që t'i tejkalojnë këto procedura me kosto më të ulët.

Figura 5. 19. *Vlerësimi për rastin e Kosovës nga Doing Business – Zgjidhja e paaftësisë paguese*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Por nga viti 2011 deri në vitin 2017, Kosova kishte vlerësim shumë të dobët sa i përket efikasitetit të procedurave për zgjidhjen e paaftësisë paguese. Ky vlerësim nga pozita numër 28 sa ishte në vitin 2010, arriti në numrin 163 në vitin 2017, duke treguar që në Kosovë nuk ka shumë lehtësira për bizneset që të zgjidhin çështjet të cilat ndërlidhen me falimentimin.

Pra, duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në figurën e mësiperme, mund të vërejmë që në vitin 2018 Kosova qëndron më mirë në krahasim me vitin paraprak sa i përket krijimit të lehtësirave për bizneset në procedurat të cilat kërkohen për zgjidhjen e falimentimit. Duke e parë ndikimin shumë të

madh të këtij indikatori në qasjen e bizneseve në kreditë e bankave komerciale, institucionet në Kosovë kanë ndërmarrë një numër të madh të reformave institucionale të cilat kanë ndihmuar në përmirësimin e rangimit të Kosovës në nivel global, duke iu referuar çështjeve që kanë të bëjnë me zgjidhjen e paaftësisë paguese. Për të vlerësuar shkallën e lehtësisë së krijuar në zgjidhjen e paaftësisë paguese janë marrë këta indikatorë matës: norma e rimëkëmbjes (cent për €), koha dhe kostoja e nevojshme e kërkuar për të rimarrë borxhin si dhe indeksi i cilësisë së procedurave të falimentimit.

Tabela 5. 10. *Analizë krahasuese e indikatorëve për zgjidhjen e paaftësisë paguese në Kosovë (2010 – 2018)*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Norma e rimëkëmbjes (cent për €)	56.8	57.4	57.4	34.7	35.3	36.5	37.7	89.2	39.1
Koha (vitet)	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Kostoja (% e pasurisë së debitorit)	15%	15%	15%	15%	15%	15%	15%	15%	15%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën 5.10 mund të vërejmë që norma e rimëkëmbjes nga viti 2017 në vitin 2018 është zvogëluar për 50.1 cent për €, duke e bërë më të lehtë zgjidhjen e paaftësisë paguese. Koha e nevojshme e kërkuar për të rimarrë borxhin është 2 vite dhe përfshin një kosto prej 15% të vlerës së pasurisë së debitorit. Foreclosure *(procesi i marrjes në posedim të pronës nga banka si rezultat i dështimit të debitorit për të realizuar pagesat e hipotekës)* është procedura që përdoret më së shumti, sepse është mënyra më e shpejtë për kthimin e kredisë së bankave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Figura 5. 20. *Analiza krahasuese në mes Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit – Zgjidhja e paftësisë paguese*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Për më tepër, riorganizimi dhe likuidimi janë jashtëzakonisht të rralla në Kosovë për shkak të shumë arsyeve që kanë të bëjnë me mungesën e ekspertizës gjyqësore, koncepteve të reja të paaftësisë paguese,

reformave gjyqësore, institucioneve të reja, kapaciteteve njerëzore, mungesës së praktikave të mëparshme etj., të cilat kanë kontribuar në praktikat e përjashtimit (World Bank Group, Doing Business, 2018).

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në figurën 5.20, mund të shohim që disa vende të rajonit kanë një rangim më të mirë se Kosova në nivel global, përsa i përket zgjidhjes së paaftësisë paguese. Maqedonia është njëri prej vendeve i cili më së shumti ka ndërmarrë reforma dhe ka lehtësuar procesin e falimentimit të një kompanie, duke vazhduar me Shqipërinë dhe Bosnia & Hercegovinen. Sipas të dhënave të vitit 2018, Kroacia mbetet një ndër vendet me rangimin më të dobët në kuadër të vendeve të rajonit, në lidhje me reformat e ndërmarra në aspektin e lehtësimit të çështjeve të falimentimit, duke u renditur në pozitën numër 60.

5.3.11. Rregullimi i tregut të punës

Ekonomitë në mbarë botën kanë krijuar një sistem të ligjeve dhe institucioneve që synojnë të mbrojnë punëtorët dhe të garantojnë një standard minimal të jetesës për popullsinë e tyre. Ky sistem në përgjithësi përfshin katër organe të së drejtës: punësimi, marrëdhëniet industriale, siguria sociale dhe ligjet e shëndetit dhe sigurisë në punë. Rregullat e punësimit janë të nevojshme për të mundësuar kontraktimin efikas midis punëdhënësve dhe punëtorëve dhe për të mbrojtur punëtorët nga trajtimi diskriminues ose i padrejtë nga punëdhënësit.

Doing Business mat fleksibilitetin në rregullimin e punësimit, orarit të punës dhe shkarkimit në një mënyrë të pajtueshme me konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) (World Bank Group, Doing Business, 2010). Ligjet e punësimit janë të nevojshme për të mbrojtur punëtorët nga trajtimi arbitrar ose i padrejtë dhe për të siguruar kontraktim efikas mes punëdhënësve dhe punëtorëve.

Rregullimi i tregut të punës ka një rëndësi mjaft të madhe edhe gjatë procesit të miratimit të kredive nga bankat komerciale të cilat iu japin kredi bizneseve të ndryshme. Njëri nga parametrat mjaft të rëndësishëm që merret parasysh gjatë fazës së analizimit të kredive janë numri i punëtorëve në atë kompani, orari i punës së tyre, kontrata e punës dhe shumë elemente të tjera të tregut të punës, të cilat kanë një ndikim të rëndësishem në politikat kreditore të bankave komerciale. Njëri nga treguesit mjaft të rëndësishëm që vlerëson rregullimin e tregut të punës në një vend është indeksi i kualitetit të punës. Në vitin 2012 Kosova rriti shpërblimin për punën e natës si dhe ditët e pushimit vjetor.

Përveç kësaj, Kosova ka zvogëluar periudhën e njoftimit të aplikueshëm në rastet e shkarkimeve të tepërta. Në vitin 2013 Kosova ndryshoi pagën minimale dhe në vitin 2019 u realizua një nga reformat më të mëdha institucionale në fushën e tregut të punës, pra u miratua ligji për pagat, i cili do të kontribojë në masë të madhe në rregullimin e tregut të punës në të gjithë sektorët e ekonomisë së Kosovës. Vlen të theksohet se sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, shuma mesatare e pagës minimale në Kosovë në vitin 2017 ishte 158.3 €, ndërsa në vitin 2018 kjo shumë mesatare ishte zvogëluar në 150.0 €. Sa i përket pagës minimale, Qeveria e Kosovës dhe institucionet e saj duhet të ndërmarrin më shumë reforma në këtë aspekt, sepse një pagë e tillë minimale në Kosovë është një diskriminim shumë i madh i familjeve kosovare, nëse të njejtën pagë e krahasojmë me vendet e tjera të rajonit.

KAPITULLI VI

ANALIZA EMPIRIKE, VLERËSIMI EKONOMETRIK I HIPOTEZAVE DHE GJETJET E STUDIMIT

Në këtë kapitull do të paraqesim të gjitha rezultatet e hulumtimeve të cilat janë realizuar për vërtetimin e hipotezave të parashtruara në fillim të këtij studimi. Përpara se të analizojmë të gjitha raportet e vlerësimit për katër hipotezat e parashtruara, është e nevojshme të sqarojmë secilin model ekonometrik i cili është aplikuar për testimin e hipotezave, variablat e përfshira në model, metodologjinë e mbledhjes së të dhënave, argumentet shkencore të përdorimit të variablave të caktuara si dhe interpretimet e rezultateve empirike.

Në fillim të këtij studimi janë përpiluar katër hipoteza bazë, nëpërmjet të cilave do të japim argumente të ndryshme shkencore për realizimin e qëllimeve studimore të këtij disertacioni të doktoraturës. Qëllimi kryesor i këtij studimi është përcaktimi i ndikimit të politikave kreditore të bankave komerciale në financimin dhe zhvillimin e sektorit real në Kosovë, të identifikojë efektet e kreditimit bankar në rritjen ekonomike të Kosovës, menaxhimin efikas të kredive jo-performuese dhe ndikimin e tyre në rritjen e kreditimit dhe zvogëlimin e riskut kreditor, ndikimndikimin e krijimit të fondeve për garanci kreditore në kreditimin e sektorit real dhe menaxhimin e riskut kreditor si dhe zbatimin e reformave institucionale në funksion të përmirësimit të biznes klimës dhe rritjen e kreditimit të sektorit bankar ndaj sektorit privat të bizneseve në Kosovë.

Në vazhdim të këtij kapitulli do të paraqesim testimin e hipotezave të parashtruara në fillim të këtij studimi si dhe të gjitha rezultatet e arritura, të cilat vërtetojnë hipotezave dhe do të na ndihmojnë të iu japim përgjigjje pyetjeve kërkimore dhe arritjen e objektivave studimore.

6.1. Vlerësimi ekonometrik dhe testimi i hipotezës së parë

Pyetja e parë kërkimore e këtij studimi, përfshin çështjen e ndikimit të bankave komerciale në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë, ku nëpërmjet procesit të kreditimit, sektori bankar ndikon në masë të madhe në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë financiare të bizneseve në një vend. Gjatë procesit të rishikimit të literaturës janë analizuar gjetjet e shumë studimeve të cilat kanë trajtuar çështjen e ndikimit të kredive në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e sektorit real në ekonomitë e vendeve të ndryshme.

Autorët si Bezemer (2014), Cojocaru, Hoffman dhe Miller (2011), Demirgüç-Kunt dhe Levine (2008), Huang (2010), Petresecu dhe Pop (2015) si dhe shumë studime të tjera kanë analizuar efektet e kredive bankare në rritjen ekonomike të vendeve të ndryshme. Gjatë interpretimit të rezultateve empirike do të bëhen krahasime të ndryshme mes gjetjeve empirike të studimit tonë si dhe rezultateve nga studimet e autorëve tjerë.

Hipoteza e parë e këtij studimi është:

Bankat komerciale nëpërmjet procesit të kredimit kanë realizuar ndikim përmbajtësor në sektorin real të ekonomisë së Kosovës.

Për testimin e kësaj hipoteze është aplikuar metoda kuantitative, duke u bazuar në të dhënat sekondare të raporteve vjetore financiare të Bankës Qendrore të Kosovës, Bankës Botërore si dhe Agjensisë së Statistikave të Kosovës. Për të analizuar efektet e kredive bankare në rritjen ekonomike është e nevojshme të merren parasysh shumë faktorë të tjerë të cilët shpjegojnë lidhjen ndërmjet këtyre variablave. Për ndërtimin dhe specifikimin e modelit ekonometrik të kësaj hipoteze, ne jemi bazuar në disa studime të autorëve tjerë të cilët e kanë analizuar ndikimin e kredive bankare në rritjen ekonomike.

Vlen të theksohet që kryesisht këto studime ndahen në dy kategori përsa i përket rezultateve dhe gjetjeve të tyre në lidhje me ndikimin pozitiv apo negativ të kredive bankare në rritjen ekonomike. Shumë studime si (Petrescu & Pop, 2015, Yakubu dhe Affoi, 2014, Lakstutiene, Krusinskas dhe Platenkoviene, 2011, Oluitan, 2011, Ramanauskas, 2005, Gozgor, 2015, Nzomoi and Rutto, 2012) kanë gjetur lidhje pozitive në mes kredive bankare dhe rritjes ekonomike, ndërsa një pjesë tjetër e autorëve si (Krishnankutty, 2011, Leitão, 2012, Takáts and Upper, 2013, Cetin, 2016, Koivu, 2002) kanë gjeturndikim negativ të kredive bankare në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e sektorit real të ekonomisë.

Modeli ekonometik i ndërtuar për testimin e kësaj hipoteze është bazuar në studimet e lartëpërmendura, duke pasur parasysh se shumica e këtyre autorëve i kanë përdorur të dhënat sekondare, duke përfshirë seri kohore dhe modele dinamike për testimin e kësaj hipoteze. Gjithashtu edhe ne jemi bazuar në të dhënat e serive kohore të publikuara nga Banka Qëndrore e Kosovës, Banka Botërore dhe Agjensia e Statistikave të Kosovës për periudhën kohore 2005 – 2018. Të dhënat e përfshira në këto modele ekonometrike janë të dhëna të raportuara në baza mujore, dhe numri i observimeve arrin deri në vlerën 168. Të dhënat janë të përpunuara në programin STATA, dhe për vërtetimin e këtyre hipotezave

kemi aplikuar këto teste statistikore: regresionin linear, modeli i efektit fiks dhe efektit random, Hausman – Taylor regression dhe Generalized method of moments (GMM).

Tabela 6. 1. *Përshkrimi i variablave për modelin e parë ekonometrik – hipoteza e parë*

Variabla	Përshkimi i variablës	Burimi i të dhënave
Variabli i varur	Produkti i Brendshëm Bruto (PBB-në)	Raportet vjetore të Agjensionit të Statistikave të Kosovës (2005 – 2018) dhe raportet financiare vjetore të Bankës Botërore
Variabli i pavarur	Kreditë bankare (KB)	Raportet e Stabilitetit Financiar 2005 – 2018 (Banka Qëndrore e Kosovës) dhe raportet vjetore të Shoqatës së Bankave të Kosovës
Variabli i pavarur	Norma e interesit në kredi (NIK)	Raportet e Stabilitetit Financiar 2005 – 2018 (Banka Qëndrore e Kosovës) dhe raportet vjetore të Shoqatës së Bankave të Kosovës
Variabli i pavarur	Indeksi i çmimit të konsumatorit (IÇK)	Raportet vjetore të Agjensionit të Statistikave të Kosovës (2005 – 2018) dhe raportet financiare vjetore të Bankës Botërore

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Qëllimi kryesor i përdorimit të këtyre modeleve qëndron në faktin sepse kemi të bëjmë me të dhëna panel dhe modele dinamike. Nëpërmjet këtyre teste statistikore t shumica e autorëve kanë identifikuar lidhjen mes kredive bankare dhe rritjes ekonomike. Në tabelën 6.1 janë paraqitur variablat të cilat do të përdoren për ndërtimin e modelit ekonometrik dhe testimin e hipotezës së parë.

Në këtë model ekonometrik si variabël të varur do të përdorim PBB-në, si një ndër treguesit më të rëndësishëm të rritjes ekonomike. Vlerat e këtij variabli janë marrë nga raportet vjetore të publikuara nga Agjensia e Statistikave të Kosovës si dhe Banka Botërore. Vlerat e PBB-së janë marrë në shuma monetare, të shprehura në euro dhe janë të paraqitura në baza mujore. Variabli i parë i pavarur i përfshirë në këtë model ekonometrik është shuma e kredive bankare. Ky variabël vlerësohet të jetë ndryshorja kryesore e pavarur e këtij modeli, sepse e shpjegon më së shumti rritjen ekonomike të sektorit real të ekonomisë.

Kreditë të cilat janë marrë parasysh në këtë model ekonometrik, janë vetëm kreditë e dhëna nga bankat komerciale për sektorin e bizneseve në Kosovë. Vlerat e këtij variabli janë marrë nga raportet e stabilitetit financiar të publikuara nga Banka Qëndrore e Kosovës dhe raportet financiare vjetore të Shoqatës së Bankave të Kosovës. Një numër i madh i studimeve shkencore, për të analizuar ndikimin e kredive bankare në rritjen ekonomike, si indikatorë të tjerë shumë të rëndësishëm që ndikojnë në direkt në kreditimin e sektorit real të ekonomisë si dhe në PBB-në e një vendi, janë normat e interesit në kredi dhe norma e inflacionit.

Norma e interesit në kredi, që vlerësohet si kostoja për marrjen e një kredie bankare nga huamarrësit, paraqet një faktor shumë të rëndësishem në kreditë e bankave komerciale dhe rritjen ekonomike. Teori të ndryshme makroekonomike e shpjegojnë ndikimin e normave të interesit në rritjen ekonomike, por edhe në kreditë e sektorit bankar. Sjellja e normave të interesit, në masë të madhe varet nga norma e inflacionit. Prandaj, në këtë model ekonometrik si variabël të tretë të pavarur kemi marrë normën e inflacionit, për periudhën kohore 2005 – 2018. Për këtë variabël, të dhënat janë marrë nga raportet tremujore të indeksit të çmimeve të konsumatorit, të publikuar nga Agjensia e Statistikave të Kosovës.

6.1.1. Statistikat deskriptive dhe analiza e korrelacionit për modelin e parë ekonometrik

Nëpërmjet statistikave deskriptive do të përshkruajmë disa nga të dhënat statistikore për variablat të cilat janë përfshirë në modelin e parë ekonometrik si dhe do të analizohet koeficienti i korrelacionit Pearson në mes variablës së varur dhe variablave të pavarura të cilat janë përfshirë në këtë studim, për të testuar hipotezën e parë. Fillimisht, do të analizohet mesatarja, devijimi standard, vlerat maksimale dhe minimale, varianca, lakorja dhe kurtoza.

Në tabelën 6.2 janë paraqitur statistikat deskriptive për variablat e përfshira në modelin e parë ekonometrik si dhe shpërndarja normale e këtyre variablave nëpërmjet histogramit. Qëllimi kryesor i përdorimit të këtyre analizave përshkruese është identifikimi i saktësisë së të dhënave, të cilat janë marrë për bazë në matjen e modeleve ekonometrike. Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mëposhtme, mund të vërehet që vlerat minimale të PBB-së në baza mujore arrin deri në vlerën 504.4 milion euro në fillim të vitit 2005 dhe 1.96 miliard € në fund të vitit 2018.

Tabela 6. 2. *Statistikat deskriptive për variablat e hipotezës së dytë*

Variablat	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Variance
PBB	168	504.40	1963.50	1201.0821	354.84400	125914.265
KB	168	381.80	2755.50	1548.0804	640.64117	410421.108
NIK	168	6.00	16.20	11.8458	3.17746	10.096
IÇK	168	76.10	104.80	92.8506	9.10104	82.829

Burimi: Kalkultimet e autorit në programin Stata

Vlera mesatare e PBB-së gjatë kësaj periudhe kohore 2005-2018 është 1.2 miliard € me një devijim standard në vlerë prej 354.84. Kreditë e bankave komerciale në fillim të vitit 2005 ishin në vlerën 381.8 milion €, ndërsa në fund të vitit 2018 vlera e kredive për biznese në Kosovë arriti në 2.75 miliard €. Në bazë të këtyre vlerave, mund të vërejmë trend pozitiv të rritjës së kredive bankare në Kosovë gjatë periudhës kohore 2005 – 2018, ku vlera mesatare e këtyre kredive arriti në 1.54 miliard € me një devijim standard 640.54. Vlera më e vogël e normës së interesit në kredi ishte 6%, ndërsa vlera më e lartë gjatë kësaj periudhe kohore ishte 16.2%. Mesatarja e normës së intereresit është 11.84% me një devijim standard prej 3.17.

Variabli e fundit i përfshirë në këtë model ekonometrik është indeksi i çmimit të konsumatorit, indeks ky i cili deri në vitin 2015 është matur me vitin bazë 2002, ndërsa prej vitit 2016 e tutje, si vit bazë i cili shërben për matjen e indeksit të harmonizuar të çmimeve është viti 2015. Vlera minimale e këtij indeksi në fillim të vitit 2015 kishte një specifikë në vlerë prej 76.1 dhe një vlerë maksimale të këtij indeksi prej 104.80. Mesatarja e këtij indeksi arrin në vlerën 92.85 me një devijim standard prej 9.10.

Figura 6. 1. *Paraqitja grafike e shpërndarjes normale të PBB-së dhe kredive bankare nëpërmjet histogramit*



Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Në figurën e mësiperme nëpërmjet histogramit dhe grafikoneve të tjera të distribuimit të vlerave statistikore do të paraqitet grafikisht shpërndarja normale e produktit të brendshëm bruto, kredive, normës së interesit në kredi dhe indeksi të çmimit të konsumatorit.

Sipas paraqitjes grafike mund të vërehet se variabla e varur (PBB-ja) ka një shpërndarje normale të vlerave, duke bërë që lakorja të jetë përafërsisht simetrike që nënkupton se vlerat e përfshira në këtë model ekonometrik të jenë plotësisht të matshme. Duke u nisur nga parimi i njejtë, edhe variabla kryesore e pavarur (kreditë bankare) ka një shpërndarje normale, që nënkupton një saktësi më të madhe në mbledhjen e të dhënave dhe matjen e tyre. Të dyja variablat e paraqitura nëpërmjet histogramit ka një lakore mezokuartile me një vlerë absolute 3.

Figura 6. 2. *Paraqitja grafike e shpërndarjes normale të normave të interesit në kredi dhe IÇK-së*



Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Në vazhdim të këtij kapitulli, do të analizojmë korrelacionin mes variablave të përfshira në këtë model ekonometrik. Matja e korrelacionit do të bëhet nëpërmjet koeficientit Pearson, i cili tregon ndërlidhëshmërinë në mes variablave të pavarura me variablen e varur. Në tabelën 6.3 janë paraqitur vlerat e koeficientit të korrelacionit në mes PBB-së dhe variablave të tjera të pavarura.

Tabela 6. 3. *Analiza e korrelacionit Pearson për variablat e përfshira në modelin e parë ekonometrik*

Variablat	GDP	CR	NICr	CPI
PBB	1	0.868	-0.819	0.800
KB	0.868	1	-0.886	0.947
NIK	-0.819	-0.886	1	-0.788
IÇK	0.800	0.947	-0.788	1

Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme vërehet që të gjitha variablat e inkorporuara në këtë model janë të korreluara njëra me tjetren. Së pari do të analizojmë korrelacionin në mes PBB-së dhe variablave të tjera të pavarura. Produkti i brendshëm bruto ka një korrelacion pozitiv me kreditë dhe indeksin e çmimit të konsumatorit, ndërsa korrelacion negativ me normat e interesit në kredi. Korrelacioni pozitiv në mes PBB-së dhe kredive bankare është 0.868, që nënkupton një lidhje të fortë mes këtyre variablave, ku me rritjen e kredive do të kemi rritje të produktit të brendshëm bruto dhe e kundërta.

Kjo lidhje mes dy variablave është edhe në nivelin e rëndësisë stastikore P-value = 0.000, që nënkupton një vlerë më të vogël se 0.05. Për vërtetimin e validitetit të hipotezës, nëse kreditë e bankave komerciale kanë ndikuar në rritjen ekonomike të sektorit real, ne kemi përdorur teste të ndryshme statistikore dhe analiza të trendit, të cilat do të vërtetojnë saktësinë e pohimeve të mësipërme.

Korrelacioni mes PBB-së dhe normave të interesit në kredi është negativ (-0.819), që nënkupton se një rritje e normave të interesit në kredi ka shkaktuar rënie të PBB-së dhe e kundërta. Duke pasur parasysh se që nga viti 2005 kemi pasur norma shumë të larta të interesit në kredi, kjo ka shkaktuar kosto shumë të lartë për huamarrësit potencial që të marrin një kredi, duke ndikuar në rritjen e riskut kreditor dhe rënien e kreditimit.

Vlera e koeficientit Pearson mes normës së interesit në kredi dhe PBB-së është një lidhje e fortë signifikante, që dëshmon një lidhje emprike shumë të rëndësishme mes këtyre dy variablave. Në figurën 6.3 janë të paraqitura në mënyrë grafike në pjesën e parë korrelacioni pozitiv mes PBB-së dhe kredive bankare si dhe në pjesën e dytë të grafikut korrelacioni negativ në mes PBB-së dhe normave të interesit në kredi.

Figura 6. 3. *Paraqitja grafike e korrelacionit Pearson në mes PBB-së me kreditë bankare dhe normat e interesit në kredi*



Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

PBB-ja dhe indeksi i çmimit të konsumatorit sipas rezultateve të analizës së korrelacionit të paraqitura në tabelën 6.3, kemi një korrelacion pozitiv mes tkëtyre dy variablave. Vlera e koeficientit Pearson, në këtë rast është 0.800, që tregon se rritja në normën e inflacionit shkakton rritje të PBB-së në Kosovë. Një vlerë e tillë e korrelacionit, tregon lidhje të fortë mes këtyre dy variablave, duke pasur parasysh ndikimin shumë të madh të inflacionit në rritjen ekonomike të një vendi.

Vlen të theksohet se është shumë e rëndësishme që në kuadër të kësaj analize, të paraqesim edhe interpretimin e disa variablave të pavarura që ndikojnë në variablën endogjene, pra në kreditë. Në këtë rast, do të analizojmë korrelacionin në mes kredive bankare dhe normave të interesit, ndërsa lidhjes ndërmjet kredive bankare dhe normës së inflacionit do t'i kushtohet një vëmendje më e madhe në testimin e hipotezës së dytë të këtij disertacioni të doktoraturës.

Korrelacioni Pearson në mes kredive bankare dhe normave të interesit është një korrelacion negativ, që nënkupton se me rritjen e normave të interesit do të zvoglohen kreditë e bankave komerciale ndaj sektorit real të ekonomisë dhe anasjelltas. Në figurën 6.4, kemi paraqitur në pjesën e parë të grafikut lidhjen në mes PBB-së me indeksin e çmimit të konsumatorit, si dhe në pjesën e dytë lidhjen në mes kredive bankare dhe normave të interesit në kredi.

Figura 6. 4. *Paraqitja grafike e korrelacionit Pearson në mes PBB-së me IÇK-së si dhe në korrelacioni mes kredive dhe normave të interesit në kredi*



Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Vlera e koeficientit Pearson në mes kredive bankare dhe normave të interesit është -0.886, duke shprehur një lidhje të fortë negative mes këtyre dy variablave. Nëse analizojmë korrelacionin mes normave të interesit dhe indeksit të çmimit të konsmuatorit, mund të vërejmë që kemi lidhje të lartë negative në vlerë prej -0.788. Kjo nënkupton që rritja e normës së inflacionit ka shkaktuar rënie të normës së interesit në kredi, rritje të kreditimit dhe rritje të PBB-së.

6.1.2. Specifikimi i modelit ekonometrik dhe analiza e regresionit të shumëfishtë linear

Për të vërtetuar hipotezën e parë, do të aplikojmë disa teste statistikore nëpërmjet softverit aplikativ Stata, dhe do të paraqesim në mënyrë të veçantë rezultatet e secilit model ekonometrik, duke realizuar analiza krahasuese mes rezutateve dhe gjetjeve të studimit. Për të analizuar ndikimin e kredive bankare në rritjen ekonomike, ne jemi bazuar në disa studime të autorëve të tjerë si Bezemer (2014), Cojocaru, Hoffman dhe Miller (2011), Demirgüç-Kunt dhe Levine (2008), Huang (2010), Petresecu dhe Pop (2015) etj.

Shumica e këtyre autorëve, për të analizuar ndikimin e kredive bankare në rritjen ekonomike, kanë përdorë të dhënat e paneleve dinamike, duke ndërtuar modele të ndryshme ekonometrike. Për specifikimin e modelit ekonometrik, ne jemi bazuar kryesisht në këto studime, por si referencë për ndërtimin e këtij modeli ekonometrik për hipotezën e parë, kemi marrë për bazë studimin e autorëve rumun Petresecu dhe Pop (2015), të cilët analizuan efektet e aktivitetit kreditor të bankave komerciale në rritjen ekonomike të Rumanisë.

Ky studim është realizuar në vitin 2015, dhe përfshinë në periudhë kohore nga viti 1990 deri në vitin 2014. Këta autorë si variabël të varur, kanë marrë produktin e brendshëm bruto dhe si variabla të pavarura shumën e kredive bankare, normën e interesit në kredi dhe indeksin e çmimit të konsumatorit, si një matës i rëndësishëm i inflacionit. Rezultatet e këtij studimi konsistojnë me një ndikim pozitiv të kredive në rritjen ekonomike si dhe ndikim negativ të normave të interesit dhe inflacionit në rritjen ekonomike. Të gjitha vlerat e përfshira në ndryshoret e këtij studimi, autorët i kanë logaritmuar, duke mundësuar një shpërndarje normale në mes variablave si dhe rezultate sa më të sakta empirike.

Duke u bazuar në këtë studim, ne kemi ndërtuar këtë model ekonometrik të cilin fillimisht do ta testojmë nëpërmjet analizës së regresionit linear:

$$Y = \beta_0 + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + \beta_3 X_3 + e$$

Ku:

Y = produkti i brendshëm bruto (PBB-ja)

X_1 = kreditë bankare (KB)

X_2 = norma e interesit në kredi (NIK)

X_3 = Indeksi i çmimit të konsumatorit (IÇK)

e = termi i gabimit (variabla stohastike)

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura për modelin e parë ekonometrik, ne secilën variabël e kemi logaritmuar me funksionin (Ln), në mënyrë që të kemi një përafrim të vlerave të përfshira në këtë model ekonometrik. Atëherë forma e ekuacionit të përgjithshëm duket:

$$Ln\ PBB = \beta_0 + \beta_1\ Ln\ KB + \beta_2\ Ln\ NIK + \beta_3\ Ln\ IÇK + e$$

Tabela 6. 4. *Rezultatet e analizës së regresionit linear shumëfaktorial*

Ln PBB	Coef.	Std. Error	t	P > |t|	95% Conf. Interval	95% Conf. Interval
Ln KB	0.502793	0.0977073	5.15	0.000	0.3098664	0.6957195
Ln NIK	-0.267978	0.0670369	-4.00	0.000	-0.4003446	-0.1356113
Ln IÇK	-0.4435357	0.4761586	-0.93	0.353	-1.383727	0.4966558
_cons.	6.063012	1.575241	3.85	0.000	2.952645	9.173379

Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Duke u bazuar në tabelën e mësipërme forma e përgjithshme e ekuacionit të regresionit linear merr këtë formë:

$$Ln\ PBB = 6.063012 + 0.50279\ KB - 0.26797\ NIK - 0.443537\ IÇK + 0.2673$$

Në bazë të vlerave të paraqitura në tabelë mund të vërejmë që kreditë bankare dhe normat e interesit janë në nivelin standard të signifikancës. Ndërsa variabla e tretë e pavarur, në bazë të analizës së regresionit nuk është signifikante, për shkak se p-value është mbi nivelin standard (0.353). Prandaj, në bazë të këtij pohimi, ne nuk do të interpretojmë ndikimin e inflacionit në rritjen ekonomike, sepse ky model nëpërmjet analizës së regresionit, rezulton që ka multikolinaritet.

Prandaj nëpërmjet krahasimit të T testit dhe F testit, do të shohim nëse është më i saktë modeli paraprak apo modeli vijues. Nëpërmjet multikolinaritetit do të identifikohet në qoftëse ka lidhje korrente në mes variablave të pavarura. Për të ditur se cili model është më i saktë, atëherë vlerat e T testit dhe F testit duhet të jenë më të mëdha se vlerat e modelit paraprak.

Pra, nëse nga modeli largojmë indeksin e çmimi të konsumatorit, atëherë rezultatet ekonometrike janë si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6. 5. *Rezultatet e analizës së regresionit linear shumëfaktorial pas largimit të IÇK-së*

Ln PBB	Coef.	Std. Error	t	P > |t|	95% Conf. Interval	95% Conf. Interval
Ln KB	0.4196456	0.0397186	10.57	0.000	0.3412233	0.4980678
Ln NIK	-0.2650849	0.066938	-3.96	0.000	-0.3972504	-0.1329194
_cons.	4.649969	0.4242947	10.96	0.000	3.812222	5.487716

Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Duke realizuar krahasimin mes rezultateve të modelit të parë dhe modelit të dytë, arrijmë në përfundimin se më i saktë është modeli i dytë, sepse vlera e T testit për variablën (kreditë bankare) është më e madhe në modelin e dytë (10.57) se sa në modelin e parë (5.15). Gjithashtu, edhe për variablën e dytë (norma e interesit në kredi), vlera e T testit është më e madhe në modelin e dytë. Një argument tjetër statistikor, që dëshmon se rezultatet e modelit të dytë nëpërmjet analizës së regresionit linear, është edhe rezultati i F testit, i cili në modelin e dytë ka vlerë më të lartë 224.48, se sa në modelin e parë ku vlera e tij ishte 149.83.

Koeficienti i përcaktimit (R Square) në këtë rast është 73.13%, që tregon një lidhje të lartë në mes variablës së varur dhe atyre të pavarura. Ky koeficient tregon se për vlerën 73.13%, kreditë dhe normat e interesit në kredi e shpjegojnë rritjen ekonomike të Kosovës për periudhën 2005 – 2018. Nëse faktorët e tjerë mbesin konstant, (kreditë bankare dhe normat e interesit në kredi janë zero), atëherë vlera e PBB-së do të jetë 4.64 miliard €. Por, në qoftëse supozojmë që kemi rritje për 1% në kreditë bankare, duke mbajtur konstat normat e interesit, atëherë kjo do të ndikojë në rritjen e PBB-së për 0.41%. Ky pohim është i saktë, sepse variabla e kredive bankare gjendet në nivelin standard të signifikancës (P- value = 0.000 < 0.005).

Por, parashtrohet pyetja se cili është ndikimi i normave të interesit në vlerën e PBB-së. Arsyeja kryesore, se përse është marrë norma e interesit në kredi dhe indeksi i çmimit të konsumatorit është sepse këta dy janë indikatorë shumë të rëndësishëm që ndikojnë në shumën e kredive të dhëna nga bankat komerciale për sektorin real të ekonomisë. Nëse kemi rritje të normës së interesit për 1%, duke mbajtur konstante kreditë bankare, kjo do të ndikojë në zvogëlimin e PBB-së për 0.26%. Ky pohim është i saktë edhe në nivelin 95% të besueshmërisë (p-value = 0.000 < 0.05).

Vlen të theksohet se sipas analizës së regresionit, efektet më të mëdha në rritjen ekonomike janë të kredive bankare, sepse në vitet e fundit në Kosovë, ulja e normave të interesit në kredi, ka shkaktuar

rritjen e vëllimit të kredive. Sipas teorisë ekonomike, një rritje në nivelin e kredive shkakton rritje të konsumit, dhe duke ditur se njëri nga komponentët mjaft të rëndësishëmqë kontriboun në rritjen e PBB-së është konsumi, atëherë rrjedhimisht ndikimndikimi i kredive në rritjen ekonomike edhe për rastin e Kosovës është shumë i madhë. Meqënëse vlera e koeficientit Pearson në mes kredive bankare dhe normave të interesit ishte negativ (-0.886), si rezultat i kësaj mund të konkludojmë që ulja e normave të interesit në kredi, vitet e fundit ka shkaktuar rritjen e vëllimit të kredive të bankave komerciale për sektorin e biznesit, dhe një rritje e kredive ka efekte edhe në rritjen ekonomike.

6.1.3. Random – Effects GLS Regression

Specifikimi i modelit të panelit dinamik (Random – Effects) për të testuar ndikimin e kredive bankare në rritjen ekonomike të sektorit real është si vijon:

$$Ln\ PBB_{it} = \beta_0 + \beta_1\ Ln\ KB_{it} + \beta_2\ Ln\ NIK_{it} + \beta_3\ Ln\ IÇK_{it} + \gamma_{it}$$

Duke pasur parasysh se të gjitha simbolet e paraqitura në modelin e mësiperm ekonometrik janë të njejta sikurse në analizën e regresionin të shumëfishtë linear, përveç simbolit ***i***, që paraqet kodin, nëpërmjet të cilit është bërë kodimi i të dhënave në baza mujore të ndara në 12 grupe, dhe simboli t, që paraqet periudhën kohore 2005 – 2018, të përfshirë në këtë analizë empirike. Në tabelën 5.6 do të paraqitën rezultatet e analizës së regresionit duke përdorur efektin random.

Tabela 6. 6. *Rezultatet e modelit Random – Effect GLS Regression*

Ln PBB	Coef.	Std. Error	Z	P > |z|	95% Conf. Interval	95% Conf. Interval
Ln KB	0.3001479	0.0610497	4.92	0.000	0.1804927	0.4198031
Ln NIK	-0.2181946	0.0403106	-5.41	0.000	-0.2972018	-0.1391873
Ln IÇK	0.5477377	0.2974864	1.84	0.066	-0.035325	1.1308
_cons.	2.921342	0.9785605	2.99	0.003	1.003398	4.839285

Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Në bazë të vlerave të paraqitura në rezultatet e efektit random, ekuacioni i modelit ekonometrik merr këtë formë:

$$Ln\ PBB_{it} = 2.921342 + 0.3001479\ KB_{it} + 0.2181946\ NIK_{it} + 0.5477377\ \ IÇK_{it} + 0.12$$

Sipas rezultateve në tabelën 5.6, mund të vërejmë që të gjitha variablat gjenden brenda intervalit të besueshmërisë 90 – 95%. Vlera e koeficientit të përcaktimit është 88%, që nënkupton se për këtë vlerë, variablat e pavarura e shpjegojnë variablën e varur (PBB-në). Duke supozuar që faktorët e tjerë që ndikojnë në rritjen ekonomike janë konstant, atëherë vlera e PBB-së do të jetë 2.92 miliard €. Nëse do të kemi rritje të kredive bankare për 1% duke mbajtur konstant normat e interesit në kredi dhe indeksin e çmimit të konsumatorit, kjo do të ndikojë në rritjen e PBB-së për 0.3% duke pasur parasysh se ky është i pranueshëm pasi që gjendet brenda intervalit të besueshmërisë 95%.

Efektet e normave të interesit në produktin e brendshëm bruto janë të njejta sikurse në analizën e regresionit linear. Nëse normat e interesit në kredi rritën për 1%, duke mbajtur konstante kreditë bankare dhe inflacionin, kjo ndikon në zvoglimin e PBB-së për 0.21%. Ndërsa, në rastin kur kemi rritje të indeksit të çmimit të konsumatorëve për 1%, kjo ndikon në rritjen e vlerës së PBB-së për 0.54%. Sa i përket, efekteve të inflacionit në rritjen ekonomike, në bazë të kësaj analize ajo është signifikante në intervalin e besueshmërisë 90%. Këto rezultate të këtij modeli i japin një mbështetje më të madhe, vërtetimit të hipotezës së parë.

6.1.4. Fixed – Effects Regression

Një prej testeve mjaft të rëndësishme që ka një aplikim shumë të gjerë në statistikë për të dhënat e paneleve dinamike është edhe modeli i efekteve fikse. Qëllimi kryesor i përdorimit të këtij modeli është sepse të dhënat nuk janë të rastësishme dhe në këtë analizë vlerësuesi i efekteve fikse përdoret duke iu referuar vlerësuesit të brendshëm të koeficientëve të regresionit. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura rezultatet e modelit ekonometrik nëpërmjet efekteve fikse:

Tabela 6. 7. *Rezultatet e modelit Fixed – Effect Regression*

Ln PBB	Coef.	Std. Error	z	P > |z|	95% Conf. Interval	95% Conf. Interval
Ln KB	0.2844542	0.0594557	4.78	0.000	0.1669818	0.4019266
Ln NIK	-0.2145418	0.0391479	-5.48	0.000	-0.2918901	-0.13781936
Ln IÇK	06244526	0.2897169	2.16	0.033	0.0520303	1.196875
_cons.	2.678772	0.9521403	2.81	0.006	0.7975342	4.56001

Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Rezultatet e paraqitura në tabelën e mësipërme janë rezultate përafërsisht të njejta sikurse rezultatet e modeleve të efektit random. Të gjitha variablat e pavarura janë signifikante në nivelin 95% të besueshmërisë dhe të gjithë parametrat tjerë janë të matshëm në aspektin statistikor. Vlera e parametrit b_0 është në nivelin standard të signifikancës (p-value=0.000 < 0.05) që nënkupton se nëse faktorët e tjerë janë konstantë, vlera e PBB-së do të jetë 2.67 miliard €.

Rezultatet e këtij modeli janë në favor të interpretimit të hipotezës së parë, duke rezultuar me një lidhje pozitive mes kredive bankare dhe rritjes ekonomike në Kosovë. Nëse kreditë ndaj bizneseve rriten për 1% duke mbajtur konstant normat e interesit dhe inflacionin, kjo do të efekt në rritjen e vlerës së PBB-së për 0.28%. Vlera e gabimit standard për parametrin b_1 është 0.0594, që nënkupton se ky parametër ka një vlerë shumë të vogël të gabimit standard dhe kjo vjen si rezultat i korrelacionit pozitiv me vlerat e PBB-së. Variacioni i vlerësuesit të parametrit $b_1=0.0594^2=0.0035$ dhe ky parametër ka rëndësi statistikore sepse vlera faktike e T testit (t_f=4.78) është një vlerë më e madhe se vlera kritike e T testit (t_{kr}=1.984).

Norma e interesit në kredi ndikon negativisht në rritjen ekonomike, ku 1% rritje në normën e interesit shkakton zvogëlim të PBB-së për 0.21%. Një efekt i tillë është shkaktuar sepse në periudhën kohore nga viti 2005 deri në vitin 2011 kemi pasur norma shumë të larta të interesit në kredi, që kanë shkaktuar kosto shumë të lartë të financimit për huamarrësit. Sipas rezultateve të metodës së efekteve fikse, parametri b_2 është në nivelin standard të signifikancës (p-value=0.000 < 0.05) dhe ka një gabim standard në vlerë prej 0.0391. Kjo vlerë e vogël e gabimit standard nënkupton që pikat në vijën e regresit janë shumë afër drejtëzës dhe kemi një shpërndarje normale në mes vlerave të X_2 dhe Y. Variacioni i vlerësuesit të parametrit $b_2=0.0391^2 = 0.00152$.

Rezultatet e regresionit nëpërmjet metodës së efekteve fikse rezultojnë të jenë shumë të rëndësishme edhe në lidhjen mes indeksit të çmimit të konsumatorit dhe produktit të brendshëm bruto në Kosovë për periudhën kohore 2005 – 2018. Në qoftëse do të kemi rritje të inflacionit për 1% duke mbajtur konstante kreditë dhe normën e interesit, atëherë rrjedh që PBB-ja do të rritet për 0.62%. Vlen të theksohet që në kuadër të variablave të pavarura, ndikimin më të madh në rritjen ekonomike e ka indeksi i çmimit të konsumatorit, sepse inflacioni ka lidhje pozitive me kreditë e bankave komerciale, ku me rritjen e normës së inflacionit, rritet kreditimi dhe rritet konsumi si një ndër kontribuesit më të mëdhenj në rritjen ekonomike të Kosovës.

Vlera e gabimit standard për indeksin e çmimit të konsumatorit është 0.2897, që është një vlerë më e madhe se gabimi standard i parametrave të tjerë të përfshirë në këtë model ekonometrik. Variacioni i vlerësuesit për parametrin b_3= 0.2897=0.0839 dhe ky parametër ka rëndësi statistikore sepse vlera faktike e T testit (t_f = 2.16) është një vlerë më e madhe se vlera kritike e këtij modeli (t_{kr} = 1.984).

Një test tjetër shumë i rëndësishëm për vërtetimin e hipotezës alternative është edhe F testi. Vlera faktike e këtij testi është 369.48, ndërsa vlera kritike e tij është 2.60 dhe duke e bërë krahasimin mes këtyre dy vlerave, mund të konkludojmë që hipoteza bazë në këtë rast nuk pranohet, por vlen hipoteza alternative që bankat nëpërmjet procesit të kreditimit kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë.

6.1.5. Hausman - Taylor Regression

Modeli Hausman dhe Taylor (1981) është një model statistikor hibrid që kombinon qëndrueshmërinë e një modeli të efekteve fikse me efikasitetin dhe zbatueshmërinë e një modeli të efekteve të rastësishme. Të dhënat e hipotezës së parë do të testohen edhe nëpërmjet këtij modeli, në mënyrë që të bëjmë krahasimet me testet e tjera statistikore. Modeli Hausman – Taylor Regression merr parasysh efektin e variablave ekzogjene në vëzhgimet e përfshira në modelin ekonometrik. Dy variabla shumë të rëndësishme që e shpjegojnë ndikimin e kredive bankare në rritjen ekonomike janë normat e interesit në kredi dhe indeksi i çmimit të konsumatorit. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura rezultatet ekonometrike të analizës së regresionit duke aplikuar modelin Hausman – Taylor.

Tabela 6. 8. *Rezultatet e modelit Hausman - Taylor Regression*

Ln PBB	Coef.	Std. Error	z	P > |z|	95% Conf. Interval	95% Conf. Interval
Ln KB	0.2920682	0.0596469	4.90	0.000	0.1751625	0.4089739
Ln NIK	-0.2165799	0.0392393	-5.52	0.000	0.0050024	-0.1396723
Ln IÇK	0.5737179	0.2901663	1.98	0.048	0.0050024	1.142433
_cons.	2.608397	0.9558181	2.73	0.006	0.7350275	4.481766

Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme mund të vërejmë që të gjitha variablat e përfshira në këtë model ekonometrik janë statistikisht të rëndësishme në nivelin e besueshmërisë 95%. Koeficienti i parametrit b_0 = 2.608 është signifikant dhe ky koeficient merret parasysh që nëse faktorët e

tjerë janë konstantë, atëherë vlera e PBB-së do të jetë 2.6 miliard €. Variabla kryesore e pavarur, kreditë bankare kanë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike, pra nëse kemi rritje të kredive bankare ndaj bizneseve për 1% duke mbajtur konstant normat e interesit dhe inflacion, PBB-ja do të rritet për 0.29% Ky pohim është i saktë sepse nëse marrim parasysh vlerën faktike të T testit (t_f=4.90), është një vlerë më e madhe se vlera kritike (t_{kr}=1.984) dhe ky fakt evidenton ndikimin pozitiv të kredive bankare në rritjen ekonomike. Vlera e gabimit standard për këtë parametër është 0.0596 dhe variacioni i vlerësuesit të këtij parametri është $b_1 = 0.0596^2 = 0.00355$.

Rezultatet e modelit Hausman – Taylor Regression rreth ndikimit të normave të interesit të kredive dhe inflacionit në rritjen ekonomike janë të njejta me modelet paraprake. Kur normat e interesit në kredi rritën për 1% duke mbajtur konstant kreditë bankare dhe indeksin e çmimit të konsumatorit, efekti do të jetë në zvogëlimin e PBB-së për 0.21%. Gabimi standard për parametrin $b_2 = 0.0392$, një vlerë e cila tregon që pikat në vijën e regresit janë shumë afër drejtëzës dhe kjo vlerë tregon shpërndarje normale në mes vlerave të X_2 dhe Y. Variancioni i vlerësuesit të parametrit $b_2 = 0.0392^2 = 0.00153$ dhe vlera faktike e T – testit është – 5.52.

Indeksi i çmimit të konsumatorit ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike, rezultat ky i cili përputhet edhe me vlerësimet e tjera të modeleve ekonometrike. Duke supozuar që një rritje prej 1% në këtë indeks, ndikon në rritjen e PBB-së për 0.57%. Vlera e gabimit standard për parametrin $b_3 = 0.2901$, ndërsa variacioni i vlerësuesit për parametrin $b_3 = 0.2901^2 = 0.0841$. Vlera faktike e T testit për këtë parametër është 1.98 që përafërsisht është e njejtë me vlerën kritike të T testit (1.984), prandaj niveli i signifikancës për këtë variabël është shumë afër nivelit standard prej 5%.

6.1.6. Generalized Method of Moments (GMM) – Arellano Bond Estimation

Në statistikë dhe ekonometri, modeli GMM është një prej metodave të përgjithshme që aplikohet për vlerësimin e parametrave në modelet statistikore. Ky model zakonisht aplikohet në të dhënat e panelit dinamik dhe kanë një numër të mostrave mbi 100. Një prej kritereve tjera të rëndësishme për zbatimin e këtij modeli është edhe vlera e parametrave të përfshirë në modelet tjera duhet të jenë shumë afër zeros si dhe nëpërmjet kësaj metode shpjegohet edhe problemi i endogjinitetit të variablave.

Duke u nisur nga këto supozime, modeli ynë plotëson pothuajse të gjitha parakushtet e nevojshme për zbatimin e këtij modeli gjatë testimit të hipotezës së parë. Mostra e përfshirë në modelin tonë është

168, të dhënat janë të koduara sipas serive kohore dhe të panelit dinamik si dhe ekziston problemi i endogjinitetit në mes variblës së pavarur (kreditë bankare) dhe variablës së varur (PBB-ja).

Shumë studime të autorëve të tjerë në këtë fushë kanë dëshmuar se në vende të ndryshme kreditë ndikojnë pozitivisht, por edhe negativisht në rritjen ekonomike. Prandaj, për rastin e Kosovës, për të zgjidhur këtë problem ne do të aplikojmë modelin GMM, nëpërmjet metodës Arellano Bond Estimation e cila jep rezultate konkrete, dhe duke e heque dilemën që ekziston në lidhje me efektet e kredive bankare në rritjen ekonomike të sektorit real. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura të gjitha rezultatet ekonometrike të modelit GMM, nëpërmjet metodës Arellano Bond Estimation:

Tabela 6. 9. *Rezultatet e modelit GMM Model – Arellano Bond Estimation*

Ln PBB	Coef.	Std. Error	z	P > |z|	95% Conf. Interval	95% Conf. Interval
Ln KB	0.3292271	0.0511212	6.44	0.000	0.2290315	0.4294228
Ln NIK	-0.1842082	0.028681	-6.42	0.000	-0.2404219	-0.1279946
Ln IÇK	0.5839103	0.2140887	2.73	0.006	0.1643041	1.003516
_cons.	2.464717	0.6575868	3.75	0.000	1.176459	3.752975

Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Të gjitha rezultatet e paraqitura nëpërmjet këtyre modeleve ekonometrike konsistojnë njëra me tjetrën duke i dhënë qëndrueshmëri më të madhe modelit ekonometrik të ndërtuar për testimin e hipotezës së parë. Nga rezultatet e modelit GMM, të gjitha variablat e pavarura janë në nivelin standard të signifikancës 95%, që nënkupton se në bazë të këtyre parametrave statistikorë, hipoteza e parë pranohetdhe konkludojmë se bankat komerciale nëpërmjet procesit të kreditimit kanë realizuar ndikim përmbajtësor (pozitiv) në sektorin real të ekonomisë së Kosovës.

Parametri b_0 = 2.4647, është signifikant në nivelin 95% dhe nëse mbahen faktorët e tjerë konstantë, atëherë vlera e PBB-së do të jetë 2.46 miliard €. Vlera e gabimit standard për këtë parametër është 0.6572 dhe vlera faktike e T testit është një vlerë më e madhe se vlera kritike (3.75 > 1.984). Rezultatet e këtij modeli na sqarojnë edhe problemin e endogjinitetit në mes kredive bankare dhe PBB-së, duke treuar që kreditë ndikojnë pozitvisht në rritjen ekonomike.

Një rritje për 1% e kredive shkakton rritje të vlerës së PBB-së për 0.32%. Vlerë kjo e cila konsiston të jetë më e madhe se në testet e tjera statistikore dhe kjo na jep një evidencë tjetër empirike për

ndikimin pozitiv të kredive në rritjen ekonomike të Kosovës në periudhën kohore 2005 – 2018. Gabimi standard për parametrin $b_1 = 0.0511$, vlerë kjo e cila nëse krahasohet me modelet paraprake është shumë e ngjashme. Variacioni i vlerësuesit të këtij parametri është $b_1 = 0.0511^2 = 0.0026$ dhe vlera faktike e T testit (6.44) është një vlerë më e madhe se ajo kritike (1.984).

Dy variablat kryesore të pavarura që ndikojnë në variablën endogjene (kreditë bankare) dhe në variablën e varur (PBB-në) janë të rëndësishme në nivelin standard të signifikancës, duke i dhënë një mbështetje më të madhe empirike testimit të hipotezës së parë. Pra, edhe nga rezultatet e modelit GMM, rritja e normës së interesit shkakton rënie në vlerën e PBB-së dhe rritja e indeksit të çmimit të konsumatorit ndikon në rritjen e vlerës së PBB-së. Gabimet standarde të dy këtyre dy parametrave janë shumë të vogla dhe gjithashtu vlerat faktike të T testit janë më të mëdha se vlera kritike.

6.1.7. Analiza e trendit linear dhe logaritmik në mes PBB-së në bujqësi dhe kredive agro

Për të testuar hipotezën e parë, ne do të aplikojmë edhe analizën e trendeve lineare, logaritmike dhe eksponenciale. Duke u nisur nga fakti se nëpërmjet modeleve ekonometrike është vërtetuar validiteti i hipotezës së parë, ne nëpërmjet analizave të trendit do të ofrojmë një analizë tjetër krahasuese në mes të dhënave sekondare si dhe nëpërmjet ekuacioneve të trendit do të realizojmë projeksione të ndryshme për variablat e përfshira në analizë.

Të gjitha analizat e trendit janë përpunuar në programin Microsoft Excel, të dhënat sekondare janë marrë nga raportet financiare vjetore të Bankës Qëndrore të Kosovës, Bankës Botërore, Agjensisë së Statistikave të Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Nëpërmjet analizës së trendit, do të realizojmë analizën krahasuese mes PBB-së, kredive të bankave komerciale për bizneset në sektorë të ndryshëm, indeksit të çmimit të konsumatorit dhe normës së interesit në kredi. Analiza do të na japë përgjigjje në pyetjet: si kanë ndikuar kreditë agro në vlerën e produktit të brendshëm bruto në sektorin e bujqësisë, si kanë ndikuar kreditë e bankave komerciale të destinuara për industri, prodhim, energjetikë dhe ndërtimtari në rritjen e PBB-së në këta sektorë dhe si kanë ndikuar kreditë e sektorit të tregtisë dhe shërbimeve në vlerën e PBB-së për këta dy sektorë. Për qëllime krahasimi me rezultatet e modeleve ekonometrike do të realizojmë edhe dy analiza të tjera të trendit në mes PBB-së dhe inflacionit si dhe PBB-së në raport me normat e interesit në kredi. Të gjitha këto analiza përfshijnë periudhën kohore 2005 – 2018.

Në tabelën 6.10, janë paraqitur të gjitha të dhënat për vlerën e PBB-së në sektorin e bujqësisë si dhe për shumën e kredive të dhëna nga bankat komerciale për sektorin e bujqësisë. PBB-ja dhe shuma e kredive agro në këtë tabelë janë të paraqitura në miliona € dhe përfshinë një periudhë kohore 14 vjeçare.

Tabela 6. 10. *Analiza e trendit në mes GDP-së dhe kredive në sektorin e bujqësisë*

Viti	PBB-ja në Bujqësi	Kreditë bujqësore	Trendi
2005	346.9	12.5	253.0
2006	372.3	16.4	261.2
2007	479.6	29.0	269.4
2008	526.3	37.4	277.6
2009	532.7	38.2	285.9
2010	630.3	38.2	294.1
2011	705.3	40.5	302.3
2012	615.37	43.6	310.5
2013	638.7	45.8	318.7
2014	661.8	49.8	326.9
2015	599.6	59.9	335.2
2016	635	59.7	343.4
2017	597.2	67.7	351.6
2018	689.3	67.7	359.8

Burimi: Kalkulimet e autorit në Microsoft Excel

Duke u bazuar në të dhënat e tabelës së mësiperme mund të vërejmë rritje të vazhdueshme të kredive bujqësore dhe produktit të brendshëm bruto në sektorin e bujqësisë.

Në vitin 2005 vlera e kredive bujqësore në Kosovë ishte 12.5 milion €, ndërsa në vitin 2018 kjo vlerë e këtyre kredive arriti në 67.7 milion €. Vlera e PBB-së në bujqësi në vitin 2005 në Kosovë ishte 346.9 milion € dhe kjo vlerë në vitin 2018 arriti në 689.3 milion €. Trendi fillestar kumulativ i raportit mes PBB-së dhe kredive në sektorin e bujqësisë në vitin 2005 ishte 253.0, vlerë kjo e cila në fund të vitit 2018, ishte 359.8.

Nëpërmjet formulës së mëposhtme do të kalkulojmë normën e rritjës së PBB-së dhe kredive në sektorin e bujqësisë në Kosovë për periudhën kohore 2005 – 2018. Duke e zëvendësuar vlerën e PBB-së në vitin 2005 që ishte 346.9 milion € dhe në vitin 2018 ishte 689.3 milion €, atëherë norma e rritjes së PBB-së në bujqësi është:

$$Norma\ e\ rritjës = (viti\ aktual/viti\ bazë)^{1/n} - 1$$

$$Norma\ e\ rritjës_{(PBB)} = (689.3/346.9)^{1/14} - 1 = 5.02\%$$

$$Norma\ e\ rritjes_{(KB)} = (67.7/12.5)^{1/14} - 1 = 12.81\%$$

Prej vitit 2005 deri në vitin 2018, PBB-ja në sektorin e bujqësisë ka shënuar rritje për 5.02%. Ndërsa kreditë bujqësore gjatë kësaj periudhe kanë shënuar rritje prej 18.40%. Në bazë të këtyre vlerave mund të shohim që rritja prej 12.81% në kreditë agro ka shkaktuar një rritje të produktit kombëtar bruto në sektorin e bujqësisë për vlerën 5.02%. Në figurën e mëposhtme është paraqitur grafikisht funksioni i trendit linear dhe trendit logaritmik në mes PBB-së në bujqësi dhe kredive agro në Kosovë për periudhën kohore 2005 – 2018.

Figura 6. 5. *Paraqitja grafike e funksionit të trendit linear dhe trendit logaritmik për PBB-në dhe kreditë në sektorin e bujqësisë*



Burimi: Kalkulimet e autorit në Microsoft Excel

Duke u bazuar në figurën 6.5, mund të shohim që rritja e kredive bujqësore ka shkaktuar rritje të PBB-së në sektorin e bujqësisë. Pavarsisht normave të larta të interesit në kreditë agro, përsëri njëri nga burimet kryesore të financimit për shumë biznese agro dhe fermerë mbeten kreditë e dhëna nga bankat komerciale. Normat e interesit për këto lloje të kredive kanë qenë jashtëzakonisht shumë të larta, duke shkaktuar kosto shumë të larta të financimit për huamarrësit, madje një pjesë e madhe e fermerëve nuk kanë mundur që ti përballojnë kostove të larta të financimit nëpërmjet kredive agro.

Norma mesatare e interesit në kreditë agro në janar të vitit 2010 ishte 28.58%, ndërsa në fund të vitit 2018, kjo normë e interesit ka rënë në 9.67%. Prandaj, në tetë vitet e fundit kemi një rënie të ndjeshme të normave të interesit në kreditë agro, dhe kjo dëshmon faktin se politikat kreditore të bankave komerciale janë të orientuara në lehtësimin e fermerëve për qasje në kreditë e sektorit bankar.

Pra, në bazë të analizave të trendit shohim që gjatë kësaj periudhe kohore rritja e kredive agro ka shkaktuar rritjen e PBB-së, një trend i tillë është pozitiv. Një ndër indikatorët shumë të rëndësishëm që ka ndikuar në rritjen e kreditimit në bujqësi është rënia e normave të interesit si dhe lehtësimi i kushteve të bankave për dhënie të kredive agro. Nëpërmjet projeksioneve të trendit linear dhe logaritmik do të llogaritim se sa do të jetë vlera e PBB-së dhe kredive në sektorin e bujqësisë për 3 vitet e ardhshme. Ky është një projeksion, i cili do të shërbejë në analizën tonë për të parë trendin e këtyre variablave.

Forma e përgjithshme e ekuacionit të trendit logaritmik për PBB-në në bujqësi është:

$$Y= 128.05 \ln (x) + 343.19 \quad R^2=0.8116$$

$$PBB_{2019} = 128.05 \ln (x) + 343.19 = 128.05 \ln (15) + 343.19 = 689.95 \text{ milion €}$$

$$PBB_{2020} = 128.05 \ln (x) + 343.19 = 128.05 \ln (16) + 343.19 = 698.21 \text{ milion €}$$

$$PBB_{2021} = 128.05 \ln (x) + 343.19 = 128.05 \ln (17) + 343.19 = 705.98 \text{ milion €}$$

Sipas këtyre projeksioneve, parashikohet që vlera e PBB-së në sektorin e bujqësisë deri në vitin 2021 do të rritet në 705.98 milion €. Vlera e koeficientit të përcaktimit në këtë rast është 81.16%, që tregon një lidhje të lartë në mes PBB-së dhe kredive në sektorin e bujqësisë në Kosovë. Pra, kreditimi i sektorit të bujqësisë nga bankat komerciale me kushte sa më të favorshme ka një rëndësi shumë të madhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Për të vazhduar me këtë trend të rritjes së kredive, është e nevojshme që të kemi ulje të normave të interesit në kredi deri në vlerën më pak se 5%. Ndërsa, forma e përgjithshme e ekuacionit të trendit linear për kreditë e bankave komerciale në sektorin e bujqësisë është:

$$Y= 3.9542X + 13.659 \quad R^2=0.9477$$

$$KB_{Agro\ (2019)}= 3.9542X + 13.659 = 3.9542 *15 + 13.659 = 72.97 \text{ milion €}$$

$$KB_{Agro\ (2020)}= 3.9542X + 13.659 = 3.9542 *16 + 13.659 = 76.92 \text{ milion €}$$

$$KB_{Agro\ (2021)}= 3.9542X + 13.659 = 3.9542 *17 + 13.659 = 80.88 \text{ milion €}$$

Projeksionet e llogaritura për kreditë bujqësore deri në vitin 2021 parashikohen të arrijnë deri në vlerën 80.88 milion €. Vlera e koeficientit të përcaktimit për analizën e trendit linear në mes të PBB-së dhe kredive në sektorin e bujqësisë është 94.77%, që nëpërmjet këtij koeficienti nënkuptojmë që kreditë e bankave komerciale e shpjegojnë produktin e brendshëm bruto në sektorin e bujqësisë për vlerën

94.77%. Faktori kryesor që ndikon në rritjen e kredive në këtë sektor, edhe sipas projeksioneve të dala nga analiza e trendit është norma e interesit për këto lloje të kredive, që edhe më tutje mbetet e lartë në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Në vazhdim të analizës së trendeve do të ofrojmë disa të dhëna të tjera për kreditë e bankave komerciale në sektorin e industrisë, prodhimit, energjetikës dhe ndërtimtarisë si dhe PBB-së së Kosovës në këta sektorë të ekonomisë.

6.1.8. Analiza e trendit linear në mes PBB-së dhe kredive në sektorin e industrisë, prodhimtarisë, energjetikës dhe ndërtimtarisë

Në vazhdim të analizës së trendeve do të paraqesim të dhënat statistikore për trendin mes PBB-së dhe kredive në sektorin e industrisë, prodhimtarisë, energjetikës dhe ndërtimtarisë. Të dhënat janë marrë duke u bazuar në të raportet financiare vjetore të BQK-së dhe në raportet statistikore vjetore të Agjensisë së Statistikave të Kosovës. Në tabelën 5.11 janë të paraqitura rezultatet e analizës së trendit mes kredive dhe PBB-së në këta sektorë të ekonomisë për periudhën kohore 2005 – 2018.

Tabela 6. 11. *Analiza e trendit në mes PBB-së dhe kredive në sektorin e industrisë, prodhimit, energjetikës dhe ndërtimtarisë*

Viti	PBB-ja në IPEN	Kreditë në IPEN	Trendi
2005	678.90	74.2	409.5
2006	715.90	97.7	452.3
2007	752.40	144.5	495.1
2008	945.89	160.2	537.9
2009	1002.97	236.7	580.7
2010	1012.49	269.3	623.6
2011	1068.99	284.7	666.4
2012	1169.41	290.4	709.2
2013	1252.20	291.4	752.0
2014	1231.20	300.0	794.8
2015	1381.10	300.6	837.6
2016	1415.50	324.8	880.4
2017	1600.20	371.5	923.2
2018	1755.60	428.5	966.0

Burimi: Kalkulimet e autorit në Microsoft Excel

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme të analizës së trendit mund të vërejmë që ekziston një trend pozitiv në mes PBB-së dhe kredive të dhëna në sektorin e industrisë, prodhimtarisë, energjetikës dhe ndërtimtarisë. Vlera e kredive në këta sektorë të ekonomisë në vitin 2005 ishte 74.2 milion €, ndërsa këto kredi deri në vitin 2018 arritën në vlerën 428.5 milion €. Trendi mesatar kumulativ i kredive në këta sektorë të ekonomisë gjatë këtyre 14 viteve është 687.8 milion €.

Norma e rritjes së këtyre kredive gjatë këtyre viteve është 13.33%. Produkti i brendshëm bruto në këta sektorë të ekonomisë (IPEN – industri, prodhimtari, energjetikë dhe ndërtimtari) në vitin 2005 kishte vlerën 678.90 milion €, ndërsa në vitin 2018 vlera e PBB-së arriti në 1.75 miliard €.

Figura 6. 6. *Paraqitja grafike e funksionit të trendit linear për PBB-në dhe kreditë në sektorin e IPEN-it*



Burimi: Kalkulimet e autorit në Microsoft Excel

Trendi mesatar kumulativ i PBB-së në sektorin e industrisë, prodhimtarisë, energjetikës dhe ndërtimtarisë gjatë periudhës kohore 2005 – 2018 arriti në vlerën 1.41 miliard €. Norma e rritjes së produktit të brendshëm bruto në këta sektorë të ekonomisë është 7.01%. Në bazë të rezultateve të analizës së trendit linear për raportin në mes PBB-së dhe kredive bankare, vlera e koeficientit të përcaktimit është 94.77%, që tregon që për këtë vlerë kreditë bankare e shpjegojnë produktin e brendshëm bruto në sektorin e IPEN-it.

Nëpërmjet kësaj analize mund të konkludojmë se bankat komerciale gjatë këtyre viteve vazhdimisht kanë rritur kreditimin e këtyre sektorëve duke ofruar mbështetje më të madhe për financimin e sektorit të industrisë, prodhimit, energjetikës dhe ndërtimtarisë. Norma e rritjes së kredive bankare në këta sektorë prej 13.33% ka shkaktuar rritjen e PBB-së për 7.01%. Një prej faktorëve shumë të rëndësishëm që ka ndikuar në kreditimin e këtyre sektorëve nga bankat komerciale është edhe norma e interesit në këto kredi. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, norma e interesit në këto kredi në vitin 2010 ishte 17.08%, ndërsa në vitin 2018 kjo normë e interesit ka rënë në 6.21%.

Rënia e tillë e normave të interesit është një indikator shumë i rëndësishëm për rritjen e kreditimit në sektorët e ndryshëm të industrisë. Një element shumë i rëndësishem i analizës së trendeve është edhe ndërtimi i projeksioneve për parashikimin e vlerës së ndryshoreve të përcaktuara në analizë. Në këtë analizë do të japim projeksionin për tri vitet e ardhshme për vlerën e PBB-së dhe kredive në sektorin e industrisë, prodhimit, energjetikës dhe ndërtimtarisë. Forma e përgjithshme e ekuacionit për trendin linear të PBB-së në sektorin e industrisë është:

$$Y= 76.23X + 569.66 \quad (R^2=0.9148)$$

$$PBB_{IPEN\ (2019)} = 76.23 * (15) + 569.66 = 1.71 \text{ miliard €}$$

$$PBB_{IPEN\ (2020)} = 76.23 * (16) + 569.66 = 1.78 \text{ miliard €}$$

$$PBB_{IPEN\ (2021)} = 76.23 * (17) + 569.66 = 1.86 \text{ miliard €}$$

Sipas vlerave të projeksionit shohim që PBB-ja në sektorin e industrisë gjatë vitit 2019 do të ketë një rënie më të ulët në krahasim me vitin 2018, ndërsa në bazë të këtyre parashikimeve sektori i industrisë do të ketë edhe më tutje rritje ekonomike, ku vlera e PBB-së deri në vitin 2021 pritet të arrijë në 1.86 miliard €. Ndërsa forma e përgjithshme e ekuacionit të trendit linear për shumën e kredive të dhëna në sektorin e industrisë është:

$$Y= 23.325X + 80.392 \quad (R^2=0.9477)$$

$$KB_{IPEN\ (2019)} = 23.325 * (15) + 80.392 = 430.26 \text{ milion €}$$

$$KB_{IPEN\ (2020)} = 23.325 * (16) + 80.392 = 453.59 \text{ milion €}$$

$$KB_{IPEN\ (2021)} = 23.325 * (17) + 80.392 = 476.91 \text{ milion €}$$

Projeksionet e realizuara nëpërmjet analizës së trendit linear parashikojnë që shuma e kredive do të rritet deri në vitin 2021 në 476.91 milion €. Këto projeksione janë shumë të rëndësishme sepse na japin një pasqyrë të saktë se si do të reflektojnë kreditë e dhëna nga bankat komerciale për sektorin e industrisë në rritjen ekonomike të sektori. Meqënese këto projeksione janë ndërtuar mbi bazën e të dhënave historike gjatë 14 viteve të kaluara, na japin një konkluzion shumë të rëndësishëm që sektori bankar do të duhet të japë edhe më shumë kredi për këta sektorë, sepse bizneset operuese në këta sektorë janë një ndër gjeneratorët kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit.

6.1.9. Analiza e trendit linear në mes PBB-së dhe kredive në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve

Njëri ndër sektorët mjaft të rëndësishëm dhe më të zhvilluar të ekonominë e Kosovës është sektori i tregtisë dhe shërbimeve. Pjesa më e madhe e kredive të sektorit bankar në Kosovë janë të përqendrura në këta dy sektorë dhe kjo nënkupton që edhe rritja ekonomike e këtyre sektorëve është më e madhe në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë reale. Nëpërmjet analizës së trendit linear do të paraqesim të gjitha të dhënat në lidhje me vlerën e PBB-së dhe shumën e kredive të dhëna nga bankat komerciale në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve.

Tabela 6. 12. *Analiza e trendit linear në mes PBB-së dhe kredive në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve*

Viti	GDP në TSH	Kreditë në TSH	Trendi i PBB-së në TSH	Trendi i kredive në TSH
2005	1,627.50	301.1	1494.47	386.11
2006	1,653.39	376.4	1619.86	448.89
2007	1,683.40	518.0	1745.25	511.67
2008	1,810.95	704.8	1870.64	574.45
2009	1,919.34	670.5	1996.02	637.24
2010	2,046.19	715.3	2121.41	700.02
2011	2,197.29	824.4	2246.80	762.80
2012	2,477.10	860.2	2372.19	825.58
2013	2,544.57	880.2	2497.58	888.37
2014	2,643.30	906.6	2622.97	951.15
2015	2,762.60	972.9	2748.35	1013.93
2016	2,816.90	1,025.5	2873.74	1076.71
2017	2,908.30	1,124.4	2999.13	1139.50
2018	3,242.10	1,238.3	3124.52	1202.28

Burimi: Kalkulimet e autorit në Microsoft Excel

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën 6.12, mund të vërejmë që kreditë në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve (TSH) kanë ndjekur trend rritjeje pozitive, ku vlera e këtyre kredive në vitin 2005 ishte 301.1 milion €, ndërsa në vitin 2018 këto kredi arritën deri në shumën 1.23 miliard €. Norma e rritjes së kredive bankare në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve gjatë këtyre viteve të fundit ka shënuar një rritje prej 10.62%.

Ndërsa, nëse i referohemi vlerës së PBB-së në vitin 2005, ajo ishte 1.62 miliard €, vlerë kjo e cila në vitin 2018 arriti në 3.24 miliard €. Në bazë të këtyre vlerave, vërehet një rritje shumë e theksuar e produktit të brendshëm bruto në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve.

Figura 6. 7. *Paraqitja grafike e funksionit të trendit linear për PBB-në dhe kreditë në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve*



Burimi: Kalkulimet e autorit në Microsoft Excel

Rritja ekonomike në kuadër të sektorëve të ekonomisë reale në Kosovë, është shumë i madh në këta dy sektorë, se sa sektorët e tjerë të ekonomisë. Norma e rritjes së PBB-së në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve ka shënuar një rritje prej 5.04%. Vlera e trendit mesatar kumulativ për PBB-në dhe kreditë e sektorit të tregtisë dhe shërbimeve është 1624.8, vlerë kjo e cila tregon që trendi është pozitiv se kjo vërteton faktin se bankat komerciale nëpërmjet procesit të kreditimit në këta dy sektorë të ekonomisë reale kanë ndikuar në rritjen e PBB-së për 5.04%. Koeficienti i përcaktimit në mes të këtyre dy variablave është 97.83%, vlerë kjo e cila tregon një lidhje shumë të lartë në mes të këtyre dy ndryshoreve.

Sipas vlerave të paraqitura në figurën e mësipërme, vërehet që kemi trend pozitiv rritës mes kredive dhe produktit të brendshëm bruto në sekorët e tregtisë dhe shërbimeve gjatë periudhës kohore 2005 – 2018. Ky pohim na jep edhe më shumë dëshmi empirike për vërtetimin e validitetit të hipotezës së parë të këtij studimi. Në bazë të ekuacionit të përgjithshëm për trendin linear të kredive në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve, edhe në këtë analizë do të ndërtojmë projeksione për tri vitet e ardhshme, për të evidentuar faktin nëse edhe në tri vitet e ardhshme parashikohet të ketë rritje të kredive dhe PBB-së në këta sektorë të ekonomisë reale.

Forma e përgjithshme e ekuacionit të analizës së trendit linear për produktin e brendshëm bruto për sektorin e tregtisë dhe shërbimeve është:

$$Y=125.39X + 1369.1 \quad (R^2 = 0.9783)$$

$$PBB_{TSH\ (2019)}=125.39 * (15) + 1369.1 = 3.24\ miliard\ €$$

$$PBB_{TSH\ (2020)}=125.39 * (16) + 1369.1 = 3.37\ miliard\ €$$

$$PBB_{TSH\ (2021)}=125.39 * (17) + 1369.1 = 3.50\ miliard\ €$$

Sipas këtyre projeksioneve për vlerën e PBB-së në tri vitet e ardhshme, parashikohet se kjo vlerë do të arrijë në 3.5 miliard €. Prandaj, për të parë në qoftëse do të kemi trend pozitiv për kreditë e bankave komerciale të dhëna për sektorin e tregtisë dhe shërbimeve, në bazë të projeksionit të trendit linear, atëherë mund të konkludojmë që bankat komerciale do të ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike të këtyre dy sektorëve.

$$Y=62.783X + 323.32\ \ (R^2 = 0.9535)$$

$$KB_{TSH\ (2019)}=62.783 * (15) + 323.32 = 1.26\ miliard\ €$$

$$KB_{TSH\ (2020)}=62.783 * (16) + 323.32 = 1.32\ miliard\ €$$

$$KB_{TSH\ (2021)}=62.783 * (17) + 323.32 = 1.39\ miliard\ €$$

Edhe në bazë të projeksioneve të realizuara për PBB-në dhe kreditë e bankave komerciale për sektorin e tregtisë dhe shërbimeve parashikohet trend pozitiv. Madje, deri në vitin 2021 vlera e kredive parashikohet të jetë 1.39 miliard €. Të gjitha këto projeksione mund të jenë të arritshme për bankat komerciale, jo vetëm në aspektin stastistikor, por duhet edhe më tutje të përshtaten politikat kreditore të bankave për financimin e bizneseve jo vetëm në këtë sektor, por në të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë reale, në mënyrë që të arrihet progres më i madh ekonomik në Kosovë.

6.1.10. Analiza e trendit logaritmik në mes PBB-së dhe normës së inflacionit në Kosovë (2005 – 2018)

Sipas vlerësimeve ekonometrike për hipotezën e parë, për periudhën kohore 2005 – 2018 norma e inflacionit ka ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike. Ky rezultat përputhet edhe me teorinë ekonomike se kur rriten çmimet, pagat dhe shpenzimet, këto trende kërkojnë më shumë para në qarkullim dhe për pasojë kërkojnë më shumë kredi dhe ndikojnë edhe në rritjen e PBB-së.

Tabela 6. 13. *Analiza e trendit logaritmik në mes PBB-së dhe inflacionit në Kosovë (2005 – 2018)*

Viti	PBB-ja	IÇK	Trendi
2005	3068.40	77.1	1701.5
2006	3191.70	77.6	1812.1
2007	3315.80	81.0	1922.8

2008	3628.10	88.6	2033.5
2009	3962.70	86.4	2144.2
2010	4402.00	89.4	2254.9
2011	4814.50	96.0	2365.6
2012	5059.00	98.4	2476.3
2013	5326.70	100.1	2587.0
2014	5567.50	100.5	2697.6
2015	5807.00	100.0	2808.3
2016	6070.20	100.3	2919.0
2017	6282.10	101.8	3029.7
2018	6764.90	102.8	3140.4

Burimi: Kalkulimet e autorit në Microsoft Excel

Prandaj, është e nevojshme që edhe nëpërmjet analizës së trendit logaritmik të shohim se si ka ndikuar norma e inflacionit në rritjen ekonomike në Kosovë gjatë periudhës kohore 14 vjeçare. Forma e përgjithshme e ekuacionit të trendit logaritmik për PBB-në dhe indeksin e çmimit të konsumatorit është:

$$Y = 1477.5 \ln (X) + 2145.8 \quad (R^2 = 0.8659)$$

Pra, siç mund të vërehet vlera e koeficientit të përcaktimit në mes PBB-së dhe inflacionit është 86.59%, që tregon një lidhje të lartë në mes të këtyre dy ndryshoreve. Vlera e indeksit të çmimit të konsumatorit në vitin 2005 ishte 77.1, vlerë kjo e cila në vitin 2018 arriti në 102.8 dhe kjo nënkupton që një rritje e vazhdueshme e këtij indeksi ka shkaktuar edhe rritjen e vlerës së PBB-së nga 3.06 miliard € në 6.76 miliard €.

Figura 6. 8. *Paraqitja grafike e funksionit të trendit logaritmik për PBB-në dhe indeksin e çmimit të konsumatorit në Kosovë*



Burimi: Kalkulimet e autorit në Microsoft Excel

Nëpërmjet paraqitjes grafike të trendit logaritmik mund të konkludojmë që rritja e indeksit të çmimit të konsumatorit ka shkaktuar rritjen e PBB-së dhe trendi mesatar kumulativ për këto dy ndryshore është

2420.9. Vlerë kjo e cila shpreh një evidencë tjetër empirike që e mbështet edhe rezultatin e arritur nëpërmjet modeleve ekonometrike. Sipas të gjitha testeve statistikore, rezulton që inflacioni ka ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike, duke e rritur sasinë e parasë në qarkullim, rritjen e kredive bankare, rënien e normave të interesit në kredi dhe rritjen e vlerës së PBB-së.

6.1.11. Analiza e trendit eksponencial në mes PBB-së dhe normës së interesit në kredi

Nëpërmjet analizës së trendit eksponencial ne do të testojmë efektet e normave të interesit në kredi në rritjen ekonomike të Kosovës për periudhën kohore 2005 – 2018. Duke u bazuar në shumë studime të tjera të cilat kanë analizuar efektet e normave të interesit në rritjen ekonomike, rezulton që për shumë vende këto norma të interesit kanë ndikuar negativisht. Duke iu referuar edhe gjetjeve empirike, rezulton që normat e interesit ndikojnë negativisht në rritjen ekonomike, sepse normat e larta të interesit në kredi janë pengesë tjetër shumë e madhe për shumë biznese që të sigurojnë një kredi, e cila do të iu ndihmonte në realizimin e aktivitetit të tyre biznesore. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura të gjitha të dhënat për PBB-në, normat e interesit në kredi dhe për rezultatet e analizës së trendit eksponencial.

Tabela 6. 14. *Analiza e trendit eksponencial në mes GDP-së dhe normës së interesit në kredi*

Viti	PBB-ja	Norma e interesit	Trendi
2005	6.0%	14.47%	0.10213
2006	4.5%	14.69%	0.09831
2007	7.3%	14.05%	0.09449
2008	2.6%	13.78%	0.09067
2009	3.3%	14.08%	0.08684
2010	3.3%	13.97%	0.08302
2011	4.8%	13.30%	0.07920
2012	2.9%	12.24%	0.07538
2013	3.4%	10.89%	0.07156
2014	1.2%	9.28%	0.06774
2015	4.1%	7.68%	0.06392
2016	4.1%	7.30%	0.06009
2017	4.2%	6.82%	0.05627
2018	3.5%	5.99%	0.05245

Burimi: Kalkulimet e autorit në Microsoft Excel

Duke u bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, vërejmë që mesatarja e normave të interesit në kredi në vitin 2005 ishte 14.47%, vlerë kjo e cila në vitin 2018, si mesatare u zvogëlua në 5.99%. Duke u nisur nga fakti, se rritja e indeksit të çmimit të konsumatorit ka ndikuar në rritjen e PBB-së, duke shkaktuar rritjen e bazës monetare, rritjen e kredive bankare, por edhe uljen e normave të interesit. Pra,

edhe sipas teorisë ekonomike, rritja e sasisë së parave në qarkullim ndikon në zvogëlimin e normave të interesit në kredi dhe rritjen e kërkesës për kredi. Duke u bazuar në gjetjet empirike të këtij studimi, kemi parë që normat e interesit kanë ndikuar negativisht në rritjen ekonomike, një fenomen i tillë është i shpjegueshëm për ekonominë e Kosovës, e sidomos në vitet 2005 – 2014, ku kemi pasur norma shumë të larta të interesit në kredi dhe që kanë shkaktuar kosto shumë të madhe për huamarrësit.

Figura 6. 9. *Paraqitja grafike e funksionit të trendit eksponencial për PBB-në dhe normat e interesit në kredi*



Burimi: Kalkulimet e autorit në Microsoft Excel

Vlera e trendit eksponencial për PBB-në dhe normat e interesit në kredi kanë trend rënës, siç mund të shihet nga të dhënat e paraqitura në tabelën 6.14 dhe në figurën 6.9. Rënia e vazhdueshme e normave e të interesit në kredi ka shkaktuar në disa vite të caktuara edhe rritjen e PBB-së, por ka ndikuar edhe negativisht në rritjen ekonomike. Meqënese gjatë gjithë periudhës kohore të analizuar, kemi pasur një trend rënës, normat e interesit kanë shkaktuar rënie të theksuar ekonomike në vitin 2006, 2008 dhe 2014. Gjatë kësaj periudhe kohore, në vitin 2014 kemi pasur rritjen më të ngadalshme ekonomike dhe njëri nga indikatorët ka qenë një barrierë shumë e madhe për shumë biznese që të financojnë aktivitetin e tyre nga kreditë e bankave komerciale është norma e lartë e interesit e cila në vitin 2014 ishte 9.28%. Forma e përgjithshme e ekuacionit të trendit logaritmik është:

$$Y = 0.0561X^{0.237} \quad (R^2 = 0.8877)$$

Kosova në raport me vendet e tjera të rajonit, ka norma më të larta të interesit në kredi, por qëndron më mirë sa i përket nivelit të kredive jo-performuese. Rezultatet e analizës së trendit eksponencial janë shumë të përafërta me rezultatet e modeleve ekonometrike, që normat e interesit në kredi kanë pasur efekte negative në rritjen ekonomike të Kosovës gjatë periudhës kohore 2005 – 2018. Një nga arsyet kryesore për rënien e normave të interesit në kredi, është edhe rritja e konkurrencës në industrinë

bankare si dhe rritje e ndjeshme e të hyrave nga jo-interesi. Pra, edhe pse bankat kanë pasur rënie ënë të hyrat nga interesat, është vërejtur një rritje e theksuar në të hyrat nga jo-interesat, duke rezultuar me rritje në shumën e provizioneve për shërbimet që i ofrojnë këto banka.

6.2. Vlerësimi ekonometrik dhe testimi i hipotezës së dytë

Hipoteza e dytë e këtij studimi ka për qëllim të identifikojë faktin nëse politikat e menaxhimit me efikasitet të kredive të këqija ndikojnë pozitivisht në rritjen e kreditimit të bankave komerciale ndaj sektorit real të ekonomisë. Për testimin e kësaj hipoteze jemi bazuar në studime të autorëve tjerë, të cilët kanë analizuar efektet e menaxhimit të kredive të këqija dhe ndikimin e tyre në kreditimin e sektorit real.

Autorët si Cucinelli (2015), Hoggarth (2005), Harr & Noelsen (2005), Bofondi & Ropele (2011), Louzis (2012), Vogiazas & Nikoloadou (2011), Farhan (2012), Klein (2013), Bruno et al., (2015) si dhe autorë të tjerë kanë studiuar faktorët që përcaktojnë nivelin e kredive jo-performuese si dhe efektet e menaxhimit të këtyre kredive në kreditimin e sektorit real të ekonomisë. Kryesisht të gjitha këto studime ndahen në dy kategori kryesore: në kategorinë e parë bëjnë pjesë të gjitha studimet të cilat përcaktojnë faktorët specifikë bankar që ndikojnë në nivelin e kredive jo-performuese dhe në kategorinë e dytë bëjnë pjesë të gjitha ato studime shkencore të cilat kanë analizuar faktorët makroekonomik të cilët kanë ndikuar në nivelin e kredive jo-performuese.

Hipoteza e dytë e këtij studimi është:

Politikat e menaxhimit me efikasitet të kredive të këqija kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit ndaj sektorit real të ekonomisë.

Për testimin e hipotezës së dytë janë aplikuar metodat kuantitative nëpërmjet të dhënave sekondare, të cilat janë grumbulluar nga raportet financiare vjetore të Bankës Qendrore të Kosovës, Bankës Botërore, Agjensisë së Statistikave të Kosovës, Shoqatës së Bankave të Kosovës si dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Për të analizuar ndikimndikimin e kredive jo-performuese në kreditimin e sektorit real dhe politikat e bankave komerciale për menaxhimin efikas të këtyre kredive është e nevojshme që të analizohen disa faktorë të cilët e përcaktojnë nivelin e kredive jo-performuese. Prandaj, një element shumë i rëndësishëm që vlen të theksohet përpara specifikimit të modelit ekonometrik, është se ndryshoret e tjera të pavarura që janë marrë parasysh në këtë studim janë kryesisht indikatorë që masin

dhe ndikojnë në nivelin e kredive jo-performuese dhe kanë efekte edhe në politikat e bankave komerciale në menaxhimin efikas të këtyre kredive si dhe përcaktimin e kritereve për dhënien e kredive.

Ndërtimi i modelit ekonometrik për testimin e kësaj hipoteze, është bazuar në shumë studime të autorëve tjerë si Cucinelli (2015), Laeven & Majnoni (2003), Gonzales (2008), Messai & Jouini (2013), të cilët kanë përdorur në studimet e tyre modele të serive kohore në baza mujore dhe vjetore, që e shpjegojnë ndikimin e kredive jo-performuese në kreditimin e sektorit real të ekonomisë. Për mbledhjen e të dhënave statistikore dhe për testimin e kësaj hipoteze edhe ne jemi bazuar në të dhënat e raportuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Banka Botërore dhe Agjensia e Statistikave të Kosovës për periudhën kohore 2005 – 2018.

Vlen të theksohet se analiza përfshin vetëm rastin e Kosovës, dhe për të ndërtuar seri kohore është e nevojshme që të kemi një numër më të madh të observimeve, edhe për këtë hipotezë të dhënat janë marrë në baza mujore dhe numri i observimeve arrin në 168. Të dhënat janë të përpunuara në programin STATA, dhe për vërtetimin e këtyre hipotezave ne kemi aplikuar këto teste statistikore: regresionin linear, modeli i efektit fiks dhe efektit random, Hausman – Taylor regression, Generalized method of moments (GMM) dhe Generalized estimating equations – (GEE).

Tabela 6. 15. *Përshkrimi i variablave për modelin ekonometrik të hipotezës së dytë*

Variabla	Përshkimi i variablës	Burimi i të dhënave
Variabla e varur	Shuma e kredive bankare (KB)	Raportet e Stabilitetit Financiar 2005 – 2018 (Banka Qëndrore e Kosovës) dhe raportet vjetore të Shoqatës së Bankave të Kosovës
Variabla e pavarur	Kreditë jo – performuese (KJP)	Raportet e Stabilitetit Financiar 2005 – 2018 (Banka Qëndrore e Kosovës) dhe raportet vjetore të Shoqatës së Bankave të Kosovës
Variabla e pavarur	Produkti i Brendëshëm Bruto (PBB)	Raportet vjetore të Agjensionit të Statistikave të Kosovës (2005 – 2018) dhe raportet financiare vjetore të Bankës Botërore
Variabla e pavarur	Indeksi i çmimit të konsumatorit (IÇK)	Raportet vjetore të Agjensionit të Statistikave të Kosovës (2005 – 2018) dhe raportet financiare

		vjetore të Bankës Botërore
Variabla e pavarur	Depozitat (DEP)	Raportet e Stabilitetit Financiar 2005 – 2018 (Banka Qëndrore e Kosovës) dhe raportet vjetore të Shoqatës së Bankave të Kosovës

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Përfshirja e këtyre variable në këtë model ekonometrik qëndron në faktin sepse shumica e studimeve për të shpjeguar efektet e menaxhimit të kredive jo-performuese në kreditimin e sektorit real nga bankat komerciale kanë përdorur këto ndryshore si indikatorë të rëndësishem që ndikojnë në nivelin e kredive jo-performuese dhe në politikat kreditore të bankave komerciale. Në këtë model ekonometrik si variabël të varur do të përdorim shumën e kredive për biznese, duke marrë parasysh vëllimin e kredive të cilat bankat komerciale i kanë dhënë për biznese në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Vlerat e shumës së kredive janë marrë nga raportet financiare mujore dhe vjetore të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës. Po ashtu, vlerat e kësaj variable janë të raportuara në baza mujore për periudhën kohore 2005 – 2018 dhe përfaqësojnë 168 observime në kuadër të të dhënave panel të cilat janë koduar në programin Stata.

Meqënese problemi kryesor që parashtrohet në hipotezën e dytë është menaxhimi efikas i kredive jo-performuese dhe ndikimi i tyre në rritjen e kreditimit, si variabël kryesore të pavarur në kuadër të modelit të dytë ekonometrik e kemi marrë nivelin e kredive jo-performuese (KJP) në Kosovë për periudhen kohore 2005 – 2018. Po ashtu, edhe kjo variabël është e raportuar në baza mujore për periudhën 14 vjeçare, ku të dhënat janë bazuar në raportet financiare të Bankës Qendrore dhe në publikimet e Bankës Botërore. Të dhënat për këtë variabël janë përpunuar, sepse nga përqindja e kredive jo-performuese dhe totali i kredive për biznese është kalkuluar shuma e kredive jo-performuese.

Modeli ekonometrik që do të testojë validitetin e hipotezës së dytë do të marrë parasysh disa variabla të cilat do të shpjegojnë nivelin e kredive jo-performuese në Kosovë. Sipas studime të autorëve tjerë, njëri nga variablat kryesore që ndikojnë në nivelin e kredive jo-performuese dhe rritjen e kredimit janë efektet e produktit të brendshëm bruto, inflacioni, depozitat dhe papunësia. Në kuadër të kësaj analize, si variabla tjera të pavarura kemi përfshirë PBB-në, inflacionin dhe depozitat, ndërsa efektet e papunësisë do ti shpjegojmë nëpërmjet analizës së trendit linear, pasi që normën e papunësisë e kemi të publikuar vetëm në baza vjetore.

Produkti i brendshëm bruto paraqet një nga faktorët mjaft të rëndësishëm në përcaktimin e nivelit të kredive jo-performuese. Shumë studiues në kuadër të faktorëve makroekonomik e kanë analizuar ndikimin e produktit të brendshëm bruto në nivelin e kredive jo-performuese si dhe në rritjen e kredimit. Kjo variabël merret si faktor makroekonomik sepse na ndihmon të shpjegojmë edhe problemin e endogjinitetit që kemi mes kredive jo-performuese dhe shumës së kredive. Pra, duke e parë ndikimin e GDP-së tek kreditë jo-performuese, mund të shpjegohet se çfarë efekti kanë pasur politikat e bankave komerciale për menaxhimin efikas të këtyre kredive. Gjithashtu, edhe për këtë variabël të dhënat janë marrë nga raportet mujore statistikore të Agjensisë së Statistikave të Kosovës, por edhe nga raportet e zhvillimeve makroekonomike të Bankës Qendrore të Kosovës.

Indeksi i çmimit të konsumatorit si matës shumë i rëndësishëm i normës së inflacionit të një vendi, është marrë parasysh në analizën tonë ekonometrike. Duke ditur se rritja e inflacionit shkakton rritje të kredimit *(rezultat i bazuar edhe në gjetjet e këtij studimi),* dhe si rezultat nivelet e larta të inflacionit janë të lidhura me nivelin e ulët të kredive jo-perfomuese (Mazreku, Morina, Misiri, Spiteri, & Grima, 2018). Por, një rritje e moderuar e normës së inflacionit ka shkaktuar rritje të nivelit të kredive për biznese, madje edhe rritje të kredive jo-performuese. Por, duke pasur parasysh që Kosova qëndron shumë më mirë se vendet e tjera të rajonit, për nga niveli i kredive jo-performuese, kjo tregon faktin se politikat kreditore të bankave komerciale kanë qenë mjaft efikase në menaxhimin e këtyre kredive.

Variabla e fundit e pavarur, në kuadër të këtij modeli ekonometrik janë depozitat e sektorit bankar, të raportuara në baza mujore për periudhën kohore 2005 – 2018. Depozitat janë të shprehura në shuma monetare dhe janë një faktor shumë i rëndësishem specifik bankar që ndikon në nivelin e kredive jo-performuese si dhe shërbejnë si burim kryesor i bankave komerciale për dhënien e kredive për biznese. Pritjet e rezultateve janë që depozitat do të kenë ndikimin në uljen e kredive jo-performuese dhe rritjen e nivelit të kreditimit. Për këtë ndryshore të dhënat janë marrë nga raportet e stabilitetit financiar të Bankës Qendrore të Kosovës si dhe të dhënat e raportuara nga publikimet periodike financiare të Shoqatës së Bankave të Kosovës.

6.3. Statistikat deskriptive dhe analiza e korrelacionit për modelin e dytë ekonometrik

Në këtë pjesë të analizës do të paraqiten të gjitha rezultatet e statistikave deskriptive për ndryshoret të cilat janë të inkorporuara në modelin e dytë ekonometrik. Në kuadër të këtyre statistikave deskriptive janë të përfshira: vlerat minimale dhe maksimale, mesatarja, devijimi standard dhe varianca. Përpos

analizave deskriptive do të bëjmë edhe paraqitjen grafike të shpërndarjes normale të të dhënave, në mënyrë që të shohim sa janë të matshme të dhënat që janë përfshirë në model. Shpërndarja normale e të dhënave do të shpjegohet nëpërmjet grafikut të vijës së regresionit dhe histogramit.

Tabela 6. 16. *Statistikat deskriptive për variablat e hipotezës së dytë*

Variablat	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Variance
KB	168	381.798	2755.473	1548.081	640.6392	410418.5
KJP	168	7.636	161.282	83.67744	47.57042	2262.944
PBB	168	504.4	1963.5	1201.082	354.844	125914.3
IÇK	168	76.1	104.80	92.8506	9.10104	82.829
DEP	168	671.1	3221.545	1881.254	727.4453	529176.6

Burimi: Kalkultimet e autorit në programin Stata

Statistikat deskriptive për shumën e kredive, produktin e brendshëm bruto dhe indeksin e çmimit të konsumatorit janë përshkruar në modelin ekonometrik tek hipoteza e parë. Ndërsa të dhënat për kreditë jo-performuese dhe depozitat do të prezentohen në këtë model ekonometrik. Fokusi kryesor i kësaj hipoteze është menaxhimi efikas i kredive jo-performuese dhe ndikimi i tyre në rritjen e kreditimit. Vlera minimale e kredive jo-performuese ishte 7.63 milion €, ndërsa vlera maksimale arrin deri në 161.2 milion €.

Mesatarja e këtyre kredive është 83.67 milion € me një devijim standard prej 47.570. variabla e depozitave ka një vlerë minimale prej 671.1 milion € në vitin 2005 dhe vlera e tyre maksimale arrin në 3.21 miliard € në dhjetor të vitit 2018. Në bazë të këtyre vlerave mund të vërehet një trend pozitiv i rritjes së depozitave në sektorin bankar në Kosovë, që tregon se bankat komerciale në përgjithësi kanë një tepricë të madhe të likuiditetit, ku një nivel kaq i lartë i depozitave mund të përdoren si burime shumë të rëndësishme për financimin e kredive për biznese.

Por, edhe në vitet e fundit, bankat komerciale në Kosovë i shohin bizneset kosovare si shumë të rrezikshme, prandaj ende kanë politika shumë strikte në aspektin e miratimit të kredive, duke aplikuar kritere shumë të vështira për marrjen e kredive. Vlera mesatare e depozitave është 1.88 miliard € me një devijim standard prej 727.44.

Figura 6. 10. *Paraqitja grafike e shpërndarjes normale të kredive jo-performuese dhe depozitave nëpërmjet histogramit*



Burimi: Kalkultimet e autorit në programin Stata

Duke u bazuar në figurën e mësipërme mund të vërejmë se variabla kryesore e pavarur (KJP) ka shpërndarje normale të vlerave, duke nënkuptuar që lakorja përafërsisht është simetrike dhe se vlerat e përfshira në model janë plotësisht të matshme. Duke iu referuar pjesës së dytë të figurës 6.10. vërejmë që depozitat kanë një shpërndarje po ashtu normale, që nënkupton një qëndrueshmëri më të madhe të të dhënave në model dhe një saktësi më të lartë në matjen e tyre. Të dyja variablat e paraqitura nëpërmjet histogramit (kreditë jo-performuese dhe depozitat) kanë një lakore mezokuartile me një vlerë absolute afër 3. Variablat e tjera të përfshira në këtë model ekonometrik (kreditë bankare, PBB-ja dhe IÇK-ja) janë analizuar në hipotezën e parë, prandaj këtu fokusi do të jetë përshkrimi i statistikave deskriptive për ndryshoret të cilat nuk kanë qenë të inkorporuara në modelin e parë ekonometrik.

Tabela 6. 17. *Analiza e korrelacionit Pearson për variablat e përfshira në modelin e dytë ekonometrik*

Variablat	KB	KJP	PBB	IÇK	DEP
KB	1	0.7252	0.8679	0.9466	0.9904
KJP	0.7252	1	0.6434	0.8598	0.7602
PBB	0.8679	0.6434	1	0.8002	0.8665
IÇK	0.9466	0.8598	0.8002	1	0.9505
DEP	0.9904	0.7602	0.8665	0.9505	1

Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Nëpërmjet analizës së korrelacionit do të identifikojmë lidhjen ndërmjet variablës së varur (kredive për biznese) dhe variablave të pavarura (KJP, PBB, IÇK dhe DEP).

Në tabelën e mësipërme janë të paraqitura rezultatet e korrelacionit Pearson, që tregon ndërlidhshmërinë mes variablave të këtij modeli. Rezultatet e analizës së korrelacionit konsistojnë që të gjitha variablat e përfshira në këtë model ekonometrik janë të korreluara njëra me tjetrën. Fillimisht do të analizojmë korrelacionin Pearson mes kredive bankare me variablat e tjera të pavarura. Kreditë për biznese kanë lidhje pozitive të lartë me kreditë jo-performuese (0.7252), që nënkupton se për rastin e Kosovës, edhe pse kemi pasur rritje të kredive jo-performuese deri në vitin 2014, prapë kreditimi ndaj bizneseve është rritur, duke nënkuptuar që këto kredi janë menaxhuar me efikasitet dhe nuk ka shkaktuar rënie të kreditimit.

Figura 6. 11. *Paraqitja grafike e korrelacionit në mes kredive bankare me kreditë jo-performuese dhe PBB-në*



Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Gjatë interpretimit të modelit ekonometrik do të japim edhe më shumë argumente shkencore për sa i përket ndikimit të kredive jo-performuese në kreditimin e bizneseve nga ana e bankave komerciale. Në figurën 6.11. janë të paraqitura grafikisht analizat e korrelacionit mes kredive bankare dhe kredive jo-performuese si dhe mes kredive dhe produktit të brendshëm bruto. Korrelacioni mes kredive bankare dhe kredive jo-performuese është lineare pozitive, përpos disa pikave të caktuara të cilat gjenden më larg vijës së regresit dhe që e përcaktojnë nivelin e gabimit standard. Ndërsa korrelacioni në mes kredive bankare dhe produktit të brendshëm bruto është pozitiv i lartë (86.72%), që tregon se për këtë vlerë këto dy variabla janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Pra, rritja e produktit të brendshëm bruto shkakton rritje të kreditimit dhe e kundërta.

Sipas rezultateve të analizës së korrelacionit mund të shohim që kreditë bankare kanë një korrelacion pozitiv shumë të lartë me indeksin e çmimit të konsumatorit (0.9466). Ky korrelacion tregon që rritja e

normës së inflacionit shkakton rritje të kreditimit dhe e kundërta. Korrelacioni në mes kredive bankare dhe depozitave është pozitiv dhe shumë i lartë (0.9904), ku argumentohet se këto dy variabla e shpjegojnë shumë mirë njëra-tjetren dhe depozitat janë indikatori më i rëndësishëm që ndikojnë tek kreditë për biznese.

Figura 6. 12. *Paraqitja grafike e korrelacionit në mes kredive bankare me IÇK-në dhe depozitat*



Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Për të shpjeguar problemin e endogjinitetit mes kredive jo-performuese dhe kreditimit të sektorit real është e nevojshme të studiohen faktorët makroekonomik dhe specifik bankar që ndikojnë në përcaktimin e kredive jo-performuese. Idenfitikimi i këtyre faktorëve ndihmon bankat komerciale që t'i përshtatin politikat e tyre kreditore në menaxhimin efikas të këtyre kredive jo-performuese. Prandaj, nëpërmjet analizës së korrelacionit do të analizojmë se si korrelohen ndryshoret e tjera të pavarura me variablën endogjene, kreditë jo-performuese.

Vlera e koeficientit Pearson në mes kredive jo-performuese dhe produktit të brendshëm bruto është pozitive dhe korrelacion i mesëm (0.6434), që nënkupton se vlerat e këtyre dy ndryshoreve janë mesatarisht të shpjegueshme njëra me tjetrën. Njëri nga faktorët mjaft të rëndësishëm makroekonomik që ndikon në nivelin e kredive jo-performuese është norma e inflacionit. Korrelacioni në mes këtyre dy ndryshoreve është pozitiv dhe lidhje e lartë (0.8598), pra me rritjen e normës së inflacionit kemi rritje të kredive jo-performuese dhe e kundërta.

Figura 6. 13. *Paraqitja grafike e korrelacionit në mes kredive jo-performuese me GDP-në, CPI-në dhe depozitat*



Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Për të analizuar ndikimin e depozitave në përcaktimin e kredive jo-performuese, mjafton që të analizojmë pjesën e tretë të figurës dhe mund të shohim që kemi një korrelacion pozitiv të lartë mes këtyre dy ndryshoreve dhe kjo nënkupton që rritja e depozitave bankare mund të shkaktojë rritjen e kredive jo-performuese, sepse likuiditeti i tepërt i bankave komerciale mund t'i nxitë ato të japin më shumë kredi, por në rastin e Kosovës edhe pse në sistemin bankar janë 600 milion € depozita të lira, që paraqesin likuiditet të tepërt për sektorin bankar këto depozita nuk jepen në formë të kredive për bizneset, sepse bankat komerciale i konsiderojnë rrezik shumicën e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë.

Në vazhdim të analizës së rezultateve empirike do të paraqesim rezultatet e 6 modeleve ekonometrike në lidhje me hipotezën e dytë, ku do të realizohet një analizë krahasuese në mes këtyre modeleve, si dhe krahasim i rezultateve empirike me disa nga autorët e tjerë që e kanë studiuar efektet e menaxhimit të kredive jo-performuese në kreditmin e sektorit real të ekonomisë.

6.4. Specifikimi i modelit ekonometrik dhe rezultatet ekonometrike të hipotezës së dytë

Studime të ndryshme shkencore kanë analizuar faktorët përcaktues të kredive jo-performuese dhe menaxhimin efikas të këtyre kredive si dhe ndikimin e tyre në kreditimin e sektorit real të ekonomisë. Për të analizuar efektet e menaxhimit të kredive jo-performuese në kreditimin e sektorit real të ekonomisë ne jemi bazuar në studimet e autorëve si Cucinelli (2015), Hoggarth (2005), Harr & Noelsen (2005), Bofondi & Ropele (2011), Louzis (2012), Vogiatzis & Nikolaidou (2011), Farhan (2012), Klein (2013), Bruno et al., (2015) etj.

Fokusi kryesor i këtyre studimeve ishte në identifikimin e faktorëve specifik bankar dhe faktorëve makroekonomik që përcaktojnë nivelin e kredive jo-performuese dhe gjetjet e këtyre studimeve kryesisht dalin me rekomandime se cilat janë politikat e menaxhimit me efikasitet të kredive të këqija si dhe sa ndikojnë këto politika në rritjen e kreditimit të bankave ndaj sektorit real të ekonomisë. Për të ndërtuar modelin ekonometrik për testimin e hipotezës së dytë të këtij studimi, jemi bazuar në të gjitha këto studime, por si referencë kryesore është studimi i autorës italiane Cucinelli (2015) e cila analizoi ndikimndikimin e kredive jo-performuese në politikat kreditore të bankave komerciale për financimin e sektorit real të ekonomisë, studim i cili ofron një evidencë empirike për sektorin bankar italian.

Qëllimi kryesor i studimit të autores Cucinelli, ishte nëse rritja e riskut kreditor do të ndikojë në zvogëlimin e aktivitetit huadhënës të bankave. Analiza përfshin në mostër 488 banka italiane dhe një periudhë kohore 7 vjeçare (2007 – 2013). Faktorët kryesor që në këtë studim janë identifikuar si faktorë që ndikojnë në aktivitetin e huadhënënies së bankave dhe shpjegojnë variablën endogjene (kreditë jo-perfomuese) janë: produkti i brendshëm bruto, norma e inflacionit, papunësia, depozitat, totali i aseteve etj.

Meqënese në analizën tonë kemi periudhën kohore 2005 – 2018 për rastin e Kosovës dhe të dhënat janë të raportuara në baza mujore, në modelin ekonometrik kemi marrë si variabla shpjeguese: PBB-në, indeksin e çmimit të konsumatorit si matës i inflacionit, depozitat. Ndërsa papunësia do të analizohet nëpërmjet analizës së trendit linear, për të parë efektet e papunësisë në aktivitetin kredidhënës të bankave komerciale. Të gjeturat e këtij studimi tregojnë një lidhje negative në mes kredive jo-performuese dhe aktivitetit kreditues të bankave komerciale.

Specifikimi i modelit ekonometrik është realizuar duke iu referuar studimeve të mësipërme, prandaj struktura e këtij modeli është si vijon:

$$KB_{it} = \beta_0 + \beta_1 KJP_{it} + \beta_2 PBB_{it} + \beta_2 IÇK_{it} + \beta_3 DEP_{it} + \gamma_{it}$$

Ku:

KB - kreditë e bankave komerciale për sektorin e bizneseve

KJP– kreditë jo-performuese

PBB – produkti i brendshëm bruto

IÇK – indeksi i çmimit të konsumatorit

DEP – depozitat e sektorit bankar

γ – variabla stohastike (faktorët e tjerë që nuk janë marrë parasysh në model)

i – kodi dhe *t* – periudha kohore

Tabela 6. 18. *Rezultatet empirike për modelin e dytë ekonometrik*

Variablat	Linear Regression	Random Effects – GLS Regression	Fixed – effects Regression	Hausman Taylor Regression	GEE Model	GMM Model
KB	-	-	-	-	-	0.1173564* (0.059)
KJP	-2.135163 *** (0.000)	-2.265791*** (0.000)	-2.330677*** (0.000)	-2.2978*** (0.000)	-2.273924*** (0.000)	-2.298651*** (0.000)
PBB	0.1018225*** (0.002)	0.093139** (0.027)	0.073472 (0.216)	0.112963** (0.041)	0.0918189** (0.032)	0.0646688 (0.383)
IÇK	2.058376*** (0.002)	2.18049*** (0.000)	2.240949*** (0.000)	2.205273*** (0.000)	2.188089*** (0.000)	2.05728*** (0.000)
DEP	0.690562*** (0.000)	0.6864475*** (0.000)	0.6903618*** (0.000)	0.6776056*** (0.000)	0.6864942*** (0.000)	0.6180618*** (0.000)
Papunësia	-	-	-	-	-	-2.269366* (0.089)
R Square	0.9874	0.9901	0.9901	-	-	-

Burimi: Kalkulimet e autorit në programin Stata

Sqarim: *p-vlerat e treguara në kllapa: *** tregon rëndësinë statistikore në nivelin 1%; ** tregon rëndësinë statistikore në nivelin 5% dhe * tregon rëndësinë statistikore në 10%.*

Për testimin e hipotezës së dytë të këtij studimi kemi aplikuar gjashtë teste statistikore nëpërmjet softverit Stata dhe ato janë: regresionin linear, modeli i efektit fiks dhe efektit random, Hausman – Taylor regression, Generalized method of moments (GMM) dhe Generalized estimating equations – (GEE). Sipas këtyre rezultateve, pothuajse të gjitha variablat e përfshira në këtë model ekonometrik janë të rëndësishme në nivelin e rëndësisë 95%, dhe për qëllime të interpretimit ne do të fokusohemi tek modeli GMM *(Arellano – Bover & Blundell – Bond Estimation)* si dhe për variablat e caktuara do të bëhen krahasim edhe me rezultatet e testeve të tjera statistikore.

Qëllimi kryesor i përdorimit të modelit GMM qëndron për shkak të problemit të endogjinitetit, sepse variabla kryesore e pavarur (KJP) është variabël e cila ndikohet nga variablat e tjera ekzogjene të cilat nuk janë marrë parasysh në model dhe bëjnë pjesë në variablën stohastike. Pjesa më e madhe e studimeve shkencore në këtë fushë, për të sqaruar faktorët përcaktues të kredive jo-performuese i analizojnë faktorët makroekonomik. Meqënese në modelin tonë ekonometrik kemi marrë si variabël kryesore të pavarur (kreditë jo-performuese) dhe variabla tjera të pavarura si PBB-ja, IÇK-ja dhe depozitat, një faktor tjetër shumë i rëndësishem makroekomik që ndikon në nivelin e kredive jo-performuese është edhe papunësia. Prandaj, ky faktor është vendosor si variabël ekzogjene që shkakton problemin e endogjinitetit në këtë model ekonometrik.

Nëpërmjet këtij modeli ekonometrik ne do të përpiqemi tëvërtetojmë hipotezën nëse politikat e menaxhimit me efikasitet të kredive të këqija kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë. Nëpërmjet rezultateve të paraqitura në tabelën 6.18. mund të konkludojmë që të gjitha variablat e pavarura kanë rëndësi stastisikore në tri nivele të ndryshme (1, 5 dhe 10%) dhe ndikojnë në kreditimin e sektorit real të ekonomisë. Interpretimi i rezultateve do të bëhet nëpërmjet modelit GMM, për shkak sepse nëpërmjet këtij testi statisikor sqarohet edhe problemi i endogjinitetit për shkak të ndikimit të papunësisë në nivelin e kredive jo-performuese.

Cili është efeti i kredive jo-performuese në aktivitetin kreditues të bankave komerciale ndaj sektorit real të ekonomisë? Kreditë jo-performuese janë nivelin signifikant (0.000) dhe nëse kemi rritje të kredive jo-performuese për 1%, atëherë kjo do të shkaktojë rënie të kreditimit për -2.29%. Një rezultat i tillë është në përputhje me studimet e autorëve Cucinelli (2015), Vogiazas & Nikolaidou (2011), Laeven & Majnoni (2003), Messai & Jouini (2013), Ladime et al., (2013) etj. Vlera e koeficientit β për variablën e varur është 0.1173, vlerë pozitive, që nënkupton se bankat komerciale në Kosovë nëpërmjet politikave të menaxhimit efikas të kredive të këqija kanë ndikuar në rritjen e kreditimit.

Duke u nisur nga fakti se deri në vitin 2015, shuma e kredive jo-performuese arriti në vlerën 160.2 milion €, ndërsa vlera e kredive të sektorit bankar ishte 1.86 miliard €, vlerë kjo e cila deri në fund të vitit 2018 arriti në vlerën 2.75 miliard €. Në bazë të këtyre të dhënave vërejmë trend pozitiv të rritjes së kredive bankare për sektorin e biznesit, ndërsa vlera e kredive jo-performuese ka rënë në 74.3 milion €. Këto shifra tregojnë se bankat komerciale në Kosovë kanë ndjekur politika shumë efikase në menaxhimin e kredive jo-performuese duke ndikuar që këto kredi të mos jenë problematike për sektorin bankar në Kosovë dhe bankat të kenë provizione të mjaftueshme për humbjet nga kreditë. Në analizën e

trendit linear do të ofrojmë më shumë të dhëna për ndikimin e kredive jo-performuese në rritjen e kreditimit.

Produkti i brendshëm bruto është një nga variablat e tjera të rëndësishme që ndikon në rritjen e aktivitetit kreditues të bankave komerciale, sidomos në dhënien e kredive për biznese. Sipas rezultateve të modelit GMM, produkti i brendshëm bruto nuk është në nivelin e rëndësisë statistikore, por me 4 teste të tjera statistikore kjo variabël është signifikante. Sipas rezultateve të regresionit linear, nëse kemi rritje 1% në vlerën e PBB-së, kjo do të ndikojë në rritjen e kreditimit për 0.10%. Vlera e devijimit standard për këtë ndryshore është 0.0740 dhe varianca e vlerësuesit të këtij parametri është 0.00547. Produkti i brendshëm bruto rezulton të jetë një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e nivelit të kredive jo-performuese, sepse sa më e madhe të jetë vlera e PBB-së aq më shumë do të zvogëlohet niveli i kredive jo-performuese. Prandaj, duke u bazuar në statistikat zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës, vlera e PBB-së në fund të vitit 2018 ka arritur në vlerën 6.76 miliard €, vlerë kjo e cila ka një trend pozitiv të rritjes dhe gjatë kësaj periudhe kohore shoqërohet me një normë të rritjes së kredive për biznese dhe rënie të kredive jo-performuese në nivelin 2.9%.

Faktori i tretë shpjegues që është marrë parasysh në këtë model është inflacioni. Kjo variabël është matur nëpërmjet indeksit të çmimit të konsumatorit për periudhën kohore 2005 – 2018 dhe është koduar në baza mujore. Një rritje e indeksit të çmimit të konsumatorit për 1%, do të ndikojë në rritjen e kreditmit për 2.05%. Lidhja mes këtyre dy variablave është në nivelin standard të signifikancës (0.000) dhe ky rezultat është në përputhje me rezultatet e studimeve të tjera shkencore të realizuara në këtë fushë. Një rritje e nivelit të çmimeve shkakton rritje të kreditimit, rënie të normave të interesit në kredi, rritje të PBB-së dhe rënie të kredive jo-performuese. Kur normat e interesit zvogëlohen, firmat kanë kosto më të ulët për të financuar aktivitet e tyre nëpërmjet kredive, prandaj inflacioni ndikon pozitivisht në rritjen e kreditimit dhe rënien e kredive jo-performuese. Një rezultat i tillë jep një dëshmi tjetër empirike për vërtetimin e hipotezës së dytë.

Njëri nga faktorët specifik bankar që ndikon në nivelin e kredive jo-performuese janë depozitat bankare, si një ndër burimet kryesore për dhënien e kredive bankare. Një rritje prej 1% në nivelin e depozitave bankare do të ndikojë në rritjen e kreditimit për 0.61%. Rritja e depozitave lejon bankat që të kenë më shumë likuiditet dhe të kenë më shumë burime financiare për dhënien e kredive. Në përgjithësi bankat komerciale në Kosovë kanë likuiditet të tepërt, që një pjesë të madhe të depozitave këto banka nuk e japin në formë të kredive bizneseve të ndryshme për shkak se sektori privat i bizneseve vlerësohet

nga këto banka që ka një nivel të lartë të rrezikut kreditor. Në këtë formë, bankat komerciale në Kosovë janë shumë të kujdesshme në përcaktimin e kritereve për dhënien e kredive dhe ky vlerësim shumë rigoroz i bankave ndaj bizneseve ndikon në reduktimin e kredive jo-performuese në vend. Një fakt i tillë mund të vërehet edhe nëse krahasojmë nivelin e kredive të tilla me vendet e rajonit, ku Kosova qëndron shumë më mirë se vendet e tjera të rajonit dhe bankat komerciale aplikojnë kritere shumë më të rrepta ndaj bizneseve në procesin e dhënies së kredive bankare.

Në kuadër të këtij modeli, ne kemi identifikuar problemin e endogjinitetit të variablës së pavarur (kredive jo-performuese) me variablat e tjera ekzogjene të cilat nuk janë të përfshira në model, por që inkorporohen në kuadër të variablës stohastike. Në shumë studime, në kuadër të faktorëve makroekonomik, papunësia është një faktor që ndikon në masë të madhe në nivelin e kredive jo-performuese dhe në mënyrë indirekte prek edhe aktivitetin kreditues të bankave komerciale. Duke e vendosur si variabël endogjene papunësinë, në modelin GMM, arrijmë të sqarojmë edhe ndikimin e papunësisë në aktivitetin kreditues të bankave komerciale. Një rritje e papunësisë për 1% do të ndikojë në rënien e kreditimit ndaj bizneseve për - 2.26%. Ky rezultat ka mbështetje në teorinë ekonomike, sepse rritja e papunësisë shkakton rënie të kreditimit. Por, meqënese vlera e koeficinetit β për variablen e varur (kreditë për biznese) është vlerë pozitive (0.1173) dhe është në nivelin e rëndësisë statistikore (10%), atëherë rënia e papunësisë ka ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit.

Figura 6. 14. *Paraqitja grafike e lidhjes lineare në mes kredive, papunësisë dhe kredive jo-performuese*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Stata

Në figurën e mësipërme është paraqitur grafikisht lidhja lineare mes kredive bankare dhe normës së papunësisë si dhe kredive jo-performuese me normën e papunësisë. Siç vërehet në mes kredive bankare dhe papunësisë kemi lidhje lineare negative, gjë e cila nënkupton se rënia e papunësisë ka shkaktuar

rritje të kreditimit, ndërsa mes kredive jo-performuese dhe normës së papunësisë kemi lidhje lineare po ashtu negative, ku rënia e papunësisë në Kosovë nga 41.4% sa ishte në vitin 2005, ka rënë në 30.7% në vitin 2018, duke shkaktuar edhe rënie të nivelit të kredive jo-performuese nga 8.20% në vitin 2014 në 2.9% në fund të vitit 2018.

Të gjitha këto rezultate ekonometrike na japin dëshmi empirike për vërtetimin e hipotezës së dytë, se bankat komerciale në Kosovë kanë arritur të ndjekin politikë efikase në menaxhimin e kredive jo-performuese, duke arritur që të gjithë faktorët makroekonomik dhe specifik bankar, që përcaktojnë nivelin e kredive jo-performuese, të ndikojnë pozitivisht në rritjen e kreditimit. Meqenëse prej vitit 2014, kemi rënie të vazhdueshme të kredive jo-performuese, në Kosovë janë ndërmarrë reforma të ndryshme financiare të cilat kanë ndikuar në reduktimin e këtyre kredive.

6.5. Analiza e trendit linear në mes vëllimit të kredive dhe faktorëve të tjerë determinues

Për ti dhënë më shumë mbështetje rezultateve empirike nëpërmjet modeleve ekonometrike, vërtetimit të hipotezës së dytë po ia bashkangjitim analizën e trendit linear në mes vëllimit të kredive për biznese dhe ndryshoreve të tjera të pavarura, të cilat janë përfshirë në këtë analizë empirike. Qëllimi kryesor i përdorimit të analizës së trendit linear, do të jetë krahasimi i të dhënave ndër vite për secilën variabël si dhe nxjerrja e konkluzioneve të rëndësishme, që do ti shërbejnë objektivave të këtij punimi. Të dhënat për këto analiza të trendit linear janë marrë nga raportet financiare vjetore të Bankës Qendrore të Kosovës, Shoqatës së Bankave të Kosovës, Bankës Botërore dhe raporteve vjetore të Agjensisë së Statistikave të Kosovës.

Këto të dhëna janë të raportuara në baza vjetore, të përpunuara në programin Microsoft Excel dhe përfshinë periudhën kohore 2005 – 2018. Fillimisht do të analizojmë trendin linear mes kredive jo-performuese dhe vëllimit të kredive, për të identifikuar ndikimin e këtyre kredive në aktivitetin kreditor të bankave komerciale.

Duke u bazuar në rezultatet e modeleve ekonometrike, është gjetur se rritja e kredive jo-performuese për 1% do të shkaktojë rënien e vëllimit të kreditimit për 2.29%. Për të parë efektin e këtyre kredive, në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura rezultatet e analizës së trendit linear për kreditë jo-performuese dhe vëllimin e kredive.

Tabela 6. 19. *Rezultatet e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive për biznese dhe kredive jo-performuese*

Viti	Vëllimi i kredive (mil. €)	KJP (mil. €)	Trendi
2005	513.9	17.2	376.6
2006	636.565	23.426	446.8
2007	892.1	31.3	517.0
2008	1,183.4	46.9	587.2
2009	1,289.0	57.7	657.4
2010	1,458.6	82.1	727.5
2011	1698.078	110.375	797.7
2012	1,763.4	130.8	867.9
2013	1,805.8	147.2	938.1
2014	1,882.2	156.2	1008.3
2015	2,019.3	125.2	1078.4
2016	2,230.0	109.3	1148.6
2017	2485.533	84.508	1218.8
2018	2755.473	74.398	1289.0

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Sipas rezultateve në tabelën 6.19. mund të vërejmë që gjatë këtyre viteve kemi pasur një trend të rritjes së kredive jo-performuese nga viti 2005 deri në vitin 2014. Këto kredi gjatë kësaj periudhe kohore janë rritur nga vlera 17.2 milion € në 156.2 milion €, ndërsa nga viti 2014 deri në vitin 2018, kemi një rënie drastike të nivelit të kredive jo-performuese, nga vlera 156.2 milion € në 74.3 milion €. Vëllimi i kredive për biznese gjatë gjithë kësaj periudhe ka shënuar rritje nga 513.9 milion € në 2.75 miliard €. Në bazë të këtyre vlerave mund të vërejmë që gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur menaxhim efektiv të këtyre kredive jo-performuese, sepse pavarësisht trendit rritës të këtyre kredive deri në vitin 2014, përsëri vëllimi i kredive ka shënuar rritje të vazhdueshme.

Figura 6. 15. *Paraqitja grafike e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive dhe kredive jo-performuese*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Në vitin 2014, sektori bankar i Kosovës u karakterizua me një trend rënës të kredive jo-performuese, duke realizuar disa reforma të rëndësishme institucionale që kanë ndikuar në menaxhimin efikas të kredive jo-performuese. Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e analizës së trendit linear, kreditë jo-performuese në përgjithësi kanë qenë të menaxhuara në mënyrë efikase dhe kjo ka bërë që vëllimi i kredive për biznese të ketë rritje të vazhdueshme të. Vlera e trendit mesatar kumulativ mes këtyre dy variablave është 832.8 milion € dhe koeficienti i përcaktimit është shumë i lartë 97.61%, që tregon se për këtë vlerë kreditë jo-performuese e shpjegojnë vëllimin e kredive për biznese. Por, parashtrohet pyetja: cili është faktori kryesor që ka ndikuar në rënien e nivelit të kredive jo-performuese nga viti 2014 në vitin 2018 në 2.9%?

Pikërisht, me 31 janar 2013, hyri në fuqi ligji për themelimin dhe funksionalizimin e institucioneve të përmbaruesve privat, të cilëve iu besohen dhe iu delegohen autorizime publike të cilat ata do t'i kryejnë në shërbim të palëve, përkatësisht kreditorëve. Këta përmbarues privat filluan të ushtrojnë aktivitetin e tyre në vitin 2014 dhe inspektohen dhe mbikqyren nga Ministria e Drejtësisë dhe Oda e Përmbaruesve Privat. Me një reformë të tillë në sistemin e drejtësisë, është bërë një hap i madh, sepse këta përmbarues privatë kanë ndihmuar shumë edhe bankat komerciale në menaxhimin e kredive jo-performuese me një efikasitet të lartë. Në vazhdim do të japim disa statistika zyrtare të cilat dëshmojnë se një pjesë e madhe e kredive jo-performuese janë rikthyer nga çështjet e zgjidhura nga përmbaruesit privatë.

Në vitin 2014, shuma e kredive jo-performuese ishte 156.2 milion € dhe gjatë këtij viti, përmbaruesit privatë kishin arritur të iu rikthejnë kreditorëve 8.9 milion € kredi të këqija. Ndërsa në vitin 2015, janë rikthyer 54.4 milion € kredi jo-perfomuese nga shuma totale e tyre në vlerë prej 125.2 milion €. Në vitin 2016, shuma totale e kredive jo-performuese në sektorin bankar në Kosovë ishte 109.3 milion € dhe nga kjo shumë përmbaruesit privatë kanë arritur t'i rikthejnë 39.7 milion €. Pra, gjatë kësaj periudhe kohore, përmbaruesit privatë kanë rikthyer 108.12 milion € kredi të këqija. Në bazë të këtyre vlerave, që janë marrë nga raportet vjetore të Odës së Përmbaruesve Privatë, mund të vërejmë që kjo është një nga reformat mjaft të rëndësishme institucionale që i ka ndihmuar bankat komerciale të menaxhojnë më sukses kreditë e këqija në sistemin bankar në Kosovë.

Në vazhdim të analizës së trendit linear do të paraqesim rezultatet e kësaj analize mes produktit të brendshëm bruto dhe vëllimit të kredive. Sipas rezultateve ekonometrike, rritja e PBB-së do të ndikojëpozitivisht në rritjen e vëllimit të kredive dhe në rënien e nivelit të kredive jo-performuese.

Tabela 6. 20. *Rezultatet e analizës së trendit linear mes vëllimit të kredive për biznese dhe PBB-së*

Viti	Vëllimi i kredive (mil. €)	PBB-ja (mil. €)	Trendi
2005	513.9	3068.4	1533.2
2006	636.6	3191.7	1781.6
2007	892.1	3315.8	2029.9
2008	1,183.4	3628.1	2278.3
2009	1,289.0	3962.7	2526.7
2010	1,458.6	4402.0	2775.1
2011	1,698.1	4814.5	3023.5
2012	1,763.4	5059.0	3271.9
2013	1,805.8	5326.7	3520.3
2014	1,882.2	5567.5	3768.7
2015	2,019.3	5807.0	4017.0
2016	2,230.0	6070.2	4265.4
2017	2,485.5	6282.1	4513.8
2018	2,755.5	6764.9	4762.2

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Ekziston një trend pozitiv rritës mes PBB-së dhe vëllimit të kredive për biznese. Gjatë kësaj periudhe kohore 2005 – 2018, vlera e trendit mesatar kumulativ mes këtyre dy variablave është 3.14 miliard €. Ky ndikim pozitiv i PBB-së në rritjen e vëllimit të kredive, mbështetet në teori sepse në periudha të rritjes ekonomike, kur kemi rritje të sasisë së parasë në qarkullim, atëherë kjo shoqërohet edhe me një rritje të vëllimit të kredive. Vlera e PBB-së në vitin 2005 ishte 3.06 miliard €, vlerë kjo e cila në vitin 2018 ka arritur në 6.76 miliard €. Gjatë kësaj periudhe kohore rritja e PBB-së është shoqëruar me rritje në vëllimin e kredive, por edhe me rënie të kredive jo-performuese.

Vlera e koeficientit të përcaktimit në këtë rast është 97.61%, që tregon një vlerë shumë të lartë të lidhjes lineare mes produktit të brendshëm bruto dhe vëllimit të kredive për biznese. Kur rriten të ardhurat për kokë banori, një pjesë e madhe e ekonomive familjare depozitojnë kursimet e tyre me norma interesi më të larta në depozita, dhe kjo shkakton që të rriten depozitat, si një indikator tjetër i rëndësishem i vëllimit të kredive. Produkti i brendshëm bruto ka efekte pozitive edhe në rënien e kredive jo-performuese, sepse rritja e të ardhurave ju mundëson shumë huamarrësve që të kenë të ardhura të mjaftueshme për të kthyer borxhet e tyre të këqija. Nëse parashikojmë një projeksion në tri vitet e ardhshme, mund të shohim që vëllimi i kredive do të rritet 3.10 miliard €.

Figura 6. 16. *Paraqitja grafike e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive dhe PBB-së*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Rritja e vazhdueshme e indeksit të çmimit të konsumatorit do të ndikojë në rritjen e vëllimit të kredive. Një efekt i tillë vërehet edhe për rastin e Kosovës gjatë kësaj periudhe kohore 2005 – 2018, ku rritja e normës së inflacionit ka shkaktuar rritjen e vazhdueshme të vëllimit të kredive, si për biznese ashtu edhe për ekonomitë familjare. Rritja e çmimeve shkakton rritjen e pagave dhe shpenzimeve, dhe trendi i tillë ndikon në rritjen e bazës monetare dhe si rezultat i kësaj kërkohen më shumë kredi, pra rritet kërkesa për fonde.

Tabela 6. 21. *Rezultatet e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive për biznese dhe IÇK-së*

Viti	Vëllimi i kredive (mil. €)	IÇK-ja	Trendi
2005	513.9	77.1	397.8
2006	636.6	77.6	465.4
2007	892.1	81.0	533.0
2008	1,183.4	88.6	600.6
2009	1,289.0	86.4	668.2
2010	1,458.6	89.4	735.8
2011	1,698.1	96.0	803.3
2012	1,763.4	98.4	870.9
2013	1,805.8	100.1	938.5
2014	1,882.2	100.5	1006.1
2015	2,019.3	100.0	1073.7
2016	2,230.0	100.3	1141.3
2017	2,485.5	101.8	1208.9
2018	2,755.5	102.8	1276.5

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Rezultatet e analizës së trendit linear konsistojnë të njejta me rezultatet e modeleve ekonometrike, duke konkluduar që rritja e inflacionit ka shkaktuar rritje të vëllimit të kredive për biznese. Vlera e indeksit të çmimit të konsumatorit në vitin 2005 ishte 77.5, vlerë kjo e cila në vitin 2018 kishte arritur në 102.8 dhe në bazë të kësaj rritje të vazhdueshme të këtij indeksi është rritur vëllimi i kredive.

Trendi mesatar kumulativ i vëllimit të kredive për biznese dhe normës së inflacionit është 837.1, kjo vlerë tregon tred rritës mes vlerave të kredisë dhe inflacionit. *Por, parashtrohet pyetja, pse ndodh një fenomen i tillë në aktivitetin kreditues të bankave kur rritet norma e inflacionit?* Është i ditur fakti që rritja e vazhdueshme e inflacionit, shkakton rënie të normave të interesit dhe si rezultat i kësaj rritet kërkesa për kredi. Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e analizës së trendit, nga viti 2010 kemi rritje të nivelit të çmimeve që ka shkaktuar edhe rritjen e vëllimit të kredive.

Figura 6. 17. *Paraqitja grafike e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive dhe IÇK-së*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Vlera e koeficientit të përcaktimit për inflacionin dhe vëllimin e kredive, edhe këtu tregon një vlerë shumë të lartë prej 97.61%. Ndikimi shumë i madh i normës së inflacionit në vëllimin e kredive, shpjegohet për vet faktin se rritja e normës së inflacionit shkakton rënie e normave të interesit për kredi dhe si rezultat i kësaj bizneset kërkojnë më shumë fonde financiare nëpërmjet kredive. Rënia e normave të interesit në kredi nga 15.71% sa ishin në vitin 2010 në 5.99% në vitin 2018, shpjegohet edhe nga fakti se vlera mesatare e indeksit të çmimit të konsumatorit ka shënuar rritje nga 89.4 sa ishte në vitin 2010 në 102.8 në vitin 2018. Pra, ndikimi i inflacionit në rënien e normave të interesit për kredi është një faktor tjetër shumë i rëndësishem në rritjen e vëllimit të kredive për sektorin real të ekonomisë, e në veçanti për bizneset e vogla dhe të mesme.

Njëra nga variablat e tjera të rëndësishme që është marrë parasysh në këtë analizë është vëllimi i depozitave në sektorin bankar në Kosovë. Kjo ndryshore kategrizohet në grupin e faktorëve specifik bankarë që ndikojnë në vëllimin e kredive për biznese dhe duke u bazuar në rezultatet e modeleve ekonometrike, vërejmë që rritja e nivelit të depozitave do të shkaktojë efekte pozitive në rritjen e vëllimit të kredive për sektorin real të ekonomisë.

Të dhënat në tabelën e mëposhtme tregojnë trendin pozitiv të rritjes së depozitave në raport me kreditë për biznese.

Tabela 6. 22. *Rezultatet e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive për biznese dhe nivelit të depozitave*

Viti	Vëllimi i kredive (mil. €)	Depozitat (mil. €)	Trendi
2005	513.9	815.3	647.7
2006	636.6	902.4	820.0
2007	892.1	1094.3	992.2
2008	1,183.4	1366.8	1164.4
2009	1,289.0	1639.7	1336.6
2010	1,458.6	1827.7	1508.8
2011	1,698.1	1982.4	1681.1
2012	1,763.4	2162.7	1853.3
2013	1,805.8	2314.0	2025.5
2014	1,882.2	2426.6	2197.7
2015	2,019.3	2579.9	2370.0
2016	2,230.0	2779.5	2542.2
2017	2,485.5	2960.4	2714.4
2018	2,755.5	3221.5	2886.6

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Vlera e depozitave në vitin 2005 ishte 815.3 milion €, vlerë kjo e cila në vitin 2018 kishte arritur në 3.21 miliard euro. Siç vërehet nga tabela e rezultateve, kemi trend rritës pozitiv mes kredive dhe depozitave dhe vlera e trendit mesatar kumulativ i cili është 1.76 miliard €. Rritja e vazhdueshme e nivelit të depozitave ndikon pozitivisht në rritjen e vëllimit të kredive për biznese.

Një nga faktorët mjaft të rëndësishem për vëllimin e depozitave janë normat e interesit në këto depozita, të cilat në Kosovë janë shumë të ulëta në raport me vendet e tjera të rajonit, por edhe kemi një diferencë të madhe mes normave të interesit në kredi dhe atyre në depozita. Nga viti 2005 deri në vitin 2014 sektori bankar i Kosovës është shoqëruar me rritje të ndjeshme të normave të interesit në depozita, por nga viti 2014 kemi pasur prapë rënie të këtyre normave të interesit dhe në fund të vitit 2018 këto norma të interesit janë në nivelin 1.47%.

Vlen të theksohet se ndikimi i depozitave në nivelin e kredive jo-performuese është faktor specifik bankar që e përcakton edhe nivelin e këtyre kredive. Rritja e depozitave ndikon pozitivisht në rritjen e kredive jo-performuese, sepse bankat kur kanë nivel më të lartë të depozitave dhe kanë më shumë likuiditet, atëherë ato kanë më shumë burime për dhënien e kredive. Por, pavarsisht trendit pozitiv të rritjes së depozitave dhe likuiditetit të tepërt, bankat komerciale në Kosovë janë shumë të kujdesshme në miratimin e kredive, përcaktimin e kritereve për dhënien e kredive dhe aplikimin e masave të nevojshme për menaxhimin efikas të këtyre kredive.

Figura 6. 18. *Paraqitja grafike e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive dhe depozitave*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Në kuadër të faktorëve të rëndësishem që ndikojnë në nivelin e kredive jo-performuese është edhe papunësia, e cila në modelin ekonometrik nëpërmjet metodës GMM është vendosur si variabël endogjene që ndikon në kreditë jo-performuese. Rezultatet e kësaj analize vlerësojnë se rritja e papunësisë shkakton rënien e vëllimit të kredive për biznese dhe rritjen e nivelit të kredive jo-performuese. Kur ekonomia e një vendi është e shoqëruar me rritje të vazhdueshme të normës së papunësisë, atëherë efektet janë shumë negative, për shkak se pjesa më e madhe e huamarrësve të cilët kanë marrë kredi, nuk mund të kthejnë borxhin e tyre ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare. Një fenomen i tillë shkakton probleme të mëdha dhe ka efekt domino edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë dhe sistemit financiar të një vendi.

Tabela 6. 23. *Rezultatet e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive për biznese dhe normës së papunësisë*

Viti	Vëllimi i kredive (mil. €)	Papunësia (%)	Trendi
2005	513.9	41.4%	363.5
2006	636.6	44.9%	429.3

2007	892.1	43.6%	495.1
2008	1,183.4	47.5%	560.9
2009	1,289.0	45.4%	626.8
2010	1,458.6	42.1%	692.6
2011	1,698.1	38.2%	758.4
2012	1,763.4	30.9%	824.3
2013	1,805.8	30.0%	890.1
2014	1,882.2	35.3%	955.9
2015	2,019.3	32.9%	1021.7
2016	2,230.0	27.5%	1087.6
2017	2,485.5	30.5%	1153.4
2018	2,755.5	30.7%	1219.2

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Nga viti 2005 deri në vitin 2008 norma e papunësisë në Kosovë ka qenë shumë e lartë dhe kjo ishte si rezultat i një periudhe të vështirë për Kosovën, sidomos në vitet e para pas luftës dhe në kohën kur ende nuk ishte shtet i pavarur. Në vitin 2008, Kosova ishte një ndër vendet me normën më të lartë të papunësisë në rajon dhe kjo normë arriti në 47.5%. Pikërisht, kur në vitin 2008, Kosova ishte shtet i pavarur, një nga sfidat më të mëdha të qeverisë së atëhershme të vendit ishte shkalla shumë e lartë e papunësisë në vend. Nga viti 2008 deri në vitin 2018, kemi pasur rënie të papunësisë në vend nga norma 47.5% në 30.7%. Kjo rënie e normës së papunësisë ka ndikuar pozitivisht edhe në rritjen e vëllimit të kredive për sektorin real. Në bazë të këtyre të dhënave, mund të konkludojmë që rënia e papunësisë në vend ka shkaktuar rritje të vëllimit të kredive, sidomos në rritjen e kredive të konsumit, por fokusi i analizës tonë janë kreditë e bizneseve.

Figura 6. 19. *Paraqitja grafike e analizës së trendit linear në mes vëllimit të kredive dhe normës së papunësisë*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Vlera e trendit mesatar kumulativ për vëllimin e kredive dhe normën e papunësisë është 791.3, gjë e cila nënkupton se gjatë këtyre viteve rënia e papunësisë ka shkaktuar rritjen e vëllimit të kredive. Si faktor i rëndësishëm makroekonomik, papunësia ka ndikim të madh edhe në nivelin e kredive jo-performuese. Ulja e papunësisë në Kosovë nga viti 2008 deri në vitin 2018 për 16.8%, ka shkaktuar edhe rënie të kredive jo-performuese për -5.42%. Të gjitha këto të dhëna janë pozitive për sektorin bankar të Kosovës dhe rritjen e vëllimit të kredive.

Prandaj, në bazë të analizave të trendit mund të konkludojmë që politikat e menaxhimit me efikasitet të kredive të këqija kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kredimit ndaj sektorit real të ekonomisë së Kosovës. Në bazë të rezultateve nga modelet ekonometrike dhe nga analizat e trendit, niveli i këtyre kredive jo-performuese nuk ka pasur efekte negative në performancën e sektorit bankar dhe trendi është pozitiv sa i përket aktivitetit kreditor të bankave.

Në këtë analizë janë shpjeguar edhe disa faktorë të tjerë përcaktues të kredive jo-performuese, në mënyrë që të shohim se si kanë ndikuar në përcaktimin e këtyre kredive dhe çfarë efekti kanë pasur në aktivitetin kreditor të bankave komerciale. Prandaj, rezulton që rritja e PBB-së, norma e inflacionit, rënia e normës së papunësisë dhe rritja e nivelit të depozitave janë faktorë të rëndësishem në menaxhimin e kredive jo-performuese nga ana e bankave komerciale si dhe kanë pasur ndikim të rëndësishem edhe në rritjen e vëllimit të kredive për biznese.

6.6. Përshkrimi i variablave dhe specifikimi i modelit ekonometrik për hipotezën e tretë

Hipoteza e tretë e këtij studimi ka për qëllim të tregojë nëse krijimi i fondit për garanci kreditore në Kosovë ka ndikuar në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë dhe zvogëlimin e riskut kreditor. Krijimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në vitin 2015 dhe fillimi i funksionimit të këtij fondi në shtator të vitit 2016, mbetet njëra ndër reformat mjaft të rëndësishme financiare në sektorin bankar, që e ka lehtësuar procesin e dhënies së kredive për biznese, menaxhimin e riskut kreditor si edhe qasjen e bizneseve në kreditë e bankave komerciale.

Autorë të ndryshem si Saadani & Arvai & Rocha (2011), Lapachi & Ormotsadze (2012), Chatzouz & Gereben & Land & Torfs (2017), Csubak (2014), Bennett & Doran (2005) dhe disa autorë të tjerë e kanë analizuar efektin e krijimit të skemave për garanci kreditore në rritjen e kreditimit dhe menaxhimin e riskut kreditor në sektorët bankarë të vendeve të ndryshme. Qëllimi kryesor i krijimit të skemave të

tilla është që të ndihmojë sektorin e bizneseve të vogla dhe të mesme që të kenë akses më të madh në kreditë e institucioneve financiare si dhe ndihmojë këto të fundit, që në rast të dështimit të huamarrësit është shteti ai që paguan një pjesë të borxhit në emër të huamarrësit.

Parimi i njejtë është edhe funksion i Fondit Kosovar për Garanci Kreditor, që është krijuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ku firmat të cilat kategorizohen si të përshtatshme për të marrë garanci kreditore nga ky fond, shuma e garantimit do të jetë deri në 50% të vlerës së kredisë. Qëllimi kryesor i funksionimit të një fondi të tillë është që të ndihmojë bizneset kosovare që kanë probleme me financa dhe kanë vështirësi në plotësimin e kritereve të përcaktuara nga bankat komerciale për të marrë kredi bankare.

Hipoteza e tretë e këtij studimi është:

Krijimi i fondit për garanci kreditore ka zvogëluar riskun kreditor dhe ka rritur kreditimin e bankave komerciale ndaj sektorit real të ekonomisë.

Për vërtetimin e kësaj hipoteze janë aplikuar metodat kuantitative nëpërmjet të dhënave sekondare në raportet vjetore të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Bankës Qendrore të Kosovës dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës. Të dhënat për testimin e kësaj hipoteze përfshijnë një periudhë kohore më të kufizuar në krahasim me analizat e tjera të cilat janë realizuar në kuadër të këtij studimi. Periudha kohore e analizuar është shtator 2016 – nëntor 2018, arsyeja është sepse Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është themeluar nga Qeveria e Kosovës me ligj të veçantë në fund të vitit 2015 dhe ka filluar aktivitetin e saj në shtator të vitit 2016.

Prandaj, për të parë efektet e një skeme të tillë në kreditimin e sektorit real dhe menaxhimin e riskut kreditor të bankave komerciale, edhe ne jemi bazuar në të dhënat e raportuara për këtë periudhë kohore. Ky fakt paraqet një kufizim për këtë analizë empirike, në aspektin kohor të mbledhjes së të dhënave, por gjithsesi përpos modeleve ekonometrike, ne do të aplikojmë edhe analizat e trendeve lineare për të ndërtuar projeksione për pesë vitet e ardhshme në mënyrë që të shohim se si do të ndikojnë garancitë kreditore në vëllimin e kredive për biznese dhe menaxhimin e riskut kreditor.

Studimet e deritanishme në këtë fushë dëshmojnë se skema të tilla të garancive kreditore kanë efekt pozitiv në rritjen e kreditimit dhe zvogëlimin e riskut kreditor. Të dhënat e raportuara për analizën empirike janë të raportuara në baza mujore dhe përfshijnë një periudhë tre vjeçare. Këto të dhëna janë të

përpunuara në programin Stata dhe për testimin e kësaj hipoteze është përdorur analizën e regresionit të thjeshtë standard, analiza e variancës nëpërmjet T – testi dhe racio testi.

Tabela 6. 24. *Përshkrimi i variablave për modelin ekonometrik të hipotezës së tretë*

Variabla	Përshkimi i variablës	Burimi i të dhënave
Variabla e parë e varur	Shuma e kredive bankare (KB)	Raportet e Stabilitetit Financiar 2016 – 2018 (Banka Qëndrore e Kosovës) dhe raportet vjetore të Shoqatës së Bankave të Kosovës
Variabla e dytë e varur	Kreditë jo – performuese (KJP)	Raportet e Stabilitetit Financiar 2016 – 2018 (Banka Qëndrore e Kosovës) dhe raportet vjetore të Shoqatës së Bankave të Kosovës
Variabla e pavarur	Garancitë kreditore (GK)	Statistikat mujore të kredive (Fondi Kosovar për Garanci Kreditore)

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në tabelën e mësipërme janë të paraqitura variablat të cilat do të përdoren për testimin e hipotezës së tretë të këtij studimi. Për të vërtetuar nëse krijimi i fondit për garanci kreditore ka ndikuar në rritjen e kreditimit për sekotrin real të ekonomisë dhe zvoglimin e riskut kreditor, ne së pari do të analizojmë efektin e këtyre garancive kreditore në vëllimin e kredive për biznese, pastaj ndikimin e këtyre garancive kreditore në nivelin e kredive jo-performuese gjatë peeriudhës kohore shtator 2016 – dhjetor 2018.

6.7. Ndikimi i garancive kreditore në rritjen e vëllimit të kredive ndaj sektorit real të ekonomisë së Kosovës

Fillimisht në këtë analizë do të paraqesim statistikat deskriptive dhe shpërndarjen normale për variablat që janë përfshirë në këtë model ekonometrik, analizën e korrelacionit, regresionin linear, analizën e variancës nëpërmjet racio testit dhe T- testit si dhe analizën e trendit linear.

Në tabelën 6.25 janë të paraqitura statistikat deskriptive për variablën e varur (shuma e kredive) dhe variablën e pavarur (garancitë kreditore). Në kuadër të statistikave deskriptive do të analizojmë vlerën minimale dhe maksimale, mesataren, devijimin standard dhe variancën.

Tabela 6. 25. *Statistikat deskriptive për shumën e kredive bankare dhe garancive kreditore*

Variablat	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Variance
KB	28	2184.5	2755.5	2455.711	180.7178	32658.93
GK	28	187.5	41665.72	15167.12	12439.46	1.55e+08

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Stata

Sipas të dhënave në tabelën e statistikave deskriptive, vlera minimale e kredive bankare në shtator të vitit 2016 ishte 2.18 miliard €, ndërsa kjo vlerë në fund të vitit 2018 arriti në 2.75 miliard €. Vlera mesatare e kredive është 2455.71 me një devijim standard prej 180.71. Duke u bazuar edhe në rezultatet e analizave paraprake, gjatë kësaj periudhe kohore është vërejtur trend pozitiv në rritjen e vëllimit të kredive për biznese të dhëna nga sektori bankar në Kosovë. Por, vlera minimale e garancive kreditore në shtator të vitit 2016 ishte 187,500 €, vlerë kjo e cila në fund të vitit 2018 arriti në 41.66 milion €.

Gjatë periudhës 2016 – 2018, kemi pasur rritje të ndjeshme të shumës së garancive kreditore, gjë që ka ndikuar pozitivisht edhe në rritjen e kreditimit të bankave ndaj sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Në figurën e mëposhtme është paraqitur shpërndarja normale e variablave të përfshira në këtë analizë empirike.

Figura 6. 20. *Shpërndarja normale e shumës së kredive dhe garancive kreditore*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Stata

Figura e mësipërme na tregon që të dy variablat e përfshira në këtë analizë kanë shpërndarje normale të të dhënave dhe kanë lidhje lineare me njëra-tjetrën. Ky fakt verifikohet sepse në të dy grafikët, pikat janë të vendosura shumë afër vijës së regresit që nënkupton se vlerat e X dhe Y janë të sakta, përpos disa devijimeve të caktuara të cilat bëjnë pjesë në variablën stohastike. Forma e ekuacionit të përgjithshëm për testimin e hipotezës së tretë është si vijon:

$$Y = b_0 + b_1X_1 + e$$

Ku:

Y – shuma e kredive bankare (variabla e varur)

b_0 dhe b_1– koeficienti i parametrave të modelit

X_1 – garancitë kreditore (variabla e pavarur) dhe

e – variabla stohastike

Pas specifikimit të këtij modeli ekonometrik dhe sqarimit të variablave të inkorporuara në të, ky model merr këtë formë:

$$KB = b_0 + b_1\ GK + e$$

Tabela 6. 26. *Rezultatet e analizës së regresionit standard linear për ndikimin e garancive kreditore në vëllimin e kredive*

KB	Coef.	Std. Error	t	P > |t|	95% Conf. Interval	95% Conf. Interval
GK	0.0141763	0.0006229	22.76	0.000	0.012896	0.0154567
_cons	2240.696	12.13042	184.72	0.000	2215.762	2265.631

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Stata

$$KB = 2240.696 + 0.0141763\ GK + 0.0478$$

Sipas këtyre rezultateve vërehet që krijimi i fondit për garanci kreditore ka ndikuar pozitivisht në rritjen e vëllimit të kredive për sektorin real të ekonomisë. Vlera e koeficientit të përcaktimit në këtë rast është 95.22%, që tregon se për këtë vlerë, variabla e pavarur e shpjegon variablën e varur. Ndërsa koeficienti i korrelacionit ka vlerën 0.9758, që tregon një lidhje shumë të fortë lineare në mes shumës së kredive bankare dhe garancive kreditore. Nëse garancitë kreditore janë zero (konstante), atëherë shuma e kredive bankare do të jetë 2.24 miliard €, duke pasur parasysh se ky pohim ka rëndësi statistikore sepse gjendet në nivelin standard të signifikancës. Nëse kemi rritje për 1 njësi të garancive kreditore, kjo do të ndikojë në rritjen e shumës së kredive për 0.14%.

Vlera e termit të gabimit në këtë rast është 0.0478, ndërsa gabimi standard për parametrin b_0 është 12.13042 dhe për parametrin b_1 = 0.0006229. Varianca e vlerësuesit të parametrit $b_0 = 12.13042^2 = 147.1$, ndërsa varianca për vlerësuesin e parametrit $b_1 = 0.0006229^2 = 0.388^{-06}$. Sipas këtyre rezultateve, vërtetohet hipoteza alternative që krijimi i fondit për garanci kreditore ka ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë.

Në vazhdim të kësaj analize do të paraqesim rezultatet e analizës së variancës nëpërmjet racio testit. Meqënese numri i observimeve është 28, është e preferueshme që të përdoret analiza e variancës nëpërmjet racio testit dhe t-testit. Për të vërtetuar, nëse krijimi i fondit për garanci kreditore ka ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit, nëpërmjet kësaj analize ne ndërtojmë dy hipoteza:

Hipoteza bazë: *Nëse vlera e racio testit është e barabartë me 1, garancitë kreditore nuk kanë ndikuar në rritjen e kreditimit.*

Hipoteza alternative: *Nëse vlera e racio testit është e vogël se 1, garancitë kreditore kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit.*

Tabela 6. 27. *Rezultatet e analizës së variancës (Racio Test) për ndikimin e garancive kreditore në vëllimin e kredive*

Variablat	Obs.	Mean	Std. Error	Std. Dev.	95% Conf. Interval	95% Conf. Interval
KB	28	2455.711	34.15246	180.7178	2385.636	2525.786
GK	28	15167.12	2530.837	12439.46	10343.6	19990.64
combined	56	8811.416	1446.108	10821.68	5913.35	11709.48
Ratio Test	Ratio = sd (KB) / sd (GK) = 0.0002 H_0 : ratio = 1 H_a : ratio < 1					

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Stata

Duke u bazuar në vlerën e racio testit që është 0.0002 e cila është vlerë më e vogël se 1, atëherë pranohet hipoteza alternative, se garancitë kreditore kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë së Kosovës. Ky rezultat është në përputhje me studimet e shumë autorëve të tjerë të cilët kanë identifikuar se krijimi i skemave të tilla për garanci kreditore e lehtëson qasjen në financa dhe ndikon në rritjen e vëllimit të kredive.

Për ti dhënë më shumë mbështetje vërtetimit të hipotezës së tretë, ne do të përdorim edhe analizën e variancës së dyanshme nëpërmjet t-testit. Duke u nisur nga parimi i njejtë si tek racio testi, edhe varianca e dyanshme,T-testi vertëton se hipoteza alternative është e saktë, atëherë kur vlera faktike e t-testit është më e vogël se zero.

Hipoteza bazë: *Nëse vlera faktike e t-testit është e barabartë me 0, garancitë kreditore nuk kanë ndikuar në rritjen e kreditimit.*

Hipoteza alternative: *Nëse vlera faktike e t-testit është e vogël me 0, garancitë kreditore kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit.*

Tabela 6. 28. *Rezultatet e analizës së variancës (T-Test) për ndikimin e garancive kreditore në vëllimin e kredive*

Variablat	Obs.	Mean	Std. Error	Std. Dev.	95% Conf. Interval	95% Conf. Interval
KB	28	2455.711	34.15246	180.7178	2385.636	2525.786
GK	28	15167.12	2530.837	12439.46	10343.6	19990.64
combined	56	8811.416	1446.108	10821.68	5913.35	11709.48
diff	-	-12711.41	2351.085	-	-17425.05	-7997.769
T - Test	Diff = mean (KB) - mean (GK) = -5.4066 H_0 : diff = 0 H_a : diff < 0					

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Stata

Në bazë të kësaj analize, rezulton që vlera faktike e t-testit është një vlerë më e vogël se zero, prandaj hipoteza bazë refuzohet dhe hipoteza alternative pranohet, se garancitë kreditore kanë ndikuar pozitvisht në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekokonomisë. Për të testuar hipotezën e tretë, në vazhdim të këtij kapitulli do të analizojmë të dhënat e variablave nëpërmjet analizës së trendeve.

Fillimisht do të analizojmë të dhënat në baza mujore për vitin 2016, për të parë trendin e kredive dhe garancive kreditore, pastaj do të vazhdojmë analizën për vitin 2017 dhe 2018, si dhe projeksionet për pesë vitet e ardhshme. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura shuma e garancive aktive të cilat janë dhënë nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore. Siç mund të vërehet në periudhën fillestare, fondi ka filluar të garantojë vetëm një numër të vogël të kredive bankare, për shkak të kapitalit të vogël fillestar që e kishte në vitin 2016.

Tabela 6. 29. *Rezultatet e analizës së trendit për kreditë totale dhe garancitë kreditore në vitin 2016*

Muaji	Viti	Kreditë Totale (mil. €)	Garancitë Kreditore (mil. €)	Trendi
Shtator	2016	2184.5	187.50	1011.65
Tetor	2016	2197.4	980.00	1422.79
Nëntor	2016	2212.3	1,723.50	1833.93
Dhjetor	2016	2230	2,133.95	2245.06

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Në shtator të vitit 2016, vlera e garancive kreditore ishte 187,000 €, vlerë kjo e cila në fund të këtij viti arriti në 2.13 milion €. Gjatë kësaj periudhe kohore, kreditë e bizneseve u rritën nga vlera 2.18 miliard € në 2.23 miliard €. Nëpërmjet këtyre të dhënave vërehet trend pozitiv i rritjes së vëllimit të kredive për biznese, duke identifikuar faktin se krijimi i fondit për garanci kreditore është duke ndikuar pozitivisht në kreditimin e sektorit real të ekonomisë. Vlera e trendi mesatar kumulativ për vitin 2016

ishte 1628.36 dhe vlera e koeficientit të përcaktimit në këtë rast është 98.16%, që tregon një vlerë shumë të lartë të këtij koeficienti.

Shuma e aprovuar e kredive nga FKGK-ja në fund të vitit 2016 ishte 4.5 milion €, ndërsa vlera e kredive të disborsuara ishte 4.35 milion €. Gjatë vitit 2016 pjesa më e madhe e garancive kreditore janë destinuar në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë (33%), prodhimtarisë (26%), bujqësisë (14%) dhe sektorëve të tjerë (28%). Shuma totale e garancive kreditore në fund të vitit 2016 ishte 2.13 milion €, ku 583,000 € ishtin të destinuara për prodhimtari dhe pajisje bujqësore, 571,000 € për pajisje, 556,250 € për ndërtim dhe renovim si dhe 423,000 € për të tjera. Siç vërehet edhe nga figura 6.21, garancitë kreditore në Kosovë gjatë vitit 2016 kanë ndikuar në rritjen e vëllimit të kredive për biznese.

Figura 6. 21. *Paraqitja grafike e trendit linear në mes shumës së kredive dhe garancive kreditore*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Në vitin 2017 shuma e garancive kreditore të aprovuara në Kosovë arriti në 14.87 milion, ndërsa vëllimi i kredive për biznese u rrit nga 2.15 miliard € në 2.48 € miliard €. Pra, edhe gjatë këtij viti siç mund të vërehet edhe nga tabela e mëposhtme vërehet trend pozitiv i rritjes së vëllimit të kredive për biznese që ndikohet edhe nga shuma e garancive kreditore të FKGK-së.

Tabela 6. 30. *Rezultatet e analizës së trendit për kreditë totale dhe garancitë kreditore në vitin 2017*

Muaji	Viti	Kreditë Totale (mil. €)	Garancitë Kreditore (mil. €)	Trendi
Janar	2017	2,215.90	2,515.95	2,052.238
Shkurt	2017	2,239.60	2,897.74	2,554.610
Mars	2017	2,294.90	3,608.74	3,056.983
Prill	2017	2,329.50	4,303.44	3,559.356
Maj	2017	2,358.30	5,558.04	4,061.729
Qershor	2017	2,390.50	6,856.57	4,564.101
Korrik	2017	2,393.50	7,797.07	5,066.474

Gusht	2017	2,382.80	8,366.72	5,568.847
Shtator	2017	2,407.20	9,481.87	6,071.220
Tetor	2017	2,430.50	10,928.00	6,573.592
Nëntor	2017	2,460.10	13,000.90	7,075.965
Dhjetor	2017	2,485.50	14,877.80	7,578.338

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Trendi mesatar kumulativ për kreditë totale dhe shumën e garancive kreditore për vitin 2017 është 4,815.288 dhe ky trend tregon për ndikimin pozitiv të garancive kreditore në shumën e kredive totale për bizneset. Shuma e aprovuar e kredive nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore në vitin 2017 ka arritur në 30 milion €, ndërsa numri total i kredive të garantura ishte 785 kredi, ku pjesa më e madhe e kredive të garantuara ishin në rajonin e Prishtinës (324 kredi), në Prizren (131 kredi), në Gjilan (77 kredi), në Pejë (74 kredi), në Mitrovicë (66 kredi), në Ferizaj (64 kredi) dhe në Gjakovë (49 kredi). Shuma e garancive kreditore në sektorin e bujqësisë ishte 1.24 milion €, në prodhimtari 2.79 milion €, në tregti me shumicë dhe pakicë 5.89 milion €, ndërtimtari 653,913 € dhe në shërbime 3.85 milion €.

Duke u bazuar në statistikat e kredive të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore për vitin 2017, pjesa më e madhe e garancive kreditore ishin të destinuara në kapitalin punues (33%), në pajisje (31%), në ndërtim dhe renovim (25%) dhe të tjera (11%). Vlera e garancive kreditore të destinuara për kreditë që financojnë kapitalin punues në vitin 2017 kishte një vlerë prej 4.83 milion €.

Figura 6. 22. *Paraqitja grafike e trendit linear në mes shumës së kredive dhe garancive kreditore*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Në vitin 2018 vlera e shumës së garancive kreditore ka arritur në 41.66 milion €, ndërsa shuma e kredive totale është rritur nga vlera 2.46 miliard € në 2.75 miliard €. Kjo rritje në vëllimin e kredive vjen si rezultat i rritjes së vazhdueshme të garancive kreditore.

Tabela 6. 31. *Rezultatet e analizës së trendit për kreditë totale dhe garancitë kreditore në vitin 2018*

Muaji	Viti	Kreditë Totale (mil. €)	Garancitë Kreditore (mil. €)	Trendi
Janar	2018	2,469.30	15,981.70	10,124.22
Shkurt	2018	2,489.30	17,988.00	10,979.50
Mars	2018	2,534.30	20,326.70	11,834.77
Prill	2018	2,570.20	21,648.70	12,690.04
Maj	2018	2,607.90	23,813.60	13,545.31
Qershor	2018	2,661.30	26,021.50	14,400.59
Korrik	2018	2,665.80	27,641.70	15,255.86
Gusht	2018	2,666.50	29,768.50	16,111.13
Shtator	2018	2,681.10	31,695.30	16,966.40
Tetor	2018	2,712.40	35,423.10	17,821.68
Nëntor	2018	2,733.80	37,487.10	18,676.95
Dhjetor	2018	2,755.50	41,665.70	19,532.22

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Trendi mesatar kumulativ për kreditë totale dhe shumën e garancive kreditore është 14,828.22. Sipas këtyre vlerave edhe gjatë vitit 2018, garancitë kreditore kanë ndikuar në rritjen e kredive për biznese. Shuma e miratuar e kredive nga FKGK-ja në vitin 2018 kishte arritur në vlerën 87.15 milion € dhe deri në dhjetor të këtij viti numri i kredive të garantuara nga ky fond arriti në 2,262 kredi.

Figura 6. 23. *Paraqitja grafike e trendit linear në mes shumës së kredive dhe garancive kreditore për vitin 2018*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Në kuadër të këtyre gjithsej kredive, 886 kredi në vlerë prej 17.07 milion € janë garanci kreditore në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, 696 kredi në vlerë prej 11.32 milion € janë garanci kreditore në sektorin e shërbimeve, 402 kredi në vlerë prej 7.61 milion € garanci në sektorin e prodhimtarisë, 160 kredi në vlerë prej 2.88 milion € garanci në sektorin e bujqësisë dhe 118 kredi në vlerë prej 2.75 milion € garanci në sektorin e ndërtimtarisë.

Në vazhdim të analizës së trendit logaritmik do të ndërtojmë një projeksion për pesë vitet e ardhshme për të parë nëse garancitë kreditore do të ndikojnë pozitivisht në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë. Forma e ekuacionit të përgjithshëm të trendit linear për kreditë totale është si vijon:

$$Y = 25.63X + 2462.4 \quad (R^2 = 0.9551)$$

$$KB_{2019} = 25.63*24 + 2462.4 = 3.07 \text{ miliard €}$$

$$KB_{2020} = 25.63*36 + 2462.4 = 3.38 \text{ miliard €}$$

$$KB_{2021} = 25.63*48 + 2462.4 = 3.69 \text{ miliard €}$$

$$KB_{2022} = 25.63*60 + 2462.4 = 4 \text{ miliard €}$$

$$KB_{2023} = 25.63*72 + 2462.4 = 4.3 \text{ miliard €}$$

Sipas këtyre projeksioneve nëpërmjet analizës së trendit logaritmik, shuma e kredive për biznese deri në vitin 2023 parashikohet të arrijë në vlerën 4.3 miliard €. Në bazë të këtyre projeksioneve nga analiza e trendit logaritmik, për pesë vitet e ardhshme do të kemi trend pozitiv të rritjes së vëllimit të kredive për biznese. Forma e ekuacionit të përgjithëshëm të trendit linear për shumën e garancive kreditore është si vijon.

$$Y = 2214.7X + 13059 \quad (R^2 = 9871)$$

$$GK_{2019} = 2214.7*24 + 13059 = 66.21 \text{ milion €}$$

$$GK_{2020} = 2214.7*36 + 13059 = 92.78 \text{ milion €}$$

$$GK_{2021} = 2214.7*48 + 13059 = 119.36 \text{ milion €}$$

$$GK_{2022} = 2214.7*60 + 13059 = 145.94 \text{ milion €}$$

$$GK_{2023} = 2214.7*72 + 13059 = 172.51 \text{ milion €}$$

Projeksionet e analizës së trendit linear për shumën e garancive kreditore parashikojnë se vlera e garancive kreditore deri në vitin 2023 do të arrijë në 172.51 milion €. Sipas këtyre projeksioneve deri në

vitin 2023, rritja e garancive kreditore do të ndikojë në rritjen e vëllimit të kredive deri në vlerën 4.3 miliard €. Në bazë të këtyre projeksioneve shihet mjaft qartë se krijimi i fondit për garanci kreditore do të ndikojë edhe në pesë vitet e ardhshme në rritjen e kreditimit për biznese.

6.8. Ndikimi i garancive kreditore në zvogëlimin e riskut kreditor të bankave komerciale

Për të analizuar ndikimin e garancive kreditore në zvogëlimin e riskut kreditor do të përdorim disa teste statistikore, të cilat do të identifikojnë efektin e këtyre garancive kreditore në menaxhimin e riskut kreditor. Edhe në këtë pjesë të analizës do të paraqesim fillimisht statistikat deskriptive, shpërndarjen normale të variablës së varur dhe asaj të pavarur, analizën e korrelacionit, regresionin linear, analizën e variancës nëpërmjet racio testit dhe T-testit si dhe analizën e trendit linear, nëpërmjet këtyre analizave statistikore do të vërtetojmë hipotezën e tretë të parashtruar në fillim të këtij studimi.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura të dhënat e statistikave deskriptive për variablën e varur (KJP – kreditë jo-performuese) dhe për variablën e pavarur (garancitë kreditore).

Tabela 6. 32. *Statistikat deskriptive për kreditë jo-performuese dhe garancive kreditore*

Variablat	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Variance
KJP	28	71.976	111.407	88.47307	14.10193	198.8645
GK	28	187.5	41665.72	15167.12	12439.46	1.55e+08

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Stata

Vlera minimale e kredive jo-performuese gjatë kësaj periudhe kohore shtator 2016 – dhjetor 2018 është 71.97 milion €, ndërsa vlera maksimale e këtyre kredive arriti në 111.4 milion €. Mesatarja e kredive jo-performuese është 88.47 me një devijim standard në vlerë prej 14.10. Shuma e garancive kreditore në vitin 2016 kishte një vlerë minimale prej 187.500 € dhe deri në fund të vitit 2018, shuma e garancive kreditore u rrit deri në 41.66 milion €. Meqenëse nga viti 2014, kemi rënie të vazhdueshme të kredive jo-performuese, si rezultat i krijimit të përmbaruesve privat, por një reformë tjetër shumë e rëndësishme institucionale që ka ndikuar në zvogëlimin e riskut kreditor të bankave komerciale është edhe krijimi i fondit kosovar për garanci kreditore.

Në figurën 6.24 janë të paraqitura grafikisht lidhja lineare dhe shpërndarja normale në mes të vlerave të kredive jo-performuese dhe shumës së garancive kreditore. Siç vërehet nga pjesa e parë e figurës,

ekziston një lidhje lineare negative në mes vlerave të X dhe Y, duke rezultuar që rritja e garancive kreditore do të zvogëlojë shumën e kredive jo-performuese. Këto dy variabla kanë shpërndarje normale të të dhënave, sepse pikat janë shumë afër vijës së regresit dhe kjo nënkupton që vlerat e gabimeve standarde për parametrat e këtij modeli nuk janë shumë të larta. Vlera e koeficientit Pearson është – 0.8925, që nënkupton një korrelacion negativ të lartë në mes garancive kreditore dhe kredive jo-performuese. Në grifikun e dytë është paraqitur matrica e shpërndarjes normale të vlerave të X dhe Y, ku nëpërmjet kësaj matrice identifikohet lidhja lineare negative në mes këtyre dy variablave.

Figura 6. 24. *Korrelacioni Pearson dhe matrica e shpërndarjes normale në mes të vlerave të KJP-së dhe GK-së*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Stata

Forma e ekuacionit të përgjithshëm për analizën e regresionit linear standard është si vijon:

$$Y = b_0 + b_1X_1 + e$$

Ku:

Y – shuma e kredive jo-performuese (variabla e varur)

b_0 dhe b_1– koeficienti i parametrave të modelit

X_1 – garancitë kreditore (variabla e pavarur) dhe

e – variabla stohastike

Pas specifikimit të këtij modeli ekonometrik dhe sqarimit të variablave të inkorporuara në të, ky model merr këtë formë:

$$KJP = \beta_0 + \beta_1 GK + e$$

Duke u bazuar në rezultatet e analizës së regresionit linear, mund të konkludojmë që krijimi i fondit për garanci kreditore në sistemin bankar në Kosovë ka ndikuar në zvogëlimin e riskut kreditor. Vlera e koeficinentit të përcaktimit R Sqaure = 0.7887, që paraqet një vlerë të lartë dhe tregon që për 78.87% garancitë kreditore e shpjegojnë zvogëlimin e kredive jo-performuese në sistemin bankar në Kosovë.

Tabela 6. 33. *Rezultatet e analizës së regresionit standard linear për ndikimin e garancive kreditore në kreditë jo-performuese*

KJP	Coef.	Std. Error	t	P > |t|	95% Conf. Interval	95% Conf. Interval
GK	-0.10118	0.0001003	-10.09	0.000	-0.0012179	-0.0008057
_cons	103.8189	1.952845	53.16	0.000	99.8048	107.8331

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Stata

Nëse faktorët e tjerë mbesin konstant, atëherë shuma e kredive jo-performuese do të jetë 103.81 milion €. Ndërsa, nëse kemi rritje për 1% të garancive kreditore, atëherë kjo do të ndikojë në rënien e kredive jo-performuese për -0.10%. Meqënëse ky fond ka vetëm 3 vite që është themeluar nga Qeveria e Kosovës, pritjet janë që në pesë vitet e ardhshme do të kemi ndikim edhe më të madh në zvogëlimin e riskut kreditor.

Për të vërtetuar këtë hipotezë do të aplikojmë edhe analizën e variancës nëpërmjet racio testit dhe T-testit. Qëllimi kryesor i përdorimit të këtyre testeve statistikore parametrike është për shkak se numri i observimeve është 28 dhe siç dihet kur kemi një numër jo shumë të madh të vëzhgimeve racio testi dhe T-testi janë të aplikueshme për testimin e hipotezave parametrike.

Hipoteza bazë: *Nëse vlera e racio testit është e barabartë me 1, garancitë kreditore nuk kanë ndikuar në zvogëlimin e riskut kreditor.*

Hipoteza alternative: *Nëse vlera e racio testit është e vogël se 1, garancitë kreditore kanë ndikuar në zvogëlimin e riskut kreditor.*

Tabela 6. 34. *Rezultatet e analizës së variancës (Racio Test) për ndikimin e garancive kreditore në KJP-ve*

Variablat	Obs.	Mean	Std. Error	Std. Dev.	95% Conf. Interval	95% Conf. Interval
KJP	28	88.47307	2.665015	14.10193	83.00491	93.94123
GK	28	15167.12	2530.837	12439.46	10343.6	19990.64
combined	56	7627.797	1545.953	11568.85	4529.638	10725.96

Ratio Test	Ratio = sd (KJP) / sd (GK) = 0.0000 H_0 : ratio = 1 H_a : ratio < 1

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Stata

Rezultatet të cilat janë gjeneruar nga analiza e variancës nëpërmjet racio testit janë të rëndësishme edhe në aspektin statistikor, sepse vlera e racios është 0.000, që është një vlerë më e vogël se 1. Prandaj, në bazë të këtij rezultati konfirmohet se garancitë kreditore gjatë kësaj periudhe kohore kanë pasur ndikim pozitiv në zvogëlimin e kredive jo-performuese të bankave komerciale në Kosovë.

Analiza e variancës nëpërmjet T-testit:

Hipoteza bazë: *Nëse vlera faktike e t-testit është e barabartë me 0, garancitë kreditore nuk kanë ndikuar në zvogëlimin e riskut kreditor.*

Hipoteza alternative: *Nëse vlera faktike e t-testit është e vogël me 0, garancitë kreditore kanë ndikuar në zvogëlimin e riskut kreditor.*

Tabela 6. 35. *Rezultatet e analizës së variancës (T-Test) për ndikimin e garancive kreditore në kreditë jo-performuese*

Variablat	Obs.	Mean	Std. Error	Std. Dev.	95% Conf. Interval	95% Conf. Interval
KJP	28	88.47307	2.665015	14.10193	83.00491	93.94123
GK	28	15167.12	2530.837	12439.46	10343.6	19990.64
combined	56	7627.797	1545.953	11568.85	4529.638	10725.96
diff	-	-15078.65	2350.839	-	-19791.8	-10365.5
T - Test	Diff = mean (KJP) - mean (GK) = -6.4142 H_0 : diff = 0 H_a : diff < 0					

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Stata

Sipas rezultateve të analizës së variancës nëpërmjet T-testit rezulton që hipoteza bazë refuzohet dhe hipoteza alternative pranohet, sepse vlera e diferencës në mesatare është një vlerë më e vogël se zero, prandaj mund të themi që garancitë kreditore kanë ndikuar në zvogëlimin e riskut kreditor. Në vazhdim të analizës do të paraqesim analizat e trendit linear mes këtyre dy variablave, për të parë efektin e shumave të aprovuara të garancive kreditore në menaxhimin e riskut kreditor të bankave komerciale në Kosovë.

Vlera e kredive jo-performuese në shtator të vitit 2016 ishte 111.4 milion €, vlerë kjo e cila deri në fund të vitit 2017 ka rënë në 84.51 milion €. Gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur rritje të vazhdueshme të garancive kreditore të cilat kanë ndikuar në rënien e shumës së kredive jo-performuese.

Tabela 6. 36. *Rezultatet e analizës së trendit për kreditë jo-performuese dhe garancitë kreditore në vitin 2016 – 2017*

Muaji	Viti	KJP (mil. €)	Garancitë Kreditore (mil. €)	Trendi
Shtator	2016	111.407	187.50	326.82
Tetor	2016	109.871	980.00	529.90
Nëntor	2016	106.191	1,723.50	732.98
Dhjetor	2016	105.268	2,133.95	936.06
Janar	2017	108.58	2,515.95	1,122.871
Shkurt	2017	105.26	2,897.74	1,589.461
Mars	2017	103.27	3,608.74	2,056.051
Prill	2017	100.17	4,303.44	2,522.640
Maj	2017	101.41	5,558.04	2,989.230
Qershor	2017	93.23	6,856.57	3,455.820
Korrik	2017	86.17	7,797.07	3,922.410
Gusht	2017	92.93	8,366.72	4,389.000
Shtator	2017	93.88	9,481.87	4,855.590
Tetor	2017	87.50	10,928.00	5,322.180
Nëntor	2017	88.57	13,000.90	5,788.770
Dhjetor	2017	84.51	14,877.80	6,255.360

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Sipas kësaj analize krahasuese që bazohet në të dhënat sekondare të raporteve financiare të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, këto shuma të garantura të kredive jo vetëm që kanë lehtësuar qasjen e shumë bizneseve për të marrë kredi në ndonjë bankë komerciale, por edhe e kanë zvogëluar në masë të madhe edhe riskun kreditor të këtyre bankave.

Figura 6. 25. *Paraqitja grafike e trendit linear në mes të kredive jo-performuese dhe garancive kreditore për vitet 2016 – 2017*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Vetëm gjatë këtyre dy viteve, këto garanci kreditore kanë ndikuar në zvogëlimin e kredive jo-performuese në 26.89 milion €. Vlera e koeficientit të përcaktimit në këtë rast është 0.8937 ose 89.37% që tregon se për këtë vlerë garancitë kreditore e shpjegojnë zvogëlimin e kredive jo-performuese në

sistemin bankar në Kosovë. Në figurën 6.25 është paraqitur grafikisht analiza e trendit linear për shumën e garancive kreditore dhe kreditë jo-performuese, ku siç vërehet edhe një herë, lidhja lineare negative e këtyre dy variblave. Në janar të vitit 2018 shuma e kredive jo-performuese ishte 76.5 milion €, vlerë kjo e cila në fund të vitit 2018 ka rënë në 69.39 milion €. Nëse këto të dhëna për vitin 2018, krahasohen me të dhënat e shumës së garancive kreditore, atëherë këto kreditë e garantuara janë rritur nga vlera 15.9 milion € në 41.66 milion €. Vetëm gjatë vitit 2018, këto garanci kreditore kanë ndikuar në zvogëlimin e kredive jo-performuese për shumën 7.15 milion €. Këto vlera dëshmojnë se krijimi i FKGK-së është një hap shumë i rëndësishëm drejt reformimit të mëtutjeshëm të sistemit bankar në Kosovë dhe një përkrahje më e madhe e institucioneve shtetërore në drejtim të financimit të bizneseve nëpërmjet kredive. Vlera e trendit mesatar kumulativ për këto dy variabla është 13,560.35 €.

Tabela 6. 37. *Rezultatet e analizës së trendit për kreditë jo-performuese dhe garancitë kreditore në vitin 2018*

Muaji	Viti	NPL (mil. €)	Garancitë Kreditore (mil. €)	Trendi
Janar	2018	76.548	15,981.70	9,074.75
Shkurt	2018	77.167	17,988.00	9,890.32
Mars	2018	73.494	20,326.70	10,705.88
Prill	2018	74.536	21,648.70	11,521.44
Maj	2018	74.228	23,813.60	12,337.01
Qershor	2018	74.116	26,021.50	13,152.57
Korrik	2018	73.976	27,641.70	13,968.13
Gusht	2018	72.662	29,768.50	14,783.70
Shtator	2018	72.071	31,695.30	15,599.26
Tetor	2018	71.234	35,423.10	16,414.83
Nëntor	2018	70.812	37,487.10	17,230.39
Dhjetor	2018	69.398	41,665.70	18,045.95

Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Forma e ekuacionit të përgjithshëm për trendin linear të kredive jo-performuese është si vijon:

$$Y = -0.5903X + 77.191 \quad (R^2 = 0.8801)$$

Projeksionet e shumës së kredive jo-performuese për pesë vitet e ardhshme janë:

$$KJP_{2019} = -0.5903*24 + 77.191 = 63.02 \text{ milion €}$$

$$KJP_{2020} = -0.5903*36 + 77.191 = 55.9 \text{ milion €}$$

$$KJP_{2021} = -0.5903*48 + 77.191 = 48.8 \text{ milion €}$$

$$KJP_{2022} = -0.5903*60 + 77.191 = 41.77 \text{ milion €}$$

$$KJP_{2023} = -0.5903*72 + 77.191 = 34.6 \text{ milion €}$$

Në bazë të projeksioneve të realizuara nëpërmjet analizës së trendit linear parashikohet që vlera e kredive jo-performuese deri në fund të vitit 2019 pritet të zvogëlohet nga 69.39 milion € sa është në vitin 2018 në 63.02 milion € në fund të vitit 2019.

Ndërsa nëse bazohemi në projeksionet për pesë vitet e ardhshme, vlera e shumës së kredive jo-performuese pritet të zvogëlohet nga shuma 63.39 milion € në 34.6 milion € dhe këto vlera nëse krahasohen me projeksionet e garancive kreditore, atëherë vlera e këtyre garancive pritet që deri në vitin 2023 të rritën në 172.51 milion €. Të gjitha këto projeksione janë shumë të rëndësishme si rezultate, sepse janë ndërtuar nëpërmjet analizës së trendit mbi bazën e të dhënave zyrtare për periudhën kohore shtator 2016 – dhjetor 2018.

Figura 6. 26. *Paraqitja grafike e trendit linear mes kredive jo-performuese dhe garancive kreditore për vitin 2018*



Burimi: Llogaritjet e autorit në programin Microsoft Excel

Në figurën e mëposhtme janë të paraqitura grafikisht analiza e trendit linear mes shumës së kredive jo-performuese dhe garancive kreditore si dhe trendi në mes të këtyre variablave. Të dhënat janë të raportuara në baza mujore për vitin 2018 dhe siç po vërehet nga ky grafik vija me gjelbërt tregon rënien e vazhdueshme të kredive jo-performuese gjatë vitit 2018 si rezultatet i rritjes së garancive kreditore. Siç e pamë edhe një herë nga të gjitha analizat ekonometrike dhe testet e tjera statistikore rezulton që krijimi i fondit për garanci kreditore ka ndikuar pozitivisht në rritjen e kredimit të sektorit real të ekonomisë dhe zvogëlimin e riskut kreditor të bankave komerciale.

6.9. Përshkrimi i variablave dhe specifikimi i modelit ekonometrik për testimin e hipotezës së katërt

Hipoteza e katërt e këtij studimi ka për qëllim të identifikojë në qoftëse zbatimi i reformave institucionale në funksion të përmirësimit të biznes klimes kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kredimit ndaj sektorit real të ekonomisë. Në kapitullin e katërt të këtij studimi janë paraqitur në mënyrë të detajuar të gjitha reformat institucionale të cilat janë ndërmarrë në Kosovë në përmirësimin e klimës së biznesit si dhe lehtësimin e qasjes në financa. Për të testuar hipotezën e katërt, ne do të aplikojmë metodat kuantitative nëpërmjet një kombinimi të të dhënave primare dhe sekondare.

Të dhënat primare për testimin e kësaj hipoteze janë mbledhur nëpërmjet metodës së anketimit me biznese dhe me banka komerciale, ndërsa të dhënat sekondare janë marrë në raportet Doing Business të Bankës Botërore për periudhën kohore 2010 – 2018. Pra, vërtetimin e kësaj hipoteze do ta bëjmë nëpërmjet të dhënave të kombinuara, në mënyrë që të bëjmë analiza krahasuese mes të dhënave si dhe të rrisim besueshmërinë e të dhënave të përdorura për anketim.

Pyetsori i cili është përdorur për anketimin e bizneseve dhe bankave komerciale (shih shtojcën ...) përmban një sistem pyetjesh të ndarë në 11 seksione dhe të vlerësuara sipas shkallës së Likertit nga 1 deri në 5. Nëpërmjet këtij pyetsori ne kemi anketuar 56 ndërmarrje dhe 10 banka komerciale. Shpërndarja e pyetësorëve është bërë nëpërmjet vizitës në secilën ndërmarrje dhe bankë komerciale dhe koha e anketimit ka zgjatë 30 ditë. Në kuadër të 56 ndërmarrjeve, pjesëmarrës të anketimit kryesisht janë ndërmarrjet më të rëndësishme në të gjitha regjionet e Kosovës dhe kjo mostër është mjaft reprezentative, për arsye sepse edhe gjatë matjeve nëpërmjet testeve statisikore rezulton që numri i ndërmarrjeve të përfshira në këtë analizë tregon një shkallë shumë të lartë të besueshmërisë. Ndërsa, për qëllime të krahasimit të të dhënave mes rezultateve të anketimit nga bizneset dhe të dhënave sekondare nga Banka Botërore, ne kemi realizuar edhe 10 intervista me analistë kreditorë të dhjetë bankave të ndryshme duke marrë opionet e tyre në lidhje me çështjet të cilat do të diskutohen në kuadër të kësaj hipoteze.

Fillimisht nëpërmjet kësaj analize ne do të paraqesim rezultatet e analizës faktoriale, analizës së besueshmërisë sipas modelit Alpha , analizën e regresionit të shumëfishtë standard dhe në fund analizën krahasuese mes të dhënave primare dhe sekondare, duke i dhënë më shumë mbështetje rezultateve të këtij hulumtimi.

Hipoteza e katërt e këtij studimi është:

Zbatimi i reformave institucionale në funksion të përmirësimit të biznes klimës ka pasur ndikim pozitiv në rritjen e kreditimit ndaj sektorit real të ekonomisë.

Në pjesën e parë të kësaj analize ne do të paraqesim disa analiza krahasuesemes të dhënave sekondare të përpunuara nga raportet e të bërit biznes për periudhën kohore 2010 – 2018 dhe gjithashtu një prezentim i rezultateve të pyetësorit të realizuar me bizneset dhe bankat komerciale në Kosovë. Qëllimi kryesor i përdorimit të analizës faktoriale për vërtetimin e kësaj hipoteze është se nëpërmjet kësaj analize ne reduktojmë numrin e variablave në analizë dhe identifikojmë se sa ndikon secila variabël në variablën e varur. Në kuadër të kësaj analize empirike ne do të marrim parasysh 11 kritere ose reforma institucionale të të bërit biznes të cilat ndikojnë në përmirësimin e qasjes në financa dhe procesin e dhënies së kredive bankare.

Duke u bazuar në rezultatet e analizës faktoriale, do të marrim parasysh vetëm variablat të cilat kanë një shkallë më të lartë të ndikimit dhe nëpërmjet këtyre variablave do të realizohet analiza e besueshmërisë sipas modelit Alpha për të identifikuar ndikimin e secilës reformë në procesin e miratimit të kredive nga bankat komerciale. Pas analizës së bësueshmërisë, do të paraqesim edhe rezultatet e dy modeleve ekonometrike, nëpërmjet të cilave do të identifikojmë ndikimin pozitiv apo negativ të reformave institucionale në rritjen e kreditimit për sektorin real të ekonomisë.

Tabela 6. 38. *Përshkrimi i variablave për testimin e hipotezës së katërt*

Variabla	Përshkimi i variablës	Burimi i të dhënave
Variabla e varur	Qasja në kredi	Raportet Doing Business për rastin e Kosovës (2010 – 2018) – Banka Botërore dhe rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale në Kosovë
Variabla e pavarur	Fillimi i një biznesi	Raportet Doing Business për rastin e Kosovës (2010 – 2018) – Banka Botërore dhe rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale në Kosovë
Variabla e pavarur	Marrja e lejës së ndërtimit	Raportet Doing Business për rastin e Kosovës (2010 – 2018) – Banka Botërore dhe rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale në Kosovë
Variabla e pavarur	Furnizimi me energji elektrike	Raportet Doing Business për rastin e Kosovës (2010 – 2018) – Banka Botërore dhe rezultatet e anketimit me biznese dhe

		bankat komerciale në Kosovë
Variabla e pavarur	Regjistrimi i pronës	Raportet Doing Business për rastin e Kosovës (2010 – 2018) – Banka Botërore dhe rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale në Kosovë
Variabla e pavarur	Mbrojtja e investitorëve	Raportet Doing Business për rastin e Kosovës (2010 – 2018) – Banka Botërore dhe rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale në Kosovë
Variabla e pavarur	Pagesa e tatimeve	Raportet Doing Business për rastin e Kosovës (2010 – 2018) – Banka Botërore dhe rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale në Kosovë
Variabla e pavarur	Tregtia përtej kufijve	Raportet Doing Business për rastin e Kosovës (2010 – 2018) – Banka Botërore dhe rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale në Kosovë
Variabla e pavarur	Zbatimi i kontratave	Raportet Doing Business për rastin e Kosovës (2010 – 2018) – Banka Botërore dhe rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale në Kosovë
Variabla e pavarur	Zgjidhja e paaftësisë paguese	Raportet Doing Business për rastin e Kosovës (2010 – 2018) – Banka Botërore dhe rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale në Kosovë
Variabla e pavarur	Rregullimi i tregut të punës	Raportet Doing Business për rastin e Kosovës (2010 – 2018) – Banka Botërore dhe rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale në Kosovë

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në tabelën e mësipërme janë të përshkruara në mënyrë të detajuar të gjitha variablat e përfshira të cilat do të përdoren për të analizuar nëse zbatimi i këtyre reformave institucionale ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e klimës biznesore dhe rritjen e kreditimit të bizneseve në Kosovë.

6.10. Analiza empirike e të dhënave sekondare dhe rezultatet e anketimit të bizneseve dhe bankave komerciale

Në këtë pjesë të analizës empirike do të paraqesim fillimisht në formë tabelare analizat krahasuese sa i përket vlerësimeve të Bankës Botërore për reformat e të bërit biznes dhe të gjitha këto vlerësime do t'i krahasojmë me variablën e varur (Qasja në kredi). Ndërsa, për secilën reformë institucionale do të

paraqesim rezultatet e pyetësorëve të realizuar me 56 biznese dhe 10 banka komerciale, këto rezultate do të na ndihmojnë në diskutimet të cilat do të realizohen për testimin e kësaj hipoteze.

Njëra nga reformat mjaft të rëndësishme të cilat ndikojnë në masë të madhe në procesin e miratimit të kredive është fillimi i një biznesi. Në këtë reformë janë vlerësuar procedurat e para regjistrimit siç janë verifikimi i emrit, noterizimi, regjistrimi i biznesit, regjistrimi i sigurimit social, marrja e miratimit nga anëtarët e tjerë të familjes për të filluar biznesin, marrja e lejeve specifike në funksion të regjistrimit të biznesit, koha e nevojshme për të përfunduar çdo procedurë, kostoja e kërkuar për të përfunduar çdo procedurë dhe kapitali minimal i kërkuar.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura së pari vlerësimet e Bankës Botërore, përsa i përket rangimit të Kosovës në krahasim me 190 vendet e tjera të botës në lidhje me procedurat, kohën dhe koston e kërkuar për fillimin e një biznesi në Kosovë. Rangimi është bërë për vitet 2010 – 2018 dhe rangimi sa më afër vlerës 1 është më pozitiv për secilin shtet.

Tabela 6. 39. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe fillimin e një biznesi*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Qasja në kredi	43	32	24	23	28	23	28	20	12
Procedura (numër)	9	10	10	9	6	5	5	3	3
Koha (nr. i ditëve)	52	58	58	52	30	11	11	6	5.5
Kostoja (% e të ardhurave për kokë banori)	43.3	28.7	26.7	23	22.1	1.2	1.1	1.1	1

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Sipas këtye të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, qasja në kredi është përmirësuar në Kosovë, sepse vlerësimi ka shënuar progres pozitiv nga pozita 43 në 12 gjatë periudhës kohore 2010 – 2018. Progresi vërehet edhe në numrin e procedurave për të hapur një biznes, kohën e nevojshme për të përfunduar secilën procedurë si dhe koston e kërkuar. Nga 9 procedura sa janë kërkuar në vitin 2010, tani është lehtësuar ky proces në 3 procedura, gjithashtu kemi fleksibilitet të madh edhe në numrin e ditëve të kërkuara për të hapur një biznes, nga 52 ditë në 5.5 ditë dhe kostoja është zvogëluar nga 43.3% në 1% e të ardhurave për kokë banori.

Sipas vlerësimeve të 56 bizneseve procedurat, koha dhe kostoja e kërkuar për të filluar një biznes ka ndikuar pozitivisht (48.2%) në procesin e marrjes së kredive bankare, ndërsa 25% nga këto biznese vlerësojnë se reformat e ndërmarra në procesin e fillimit të një biznesi kanë ndikuar shumë pozitivisht. Në kuadër të firmave të cilat kanë qenë pjesë e anketimit vetëm 9% prej tyre kanë mendim se këto

reforma kanë ndikuar negativisht, ndërsa 17.9% prej vlerësojnë se këto reforma nuk kanë ndikim fare në procesin e marrjes së kredive.

Figura 6. 27. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – fillimi i një biznesi*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Nga 10 banka komerciale, sipas rezultateve të anketimit, pothuajse 90% prej analistave kreditorë kanë dhënë opinionin e tyre se të gjitha reformat të cilat janë ndërmarrë në aspektin e fillimit tënjë biznesi ka ndikuar pozitivisht në procesin e marrjes së kredive bankare dhe madje e kanë përmirësuar qasjen e tyre në këto kredi.

Sipas vlerësimeve të analistëve kreditorë, firmat të cilat kryesisht janë biznese të reja dhe kërkojnë kredi për financimin e kapitalit themelor, nga procesi i reformimit të njejtat kanë përfituar shumë dhe iu është krijuar një mundësi më e madhe të kenë qasje më të lehtë në kreditë e bankave komerciale. Nga 56 biznese të anketuara, 41 prej tyre kanë vlerësuar se procedurat e para – regjistrimi të biznesit, regjistrimi i sigurimit social, koha e nevojshme për të realizuar çdo procedurë, kostoja dhe kapitali minimal i paguar kanë ndikuar pozitivisht në procesin e marrjes së kredive. Në bazë të këtyre vlerësimeve vlen të theksohet se reformat të cilat janë ndërmarrë në këtë aspekt, kanë lehtësuar mjaft shumë procesin e miratimit të kredive dhe ka përmirësuar qasjen në financa të këtyre bizneseve.

Tabela 6. 40. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe marrjen e lejës së ndërtimit*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Qasja në kredi	43	32	24	23	28	23	28	20	12
Marrja e lejës së ndërtimit	176	173	171	144	136	135	136	129	122

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Tabela e mësipërme pasqyron rezultatet e analizës krahasuese në kuadër të vlerësimeve të Bankës Botërore për reformat të cilat janë ndërmarrë në marrjen e lejes së ndërtimit. Një reformë e tillë mund të ndikojë sidomos tek firmat të cilat kërkojnë kredi investuese dhe mjetet të cilat merren nga këto kredi janë të destinuara në ndërtimin e objekteve të ndryshme biznesore ose banesore. Nga viti 2010 deri në vitin 2018 Kosova ka bërë progres jo shumë të madh në drejtim të reformimit të procedurave, kohës dhe kostos së nevojshme për marrjen e lejes së ndërtimit.

Vlerësimi i Bankës Botërore përsa i përket këtyre reformave për rastin e Kosovës është nga pozita e 176, Kosova ka shënuar një progres në pozitën e 122. Reformat që janë ndërmarrë kryesisht janë në reduktimin e procedurave nga 21 në 15, koha e nevojshme për të përfunduar këto procedura është zvogëluar nga 320 ditë në 152 ditë dhe kostoja është zvogëluar në 5.8% e të ardhurave për kokë banori.

Figura 6. 28. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – marrja e lejës së ndërtimit*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Rezultatet e anketimit me biznese dëshmojnë se firmat të cilat kanë kërkuar kredi investuese me destinim ndërtimin e objekteve biznesore apo banesore vlersojnë se reformat të cilat janë ndërmarrë në marrjen e lejes së ndërtimit kanë ndikuar pozitivisht (57.2%) në procesin e marrjes së kredive. Vlerësimi i analistëve të kredisë se reformat të cilat janë ndërmarrë në këtë aspekt është se kanë pasur ndikim neutral (60%) në procesin e miratimit të kredive, ndërsa vetëm 30% prej tyre kanë vlerësuar se këto reforma kanë ndikim pozitiv.

Në përgjigjjet e anketimit, siç vërehet kemi mospërputhje të vlerësimeve të tyre, prandaj arsyeja kryesore mund të jetë sepse bankat komerciale pjesën më të madhe të kredive ua kanë dhënë firmave për të realizuar investime të tjera dhe kryesisht financimin e kapitalit punues të tyre, ndërsa bizneset

kondiserojnë që këto procedura e kanë lehtësuar procesin e marrjes së kredive bankare. Por, vlen të theksohet se një pjesë e konsiderueshme e bizneseve vlerësojnë se këto reforma nuk kanë pasur ndonjë efekt pozitiv në procesin e marrjes së kredive.

Tabela 6. 41. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe furnizimin me energji elektrike*

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Qasja në kredi	24	23	28	23	28	20	12
Furnizimi me energji elektrike	124	116	121	112	124	114	106

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Nëse i krahasojmë të dhënat mes reformave të ndërmarra për furnizimin me energji elektrike dhe qasjen në kredi, atëherë gjatë kësaj periudhe kohore është shënuar progres mesatar pozitiv në drejtim të reformimit të procedurave, kohës dhe kostos së nevojshme për të realizuar furnizimin me energji elektrike. Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, Kosova që nga viti 2012 deri në vitin 2018 ka shënuar progres për 18 më lartë në krahasim me vitin 2012. Reformat kryesisht janë shënuar në kohën e nevojshme për të përfunduar secilën procedurë dhe kemi reduktim të kostos së kërkuar për furnzim me energji elektrike nga ana e bizneseve.

Figura 6. 29. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – furnizimi me energji elektrike*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në bazë të rezultateve të anketimit me biznese, pjesa më e madhe e tyre (48.2%) kanë deklaruar se reformat të cilat janë ndërmarrë për furnizimin me energji elektrike nuk kanë pasur ndonjë efekt pozitiv në procesin e marrjes së kredive. Ndërsa 44.7% e këtyre firmave kanë vlerësuar se efektet janë pozitive në këtë drejtim. Përderisa 50% e analistëve kreditorë kanë vlerësuar se reformat të cilat janë përmbushur në aspektin e furnizimit me energji elektrike kanë ndikuar pozitivisht në procesin e dhënies së kredive.

Vlen të theksohet se gjatë procedurave për miratimin e kredive, bankat komerciale kërkojnë nga firmat edhe gjendjen e pagesave për energji elektrike, kështu që në aspektin teknik dhe procedural ky është një kriter që vlerësohet nga ana e bankave.

Nga 56 firma që janë pjesë e këtij anketimi, 23 prej këtyre firmave kanë vlerësuar se dorëzimi i të gjitha dokumenteve relevante dhe marrja e lejeve të nevojshme, marrja e punimeve të jashtme të instalimit, përfundimi i çdo kontrate të nevojshme të furnizimit, koha e nevojshme për të përfunduar çdo procedurë dhe kostoja e nevojshme kanë ndikuar pozitivisht në procesin e marrjes së kredive, ndërsa 33 prej këtyre firmave kanë vlerësuar se këto reforma nuk kanë pasur efekte pozitive në këtë proces.

Tabela 6. 42. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe regjistrimin e pronës*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Qasja në kredi	43	32	24	23	28	23	28	20	12
Regjistrimi i pronës	68	65	73	76	58	34	32	33	34

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Vlerësimet e Bankës Botërore për reformat e ndërmarra gjatë regjistrimit të pronës janë të paraqitura në tabelën 6.42. Sipas këtyre vlerësimeve, Kosova renditet në pozitën e 34-të në kuadër të 190 ekonomive botërore. Pra, gjatë kësaj periudhe kohore progesi i cili është arritur në reformmin e procedurave për regjistrimin e pronës, ka ndikuar pozitivisht edhe në procesin e marrjës së kredive nga ana e bizneseve në Kosovë. Reformat kryesisht janë realizuar në aspektin procedural, ku kemi pasur zvogëlim të procedurave të kërkuara për regjistrimin e pronës, gjë që e ka lehtësuar procesin e shumë firmave për të regjistruar pronat e tyre. Gjithashtu, reforma pozitive kemi pasur edhe në aspektin e kohës dhe uljen e kostos për të përfunduar të gjitha procedurat e nevojshme.

Figura 6. 30. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – regjistrimi i pronës*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në figurën 6.30 janë të paraqitura rezultatet e anketimit me bizneset dhe bankat komerciale në lidhje me vlerësimin e tyre se kanë pasur ndikim reformat e ndërmarra gjatë regjistrimit të pronës në procesin e marrjes së kredive bankare. Nga 56 biznese të përfshira në këtë anlizë, mbi 53.6% prej tyre vlerësojnë se këto reforma kanë ndikuar pozitivisht, sidomos kur për kredi kërkohet si kolateral pasuria e paluajtshme.

Prandaj, sipas vlerësimeve të tyre, disa nga reformat të cilat janë ndërmarrë kanë pasur efekte pozitive, përderisa 25% nga këto firma vlerësojnë se efektet janë neutrale dhe 21.4% prej tyre mendojnë se këto reforma kanë ndikuar negativisht, pasi që kanë vlerësuar se procedurat për regjistrimin e pronës, kur është kërkuar si kolateral pasuria e paluajtshme, atëherë këto procedura sipas tyre e kanë vështirësuar procesin e marrjes së kredive. Nga 10 analistë kreditorë të intervistuar, 7 prej tyre kanë dhënë vlerësime se këto reforma nuk kanë ndikuar në procesin e dhënies së kredive, prandaj vlerësimi i tyre është neutral. Gjithsesi, për të parë nëqoftëse reformat e regjistrimit të pronës kanë ndikuar pozitivisht në procesin e miratimit të kredive, do ti shohim në rezultatet e analizës faktoriale dhe analizës së besueshmërisë.

Figura 6. 31. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – reformat e qasjës në kredi*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në figurën e mësipërme janë paraqitur rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale në lidhje me reformat e ndërmarra gjatë procesit të dhënies së kredive nga bankat komerciale. Nga 56 biznese, mbi 55.4% prej tyre kanë vlerësuar se reformat siç janë: të drejtat e huamarrësit dhe huadhënësit nëpërmjet ligjeve të kolateralit, mbrojtja e të drejtave të kreditorëve nëpërmjet ligjeve të bankrotimit, fushëveprimi dhe qasja në informacionin kreditor të shpërndarë nëpërmjet regjistrit të kredive kanë ndikuar pozitivisht në procesin e marrjës së kredive.

Ndërsa, vlerësimi i analistëve kreditorë për këtë proces është shumë pozitiv, që sipas vlerësimeve të tyre të gjitha reformat të cilat i kanë ndërmarrë bankat komerciale, iu kanë lehtësuar në masë të madhe bizneseve procesin e miratimit të kredive. Vetëm 26.8% e firmave apo 15 prej tyre vlerësojnë që këto reforma nuk kanë pasur ndonjë efekt në procesin e marrjës së kredive, ndërsa 10 prej këtyre firmave kanë vlerësuar që efektet e këtyre reformave janë negative.

Tabela 6. 43. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe mbrojtjën e investitorëve*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Qasja në kredi	43	32	24	23	28	23	28	20	12
Mbrojtja e investitorëve	172	173	174	100	98	62	57	63	89

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Sipas këtyre vlerësimeve të Bankës Botërore në lidhje me reformat e ndërmarra në aspektin e mbrojtjës së investitorëve, Kosova ka shënuar progres të rëndësishëm në këtë aspekt, duke e përmirësuar pozitën e saj nga 172 në 89 në vitin 2018. Prandaj, mund të themi që progresi pozitiv që është realizuar në mbrojtjen e investitorëve ka ndikuar në masë të madhe edhe në procesin e miratimit të kredive nga bankat komerciale. Kriteret të cilat janë vlerësuar nga bizneset dhe bankat komerciale janë: kërkesat e shqyrtimit dhe miratimit për transaksionet e palëve të ndërlidhura, aftësia e aksionarëve të vegjël për të ngritur padi dhe për të mbajtur drejtorët e interesuar përgjegjës për transaksionet, qasja në dokumentet e brendshme të korporatës, të drejtat e aksionarëve dhe roli në vendimet e mëdha të korporatave, transparenca si dhe shkalla e rregullimit të konfliktit të interesave. Të gjithë këta indikatorë janë marrë parasysh gjatë intervistimit të bizneseve dhe bankave.

Figura 6. 32. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – mbrojtja e investitorëve*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në bazë të këtyre vlerësimeve, nga 56 biznese të anketuara 35.7% prej tyre vlerësojnë se reformat e ndërmarra në aspektin e mbrojtjes së investitorëve kanë ndikuar pozitivisht në procesin e miratimit të kredive, ndërsa 37.5% prej këtyre bizneseve kanë vlerësuar se ndikimi i këtyre reformave është neutral. Nga 10 banka komerciale të përfshira në këtë anketim, mbi 80% prej tyre kanë vlerësuar se reformat e tilla kanë ndikuar pozitivisht në procesin e miratimit të kredive.

Bankat komerciale kanë vlerësuar se kërkesat e shqyrtimit dhe miratimit për transaksionet e palëve të ndërlidhura dhe transparenca e korporatave mbi aksionet e pronësisë, kompenzimet, auditimet dhe perspektivat financiare janë reforma të cilat kanë ndikuar pozitivisht në procesin e dhënies së kredive. Sipas vlerësimeve të bizneseve, reforma e cila ka ndikuar më së shumti në procesin e dhënies së kredive, është qasja në dokumentet e brendshme të korporatës, duke iu mundësuar bizneseve që të ofrojnë sa më shumë informacione gjatë procesit të aplikimit për kredi, informacione këto të cilat e zvogëlojnë edhe asimetrinë e informacioneve në mes bankës dhe huamarrësit.

Tabela 6. 44. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe pagesën e tatimeve*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Qasja në kredi	43	32	24	23	28	23	28	20	12
Pagesa e tatimeve	50	41	46	44	43	63	67	43	45

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Sa i përket reformave të cilat janë ndërmarrë në sistemin tatimor në Kosovë, Banka Botërore e rangon Kosovën në pozitën 45 për vitin 2018 në kuadër të 190 ekonomive globale, duke e vlerësuar sistemin tatimor mjaft efikas si në aspektin e pagesave, kohës dhe procedurave tjera të nevojshme në realizimin e pagesës së tatimeve dhe taksave. Për të vlerësuar se si kanë ndikuar reformat institucionale të sistemit tatimor në Kosovë në procesin e miratimit kredive, bizneset dhe bankat komerciale në Kosovë janë pyetur për këto çështje: numrin total të tatimeve dhe kontributeve të paguara, metodën dhe shpeshtësinë e dorëzimit të pagesës, kohën e nevojshme për të paguar tatimet, tatimet totale dhe përqindja e kontributit si dhe rimbursimi i TVSH-së dhe auditimi i tatimit në të ardhurat e korporatës.

Rreth 70% e firmave të anketuara vlerësojnë se reformat e ndërmarra në pagesën e tatimeve kanë ndikuar pozitivisht në procesin e marrjes së kredive, ndërsa 21.4 prej këtyre firmave vlerësojnë se efekti është neutral. Në kuadër të 56 firmave të anketuara, 29 prej tyre janë përgjigjur se numri total i tatimeve dhe kontributeve të paguara, përqindja e kontributit dhe rimbursimi i TVSH-së kanë ndikuar shumë pozitivisht në procesin e marrjes së kredive. Reformat e tilla në sistemin tatimor iu kanë lehtësuar

firmave të cilat janë pagues të rregullt të tatimeve dhe kontributeve të caktuara të kenë një qasje më të lehtë në kreditë e bankave komerciale, sepse këto të fundit kërkojnë që firmat të kenë raporte të mira në shlyerjën e detyrimeve ndaj Administratës Tatimore të Kosovës.

Figura 6. 33. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – pagesa e tatimeve*



	Bizneset	Bankat Komerciale
Shumë negativisht	1.8%	0.0%
Negativisht	7.1%	0.0%
Neutral	21.4%	10.0%
Pozitivisht	51.8%	60.0%
Shumë Pozitivisht	17.9%	30.0%

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Në kuadër të bankave komerciale më shumë se 90% prej tyre kanë vlerësuar reformat e sistemit tatimor kanë ndikuar pozitivisht në procesin e dhënies së kredive. Informacioni që më së shumti iu nevojitet bankave komerciale gjatë procesit të miratimit të kredive është gjendja sa janë të rregullta firmat në pagesën e tatimeve, kontributeve si dhe shumat e rimbursimit të TVSH-së.

Tabela 6. 45. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe tregtinë përtej kufijve*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Qasja në kredi	43	32	24	23	28	23	28	20	12
Tregtia përtej kufijeve	132	130	131	124	121	118	71	51	48

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Kosova ka bërë progres shumë të madh në drejtim të reformimit të sistemit të tregtisë me vendet e tjera. Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, shohim që Kosova gjatë këtyre viteve të fundit ka përmirësuar dukshëm rangimin e saj në ranglistën botërore. Por, parashtrohet pyetja: cili është efekti i reformave të tilla në procesin e miratimit të kredive, sidomos për ato kompani të cilat eksportojnë dhe importojnë nga vendet e tjera dhe marrin kredi të ndryshme për financimin e aktivetit të tyre. Reformat kryesore të cilat janë ndërmarrë në sistemin e tregtimit me vendet e tjera janë: përputhshmëria me dokumentacionin – marrja, përgaditja dhe dorëzimi i dokumenteve gjatë transportit dhe inspektimeve

jashtë kufijeve, çdoganimi dhe inspektimet, ngarkimi dhe shkarkimi i dërgesës, transporti si dhe vonesat e trafikut dhe kontrollet e ndryshme.

Figura 6. 34. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – tregtimi përtej kufijeve*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Sipas rezultateve të anketimit me biznese, 42.9% e tyre kanë vlerësuar se efektet e reformave të ndërmarra në sistemin e tregtimit me vendet e tjera është neutral në procesin e marrjes së kredive bankare, ndërsa 32.1% nga këto biznese janë përgjigjur se këto reforma kanë ndikuar pozitvisht. Shumica e bankave komerciale kanë vlerësuar njësoj sikurse bizneset, se këto reforma nuk kanë ndonjë ndikim të rëndësishëm në procesin e dhënies së kredive. Në kuadër të bankave komerciale, vetëm dy analistë kreditorë, kanë vlerësuar se gjatë dhënies së kredive, për firmat të cilat eksportojnë, janë të rëndësishme dokumentet të cilat dëshmojnë për eksportimin e produkteve nga kompanitë të cilat kreditohen nga bankat komerciale.

Tabela 6. 46. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe zbatimin e kontratave*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Qasja në kredi	43	32	24	23	28	23	28	20	12
Zbatimi i kontratave	157	155	157	138	138	138	48	44	49

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Reformat e bëra në fushën e zbatimit të kontratave janë shumë të rëndësishme për procesin e miratimit të kredive. Kosova, sipas vlerësimeve të të bërit biznes ka bërë progres shumë të madh në aspektin e reformave të krijuara në zbatimin e kontratave. Pra, nga viti 2010 deri në vitin 2018 Kosova ka shënuar një ngritje në rangimin botëror për 108 vende, për nga lehtësirat e krijuara në aspektin e zbatimit të kontratave. Ashtu, siç është shpjeguar në vërtetimin e hipotezës së tretë, krijimi dhe

funksionalizimi i përmbaruesve privatë është një prej reformave më të rëndësishme në aspektin e drejtësisë, që ka lehtësuar në masë të madhe procesin e menaxhimit të kredive jo-performuese dhe ka krijuar një fleksibilitet më të madh në miratimin e kredive.

Figura 6. 35. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – zbatimi i kontratave*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Rezultatet e anketimit me biznese argumentojnë se pjesa më e madhe e firmave të anketuara (62.5%) kanë deklaruar se reformat e ndërmarra gjatë zbatimit të kontratave kanë pasur efekte pozitive në procesin e miratimit të kredive. Nga 56 firma të anketuara, 35 prej tyre kanë vlerësuar se koha e nevojshme për të zbatuar një kontratë nëpër përmbarues privat, kostoja e kërkuar për të zbatuar një kontratë (tarifat e avokatit, tarifat e përmbarimit dhe ato të ekzekutimit) dhe cilësia e këtyre proceseve ka ndikuar pozitivisht në disiplinimin e shumë bizneseve të cilat marrin kredi nga bankat komerciale.

Kjo nënkupton që këto reforma janë shumë strikte dhe korrekte, prandaj të gjitha bizneset i kanë parasysh pasojat e mundshme që mund të rezultojnë nga mos zbatimi i kushteve të parapara në kontratë. Mbi 80% e bankave të anketuara, kanë deklaruar së procesi i zbatimit të kontratave ka pasur ndikim pozitiv në dhënien e kredive dhe të gjitha këto reforma të ndërmarra sidomos nga viti 2014 e kanë lehtësuar shumë procesin e menaxhimit të kredive jo-performuese si dhe në vetëdijësimin e huamrrësëve që të shlyejnë detyrimet e tyre në kohën e duhur. Në këtë aspekt do të shohim se cilat janë efektet e reformave të ndërmarra gjatë zgjidhjes së paaftësisë paguese të firmave në procesin e miratimit të kredive bankare.

Njëra nga reformat mjaft të rëndësishme që ndikon në procesin e miratimit të kredive është zgjidhja e paaftësisë paguese të firmave. Në kuadër të këtyre reformave janë vlerësuar: koha e nevojshme për të

rikthyer borxhin, kostoja e kërkuar për të rikthyer borxhin, rezultatet – nëse biznesi vazhdon të funksionojë ose asetet e saj shiten ngadalë dhe norma e rikthimit për kreditorët.

Tabela 6. 47. *Analiza krahasuese e vlerësimit të Bankës Botërore për qasjen në kredi dhe zgjidhjen e paaftësisë paguese*

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Qasja në kredi	43	32	24	23	28	23	28	20	12
Zgjidhja e paaftësise paguese	28	31	31	87	83	164	163	163	49

Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Prej vitit 2017 Kosova ka bërë një reformë shumë të madhe në aspektin e rregullimit të paaftësisë paguese, duke e zbatuar me një efikasitet të madh kornizën ligjore për falimentimin e kompanive. Prandaj, siç shihet në Kosovë prej vitit 2017 deri në vitin 2018 kemi përmirësim të dukshëm në fushën e zbatimit të kornizës ligjore për zgjidhjen e paaftësisë paguese të firmave. Të gjitha ndryshimet e ligjeve në fushën e falimentimit, likuidimit dhe riorganizimit të firmave kanë ndihmuar shumë edhe procesin e miratimit të kredive në sistemin bankar në Kosovë.

Figura 6. 36. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – zgjidhja e paaftësisë paguese*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Sipas vlerësimeve të anketimeve me biznese, mbi 58% prej tyre kanë vlerësuar se lehtësirat të cilat janë krijuar në zgjidhjen e paaftësisë paguese të firmave kanë pasur efekte pozitive në procesin e marrjes së kredive bankare, ndërsa vetëm 25% prej tyre kanë deklaruar se efektet janë neutrale dhe 16% nga këto firma kanë vlerësuar se këto reforma kanë ndikuar negativisht. Nëse bazohemi në vlerësimet e dhëna nga analistët kreditorë, atëherë mbi 90% e këtyre bankave komerciale kanë dhënë vlerësime pozitive për reformat e ndërmarra në procesin e zgjidhjes së paaftësisë paguese. Analistët kreditorë kanë deklaruar se në momentin kur firmat e ndryshme bëjnë kërkesë për të inicuar procedurën e falimentimit,

likuidimit ose riorganizimit, të gjitha informacionet barten tek zyra e regjistrit kreditor dhe këto informacione i ndihmojnë bankat në përzgjedhjen e firmave të mundëshme për huamarrës potencial.

Figura 6. 37. *Rezultatet e anketimit me biznese dhe bankat komerciale – rregullimi i tregut të punës*



Burimi: Përpunimi i të dhënave nga autori

Njëri nga kriteret e rëndësishme që ndikon në përmirësimin e klimës së biznesit dhe ndikon në procesin e miratimit të kredive janë edhe reformat e ndërmarra në aspektin e rregullimit të tregut të punës. Në këtë pikë janë vlerësuar punësimi, përvoja e punës, paga minimale, orari i punës, numri i punëtorëve dhe çështje të tjera të cilat janë të ndëlidhura me rregullimin e tregut të punës. Nga 56 biznese të anketuara, pjesa më e madhe e tyre (44.6%) janë përgjigjur se reformat e ndërmarra në tregun e punës nuk kanë pasur ndonjë ndikim të madh në procesin e miratimit të kredive, vlerësim ky i cili është në përputhje edhe vlerësimin e analistëve të kredisë, të cilët po ashtu mendojnë që këto reforma nuk kanë pasur ndonje efekt shumë të rëndësishëm në procesin e miratimit të kredive.

6.11. Analiza faktoriale – metoda e komponentëve themelorë

Për të testuar validitetin e hipotezës së katërt ne do të përdorim fillimisht analizën faktoriale nëpërmjet metodës së komponentëve themelorë. Analiza faktoriale është një ndër teknikat statistikore me shumë ndryshore e cila përdoret për të reduktuar numrin e ndryshoreve që janë në lidhje me njëra-tjetrën me një numër të vogël të faktorëve të rëndësishëm të pavarur me njëri tjetrin. Meqënëse në hipotezën e katërt ne kemi përfshirë 11 variabla të cilat janë matur nëpërmjet shkallës së Likertit nga 1 deri në 5, atëherë qëllimi kryesor i përdorimit të analizës faktoriale do të jetë reduktimi i numrit të ndryshore në disa faktorë të rëndësishëm që janë të pavarur me njëri – tjetrin.

Për të reduktuar numrin e variablave në këtë model ekonometrik, ne do të aplikojmë metodën e komponentëve themelorë, metodë kjo e cila llogarit faktorin e parë që shpjegon variancën ndërmjet ndryshoreve. Analiza faktoriale do të realizohet në katër faza: së pari do të vlerësohet përshtatshmëria e e setit të të dhënave për analizën faktoriale, përfitimi i faktorëve, rotacioni i faktorëve dhe emërimi i këtyre faktorëve.

Për të vlerësuar përshtatshmërinë e të dhënave në analizën faktoriale përdoren këto metoda: krijimi i i matricës së korrelacioneve, testi Barlett dhe testi Kaiser-Meyer-Olkin (KMO). Në vazhdim do të paraqesim rezultatet e analizës faktoriale nëpërmjet metodës së komponentëve themelorë si dhe interpretimin e rezultateve.

Tabela 6. 48. *Rezultatet – KMO dhe Bartlett's Test*

Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy.		**.791**
Bartlett's Test of Sphericity	Approx. Chi-Square	451.176
	df	55
	Sig.	.000

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Siç shihet në tabelën e mësipërme, testi KMO është 79.1% dhe kjo nënkupton se seti i të dhënave është i përshtatshëm për analizën faktoriale për arsye sepse vlera e këtij testi është më i madh se 0.50, pra 0.791 > 0.50. Testi i dytë të cilin do ta shikojmë është Testi Barlett. Duke u bazuar në tabelën 6.48, testi Barlett është i rëndësishëm dhe kjo do të thotë që ekzistojnë korrelacione të larta ndërmjet ndryshoreve , pra në përgjithësi seti i të dhënave është i përshtatshëm për analizën faktoriale.

Tabela 6. 49. *Numri i faktorëve në fidhje me vlerën Eigen dhe përqindja shpjeguese e variancës*

Component	**Initial Eigenvalues**			**Extraction Sums of Squared Loadings**			**Rotation Sums of Squared Loadings**		
	Total	% of Variance	Cumulative %	Total	% of Variance	Cumulative %	Total	% of Variance	Cumulative %
1	5.015	45.591	45.591	5.015	45.591	45.591	4.927	44.795	44.795
2	2.332	21.201	66.792	2.332	21.201	66.792	2.420	21.997	66.792
3	.936	8.513	75.306						
4	.758	6.893	82.198						
5	.655	5.953	88.151						
6	.464	4.218	92.369						
7	.279	2.532	94.901						
8	.246	2.236	97.137						
9	.184	1.669	98.805						
10	.078	.713	99.518						
11	.053	.482	100.000						

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Një hap tjetër shumë i rëndësishem në këtë analizë është përcaktimi i numrit të faktorëve më të mëdhenj se 1. Në tabelën 6.49. janë të paraqitura rezultatet e kësaj analize që përcaktohet numri i faktorëve në lidhje me vlerën Eigen dhe përqindja shpjeguese e variancës. Në këtë tabelë janë vetëm dy faktorë më të mëdhenj se vlera 1. Faktori i parë e shpjegon variancën totale për 44.795%, ndërsa ndërsa faktori i dytë së bashku me faktorin e parë e shpjegojnë variancën totale për 66.792%.

Figura 6. 38. *Grafiku i analizës faktoriale për hipotezën e katërt*



Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Siç vërehet nga figura e mësipvrme numri i faktorëve përcaktohet deri në pikën kur vija e pjerrësisë fillon të humb në grafik. Në bazë të kësaj, vërehet që pas pikës së tretë vija e grafikut do të fillojë të humb trendin në masë të konsiderueshme. Nga kjo, numrin e faktorëve mund ta kufizojmë në 2 ose 3, por në bazë të rezultateve në tabelën 6.48, rezulton që 11 variablat e kësaj hipoteze janë kategorizuar në 2 faktorë të pavarur me njëri-tjetrin. Në vazhdim të analizës faktoriale, do të kalojmë tek faza e rotacionit, ku në këtë matricë do të shihen korrelacionet ndërmjet ndryshores origjinale dhe faktorit të saj. Peshat që janë mbi vlerën 0.50 dhe më lartë pranohen si vlera shumë të mira.

Tabela 6. 50. *Matrica e faktorëve të rrotulluar*

Variablat	Component	
	1	2
Fillimi i një biznesi	.942	.085
Pagesa e tatimeve	.915	.019
Qasja në kredi	.915	.024
Zbatimi i kontratave	.914	.028
Zgjidhja e paaftësisë paguese	.897	-.026

Rregullimi i tregut te punës	.646	.091
Mbrotja e investitorëve	.004	.890
Furnizimi me energji elektrike	-.031	.751
Marrja e lejës së ndërtimit	.282	.605
Tregtia përtej kufijeve	-.177	.598
Regjistrimi i pronës	.443	.568

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Në tabelën e mësipërme janë dhënë 2 faktorë dhe peshat e secilës ndryshore nën faktorë. Në bazë të këtyre rezultateve në faktorin e parë, peshën më të madhe e ka ndryshorja *(fillimi i një biznesi)* me 0.942, pastaj pagesa e tatimeve (0.915), qasja në kredi (0.915), zbatimi i kontratave (0.914), zgjidhja e paaftësisë paguese (0.897) dhe rregullimi i tregut të punës (0.646), ndërsa në faktorin e dytë peshën më të madhe e mbrojtja e investitorëve (0.890), furnizimi me energji elektrike (0.751), marrja e lejes së ndërtimt (0.605), tregtia përtej kufijve (0.598) dhe regjistrimi i pronës (0.568).

Pra, nëpërmjet analizës faktoriale arritëm që të reduktojmë nivelin e ndryshoreve nga 11, i reduktuam në 2 faktorë kryesorë të cilët janë të pavarur njëri me tjetrin. Meqënëse ndryshoret të cilat bëjnë pjesë në faktorin e parë dhe shpjegojnë për 44.79% variancën totale të modelit, ateherë në analizën e besueshmërisë do t'i marrim parasyh vetëm këto variabla që kanë peshë më të madhe në faktorin e parë. Ndryshoret më të rëndësishme janë: fillimi i një biznesi, zbatimi i kontratave, qasja në kredi, pagesa e tatimeve dhe zgjidhja e paaftësisë paguese. Të gjitha këto ndryshore kanë të bëjnë me reformat institucionale që ndihmojnë qasjen e firmave në financa, prandaj këtë faktor do ta emërtojmë me emrin reformat e të bërit biznes.

6.12. Analiza e besueshmërisë sipas modelit Alpha dhe analiza e regresionit të shumëfishtë standard

Analiza e besueshmërisë është metodë e zhvilluar për vlerësimin e karakteristikave dhe besueshmërisë së testeve, anketave apo matësve të përdorur gjatë matjes. Nëpërmjet koeficientit Alpha, do të bëjmë matjen e besueshmërisë së të dhënave të cilat janë përdorur në analizën faktoriale.

Kjo metodë hulumton nëse pyetjet të cilat marrin pjesë në matës a tregojnë strukturë homogjene në përgjithësi. Është mesatarja e ndryshimit standart të ponderuar dhe përfitohet me ndarjen e totalit të variancave të pyetjeve të një matësi me variancën e përgjithshme. Në vijim do të paraqesim edhe rezultatet e kësaj analize.

Tabela 6. 51. *Rastet e selektuara për analizën e besueshmërisë*

Case Processing Summary		N	%
Cases	Valid	56	100.0
	Excluded[a]	0	0.0
	Total	56	100.0

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Tabela 6. 52. *Vlera e koeficientit Alpha*

Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.960	.960	5

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Tabela 6.51 e titulluar Case Processing Summary jep përshkrimin e rasteve të selektuara për analizën e besueshmerisë. Në këtë analizë janë të përfshirë 56 observime dhe janë marrë parasysh vetëm ndryshoret e faktorit të parë, të cilat kanë rezultuar që janë të rëndësishme dhe kanë peshë më të madhe në variacën totale të modelit. Tabela 6.52 e titulluar Reliability Statitstics jep vlerën e koeficientit Alpha të Cronbach dhe numrin e njësive të selektuara për shkallën. Për shkallën tonë të besueshmërisë ne gjejmë vlerën alpha të Cronbach që të jetë 0.96. Vlera e këtij koeficienti tregon që ndryshoret që janë përfshirë në model kanë një shkallë të lartë të besueshmërisë.

Tabela 6. 53. *Statistikat e analizës së besueshmërisë*

Variablat	Mean	Std. Deviation	N
Zbatimi i kontratave	3.41	1.023	56
Fillimi i një biznesi	3.32	1.011	56
Qasja në kredi	3.21	1.074	56
Pagesa e tatimeve	3.21	1.107	56
Zgjidhja e paaftësisë paguese	3.36	1.034	56

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Në tabelën 6.53 janë të paraqitura statistikat deskriptive të analizës së besueshmërisë, duke përfshirë vlerën mesatare, devijimin standard dhe numrin e observimeve. Ndërsa në tabelën 6.54 janë të paraqitura rezultatet e matricës së korrelacionit mes variablave të ndryshme të këtij modeli ekonometrik. Korrelacioni në mes variablave zbatimi i kontratave dhe qasjes në kredi është korrelacion pozitiv i lartë

(0.796), që nënkupton se zbatimi i reformave institucionale në fushën e zbatimit të kontratave ka ndikuar përmirësimin e qasjes në financa.

Tabela 6. 54. *Matrica e korrelacionit*

Variablat	Zbatimi i kontratave	Fillimi i një biznesi	Qasja në kredi	Pagesa e tatimeve	Zgjidhja e paaftësisë paguese
Zbatimi i kontratave	1.000	.890	.796	.756	.769
Fillimi i një biznesi	.890	1.000	.873	.847	.775
Qasja në kredi	.796	.873	1.000	.893	.781
Pagesa e tatimeve	.756	.847	.893	1.000	.884
Zgjidhja e paaftësisë paguese	.769	.775	.781	.884	1.000

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Gjithashtu, edhe variablat tjera si fillimi i një biznesi, pagesa e tatimeve dhe zgjidhja e paaftësisë paguese kanë korreleacion pozitiv me qasjen në kredi dhe kjo nënkupton që këto reforma institucionale kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e qasjes së këtyre bizneseve në kreditë e bankave komerciale. Në tabelën 6.55 janë të paraqitura në formë të përmbledhur të gjitha statistikat deskriptive të kësaj analize, siç janë: mesatarja, vlerat minimale dhe maksimale, rangimi, varianca etj.

Tabela 6. 55. *Përmbledhja e statistikave deskriptive të analizës së besueshmërisë*

	Mean	Minimum	Maximum	Range	Maximum / Minimum	Variance	N of Items
Item Means	3.304	3.214	3.411	.196	1.061	.008	5
Item Variances	1.104	1.022	1.226	.204	1.199	.007	5
Inter-Item Covariances	.911	.810	1.062	.252	1.311	.007	5
Inter-Item Correlations	.826	.756	.893	.138	1.182	.003	5

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Mesatarja e përgjithshme (grand mean) e ndryshoreve është 3.304 dhe varianca mesatare 1,104. Intervali i mesatareve të 5 ndryshoreve është 0,196 dhe intervali i ndryshimit të variancave është 0,204. Në analizën tonë, korrelacionet (Item-Total) janë ndërmjet 0,853 dhe 0,912 dhe si të tilla paraqesin vlera të larta. Koeficienti i përgjithshëm Alpha i besueshmërisë së matësit i llogaritur në tabelën 6.56 është 0,96. Kjo është një vlerë e lartë dhe tregon se matësi i përdorur është shumë i besueshëm.

Tabela 6. 56. *Përmbledhja e statistikave të përgjithshme të analizës së besueshmërisë*

Variablat	Scale Mean if Item Deleted	Scale Variance if Item Deleted	Corrected Item-Total Correlation	Squared Multiple Correlation	Cronbach's Alpha if Item Deleted
Zbatimi i kontratave	13.11	15.770	.853	.824	.955
Fillimi i një biznesi	13.20	15.470	.912	.878	.946
Qasja në kredi	13.30	15.088	.899	.852	.948
Pagesa e tatimeve	13.30	14.761	.912	.899	.946
Zgjidhja e paaftësisë paguese	13.16	15.665	.856	.819	.955

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Me nxjerrjen e variablave përkatëse nga matësi, me rastin e krahasimit të koeficientit Alpha me koeficientin e përgjithshëm Alpha të besueshmërisë mund të shohim se vlerat e llogaritura janë shumë afër vlerës së përgjitshme Alpha 0,96 apo më të ulëta. Ky rast tregon se të gjitha variablat duhet të marrin pjesë në matës. Në tabelën 6.57 janë të paraqitura statistikat e shkallës, ku mesatarja e faktorit të parë të përbërë nga 5 ndryshore është 16.52 dhe devijimi standart 4.873.

Tabela 6. 57. *Statistikat e shkallës*

Mean	Variance	Std. Deviation	N of Items
16.52	23.745	4.873	5

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Në këtë analizë të besueshmërisë sipas vlerës së përfituar Alpha mund të bëjmë renditjen e reformave institucionale sipas ndikimit të tyre nga vlera më e vogël tek vlera më e madhe (fillimi i një biznesi, pagesa e tatimeve, qasja në kredi, zbatimi i kontratave dhe zgjidhja e paaftësisë paguese). Sipas kësaj renditjeje këto janë reformat më të rëndësishme institucionale të cilat kanë ndikuar pozitivisht në drejtim të rritjes së kreditimit të bankave komerciale ndaj sektorit real të ekonomisë dhe janë matës që kanë një shkallë shumë të lartë të besueshmërisë.

Duke u bazuar në rezultatet e analizës faktoriale, ku nëpërmjet saj reduktuam numrin e variablave në dy faktorë të rëndësishem dhe të pavarur me njëri-tjetrin dhe nëpërmjet analizës së besueshmërisë sipas modelt Alpha identifikuam rëndësinë e secilit parametër në këtë hipotezë. Pra, si konkluzion i kësaj

analize mund të themi se reformat më të rëndësishme institucionale që kanë ndikuar në rritjen e kreditimi të bankave ndaj sektorit real të ekonomisë janë reformat e ndëmarra në fillimin e një biznesi, pagesën e tatimeve, qasjes në kredi, zbatimin e kontratave si dhe zgjidhjen e paaftësisë paguese.

Për të parë se sa kanë ndikuar këto reforma institucionale në përmirësimin e firmave për t'iu qasur kredive të bankave komerciale ne do të ndërtojmë dy modele ekonometrike dhe testimin do ta bëjmë nëpërmjet regresionit të shumëfishtë standard.

Forma e përgjithshme e ekuacionit të analizës së regresionit të shumëfishtë standard është:

$$Y = \beta_0 + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + e$$

Ku:

Y = qasja në kredi (variabla e varur)

β_0, β_1 dhe β_2 – parametrat e modelit ekonometrik

X_1 – fillimi i një biznesi (varibla e pavarur)

X_2 – pagesa e tatimeve (variabla e pavarur)

e – variabla stohastike (termi i gabimit të modelit).

$$\text{Qasja në kredi} = \beta_0 + \beta_1 \text{ (Fillimi i një biznesi)} + \beta_2 \text{ (Pagesa e tatimeve)} + e$$

Hipoteza bazë: *Reformat institucionale që kanë lehtësuar procedurat, kohën dhe koston për fillimin e një biznesi dhe pagesën e tatimeve nuk kanë ndikuar në rritjen e kreditimit të bizneseve nga bankat komerciale.*

Hipoteza alternative: *Reformat institucionale që kanë lehtësuar procedurat, kohën dhe koston për fillimin e një biznesi dhe pagesën e tatimeve kanë ndikuar në rritjen e kreditimit të bizneseve nga bankat komerciale.*

Tabela 6. 58. *Përmbedhja e statistikave të modelit të parë ekonometrik*

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Durbin-Ëatson
1	.920[a]	.846	.840	.429	2.082

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Në tabelën e mësiperme janë të paraqitura të dhënat përmbledhëse të modelit. Vlera e koeficientit të koreelacionit është 0.920, që tregon një korrelacion shumë të lartë në mes vlerave të X dhe Y. Ky korrelacion tregon që reformat institucionale të ndërmarra në procedurat, kohën dhe koston e kërkuar për të filluar një biznes dhe në pagesën e tatimeve kanë ndikuar pozitivisht në qasjen e ndërmarrjeve në kreditë e bankave komerciale.

Vlera e koeficientit të përcaktimit është 0.846, që tregon se për vlerën 84.6% variablat e pavarura e shpjegojnë variablën e varur (qasjen në kredi). Përderisa vlera e gabimit standard të modelit është e = 100% - R Square = 100% - 84.6% = 15.4% ose 0.154. Vlera e koeficientit Durbin Ëatson është 2.082, që tregon se ky model ekonometrik nuk ka autokorrelacion.

Tabela 6. 59. *Rezultatet e analizës Anova për modelin e parë ekonometrik*

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	53.678	2	26.839	145.882	.000[b]
	Residual	9.751	53	.184		
	Total	63.429	55			

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Në tabelën 6.59 janë të paraqitura rezultatet e analizës së variancës, ku fokusi i analizës tonë do të jenë të dhënat për vlerat e F – testit dhe niveli i signifikancës për modelin në tërësi. Vlera kritike e F – Testit është $\mathbf{F_{kr}=F_{0.05;\ (3-1),\ (56-1)}=3.15}$, dhe duke u bazuar në këtë vlerë, ateherë mund të konkludojmë që hipoteza bazë nuk pranohet, pasi që vlera faktike e F – testit është një vlerë më e madhe se vlera kritike (145.882 > 3.15), pra në këtë rast hipoteza pranohet alternative. Vlen të theksohet se modeli në tërësi është signifikant, sepse vlera e P-value është 0.000 < 0.05.

Tabela 6. 60. *Rezultatet e analizës së regresionit të shumëfishtë standard për modelin e parë ekonometrik*

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	.063	.199		.317	.753
	Fillimi i një biznesi	.438	.108	.412	4.070	.000
	Pagesa e tatimeve	.528	.098	.544	5.373	.000

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Sipas rezultateve të analizës së regresionit, mund të vërejmë që të dyja variablat e pavarura kanë rëndësi statistikore, pasi vlera e signifikanës është në nivelin standard 95%. Nëse për 1% do të kemi rritje të përmirësimit të reformave në procedurat, kohën dhe koston e kërkuar për të filluar një biznes, atëherë kjo do të ndikojë në rritjen e qasjes së firmave në kreditë e bankave komerciale për 0.43%, duke mbajtur konstant faktorët e tjerë. Në të njejtën mënyrë mund të interpretojmë edhe pohimin, nëse për 1% kemi rritje të përmirësimit të reformave institucionale në aspektin procedural, kohor dhe atë financiar në pagesën e tatimeve, atëherë efektet do të jenë që për vlerën 0.52% do të rritet qasja e bizneseve në kreditë e bankave komerciale.

Nëse e krahasojmë vlerën kritike dhe vlerat faktike të T - testit, atëherë vlerat faktike që janë 4.07 dhe 5.373 janë vlera më të mëdha se ajo kritike $\mathbf{t_{kr}=t_{\alpha/2;n-k}=t_{0.025;55}=1.671.}$ Kjo nënkupton që hipoteza bazë refuzohet dhe pranohet hipoteza alternative që reformat institucionale (fillimi i një biznesi dhe pagesa e tatimeve) në funksion të përmirësimit të klimës biznesore kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë (qasja në kredi).

Në vazhdim të analizës së regresionit të shumëfishtë standard do të japim përgjigjje edhe në pyetjen se si kanë ndikuar reformat institucionale (zbatimi i kontratave dhe zgjidhja e paaftësisë paguese) në rritjen e kreditimit të bizneseve. Forma e përgjithshme e ekuacionit të analizës së regresionit të shumëfishtë standard është:

$$Y = \beta_0 + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + e$$

Ku:

Y = qasja në kredi (variabla e varur)

β_0, β_1 *dhe* β_2 *– parametrat e modelit ekonometrik*

X_1 *– zbatimi i kontratave (varibla e pavarur)*

X_2 *– zgjidhja e paaftësisë paguese (variabla e pavarur)*

e – variabla stohastike (termi i gabimit të modelit).

$$\textit{Qasja në kredi} = \beta_0 + \beta_1\ (\textit{Zbatimi i kontratave}) + \beta_2\ (\textit{Zgjidhja e paaftësisë paguese}) + e$$

Hipoteza bazë: *Reformat institucionale që kanë lehtësuar procedurat, kohën dhe koston në zbatimin e kontratave dhe zgjidhjen e paaftësisë paguese nuk kanë ndikuar në rritjen e kreditimit të bizneseve nga bankat komerciale.*

Hipoteza alternative: *Reformat institucionale që kanë lehtësuar procedurat, kohën dhe koston në zbatimin e kontratave dhe zgjidhjen e paaftësisë paguese kanë ndikuar në rritjen e kreditimit të bizneseve nga bankat komerciale.*

Tabela 6. 61. *Përmbedhja e statistikave të modelit*

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Durbin-Ëatson
1	.838[a]	.703	.692	.596	1.955

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Sipas rezultateve të prezentuara në tabelën e mësipërme vërehet që kemi korrelacion të lartë pozitiv (0.838) mes variablës së varur (qasja në kredi) dhe variablave të pavarura (zbatimi i kontratave) dhe (zgjidhja e paaftësisë paguese). Vlera e koeficientit të përcaktimit është 0.703, që tregon se për këtë vlerë 70.3% reformat e ndërmarra në fushën e zbatimit të kontratave dhe zgjidhjen e paaftësisë paguese e shpjegojnë përmirësimin e qasjes së bizneseve në kreditë e bankave komerciale. Vlera e termit të gabimit në këtë rast është 0.596, që tregon se të gjithë faktorët e tjerë që nuk janë marrë parasysh në këtë model ekonometrik. Ndërsa, në bazë të vlerës së koeficientit Durbin Ëatson shohim që modeli qëndron shumë mirë në aspektin statistikor, sepse vlera e këtij koeficienti është 1.955 që tregon se ky model nuk ka autokorrelacion.

Tabela 6. 62. *Rezultatet e analizës Anova për modelin e dytë ekonometrik*

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	44.577	2	22.288	62.662	.000[b]
	Residual	18.852	53	.356		
	Total	63.429	55			

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Rezultatet e analizës së variancës tregojnë që modeli në tërësi është i rëndësishëm pasi niveli i signifikancës është brenda intervalit të besueshmërisë prej 95%. Vlera faktike e F-testit është një vlerë më e madhe se ajo kritike (62.662 > 3.15) dhe në bazë të këtij pohimi mund të konkludojmë se hipoteza

bazë refuzohet dhe hipoteza alternative pranohet. Pra, të gjitha reformat të cilat janë ndërmarrë për të lehtësuar procesin e zbatimit të kontratave dhe zgjidhjen e paaftësisë paguese kanë ndihmuar shumë biznese që të kenë qasje më të lehtë në kreditë e bankave komerciale, si dhe i ka ndihmuar këto të fundit që të menaxhojnë me efikasitet më të madh edhe kreditë jo-performuese si rezultat i këtyre reformave institucionale.

Tabela 6. 63. *Rezultatet e analizës së regresionit të shumëfishtë standard për modelin e parë ekonometrik*

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	.064	.293		.218	.829
	Zbatimi i kontratave	.501	.123	.477	4.071	.000
	Zgjidhja e paaftësisë paguese	.429	.122	.414	3.527	.001

Burimi: Llogaritjet e autorit në SPSS

Në përfundim të kësaj analize empirike, do të interpetojmë edhe rezultatet e analizës së regresionit të shumëfishtë standard për modelin e dytë ekonometrik. Sipas këtyre vlerësimeve ekonometrike, të dy variablat e pavarura janë signifikante dhe kanë ndikim pozitiv në rritjen e kredimit të bizneseve nga bankat komerciale. Nëse për 1% kemi rritje në përmirësimin e reformave të ndërmarra në procedurat, kohën dhe koston e nevojshme gjatë procesit të zbatimit të kontratave, ateherë kjo do të lehtësojë bizneset për 0.50% që të kenë qasje në kreditë e bankave komerciale, duke mbajtur faktorët e tjerë konstantë. Gjithashtu, nëse për 1% kemi rritje në përmirësimin e reformave institucionale në funksion të procedurave, kohës dhe kostos së nevojshme për zgjidhjen e paaftësisë paguese të firmave, atëherë efektet do të jenë se për vlerën 0.42% do të lehtësohet qasja e bizneseve në kreditë e bankave komerciale.

Pra, si konkluzion i kësaj analize empirike është se reformat institucionale në funksion të përmirësimit të klimës biznesore kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kredimit të sektorit real të ekonomisë. Sipas rezultateve të këtij studimi, reformat që më së shumti e kanë rritur qasjen e bizneseve në kreditë e bankave komerciale janë lehtësimet e bëra në aspektin e procedurave, kohës dhe kostos së nevojshme për fillimin e një biznesi, pagesën e tatimeve, zbatimin e kontratave dhe zgjidhjen e paaftësisë paguese.

KAPITULLI VIII

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ndikimi ekonomik që kanë bankat komerciale në zhvillimin ekonomik të një vendi janë shumë të rëndësishme për ruajtjen e nivelit aktual ekonomik dhe për zhvillimin në perspektivë. Bankat dhe institucionet e tjera financiare janë transformatorët e kursimeve në investime dhe pastaj kthehen sërish në kursime. Pagesat dhe konsumi kryesisht drejtohen përmes bankave, duke përfshirë eksportet, importet si dhe shpenzimet qeveritare fakt ky që kërkonë një sistem financiar funksional dhe të qëndrueshëm. Bankat si ndërmjetës financiar kanë njohuri të avansuara dhe specializuara për të investuar në zona që ofrojnë kthim më të lartë dhe kjo luan rol dhe në tërheqje të depozitave më të mëdha në perspektivë. Shuma e kredive në vitin 2018 në sektorin bankar në Kosovë ka arritur vlerën prej 2.75 miliard €, ndërsa depozitat kan evidentuara nivelin prej 3.22 miliard €.

Për të studjuar ndikimin e politikave kreditore të bankave komerciale në zhvillimin e sektorit real në vende të ndryshme (të zhvilluara dhe në zhvillim-tranzicion) janë realizuar shumë studime nga autorë të ndryshëm të cilët kanë nxitur shumë debate shkencore dhe profesional në lidhje me efektet e kreditimit në rritjen ekonomike. Duke pasur parasysh debatin në vazhdimësi në vendet e Ballkanit Përendimor për sa i përket ndikimit të politikave kreditore të bankave komerciale në zhvillimin e sektorit real ky studim synon të analizojë kontributin e bankave komerciale në zhvillimin e sektorit real të ekonomisë së Kosovës si pjesë e Ballkanit Përendimor.

Ky studim ka pasur si pyetje të parë kërkimore nëse bankat komerciale nëpërmjet procesit të kreditimit kanë realizuar ndikim përmbajtësor në sektorin real të ekonomisë së Kosovës. Për hulumtimin e kësaj pyetje kërkimore dhe vërtetimin e vlefshmërisë së hipotezës së parë janë mbledhur të dhënat për PBB-në shumën e kredive për biznese, normën e interesit në kredi dhe indeksin e çmimit të konsumatorit për periudhën kohore 2005–2018. Të dhënat janë të raportuara në baza mujore dhe janë mbledhur nga raportet financiare vjetore të Bankës Qëndrore të Kosovës, Bankës Botërore, Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës. Duke u bazuar në analizën empirike përmes modeleve ekonometrike dhe analizave të trendit, rezultatet kanë treguar se ekzistojnë marrëdhënie të rëndësishme midis variablave të studimit dhe rezulton që kjo analizë empirike është e mundur.

Rezultatet dëshmojnë që **bankat komerciale nëpërmjet procesit të kreditimit kanë pasur ndikim përmbajtësor pozitiv në zhvillimin e sektorit real në ekonominë e Kosovës.** Konkluzionet kryesore të cilat rezultojnë nga analiza e parë empirike janë :

- Në bazë të statistikave deskriptive, rezulton që të gjitha variablat e përfshira në model kanë shpërndarje normale dhe tregojnë që vlerat e këtyre ndryshoreve janë mjaft të sakta që kanë ndikuar në rritjen e besueshmërisë statistikore të modelit ekonometrik.

- Sipas rezultateve të analizës së korrelacionit vërehet që kemi një lidhje lineare pozitive në mes PBB-së dhe kredive bankare (0.868), që nënkupton se rritja e vëllimit të kredive për biznese ka shkaktuar rritje të PBB-së .

- Në bazë të kësaj analize, rezulton që kemi një lidhje lineare negative në mes normës së interesit në kredi dhe PBB-së (- 0.819), ku rritja e normave të interesit në kredi do të shkaktojë zvoglim të PBB-së dhe e kundërta.

- Ndërsa në mes indeksit të çmimit të konsumatorëve dhe produktit të brendshëm bruto ekziston një lidhje e lartë lineare pozitive (0.800), ku rritja e inflacionit ka shkaktuar rritjen e PBB-së në Kosovë për periudhen kohore 2005 – 2018.

- Në bazë të rezultateve empirike përmes modeleve ekonometrike mund të konkludohet se kreditë bankare dhe indeksi i çmimit të konsumatorit kanë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike, ndërsa normat e interesit në kredi kanë ndikim negativ. Të gjitha këto variabla janë të rëndësishme (signifikante) në nivelin standard të rëndësisë statistikore.

- Nëse kreditë bankare, normat e interesit në kredi dhe indeksi i çmimit të konsumatorit janë konstante, ateherë vlera e PBB-së do të jetë 2.46 miliard €. Nëse kemi rritje të kredive bankare për 1%, duke mbajtur konstante normat e interesit në kredi dhe indeksin e çmimit të konsumatorit, ateherë kjo do të ndikojë në rritjen e produktit të brendshëm bruto për 0.32%.

- Një rritje prej 1% e normës së interesit në kredi, duke mbajtur konstante shumën e kredive bankare dhe indeksin e çmimit të konsumatorit do të shkaktojë rënie në vlerën e PBB-së për – 0.18% dhe rritja për 1 njësi në indeksin e çmimit të konsumatorit, duke mbajtur konstant faktorët e tjerë (kreditë bankare dhe normën e interesit në kredi), ateherë kjo do të ndikojë në rritjen e PBB – së për 0.58%.

- Sipas rezultateve të analizës së trendit në mes të PBB-së në bujqësi dhe kredive bujqësore, vërehet një trend pozitiv i rritjës ekonomike në këtë sektor si rezultat i dhënies së kredive bujqësore. Gjatë periudhës kohore 2005 – 2018, kreditë bujqësore kanë shënuar një rritje nga 12.5 milion € në 67.7 milion €, rritje kjo e cila është shoqëruar me një rritje të vlerës së PBB-së në bujqësi nga 346.9 milion € në 689.3 milion €. Vlen të theksohet se këto ndryshore përmes analizës së trendit janë të shpjegueshme në nivelin e 94,77%.

- Rezultatet e analizës së trendit linear identifikojnë një ndikim pozitiv të kredive në sektorin e industrisë, prodhimtarisë, energjetikës dhe ndërtimtarisë në rritjen ekonomike të këtyre sektorëve. Periudha kohore 2005 – 2018 në Kosovë është shoqëruar me një rritje të kredive në këta sektorë nga vlera 74.2 milion € në 428.5 milion € dhe produkti i brendshëm bruto është rritur nga vlera 678.9 milion € në 1.75 miliard €. Në bazë të kësaj analize vërehet që kemi një trend rritës pozitiv të kredive në sektorin e industrisë, prodhimtarisë, energjetikës dhe ndërtimtarisë dhe rritjes ekonomike në këta sektorë të rëndësishëm të ekonomisë së Kosovës. Këto dy variabla janë të shpjegueshme në nivelin e 91,48%.

- Duke u bazuar në rezultatet e analizës së trendit linear në mes kredive në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve në rritjen ekonomike të këtyre sektorëve, ateherë vërehet një trend pozitiv në mes të këtyre dy variablave. Kreditë në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve në Kosovë për periudhën kohore 2005 – 2018 kanë shënuar një rritje nga 301.1 milion € në 1.23 miliard €, ndërsa PBB-ja në vitin 2005 kishte një vlerë prej 1.62 miliard €, vlerë kjo e cila në fund të vitit 2018 ka arritur në 3.24 miliard €. Këto dy variabla janë të shpjegueshme në nivelin e 97,83%.

- Në bazë të rezultateve të analizës së trendit logaritmik në mes indeksit të çmimit të konsumatorit dhe vlerës së PBB-së në Kosovë, për periudhën kohore të analizuar rezulton që inflacioni ka ndikuar në rritjen e vlerës së PBB-së nga 3.06 miliard € në 6.76 miliard €. Të dyja këto variabla janë të shpjegueshme në nivelin e 86,59%.

- Analiza e trendit eksponencial tregon që ulja e vazhdueshme e normave të interesit në kredi në disa vite ka shkaktuar rritjen e vlerës së PBB-së, por edhe rënie në vlerën e produktit të brendshëm bruto. Pra, edhe pse gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur rënie të vazhdueshme të normave të interesit në kredi, prap se prapë këto norma të interesit janë shumë të larta dhe shkaktojnë një kosto të lartë të huamarrjës, sidomos për bizneset e reja të cilat si burim kryesor të financimit i kanë kreditë e bankave komerciale.

Bazuar në rezultatet e mësiperme jipen rekomandimet vijuese :

- Bankat duhet të rrisin potencialin e tyre kreditor, duke pasur parasysh likuiditetin e tepruar dhe kjo situat të nxit në masë më të madhe edhe ofertat kreditore më të favorshme ndaj dy sektorëve të ekonomisë (ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve).

- Bankat duhet të përmirësojnë dhe të lehtësojnë edhe më shumë kushtet për dhënien e kredive, si uljen e normave të interesit në kredi, rritjen e maturitetit të kredive si dhe lehtësime në kolateralin e kërkuar në nivelin e mesatares së vendeve të Ballkanit Përëndimor.

- Bankat duhet të aplikojn norma te interesit të subvencionuara për kreditë në sektorin e bujqësisë dhe prodhimtarisë, si dy degë shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe për zvoglimin e papunësis në vend.

- Bankat komerciale në Kosovë kan hapësirë të zvoglojnë margjinën e normave të interesit në mes normave të interesit në kredi dhe të normave të interesit në depozita, në mënyre që ndërmarrjet e sektorit real e sidomos ndërmarrjet e reja të kenë një kosto më të ulët të huamarrjës.

- Duke ditur që raporti i kreditimit bankar ndaj PBB-së është 41.4% tregon se sektori financiar në Kosovë është ende në zhvillim dhe është një tregues i niveleve të ulëta të kreditimit, madje edhe kur krahasohet me mesataren e Ballkanit Përendimor prej 55%, ateherë duke u nisur nga fakti që sistemi bankar në Kosovë ka likuiditet të pashfrytëzuar (të tepërt), niveli prej 41,4% të ngritet në së paku 50% dhe të përafrohet me vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Përëndimor.

- Bankat komerciale duhet të veprojnë në mënyrë më proaktive për të ndryshuar qasjen konservative ndaj ndërmarrjeve të sektorit real, duke adaptuar praktika më të pranueshme të matjes dhe menaxhimit të riskut për sektorin real.

- Ndërmarrjet e sektorit real të ekonomisë, sidomos ato prodhuese dhe bujqësore duhet të rrisin kapacitet humane profesionale dhe në procesin e aplikimit për kredi bankare duhet të prezentojnë plane investive ambicioze dhe profesionalisht të argumentuara, sepse kjo është një kërkesë e vazhdueshme e bankave në momentin kur shqyrtojn aplikimet kreditore të biznesve në veçanti të destinuara për investime.

- Për të përkrahur më intensivisht zhvillimi e sektorit real qeveria qendrore dhe lokal duhet të ndajnë fonde të caktuara ekonomike dhe financiare, të cilat në koordinim me bankat komerciale do të alokohen në funksion të zhvillimit të sektorit real në funksion të rritjes së punsimit.

Pyetja e dytë kërkimore e këtij studimi ka pasur për qëllim që të identifikojë nëse politikat e menaxhimit me efikasitet të kredive të këqija kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit ndaj sektorit real të ekonomisë. Për testimin e kësaj hipoteze janë mbledhur të dhëna për shumën e kredive për biznese, nivelin e kredive jo-performuese, produktin e brendshëm bruto, indeksin e çmimit të konsumatorit, depozitat dhe papunësinë. Të dhënat janë mbledhur nga raportet financiare vjetore të BQK-së, Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Bankës Botërore dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës, që përfshinë periudhen kohore 2005 – 2018 dhe janë të raportuara në baza mujore. Rezultatet e studimit konsistojnë të jenë shumë të rëndësishme në aspektin e vërtetimit të validitetit të kësaj hipoteze.

Duke u bazuar në rezultatet empirike të kësaj hipoteze gjetjet kryesore të këtij studimi janë:

- Rezultatet e analizës së korrelacionit tregojnë një lidhje të fortë lineare në mes kredive jo-performuese dhe shumës së kredive bankare (0.7252), që tregon se rritja e kredive jo-performuese do të shkaktojë zvoglim të vëllimit të kredive për biznese. Duke ditur që Kosova është një ndër vendet me normat më të ulëta të kredive jo-performuese jo vetëm në rajon por edhe në Evropë, argumentohet se riskut kreditor nuk është ndër problematikat më shqetësuese për sektorin bankar në Kosovë.

- Vlera e koeficientit Pearson në mes PBB-së dhe shumës së kredive për biznese është korrelacion i lartë (0.8679) që nënkupton se rritja e vlerës së PBB-së do të shkaktojë rritje të kredive për biznese, sidomos në rritjen e kredive për konsum. Indeksi i çmimit të konsumatorit dhe shuma e kredive kanë një korrelacion pozitiv (0.9466) dhe depozitat gjithashtu kanë një lidhje shumë të fortë lineare me shumën e kredive bankare (0.9904).

- Kreditë jo-performuese janë në nivelin signifikant (0.000) dhe nëse kemi rritje të këtyre kredive për 1%, ateherë kjo do të shkaktojë rënie të kreditimit për -2.29%, por vlera e koeficientit β për variablen e varur në bazë të analizës GMM është 0.1173, vlerë pozitive, që nënkupton se bankat komerciale përmes politikave të menaxhimit efikas të kredive të këqija kanë ndikuar në rritjen e kreditimit për sektorin real të ekonomisë.

- Sipas vlerësimeve të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës për vitin 2018, përqindja e kredive jo-performuese në sektorin bankar në Kosovë ka arritur në 2.8%, vlerë kjo që tregon se bankat kanë qenë shumë efikase në menaxhimin e kredive të këqija dhe trendi i vazhdueshëm i rritjës së kredive për biznese, tregon një tjetër indikatorë të rëndësishëm për vërtetimin e hipotezës së dytë të këtij studimi.

- Kreditë jo-performuese nga viti 2005 deri në vitin 2014 kanë shënuar një rritje nga 17.2 milion € në 156.2 milion €, ndërsa nga viti 2014 deri në vitin 2018 këto kredi kanë shënuar në rënie të theksuar në vlerën 74.39 milion €. Ndërsa në periudhën e njejtë kohore 2005-2018, kreditë për biznese janë rritur nga vlera 513.9 milion € në 2.75 miliard €.

- Produkti i brendshëm bruto është një prej indikatorëve që ndikon në nivelin e kredive jo-performuese, por ka edhe efekte direkte në shumën e kredive bankare. Rezultatet e modeleve ekonometrike tregojnë që kjo variabël është signifikante në nivelin 95% të besueshmërisë dhe nëse kemi 1% rritje në vlerën e PBB-së kjo do të ndikojë në rritjen e shumës së kredive bankare për 0.10%.

- Indeksi i çmimit të konsumatorit gjithashtu është në nivelin standard të signifikancës që tregon se një rritje për 1 njësi e këtij indeksi do të ndikojë në rritjen e vëllimit të kredive bankare për 2.05%. Gjithashtu edhe variabla tjetër e pavarur (depozitat) kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kredive për biznese, ku një rritje për 1% në shumën e depozitave do të ndikojë në rritjen e kreditimit për 0.61%.

- Rezultatet e analizës GMM tregojnë që variabla e papunësisë ndikon negativisht në shumën e kredive për biznese, ku nëse papunësia rritet për 1% do të ndikojë në rënien e kreditimit ndaj bizneseve për -2.26%. Por meqënese rezultatet e korrelacionit tregojnë një lidhje lineare negative në mes papunësisë dhe kredive bankare, ateherë rënia e papunësisë ka pasur efekte pozitive në kreditimin e sektorit real nga bankat komerciale në Kosovë.

- Procesi i shlyerjës së kredive jo-performuese nga bilancet e bankave komerciale ka ndikuar në masë të madhe në përmirësimin e portfolios kreditore, por në bazë të analizave të trendit njëri nga faktorët tjerë kryesor që ka ndikuar në përshpejtimin e procesit të kthimit të kredive është funksionalizimi i përmbaruesve privat.

- Procedurat dhe kriteret e shumëta për të marrë një kredi si dhe zhvlerësimi i patundëshmërive të lëna si hipotekë në bankat komerciale, janë dy faktorë tjerë kryesor që niveli i kredive jo-performuese në Kosovë është në nivel kaq të ulët.

Niveli i ulët i kredive jo-performuese është një tregues i stabilitetit financiar të bankave komerciale, por këtë nivel bankat komerciale në Kosovë po e mbajnë me procedura dhe kritere shumë të ashpra për ndërmarrjet e sektorit real, prandaj duke u nisur nga ky problem dhe çështjet e tjera që ndërlidhen me menaxhimin e riskut kreditor në bankat komerciale, ne japim këto rekomandime:

- Duke marrë parasysh se ndërmarrjet e sektorit real janë kredimarrësit më të mëdhenj dhe niveli i ulët i kredive jo-performuese argumenton se kemi një përmirësim në kulturën menaxheriale të biznesve në drejtim të përmbushjes së detyrimeve ndaj sektorit bankar, rekomandohet që bankat ndaj bizneseve të mëdha të lehtësojnë kriteret për kreditim në veçanti për sektorët e ekonomisë që konsiderohen strategjik në zhvillimin ekonomik të vendit dhe uljen e papunsisë.

- Sipas aktivitetit ekonomik, bujqësia është sektori që ka nivelin me të lartë të kredive jo-performuese me 8,2% në vitin 2018 dhe është një prej sektorëve më pak të krediduar nga bankat komerciale në Kosovë. Bankat komerciale në perspektivë duhet të rrisin portfolion e tyre kreditore, duke ofruar më shumë lehtësi për këtë sektorë i cili konsiderohet si një ndër degët më të rëndësishme të ekonomisë së Kosovës. Në këtë drejtim ky veprim i bankave komerciale dhe shoqatave të mikrokreditimit duhet të jetë i koordinuar me Qeverinë e Kosovës në drejtim të krijimit të një fond të posaçëm financiar dhe lehtësive tjera fiskale dhe sociale që do të ndihmojnë ndërmarrjet e këtij sektori në përmballimin më të lehtë të kostove kreditore.

- Ekspozimi ndaj riskut kreditor ka shënuar rënie në vitet e fundit si rezultat i kushteve më të favorshme makroekonomike dhe performancen e mirë të sektorit të ndërmarrjeve, prandaj kjo rënie e ekspozimit ndaj riskut kreditor do të duhet t'i nixisë bankat në rritjen më të vëllimëshme të kreditimit sektorit real të ekonomisë.

- Roli i përmbaruesve privat është dështuar mjaftë efektiv në procesin e arkëtimit të kredive jo-performuese nga bankat komerciale në Kosovë. Duke ditur që këta përmbarues privat janë funksionalizuar në Kosovë që nga viti 2014 dhe vërehet një trend pozitiv në arkëtimin e kredive jo-performuese, duke arritur deri në 108 milion € kredi të arkëtuara gjatë tri viteve të fundit. Rekomandohet që të punohet paraprakisht dhe paralelisht në forcimin e sistemit ligjor, sidomos

sektorin e përmbaruesve privat duke ofruar siguri dhe transparencë ligjore të procesit duke vendosur balancimin e interesave të kreditorit, debitorit dhe palëve të treta.

- Rekomandohet që autoritetet qeveritare, bizneset dhe qytetaret të punojnë të koordinuar dhë në vazhdimësi uljen e shkallës së informalitetit dhe evazionit fiskal tek bizneset në Kosovë. Informaliteti i lartë ka shkaktuar që të ketë likuiditet të tepërt në sistemin bankar në Kosovë sepse bankat komerciale financojn vetëm bizneset formale fakt ky që pamundëson plasmanin e tepërt të portfolios kreditore te bankave dhe prodhon tregun informal kreditor.

- Të bëhen ndryshime të legjislacionit në funksion të rritjes së auditimit të brendshëm të biznesve dhe rritjen e kontrolleve fiskale të biznesve nga autoritetet qendrore qeveritare fiskale sepse bankat komerciale gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimeve kreditore kanë mungesë të informacioneve të besueshme të biznesve bazuar në raportet financiare zyrtare.

Pyetja e tretë kërkimore e këtij studimi kishte për qëllim të identifikojë nëse krijimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore ka ndikuar në zvoglimin e riskut kreditor dhe rritjen e kreditimit të bankave komerciale ndaj sektorit real të ekonomisë. Të dhënat për testimin e kësaj hipoteze janë marrë nga raportet e stabilitetit financiar të Bankës Qendrore të Kosovës dhe statistikat e kredive tek raportet e FKGK-së. Në këtë rast janë mbledhur të dhënat nga shtatori i vitit 2016 deri në dhjetor të vitit 2018 si dhe janë ndërtuar projeksione për pesë vitet e ardhshme se sa mund të jetë shuma e garancive kreditore në totalin e kredive bankare. Rezultatet e modeleve ekonometrike dhe analizave të trendit konsistojnë të jenë shumë të rëndësishme dhe hipoteza është e matshme në aspektin statistikor. Disa nga konkluzionet kryesore të analizes empirike për hipotezën e tretë janë:

- Sipas rezultateve ekonometrike mund të konkludojmë që krijimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore ka ndikuar pozitivisht në rritjen e vëllimit të kredive për sektorin real të ekonomisë së Kosovës.

- Nëse kemi rritje për 1% në shumën e garancive kreditore, kjo do të ndikojë në rritjen e shumës së kredive për 0.14%.

- Në bazë të analizave të trendit, vërehet një trend pozitiv rritës në mes të garancive kreditore dhe vëllimit të kredive për biznese, ku vlera e garancive kreditore deri në fund të vitit 2018 ka arritur deri në 41.66 milion €.

- Projeksionet e analizës së trendit, parashikojnë që fondi do të ndjekë një trend pozitiv edhe për pesë vitet e ardhshme, ku vlera e garancive kreditore parashikohet se do të ketë rritje deri në 172.51 milion €.

- Rezultatet e modeleve ekonometrike na japin dëshmi empirike se krijimi i këtij fondi për garanci kreditore ka ndikuar në masë të madhe edhe në zvoglimin e riskut kreditor.

- Një rritje për 1% e shumës së garancive kreditore do të ndikojë në zvoglimin e kredive jo-performuese për -0.10%.

- Prej vitit 2016 kur është funksionalizuar FKGK-ja, kreditë jo-performuese janë zvogluar nga 111.4 milion € në 69.39 milion € në fund të vitit 2018. Të dhënat e tilla tregojnë për efektet pozitive që ka pasur krijimi i këtij fondi në zvoglimin e riskut kreditor të bankave komerciale.

- Projeksionet e realizuara përmes analizave të trendit linear dëshmojnë se për pesë vitet e ardhshme shuma e kredive jo-performuese në Kosovë si rezultat i krijimit të këtij fondi mund të zvoglohet deri në 34.6 milion €. Sigurisht që në zvoglimin e riskut kreditor do të ndikojnë edhe shumë reforma të tjera që ndihmojnë procesin e menaxhimit efikas të këtyre kredive.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka një rëndësi të madhe në ekonominë e Kosovës sepse kontriboun në zhvillimin ekonomik të vendit, duke krijuar vende të reja të punës, duke rritur dhe stimuluar prodhimin vendor, duke ulur shkallën e varfërisë dhe në anën tjetër ky fond do të zhbllokojë likuiditetin e tepërt në Kosovë, shumë kjo që arrin deri në 600 milion € përshkak të riskut të lartë dhe pasigurisë të madhe që kanë bankat komerciale në kreditimin e bizneseve në Kosovë. Andaj ne rekomandojmë që:

- Në ligjin për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore të precizohet saktë përqindja e mbulueshmërisë si dhe tarifave nga përfituesit e këtij fondi.

- Të bëhet ristrukturimi i mëtejshem i këtij fondi, duke rekomanduar që qeveria e Kosovës të rit pjesëmarrjen me më shumë fonde për garantimin e kredive në bazë të normës së rritjes së PPB-së së vendit në bazë vjetore.

- Të rritet kontributi i donatorëve të jashtëm dhe bankave komerciale në shumën totale të fondit në bazë të një plani paraprakisht të harmonizuar me qeverin e Kosovës bazuar në rezultatet e aritura.

- Të zbuten kriteret e pranimit të kolateralit nga bankat komerciale në veçanti në vendbanimet rurale dhe për tokat bujqësore dhe aktivet ndertimore jolegale që janë në proces të legalizimit sepse kriteret aktuale për pranim të kolaterlait janë shumë rigjide dhe janë pengesa kryesore e pranimit të aplikimeve kreditore në përgjithësi dhe në veçanti në sektorin e bujqësisë.

- Të rishikohen mundsit buxhetore që qeveria e Kosovës së bashku me donatorë të tjerë të ndajnë më shumë fonde financiare që do të ndikojnë në rritjen e mbulueshmërisë së kredive (mbi 50%) në sektorin e bujqësisë dhe prodhimtarisë që cilësohen si sektorë strategjik të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Pyetja e katërt kërkimore e këtij studimi kishte si objektivë kryesore të identifikojë nëse zbatimi i reformave institucionale në funksion të përmirësimit të biznes klimes ka ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit ndaj sektorit real të ekonomisë. Për testimin e kësaj hipoteze janë aplikar metodat kuantitative përmes të dhënave primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë mbledhur përmes metodës së anketimit me biznese dhe me bankat komerciale, ndërsa të dhënat sekondare janë bazuar në raportet e të bërit biznes të Bankës Botërore që përfshinë periudhen kohore prej vitit 2010 – 2018. Për vërtetimin e saktësisë së hipotezave janë aplikuar metodat krahasuese si dhe modelet ekonometrike përmes analizës faktoriale, analizës së besueshmerisë dhe analizen e regresionit linear. Gjetjet kryesore dhe konkluzionet të cilat rrjedhin nga analiza empirike për hipotezën e katërt të këtij studimi janë:

- Vlera e testit Kaiser – Meyer – Olkin (KMO) është 79.1% që nënkupton se seti i të dhënave është i përshtatshëm për analizën faktoriale. Testi Barlett është i rëndësishem dhe kjo nënkupton se ekzistojnë korrelacione të larta ndërmjet ndryshoreve.

- Reformat institucionale që më së shumti kanë ndikuar në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë janë: lehtësirat e ofruara në aspektin e procedurave, kohës dhe kostos për fillimin e një biznesi, pagesen e tatimeve, qasjën në kredi, zbatimin e kontratave, zgjidhjen e paaftësisë paguese dhe rregullimi i tregut të punës. Sipas rezultateve të analizës faktoriale këto reforma institucionale klasifikohen në faktorin e parë që shpjegon 44.79% të variancës totale.

- Ndërsa reformat institucionale që kanë pasur më pak ndikim në rritjen e kredimit të sektorit real të ekonomisë janë lehtësirat e ofruara në aspektin e procedurave, kohës dhe kostos për mbrojtjen e investitorëve, furnizimin me energji elektrike, marrjen e lejës së ndërtimit, tregtimin përtej

kufijeve dhe regjistrimin e pronës. Këto reforma sipas rezultateve të analizës faktoriale klasifikohen në faktorin e dytë që shpjegon 21.9% të variancës totale.

- Rezultatet e analizës së besueshmërisë konsistojnë të jenë shumë relevante, sepse vlera e koeficientit Alfa është 96%, që tregon se varialbat të cilat janë përfshirë në kuadër të faktorit të parë kanë një shkallë shumë të lartë të besueshmërisë.

- Reformat e ndërmarra në fushën e zbatimit të kontatave kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit të ndërmarrjeve të sektorit real të ekonomisë. Një efekt i tillë vërehet sepse reformimi i sistemit të drejtësisë dhe funksionalizimi i përmbaruesve privat, kanë ndikuar pozitivisht në menaxhimin e riskut kreditor por edhe në përmirësimin e qasjës në kredi. Ky indikator ka një nivel shumë të lartë të besueshmërisë për 95.5%.

- Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, Kosova që nga viti 2010 deri në vitin 2018 ka shënuar një progres pozitiv në fushën e zbatimit të kontratave, duke përmirësuar poziten e saj nga 157 në 49.

- Rezultatet e anketimit, theksojnë se 62.5% e biznesve të anketuara dhe mbi 80% e bankave komerciale kanë dhënë përgjigje pozitive se reformat e ndërmarra gjatë zbatimit të kontratave kanë pasur ndikim pozitiv në procesin e miratimit të kredive.

- Nëse për 1% kemi rritje në përmirësimin e reformave të ndërmarra gjatë zbatimit të kontratave, ateherë kjo do të ndikojë që bizneset për 0.50% të kenë qasje më të lehtë në kreditë e bankave komerciale.

- Të gjitha reformat e ndërmarra në aspektin e zgjidhjes së rasteve të paaftësisë paguese kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit të sektorit real të ekonomisë. Vlera e koeficientit Alfa për këtë variabël është 95.5%, që tregon një nivel shumë të lartë të besueshmërisë.

- Në vitin 2018 sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, Kosova rangohet në pozitën 49 në kuadër të 190 ekonomive, sa i përket reformave të ndërmarra në zgjidhjen e paftësisë paguese dhe nga ky vlerësim shihet një trend pozitiv i këtyre reformave që kanë ndikuar në përmirësimin e qasjes në kredi.

- Duke u bazuar në rezultatet e anketimit, mbi 58% e firmave dhe mbi 90% e bankave komerciale vlerësojnë se lehtësirat të cilat janë krijuar në zgjidhjen e rasteve të paaftësisë paguese kanë pasur efekte pozitive në procesin e miratimit të kredive bankare.

- Nëse për 1% kemi rritje në përmirësimin e reformave institucionale në funksion të procedurave, kohës dhe kostos së nevojshme për zgjidhjen e rasteve të paaftësisë paguese të firmave, ateherë impakti do të jetë se për vlerën 0.42% do të lehtësohet qasja e bizneseve në kreditë e bankave komerciale.

- Reformat e ndërmarra në aspektin e procedurës, kohës, kostos dhe kapitalit minimal të kërkuar për fillimin e një biznesi është një ndër faktorët që e ka lehtësuar procesin e miratimit të kredive nga ana e bankave komerciale.

- Në vitin 2018 Kosova rangohet në pozitën 10 sa i përket lehtësirave të ofruara për fillimin e një biznesi. Kjo ndryshore ka një koeficient të lartë të besuershmërisë për 94.6%.

- Sipas vlerësimeve nga firmat e anketuara (73.2%) dhe bankat komerciale (90%) prej tyre janë deklaruar se reformat e ndërmarra për fillimin e një biznesi kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit dhe përmirësimin e qasjes së bizneseve në kreditë e bankave komerciale.

- Nëse për 1% do të kemi rritje të përmirësimit të reformave në aspektin procedural, kohor dhe atë financiar për të filluar një biznes, ateherë kjo do të ndikojë në rritjen e qasjës së firmave në kreditë e bankave komerciale për 0.43%, duke mbajtur faktorët e tjerë konstant.

- Reformat institucionale që janë ndërmarrë për të drejtat e huamarrësit dhe huadhënësit përmes ligjeve të kolateralit, mbrojtja e të drejtave të kreditorëve përmes ligjeve të bankrotimit, fushëveprimi dhe qasja në informacionin kreditor të shpërndarë përmes regjistrit të kredive kanë ndikuar pozitivisht në procesin e marrjës së kredive bankare.

- Rezultatet e analizës faktoriale tregojnë që reformat institucionale që janë ndërmarrë në sistemin e pagesës së tatimeve kanë lehtësuar në masë të madhe procesin e dhënies së kredive dhe kanë përmirësuar qasjen e bizneseve në kreditë e bankave komerciale. Kjo variabël ka një nivel të lartë të besueshmërisë prej 94.6%, duke treguar një saktësi mjaft të madhe të modelit edhe në aspektin e matjes statistikore.

- Vlerësimet e fundit të Bankës Botërore në lidhje me reformimin e sistemit të pagesës së tatimeve janë shumë pozitive dhe Kosova rënditet në pozitën nr. 45 në kuadër të 190 ekonomive botërore. Në kuadër të 56 ndërmarrjeve të anketuara, rreth 70% prej tyre vlerësojnë se lehtësirat e ofruara në pagesën e tatimeve kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kreditimit të bizneseve, por e kanë

lehtësuar edhe procesin e dhënies së kredive. Vlen të theksohet, se edhe analistët kreditorë vlerësojnë që reformat e vazhdueshme fiskale kanë ndikuar pozitivisht në këtë proces.

- Nëse për 1% kemi rritje në përmirësimin e reformave institucionale në aspektin procedural, kohor dhe atë financiar në pagesën e tatimeve, ateherë efektet do të jenë që për vlerën 0.52% do të rritet qasja e bizneseve në kreditë e bankave komerciale.

Duke u mbështetur në të gjitha këto gjetje empirke për hipotezën e katërt rekomandoj :

- Të forcohen mekanizmat shtetërorë për luftimin e ekonomisë informale, evazionit fiskal dhe korrupsionit, sepse këta faktorë janë pengesat kryesore për një konkurrencë të barabartë dhe për të bërit biznes në Kosovë dhe janë ndër pengesat kryesore për bankat komerciale në financimin e sektorit real, duke ndikuar në rritjen e shkallës së pasigurisë së bankave komerciale në kreditimin e këtij sektori sepse të dhënat financiare në raportet financiare zyrtare janë pjesërisht të besueshme.

- Të krijohen praktika më të mira bankare dhe të ofrohet një fond garantues që iu jep një mbështetje më të madhe lizingut, si një formë shumë e përshtatshme e kreditimit dhe që shumë pak aplikohet nga ndërmarrjet e sektorit real në Kosovë.

- Të ndërmerren edhe më shumë reforma institucionale në aspektin e regjistrimit të pronës, të cilat mund të ndikojnë në rritjen e efikasitetit për ekzekutimin e regjistrave të pronës së luajtshme dhe të paluajshme. Një sistem i tillë i reformimit do të ndihmojë ndërmarrjet për rregullimin e problemit të hipotekave në momentin kur aplikojnë për kredi bankare.

- Rritjen e konkurrencës bankare dhe ofertës bankare përmes licencimit të bankave të reja në tregun bankar, që do të ketë ndikim në përmirësimin e kushteve të kreditmit për ndërmarrjet e sektorit real në Kosovë, uljen e normave të interesit në kredi si dhe ofrimin e kushteve më të favorshme në kreditimin e sektorit real të eknomisë.

Literatura dhe referencat

Acemoglu, D. &. (1997). Was prometheus unbound by chance? risk, diversification and growth. *The Journal of Political Economy*, 709-751.

Acemouglu, D., Johnson, S., & Robinson, J. (2001). The Colonial Origins of Comparative Development: An Empirical Investigation. *American Economic Review 91*.

Adamu, B. I. . (2005). Small and Medium Industries Equity Investment scheme. *Abuja: CBN Bullion, 29 (4),*.

Ahmed, J. (2006). An investigation of the relationship between Non-performing loans, macroeconomic factors, and financial factors in context of private commercial banks in Bangladesh. *Independent University, Bangladesh*.

Aizenman, J., & Ötker-Robe, I. (2013). Managing Risk for Development: International Risk Sharing. *Background Paper, World Bank*.

Ajagbe & Brimah. (2013). An empirical study on foreign investment in Nigerian. *Journal of Research in International Business and Management (ISSN: 2251-0028) Vol. 3(3)*.

Alessio D'Ignazio & Carlo Menon. (2012). The Causal Effect of Credit Guarantees for SMEs: Evidence from Italy. *UK Spatial Economics Research Centre*.

Al-Jarrah, I. M. (2012). Evaluating the riskiness of the banking sector of Jordan. *European Journal of Economics, Finance and Administrative Sciences, Vol. 48*.

Amador, J., Gómez-González, E., & Pabón, M. (2013). Loans Growth and Banks' Risk: New Evidence. *Borradores de Economía, No. 763, Banco de la República, Colombia*.

Amin, M. (2009). Labor Regulation and Employment in India's Retail Stores. *Journal of Comparative Economics*

Angela Roman & Valentina Diana Rusu. (2012). he Access Of Small And Medium Size Enterprises To Banking Financing And Current Challanges: The Case Of Eu Countries. *Annales Universitatis Apulensis Series Oeconomica, 14(2)*.

Angrist, J. and Pischke, J. . (2008). Mostly Harmless Econometrics: An Empiricist's Companion. *Princeton University Press, Princeton, NJ.*

Arellano, Manuel, and Bover, Olympia. (1995). Another look at the Instrumental-Variable Estimation of Error-Components Models. *Journal of Econometrics*, pp. 29-52.

Aremu & Adeyemi . (2011). Small and Medium Scale Enterprises as A Survival Strategy for Employment Generation in Nigeria. *Journal of Sustainable Development*.

Arnold, L. (1998). Growth, Welfare, and Trade in an Integrated Model of Human-Capital Accumulation and Research. *Journal of Macroeconomics, vol. 20, issue 1, 81-105*.

Aruwa. (2004). Financing options for small and medium-scale enterprises in Nigeria. *Niger. J. Acct. Res, Dept. Acct, Ahmadu Bello Univ. Zaria, 1: 2.* .

Auronen, L. (2003). Asymmetric Information: Theory and Applications. *Seminar of strategy and International Business as Helsinki University of Technology*.

Australia, C. (2009). *Risk Management Guide for Small and Medium sized Business.* Gjetur nw https://www.cpaaustralia.com.au

Ayyagar, M., Juarros, P., Martinez, M., & Singh, S. (2016). Access to Finance and Job Growth: Firm-Level Evidence across Developing Countries. *Policy Research Working Paper 7604, World Bank, Washington, DC*.

Ayyagari, M., Beck T. and A. Demirgüç-Kunt . (2007). "Small and medium enterprises across the globe: A new database". . *Policy Research Working Paper 3127, The World Bank, Washington.* .

Balgova, M., & Plekhanov, A. (2016, November 18). *The economic impact of reducing non-performing loans*. Gjetur nw https://voxeu.org/article/economic-impact-reducing-non-performing-loans

Balgova, M., Nies, M., & Plekhanov, A. (2016). The economic impact of reducing non performing loans. *Working Paper No. 193*.

Banka Qendrore e Kosovws. (2016). *Raporti i Stabilitetit Financiar.* Prishtinw: BQK.

Bardong, F., Bartram, S., & Yadav, P. (2009). Corporate Break-Ups and Information Asymmetry: A Market Microstructure Perspective. *CFR working paper, No. 09-08*.

Barr, R., Seiford, L., & Siems, T. (1994). Forecasting Bank Failure: a Non-Parametric Frontier Estimation Approach. *Louvain Economic Review, Vol. 60*.

Barth, J. (2008). Rethinking Bank Regulation: Till Angels Govern. *Cambridge, Cambridge University Press*.

Basel Committee on Banking Supervision. (2000). *Credit rating and complementary sources of credit quality information.* working paper, No.3.

Beck, T. & Demirguc-Kunt, A. (2006). Small and medium-size enterprises: Access to finance as a growth constraint. *The World Bank, Washangton DC, United States.*

Beck, T. A.-K. (2000). "A New Database on the Structure and Development of the Financial Sector"". *World Bank Economic Review*, 597-605.

Beck, T. (2007) - Financing Constraints of SMEs in Developing Countries: Evidence, Determinants and Solutions.

Beck, T. Klapper, L. and Menadoza, J. (2008). The typology of partial credit guarantee funds around the World. *The World Bank, Policy research working paper n.4771*.

Beck, T., c¸-Kunt, A. D., & Peria, M. (2008). Banking Services for Everyone? Barriers to Bank Access and Use around the World. *THE WORLD BANK ECONOMIC REVIEW, VOL. 22, NO. 3*.

Beck, T., Demirguc-Kunt, A.& V. Maksimovic . (2008). Financing patterns around the World – Are small firms different? . *Journal of Financial Economics, 89.*

Benavente, J. M., Galetovic, A. and Sanhueza, R. . (2006). Fogape: an economic analysis, mimeo .

Bennett, F., Doran, A., & Billington, H. (2005). Do Credit Guarantees Lead to Improved Access to Financial Services? Recent Evidence from Chile, Egypt, India and Poland. *Policy Division Working Paper, Department for International Development, London*.

Berger, A., & DeYoung, R. (1997). Problem loans and cost efficiency in commercial banks. *Journal of Banking & Finance, Elsevier, vol. 21(6)*.

Berger, A., & Udell, F. (2006). A More Complete Conceptual Framework for SME Finance. *Journal of Banking and Finance*.

Biabani, S. G. (2012). Assessment of Effective Factors on Non-Performing Loans (NPLs) Creation: Empirical Evidence from Iran (2006-2011). *Journal of Basic and Applied Scientific Research, 2(10)10589-10597*.

Blavy, R., & Suoto, M. (2009). Estimating Default Frequencies and Macro-financial Linkages in the Mexican Banking Sector. *IMF Working Paper*.

Bock, R. D., & Demyanets, A. (2012). Bank Asset Quality in Emerging Markets: Determinants and Spillovers. *Working Paper Series, No. wp/12/71, International Monetary Fund*.

Bofondi, M., & Ropele, T. (2011). Macroeconomic determinants of bad loans: evidence from Italian banks, Italy: Banca D'Italia.

Boiko, A. (1998). Final Reportof Expert meeting on the best practice in Financing SMEs. *United Nations/ECE Switzerland, May*.

Bonaccorsi, A. (1992). On the Relationship Between Firm Size and Export Intensity. *Journal of International Business Studies, vol. 23, issue 4, 605-635*.

Boyreau-Debray, G. (2010). "Financial Intermediation and Growth: Chinese Style". *World Bank, Development Research Group*.

BQK. (2009). *Raporti i Stabilitetit Financiar, Banka Qwndrore e Kosovws,* Prishtinw. https://www.bqk-kos.org/

BQK. (2010). *Raporti i Stabilitetit Financiar nr. 1. Banka Qwndrore e Kosovws,* Prishtinw. https://www.bqk-kos.org/

BQK. (2011). *Raporti i Stabilitetit Financiar nr.2 . Banka Qwndrore e Kosovws,* Prishtinw. https://www.bqk-kos.org/

BQK. (2012). *Raporti i Stabilitetit Financiar. Banka Qwndrore e Kosovws,* Prishtinw. https://www.bqk-kos.org/

BQK. (2013). *Raporti i Stabilitetit Financiar Nr.04. Banka Qwndrore e Kosovws,* Prishtinw. https://www.bqk-kos.org/

BQK. (2014). *Raporti i Stabilitetit Financiar Nr.06. Banka Qwndrore e Kosovws,* Prishtinw. https://www.bqk-kos.org/

BQK. (2015). *Raporti i Stabilitetit Financiar. Banka Qwndrore e Kosovws,* Prishtinw. https://www.bqk-kos.org/

BQK. (2016). *Raporti i Stabilitetit Financiar. Banka Qwndrore e Kosovws,* Prishtinw. https://www.bqk-kos.org/

BQK. (2017). *Raporti i Stabilitetit Financiar. Banka Qwndrore e Kosovws,* Prishtinw. https://www.bqk-kos.org/

C. Burnside D. Dollar. (2000). Aid, policies, and growth. *American Economic Review*, vol.90, p.847–868.

Cahuc, P., & Zylberberg, A. (2004). *Labor Economics.* Cambridge, Massachusetts: The MIT Press.

Canton, E. (2014). *Financing the real economy.* European Commission.

Capital Markets & SMEs - https://www.wsbi-esbg.org. (a.d.). Gjetur June 10, 2018, nga www.wsbi-esbg.org

Caporale, G. M., Rault, C., Sova, R., & Sova, A. (2009). Financial Development and Economic Growth: Evidence from Ten New EU Members. *DIW Berlin Discussion Paper 940*.

Carletti, F. A. (2005). Credit risk transfer and contagion. *Journal of Monetary Economics 53 (2006) 89–111*.

Chang, C. (1999). The nonparametric risk-adjusted efficiency measurement: an application to Taiwan's major rural financial intermediaries. *American Journal of Agricultural Economics, 81(4)*.

Chang, H. (2005). Understanding the Relationship between Institutions and Economic Development: Some Key Theoretical Issues. *Paper presented at the UNU/WIDER Jubilee Conference, Helsinki*.

Chatzouz, M., Gereben, A., Lang, F., & Torfs, W. (2017). *Credit Guarantee Schemes for SME lending in Western Europe.* European Investment Bank.

Cho, Y. J. (1988). The Effect of Financial Liberalization on the Efficiency of Credit Allocation: Some Evidence from Korea. *Journal of Development Economics, Vol. 2*, pp. 101-110.

Chodechai, S. (2004). Determinants of Bank Lending in Thailand: An Empirical Examination for the years 1992 – 1996.

Clichici, D., & Colesnicova, T. (2014). The impact of macroeconomic factors on non-performing loans in the Republic of Moldova. *Journal of Financial and Monetary Economics, Centre of Financial and Monetary Research "Victor Slavescu", 1(1)*.

Commission, E. (2018). *First Progress Report on the Reduction of Non-Performing Loans in Europe.* Brussels.

Compas, N., & Horváth, R. (2012). Reform redux: measurement, determinants and growth implications. *European Journal of Political Economy 28*.

Cowan, K., Drexler, A., & Yañez, A. (2009). The Effect of Partial Credit Guarantees on the Credit Market for Small Businesses. *Working Papers Central Bank of Chile, Number 524*.

Dash, M., & Kabra, G. (2010). The Determinants of Non-performing Assets in Indian Commercial Bank: An Econometric Study. *Middle Eastern Finance and Economics, Issue 7*.

Deelen, L., & Molenaar, K. (2004). Guarantee Funds for Small Enterprises, A manual for guarantee fund managers. *International Labour Organization*.

Demirgüç-Kunt, A., & Detragiache, E. (1998). The determinants of banking crises in developing and developed countries. *IMP International Monetary Fund*.

Djankov, S. (2002). Enterprise restructuring in transition: A quantitative survey. *Journal of Economic Literature 60*.

Dorin, L., V. & Ligia, V. (2008). Control Reluctancce And Legitimacy For SMEs Applying Bank Loans. *Faculty of Economic and Business Administration, Finance Department, Romania*.

Dorn, H. (1998). Round table discussion on recommendations for the best practice in Financial Intermediaries for SMEs: UN/ECE, Switzerland, May.

Ebben, J., & Johnson, A. (2006). Bootstrapping in small firms: An empirical analysis of change over time. *Journal of Business Venturing*.

EBCI. (2014). *Credit Guarantee Schemes for SME lending in Central, Eastern and South-Eastern Europe.*

ECB. (2016). *Survey on the access to finance of enterprises in the Euro Area.*

Erdinç, D., & Gurov, A. (2016). The effect of regulatory and risk management advancement on non-performing loans in European banking, 2000–2011. *International Advances in Economic Research 22*.

Erdoğdu, A. (2015). Non-performing Loans in Turkish Banking Sector and Balance Sheets Effects. *Journal of Modern Accounting and Auditing, Vol. 11, No. 12*.

Erdoğdu, A. (2016). Assessing the Impact of Non-Performing Loans on Economic Growth in Turkey. *American Research Journal of Business and Managemen*.

Espinoza, R., & Prasad, A. (2009). Non-performing Loans in the gcc Banking System and their Macroeconomic Effects. *Working Paper Series, No. wp/10/224, International Monetary Fund, 24 pages* .

Espinoza, R., & Prasad, A. (2010). Nonperforming Loans in the GCC Banking System and their Macroeconomic Effects. *IMF Working Papers 10/224*.

Evropian, K. (2006). *Guarantees and mutual guarantees - BEST Reports, Guarantees and mutual guarantees.*

Federation, E. B. (2018, 01 26). Gjetur nw https://www.ebf.eu/facts-and-figures/non-performing-loans/

FKGK. (2016). *Raporti vjetor i Fondit Kosovar pwr Garanci Kreditore.* http://www.fondikgk.org/

FKGK. (2017). *Raporti vjetor i Fondit Kosovar pwr Garanci Kreditore.* Prishtinw. http://www.fondikgk.org/

Fofcack, H. (2005). Non-performing loans in sub-Saharan Africa: Causal Analysis and Macroeconomic Implications. *World Bank Policy Research Working Paper No. 3769*.

Fry, M. J. (1995). *Money, Interest, and Banking in Economic Development.* The Johns Hopkins University Press.

Fund, I. M. (2005). *Clasification and Elaboration of Issues Raised by the December 2004 Meeting of the Advisory Expert Group of the Intersecretariat Working Group on National Accounts.*

GAP, I. (2015). *Fondi Kosovar pwr Garanci Kreditore: modelet e menaxhimit dhe efektiviteti.*

Garrido, J., Kopp, E., & Weber, A. (2016). Cleaning up Bank Balance Sheets: Economic, Legal, and Supervisory Measures for Italy. *IMF Working Paper 16/135*.

Gelinas. (1998). Freedom from Debt: The re-appropriation of development through financial self-reliance. *Dhaka-Ottawa, University Press*.

Gertler, M., & Kiyotaki, N. (2010). Financial intermediation and credit policy in business cycle analysis. *Handbook of monetary economics, 3(3)*.

GF, U. (2011). SME Financing and the Financial Crisis: A Framework and Some Issues', in G Calcagnini and I Faveretto (eds),. *The Economics of Small Businesses: An International Perspective, Contributions to Economics*.

Gibson, T. (2008). Defining SMEs: A Less Imperfect Way of Defining Small and Medium Enterprises in Developing Countries. *Brrokings Global Economy and Development*.

Gilchrist, S., & Zakrajsek, E. (2011). Bank Lending and Credit Supply Shocks. *NBER Working Paper, No: 14863*.

Godlewski, C. (2004). Capital Regulation and Credit Risk Taking: Empirical Evidence from Banks in Emerging Market Economies. *Journal of Banking Regulation 6(2)*.

Gonzales-Hermosillo, B. (1997). Determinants of Banking System Fragility: a Case Study of Mexico. *IMF Staff Papers, Vol. 44*.

Graham, T. (2004). Graham Review of the Small Firms Loan Guarantee - Recommendations. *ISBN: 1-84532-037-9, HM Treasury*.

Green, A. (2003). Credit Guarantee Schemes for Small Enterprises: An Effective Instrument to Promote Private Sector-Led Growth?. *Working Paper No. 10, United Nations Industrial Development Organization*.

Greuning, H., & Bratanovic, S. (2003). Analyzing and Managing Banking Risk. *A Framework for Assessing Corporate Governance and Financial Risks. 2nd edition. The World Bank, Washington, D. C.*

Greuning, H., & Iqbal, Z. (2007). Banking and Risk Environment. *John Wiley & Son (Asia) Pte Ltd.*

Group, W. B. (2010). *Doing Business - Kosovo.* Washington: The International Bank for Reconstruction and Development.

Group, W. B. (2011). *Doing Business - Making a difference for a entrepreneurs.* Washington : The International Bank for Reconstruction and Development.

Group, W. B. (2013). *Doing Business - Smarter Regulations for Small and Medium - Size Enterprises.* Washington: IFC.

Group, W. B. (2015). *Doing Business - Going Beyond Efficiency* . Washington: The International Bank for Reconstruction and Development.

Group, W. B. (2016). *Doing Business - Measuring Regulatory Quality and Efficiency.* Washington : The International Bank for Reconstruction and Development .

Group, W. B. (2017). *Doing Business: Equal opportungity for all.*

Group, W. B. (2018). *Doing Business - Reforming to Create Jobs.*

Group, W. B. (2018). *Improving Access to Finance for SMEs* .

Haahti, Antti, Graham Hall, and Rik Donckels. (1998). The Internationalization of SMEs: The Interstratos Project. London: Routledge.

Hallen, L., & Johanson, &. M. (2004). Intergration of relationship and business network development in the Russian transition economy. *International Marketing review*.

Hancock, D., Peek, J. and Wilcox, J. (2007). The repercussions on small banks and small business of bank capital and loan guarantees. *Working paper 07-22, Wharton University*.

Haneef, S., Riaz, T., & Ramzan, M. (2012). Impact of Risk Management on Non-Performing Loans and Profitability of Banking Sector of Pakistan. *International Journal of Business and Social Science*.

Hanson, M. S. (2000). "Do Local Banks Matter for the Local Economy ? In Search of a Regional Credit Channel.". *G. D. Hess and E. van Wincoop, eds., Intranational Macroeconomics.*

Hasan, I., & Wall, L. (2004). Determinants of the loan loss allowance: some cross-country comparisons. *The Financial Review, vol. 39, issue 1*.

Hébert R. & Link A. (1989). In search of the meaning of entrepreneurship. *Small Business Economics*.

Hoff, B. (2007). On the Frontiers of Finance Investing in Sustainable SMEs in Emerging Markets. *Boston College Institute for Responsible Investment*.

Honohan, P. (2008). Partial Credit Guarantees: Principles and Practice. *Conference on Partial Credit Guarantees, Washington DC*.

Hull, J. (2015). *Risk Management and Financial Institutions.* Ney Jersey: Pearson Education.

Impavido, G., Klingen, C., & Sun, Y. (2012). Non Performing Loans and the Macroeconomy. Nw *Chapter 2 of Working Group on NPLs in Central, Easter and Southeastern Europe.*

Inang E.E. & Ukpong, G.E. (1992). A review of small-scale enterprises credit delivery strategies in Nigeria. *CBN Economic and Financial review. 30(4): 249 – 278*.

International Monetary Fund. (2005). *Clarification and Elaboration of Issues Raised by the December 2004 Meeting of the Advisory Expert Group of the Intersecretariat Working Group on National Accounts.*

Jamaat, A., & Asgari, F. (2010). Credit risk management in banking system with data mining approach. *Quarterly magazine of quantity studies in management*.

Javed, H., Millman, C., & Matlay, H. (2006). SME financing in the UK and in China: a comparative perspective. *Journal of Small Business and Enterprise Development*.

Jayaratne, j., & Strahan, P. (1996). The Finance –Growth Nexus: Evidence from Bank Branch Deregulation. *The Quarterly Journal of Economics*.

Jimenez, G. (2008). "Hazardous Times for Monetary Policy: What Do Twenty-Three Million Bank Loans Say About the Effects of Monetary Policy on Credit Risk?,". *Madrid: Banco de España.*

John, H. (2015). *Risk Management and Financial Institutions.* New Jersey: Pearson Education.

Johnson, S., McMillan, J., & Woodruff, C. (2002). Property Rights and Finance. *American Economic Review 92(5)*.

Jonsson, M. (2009). Performance of Credit Guarantee Schemes (CGS). *Copenhagen Business School*.

Joseph, E. R. (2010). Credit and Loan Management – strategic measures to control & audit credit and loans. *LSW International, Selangor, Malaysia.*, 45-67.

K, W. (1954). *Value, capital and rent.* London: Mises Institute Student Series.

K.N, B. B. (2005). "What Explains the Stock Market's Reaction to Federal Reserve Policy?". *Journal of Finance*, pp. 1221-58.

Kaaya, A., & Pastory, D. (2013). Credit Risk and Commercial Banks Performance in Tanzania: a Panel Data Analysis. *Research Journal of Finance and Accounting ISSN 2222-2847, Vol.4*.

Kang, J. W. and Heshmati, A. . (2008). Effect of credit guarantee policy on survival and performance of SMEs in Republic of Korea. *Small Business Economics 31.*

Kang, S. (2001). The fixed payment financing decision. *Review of Financial Economics*.

Kargi, H. (2011). Credit Risk and the Performance of Nigerian Banks. *Ahmadu Bello University, Zaria*.

Karim, M. (2010). Bank Efficiency and Non-Performing Loans: Evidence from Malaysia and Singapore. *Prague Economic Papers, 2*.

Keeton, W. (1999). Does Faster Loan Growth Lead to Higher Loan Losses? *ECONOMIC REVIEW* .

Keeton, W., & Morris, C. (1987). Why Do Banks' Loan Losses Differ? *Federal Reserve Bank of Kansas City, Economic Review, (May): 3-21*.

Kelly, R., McQiunn, K., & Stuart, R. (2013). Exploring the steady-state relationship between credit and GDP for a small open economy the case of Ireland. *European Central Bank" Working Paper Series No. 1531.*

Kero, A. (2013). Banks' risk taking, fnancial innovation and macroeconomic risk. *The Quarterly Review of Economics and Finance, Vol. 53*.

Kerr, W., & Nanda, R. (2009). Democratizing entry: Banking deregulations, financing constraints, and entrepreneurship. *Journal of Financial Economics*.

Khemraj, T., & Pasha, S. (2009). The Determinants of Non-performing Loans: An Econometric Case Study of Guyana. *3rd Biennial International Conference on Business, Banking and Finance* . St. Augustine, Trinidad and Tobago, May 27 to 29.

Klein, N. (2013). Non-Performing Loans in CESEE: Determinants and Macroeconomic Performance. *IMF Working Paper, WP/13/72*.

Kokorović, M. (2014). Institutional reforms needed for better access to finance for small and medium enterprises in Bosnia and Herzegovina . *Federal Ministry of Education and Science(contract No. 01-4169/14*.

Kraemer-Eis, H., Lang, F., & Gvetadze, S. (2014). European Small Business Finance Outlook. *EIF Working Paper 2016/26, EIF Research & Market Analysis*.

Kremer, M. (1993). The O-Ring Theory of Economic Development. *Quarterly Journal of Economics 108*.

Krueger, A., & Tornell, A. (1999). The Role of Bank Restructuring in Recovering from Crises: Mexico 1995-1998. *NBER Working Paper No. 7042.*

Kuttner, B. B. (2005). "What Explains the Stock Market's Reaction to Federal Reserve Policy?". *Journal of Finance*.

Laeven, L., & Laryea, T. (2009). Principles of household debt restructuring. *IMF Staff Position Note 09/15, International Monetary Fund, Washington, D.C.*

Lapachi, K., & Ormotsadze, R. (2012). Credit Guarantee Fund for Georgia. *Journal of Business*.

Larraín, C., & Quiroz, J. (2006). Estudio para el fondo de garantía de pequeños empresarios. *Mimeo, Banco del Estado*.

Lehmann, E., & Neuberger, D. (2001). Do lending relationships matter? Evidence from bank survey data in Germany. *Journal of Economic Behaviour and Organization*.

Lelarge, C., Sraer, D. and Thesmar, D. . (2008). Entrepreneurship and credit constraints. evidence from a french loan guarantee program, mimeo .

Leon, H., & Tracey, M. (2011). The Impact of Non-Performing Loans on Loan Growth. *IMF Working Paper*.

Levine, R. (1997). Financial Development and Economic Growth: Views and Agenda. *Journal of Economic Literature*, 688-726.

Levitsky, J. (1997). Credit guarantee schemes for SMEs an international review. *Small Enterprise Development, No 2*.

Loayza, N., Oviedo, A., & Serven, L. (2005). The Impact of Regulation on Growth and Informality: Cross Country Evidence. *World Bank Policy Working Paper 3623*.

Lu, W., & Whidbee, D. (2013). Bank Structure and Failure during the Financial Crisis. *Journal of Financial Economic Policy, Vol. 5,*.

M. Schiffer & B. Weder. (2001). Firm Size and the Business Environment: Worldwide Survey Results. *International Finance Corporation*.

M., S. (2014). Concept paper on effects of finance on industry under different financial systems, mimeo.

Mazreku, I., Morina, F., Misiri, V., Spiteri, J., & Grima, S. (2018). Determinants of the Level of Non-Performing Loans in Commercial Banks of Transition Countries. *European Research Studies Journal Volume XXI, Issue 3*.

McKinnon, R. (1973). Money and Capital in Economic Development. *Washington, D.C.: The Brookings Institution.*

McNaughton, D., & C, D. (1997). Managing Credit Risk. Banking Institutions in Developing Markets. *Vol. 1, The World Bank, Washington, D. C*.

McNaughton, D., & Dietz, C. (1997). Managing Credit Risk. Banking Institutions in Developing Markets. *Vol. 1, The World Bank, Washington, D. C*.

Meyer, R., & Nagarajan, G. (1996). Evaluating Credit Guarantee Programs in Developing Countries. *Occational Paper No. 2322, Rural Finance Program, Ohio State University*.

Meza, D. D. (2002). Overlending? *The Economic Journal*.

Michael, J., Vasanthi, G., & Selvaraju, R. (2006). Effect of Non-Performing Assets on operational Efficiency of Central-Cooperative Banks. *Indian Economic Panorama*.

Mileris, R. (2014). MACROECONOMIC FACTORS OF NON-PERFORMING LOANS IN COMMERCIAL BANKS. *ISSN 1392-1258. EKONOMIKA 2014 Vol. 93(1)*.

Mimir, Y. (2013). Financial Intermediaries, Credit Shocks and Business Cycles. *TCMB Working Paper, No:13/13*.

Mistrulli, P. and Vacca, V. (2011). Mutual guarantee institutions and small business credit during the crisis. *Occasional paper 105, Bank of Italy* .

Moges, H., Dejaeger, K., & Baesens, B. (2013). A multidimensional analysis of data quality for credit risk management: new insights and challenges. *Information & Management, Vol. 50*.

Montiel, P. J. (1995). Financial policies and economic growth: Theory, evidence and country-specific experience from sub-Saharan Africa. *African Economic Research Consortium, Special Paper No 18*.

Morton, G. (2003). *Managing Bank Risk.* Academic Press.

Ngoc, T., & Nguyen, V. (2009). The Impact of Networking on Bank Financing: The Case of Small and Medium-Sized Enterprises in Vietnam. *Baylor University. Hanoi, Vietnam.*

Nickell, S. (1997). Unemployment and Labor Market Regidities: Europe versus North America. *Journal of Economic Perspectives 3*.

Nikolic, N., Joksimovic, N., & Stojanovski, N. (2013). The application of brute force logistic regression to corporate credit scoring models: evidence from Serbian financial statements. *Expert Systems with Applications, Vol. 40*.

Nnanna. (2001). Financing small businesses under the new CBN directive and its likely impact on industrial growth of the Nigerian economy. *CBN Bulletin 25(3)*.

North, D. (1992). The New Institutional Economics and Development. *St. Louis: Washington University*.

Nwakanma, P. C., Nnamdi, I. S. & Omojefe, G. O. (2014). Bank credits to the private sector: Potency and relevance in Nigeria's economic growth process. *Accounting and Finance Research, 3(2): 23-35.*

Osmani, R. (2015). Improved Business Climate and FDI in the Western Balkans. *Journal of Economic and Social Studies*.

Pagano, M. (1993). Financial markets and growth. *European economic review*, 613-622.

Patro, D., & Sun, X. (2013). A simple indicator of systemic risk. *Journal of Financial Stability, Vol. 9*.

Peltzman, S. (1976). Toward a More General Theory of Regulation. *Journal of Law and Economics*.

Pesola, J. (2001). The role of macroeconomic shocks in banking crises. *Bank of Finland Discussion Papers 6/*.

Petkovski, Mihail & Jordan Kjosevski. (2014). Does banking sector development promote economic growth? An empirical analysis for selected countries in Central and South Eastern Europe. *Economic Research , Volume 27, Issue 1*.

Podpiera, J., & Weill, L. (2008). Bad Luck or Bad Management, Emerging Banking Market Experience. *Journal of Financial Stability 4*.

Poudel, R. (2012). The impact of credit risk management on financial performance of commercial banks in Nepal. *International Journal of Arts and Commerce Vol. 1 No. 5*.

Ramos, R. a. (1997). Bailout or Not, Korea Needs Change. *Asian Wall Street Journal*.

Report, E. C. (2018). *Non-performing loans in Europe. What are the solutions?*

Richardson, D. C. (2002). PEARLS Monitoring system World Council information center. *Maddison, WI, WOCCU Toolkit series NO.4*.

Riding, A., Madill, J. and Haines, G. (2007). Incrementality of SME loan guarantees. *Small Business Economics 29.*

Rodriguez-Moreno, M., & Pena, J. (2013). Systemic risk measures: the simpler the better? . *Journal of Banking & Finance, Vol. 37*.

Role of Financial Intermediaries in Economic Development. (a.d.). Gjetur June 9, 2018, nga www.accountlearning.com

Roman, A., & Tomuleasa, I. (2013). Analysis of Profitability Determinants: Empirical Evidence of Commercial Banks in the New EU Member States.

Rossi, S., Schwaiger, M., & Winkler, G. (2005). Managerial Behaviour and Cost/Profit Efficiency in the Banking Sectors of Central and Eastern European Countries. *Working Paper No. 96, Austrian National Bank*.

Saadani, Y., Arvai, Z., & Rocha, R. (2010). A Review of Credit Guarantee Schemes in the Middle East and North Africa Region. *The World Policy Research Working Paper 5612*.

Salas, V., & Saurina, J. (2002). Credit risk in two institutional regimes: Spanish commercial and savings bank. *Journal of Financial Services Research*.

Sanni, M. (2009). The effects of the 2006 consolidation on profitability of Nigerian Banks. *Nigerian Research Journal of Accountancy (NRJA)*.

Sawyer, M. (2014). Concept paper on effects of finance on industry under different financial systems, mimeo.

Scardovi, C. (2016). *Holistic active management of non-performing loans.* Springer.

Schneider-Barthold. (2002). Africa's aborted Industrialisation; Modernisation Strategies Impede Organic Industrial Growth Development & Cooperation . *(No. 1, January/February, P. 15-17)*.

SHBK. (2016). *Periodiku Bankar, Vwshtrim mbi sektorin financiar tw Kosovws.* https://www.bankassoc-kos.com/

SHBK. (2016). *The Kosovo Banker, Publikim i Shoqatws sw Bankave tw Kosovws, nr.10.* https://www.bankassoc-kos.com/

Shingjergji, A. (2013). The Impact of Macroeconomic Variables on the Non Performing Loans in the Albanian Banking System During 2005-2012. *Academic Journal of Interdisciplinary Studies, vol. 2, no.9*.

Shleifer, A. (2005). Understanding Regulation. *European Financial Management 11(4)*.

Shoqata e Bankave tw Kosovws. (2016). *Periodiku Bankar, nr.16.* Prishtinw.

Smith, C., & Stulz, R. (1985). The Determinants of Firms Hedging Policies. *Journal of Financial and Quantitative Analysis*.

Stern, N. (2002). A Strategy for Development. *Washington, DC: The World Bank*.

Stiglitz, J. a. (1981). Credit rationing in markets with imperfect information. . *American Economic Review* .

Stijepović, R. (2014). Recovery and reduction of non-performing loans–Podgorica approach. *Journal of Central Banking Theory and Practice 3*.

Stulz, B. N. (2006). Enterprise Risk Management: Theory and Practice. *Ohio State University*.

Supervision, B. C. (2000). *Credit rating and complementary sources of credit quality information.* Working paper, No.3.

Szczesny, R. E. (2000). Determinants Of Bank Lending Performance In Germany. Evidence From Credit File Data. *Schmalenbach Business Review* .

Tagoe, Nyarko & Anuwa-Amarh . (2008). SME access to bank finance in an emerging economy: the role of information management practices. *International Journal of Financial Services Management, vol. 3, issue 2, 148-170*.

Thalassinos, E., & Stamatopoulos, D. (2015). The European Sovereign Debt Crisis and the Role of Credit Swaps. Nw *The WSPC Handbook of Futures Markets (eds) W. T. Ziemba and A.G. Malliaris, in memory of Late Milton Miller (Nobel 1990) World Scientific Handbook in Financial Economic Series Vol. 5* (fv. 605-639).

Turan, G., & Koskija, A. (2014). Nonperforming Loans in Albania. *Academic Journal of Interdisciplinary Studies. MCSER Publishing, 3(3)*.

Turan, S. (2016). The Effects of the Changes in Some Macroeconomic Indicators on the Non-Performing Loans in the Albanian Banking Sector (2007-2014). *Mediterranean Journal of Social Sciences, MCSER Publishing, 7(3)*.

Valverde & Fernandez & Udell. (2009). Bank Market Power and Sme Financing Constraints. *Review of Finance, Vol. 13, Issue 2, pp. 309-340*.

Vogel, R. and Adams, D. (1997). Costs and benefits of loan guarantee programs. *The Financier - Analyses of Capital and Money Market Transactions 4.*

Walter, I. (2002). Financial integration across borders and across sectors: implications for regulatory structures. *New York University Working Papers*, No. S-FI-02-06.

Weise, C. (2006). A simple Wicksellian macroeconomic model. *Department of Economics Gettysburg College Gettysburg*.

Westenmann, F. (2003). Special. In CESifo forum (Vol. 4, no. 1, p. 36). Institut für Wirtschaftsforschung (Ifo).

Woo, D. (2000). Two Approaches to Resolving Nonperforming Assets during Financial Crisis. *IMF Working Paper 00/33*.

Xu, L. C. (2010). Te Effects of Business Environments on Development. *Te World Bank. Development Research Group, Finance and Private Sector Development Team*.

Yang, C. (2017). Reduction of non-performing loans in the banking industry: an application of data evelopment analysis. *Journal of Business Economics and Management*.

Zander, R., Miller, C., & Mhlanga, N. (2013). Credit guarantee systems for agriculture and rural enterprise development . *Rome : Food and Agriculture Organization of the United Nations*.

Zazzaro, D. S. (2009). Do Inter-Firm Networks Make Access to Finance Easier? Issue and Empirical Evidence. *Faculty of Economics. Spain*.

Zecchini S. & Ventura M. (2009). The impact of public guarantees on credit to SMEs. *Small Business Economics, vol. 32, issue 2, 191-206*.

05/L-057, L. n. (2016). *Ligji për Themelimin e FondiT Kosovar për Garanci Kreditore.* Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.2.

Shtojca 1

Rezultatet ekonometrike të hipotezës së parë

```
. regress GDP2 Kreditë2 NIKr2 CPI2

      Source |       SS       df       MS              Number of obs =     168
-------------+------------------------------           F(  3,   164) =  149.83
       Model |  13.2703889     3  4.42346296           Prob > F      =  0.0000
    Residual |  4.84196058   164   .02952415           R-squared     =  0.7327
-------------+------------------------------           Adj R-squared =  0.7278
       Total |  18.1123495   167  .108457182           Root MSE      =  .17183

------------------------------------------------------------------------------
        GDP2 |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]
-------------+----------------------------------------------------------------
    Kreditë2 |    .502793   .0977073     5.15   0.000     .3098664    .6957195
       NIKr2 |   -.267978   .0670369    -4.00   0.000    -.4003446   -.1356113
        CPI2 |  -.4435357   .4761586    -0.93   0.353    -1.383727    .4966558
       _cons |   6.063012   1.575241     3.85   0.000     2.952645    9.173379
------------------------------------------------------------------------------
```

```
. regress GDP2 Kreditë2 NIKr2

      Source |       SS       df       MS              Number of obs =     168
-------------+------------------------------           F(  2,   165) =  224.48
       Model |  13.2447717     2  6.62238585           Prob > F      =  0.0000
    Residual |  4.86757776   165  .029500471           R-squared     =  0.7313
-------------+------------------------------           Adj R-squared =  0.7280
       Total |  18.1123495   167  .108457182           Root MSE      =  .17176

------------------------------------------------------------------------------
        GDP2 |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]
-------------+----------------------------------------------------------------
    Kreditë2 |   .4196456   .0397186    10.57   0.000     .3412233    .4980678
       NIKr2 |  -.2650849    .066938    -3.96   0.000    -.3972504   -.1329194
       _cons |   4.649969   .4242947    10.96   0.000     3.812222    5.487716
------------------------------------------------------------------------------
```

```
Fixed-effects (within) regression               Number of obs      =       168
Group variable: Kodi                            Number of groups   =        14

R-sq:  within  = 0.8801                         Obs per group: min =        12
       between = 0.5978                                        avg =      12.0
       overall = 0.7234                                        max =        12

                                                F(3,151)           =    369.48
corr(u_i, Xb)  = 0.1312                         Prob > F           =    0.0000

------------------------------------------------------------------------------
        GDP2 |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]
-------------+----------------------------------------------------------------
    Kreditë2 |   .2844542   .0594557     4.78   0.000     .1669818    .4019266
       NIKr2 |  -.2145418   .0391479    -5.48   0.000    -.2918901   -.1371936
        CPI2 |   .6244526   .2897169     2.16   0.033     .0520303    1.196875
       _cons |   2.678772   .9521403     2.81   0.006     .7975342     4.56001
-------------+----------------------------------------------------------------
     sigma_u |  .15192053
     sigma_e |  .09871091
         rho |  .70314601   (fraction of variance due to u_i)
------------------------------------------------------------------------------
F test that all u_i=0:     F(13, 151) =    26.61             Prob > F = 0.0000

Random-effects GLS regression                   Number of obs      =       168
Group variable: Kodi                            Number of groups   =        14

R-sq:  within  = 0.8800                         Obs per group: min =        12
       between = 0.6043                                        avg =      12.0
       overall = 0.7248                                        max =        12

                                                Wald chi2(3)       =   1056.96
corr(u_i, X)   = 0 (assumed)                    Prob > chi2        =    0.0000

------------------------------------------------------------------------------
        GDP2 |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]
-------------+----------------------------------------------------------------
    Kreditë2 |   .3001479   .0610497     4.92   0.000     .1804927    .4198031
       NIKr2 |  -.2181946   .0403106    -5.41   0.000    -.2972018   -.1391873
        CPI2 |   .5477377   .2974864     1.84   0.066     -.035325      1.1308
       _cons |   2.921342   .9785605     2.99   0.003     1.003398    4.839285
-------------+----------------------------------------------------------------
     sigma_u |  .10968355
     sigma_e |  .09871091
         rho |  .55250768   (fraction of variance due to u_i)
------------------------------------------------------------------------------
```

```
Hausman-Taylor estimation                       Number of obs      =       168
Group variable: Kodi                            Number of groups   =        14

                                                Obs per group: min =        12
                                                               avg =        12
                                                               max =        12

Random effects u_i ~ i.i.d.                     Wald chi2(4)       =   1223.13
                                                Prob > chi2        =    0.0000
```

GDP2	Coef.	Std. Err.	z	P>|z|	[95% Conf.	Interval]
TVexogenous						
NIKr2	-.2165799	.0392393	-5.52	0.000	-.2934874	-.1396723
CPI2	.5737179	.2901663	1.98	0.048	.0050024	1.142433
TVendogenous						
Kreditë2	.2920682	.0596469	4.90	0.000	.1751625	.4089739
TIexogenous						
Kodi	.0333171	.0039247	8.49	0.000	.0256248	.0410094
_cons	2.608397	.9558181	2.73	0.006	.7350275	4.481766
sigma_u	.05056219					
sigma_e	.09774471					
rho	.21109957	(fraction of variance due to u_i)				

```
Dynamic panel-data estimation                   Number of obs         =       168
Group variable: Kodi                            Number of groups      =        14
Time variable: Viti
                                                Obs per group:    min =        12
                                                                  avg =        12
                                                                  max =        12

Number of instruments =     75                  Wald chi2(3)          =    944.08
                                                Prob > chi2           =    0.0000
One-step results
```

GDP2	Coef.	Std. Err.	z	P>|z|	[95% Conf.	Interval]
Kreditë2	.3292271	.0511212	6.44	0.000	.2290315	.4294228
NIKr2	-.1842082	.028681	-6.42	0.000	-.2404219	-.1279946
CPI2	.5839103	.2140887	2.73	0.006	.1643041	1.003516
_cons	2.464717	.6572868	3.75	0.000	1.176459	3.752975

```
Instruments for differenced equation
        GMM-type: L(2/.).Kreditë2
Instruments for level equation
        Standard: _cons
```

Shtojca 2

Rezultatet ekonometrike të hipotezës së dytë

```
. regress Kreditë NPL GDP CPI Depozitat

      Source |       SS       df       MS              Number of obs =     168
-------------+------------------------------           F(  4,   163) = 3187.13
       Model |  67674618.9     4  16918654.7           Prob > F      =  0.0000
    Residual |  865274.726   163   5308.4339           R-squared     =  0.9874
-------------+------------------------------           Adj R-squared =  0.9871
       Total |  68539893.7   167  410418.525           Root MSE      =  72.859

------------------------------------------------------------------------------
     Kreditë |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]
-------------+----------------------------------------------------------------
         NPL |  -2.135163    .249441    -8.56   0.000    -2.627716   -1.642611
         GDP |   .1018225   .0322921     3.15   0.002     .0380577    .1655872
         CPI |   20.58376   2.754638     7.47   0.000     15.14438    26.02314
   Depozitat |    .690562   .0322297    21.43   0.000     .6269203    .7542036
       _cons |  -1605.888    198.979    -8.07   0.000    -1998.797   -1212.979
------------------------------------------------------------------------------

Random-effects GLS regression                   Number of obs      =       168
Group variable: Kodi                            Number of groups   =        14

R-sq:  within  = 0.9901                         Obs per group: min =        12
       between = 0.9350                                        avg =      12.0
       overall = 0.9873                                        max =        12

                                                Wald chi2(4)       =  14920.66
corr(u_i, X)   = 0 (assumed)                    Prob > chi2        =    0.0000

------------------------------------------------------------------------------
     Kreditë |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]
-------------+----------------------------------------------------------------
         NPL |  -2.265791    .229813    -9.86   0.000    -2.716216   -1.815366
         GDP |    .093139   .0422441     2.20   0.027     .0103421    .1759359
         CPI |    21.8049   2.536558     8.60   0.000     16.83334    26.77646
   Depozitat |   .6864475   .0315951    21.73   0.000     .6245222    .7483728
       _cons |  -1690.171   183.6569    -9.20   0.000    -2050.132    -1330.21
-------------+----------------------------------------------------------------
     sigma_u |  28.398109
     sigma_e |  65.676404
         rho |  .15751511   (fraction of variance due to u_i)
------------------------------------------------------------------------------
```

```
Fixed-effects (within) regression               Number of obs      =       168
Group variable: Kodi                            Number of groups   =        14

R-sq:  within  = 0.9901                         Obs per group: min =        12
       between = 0.9326                                        avg =      12.0
       overall = 0.9873                                        max =        12

                                                F(4,150)           =   3740.12
corr(u_i, Xb)  = -0.0051                        Prob > F           =    0.0000
```

Kreditë	Coef.	Std. Err.	t	P>|t|	[95% Conf.	Interval]
NPL	-2.330677	.2293855	-10.16	0.000	-2.783921	-1.877433
GDP	.073472	.0591193	1.24	0.216	-.0433421	.1902861
CPI	22.40949	2.530295	8.86	0.000	17.40987	27.40911
Depozitat	.690361	.035024	19.71	0.000	.6211569	.7595652
_cons	-1724.619	183.3923	-9.40	0.000	-2086.985	-1362.253
sigma_u	38.127142					
sigma_e	65.676404					
rho	.25206547	(fraction of variance due to u_i)				

```
F test that all u_i=0:     F(13, 150) =     3.89            Prob > F = 0.0000
```

```
GEE population-averaged model                   Number of obs      =       168
Group variable:                      Kodi       Number of groups   =        14
Link:                            identity       Obs per group: min =        12
Family:                          Gaussian                      avg =      12.0
Correlation:                  exchangeable                     max =        12
                                                Wald chi2(4)       =  15542.73
Scale parameter:                  5165.227      Prob > chi2        =    0.0000
```

Kreditë	Coef.	Std. Err.	z	P>|z|	[95% Conf.	Interval]
NPL	-2.273924	.225134	-10.10	0.000	-2.715178	-1.83267
GDP	.0918189	.0427633	2.15	0.032	.0080044	.1756333
CPI	21.88089	2.484789	8.81	0.000	17.01079	26.75098
Depozitat	.6864942	.0312014	22.00	0.000	.6253405	.7476479
_cons	-1695.048	179.9698	-9.42	0.000	-2047.782	-1342.313

```
System dynamic panel-data estimation         Number of obs         =       144
Group variable: Kodi                         Number of groups      =        14
Time variable: Viti
                                             Obs per group:    min =        10
                                                               avg =  10.28571
                                                               max =        11

Number of instruments =    119               Wald chi2(8)          =  16563.18
                                             Prob > chi2           =    0.0000
One-step results
```

Kreditë	Coef.	Std. Err.	z	P>|z|	[95% Conf.	Interval]
Kreditë						
L1.	.1173564	.0622267	1.89	0.059	-.0046057	.2393185
Papunësia						
--.	-2.269366	1.335516	-1.70	0.089	-4.88693	.3481981
L1.	5.447454	1.133218	4.81	0.000	3.226387	7.66852
NPL	-2.298651	.1743808	-13.18	0.000	-2.640432	-1.956871
GDP	.0646688	.0740662	0.87	0.383	-.0804982	.2098359
CPI	20.5728	1.923047	10.70	0.000	16.80369	24.3419
Depozitat	.6180618	.0584573	10.57	0.000	.5034877	.732636
Kodi	-.7353447	3.092931	-0.24	0.812	-6.797378	5.326689
_cons	-1682.765	162.6244	-10.35	0.000	-2001.503	-1364.027

```
Instruments for differenced equation
        GMM-type: L(2/.).Kreditë L(2/.).L.Papunësia
        Standard: D.NPL D.GDP D.CPI D.Depozitat
Instruments for level equation
        GMM-type: LD.Kreditë L2D.Papunësia
        Standard: _cons
```

```
Hausman-Taylor estimation                       Number of obs      =       168
Group variable: Kodi                            Number of groups   =        14

                                                Obs per group: min =        12
                                                               avg =        12
                                                               max =        12

Random effects u_i ~ i.i.d.                     Wald chi2(5)       =  15053.84
                                                Prob > chi2        =    0.0000
```

Kreditë	Coef.	Std. Err.	z	P>|z|	[95% Conf.	Interval]
TVexogenous						
GDP	.1129635	.055239	2.04	0.041	.0046969	.22123
CPI	22.05273	2.528863	8.72	0.000	17.09625	27.00922
Depozitat	.6776056	.0341422	19.85	0.000	.6106882	.744523
TVendogenous						
NPL	-2.2978	.2295002	-10.01	0.000	-2.747612	-1.847988
TIexogenous						
Kodi	-1.981092	3.141254	-0.63	0.528	-8.137837	4.175653
_cons	-1702.823	183.4141	-9.28	0.000	-2062.308	-1343.338
sigma_u	31.533192					
sigma_e	64.817852					
rho	.19137805	(fraction of variance due to u_i)				

Note: TV refers to time varying; TI refers to time invariant.

Shtojca 3

Rezultatet ekonometrike të hipotezës së tretë

```
. regress NPL Garancitë

      Source |       SS       df       MS              Number of obs =      28
-------------+------------------------------           F(  1,    26) =  101.81
       Model |  4277.03704     1  4277.03704           Prob > F      =  0.0000
    Residual |  1092.30559    26  42.0117534           R-squared     =  0.7966
-------------+------------------------------           Adj R-squared =  0.7887
       Total |  5369.34263    27  198.864542           Root MSE      =  6.4816

------------------------------------------------------------------------------
         NPL |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]
-------------+----------------------------------------------------------------
   Garancitë |  -.0010118   .0001003   -10.09   0.000    -.0012179   -.0008057
       _cons |   103.8189   1.952845    53.16   0.000      99.8048    107.8331
------------------------------------------------------------------------------
```

```
. regress Kreditë Garancitë

      Source |       SS       df       MS              Number of obs =      28
-------------+------------------------------           F(  1,    26) =  517.97
       Model |  839644.827     1  839644.827           Prob > F      =  0.0000
    Residual |  42146.3847    26  1621.01479           R-squared     =  0.9522
-------------+------------------------------           Adj R-squared =  0.9504
       Total |  881791.211    27  32658.9338           Root MSE      =  40.262

------------------------------------------------------------------------------
     Kreditë |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]
-------------+----------------------------------------------------------------
   Garancitë |   .0141763   .0006229    22.76   0.000      .012896    .0154567
       _cons |   2240.696   12.13042   184.72   0.000     2215.762    2265.631
------------------------------------------------------------------------------
```

Two-sample t test with equal variances

Variable	Obs	Mean	Std. Err.	Std. Dev.	[95% Conf.	Interval]
NPL	28	88.47307	2.665015	14.10193	83.00491	93.94123
Garanc~ë	28	15167.12	2350.837	12439.46	10343.6	19990.64
combined	56	7627.797	1545.953	11568.85	4529.638	10725.96
diff		-15078.65	2350.839		-19791.8	-10365.5

```
    diff = mean(NPL) - mean(Garancitë)                            t =  -6.4142
Ho: diff = 0                                     degrees of freedom =       54

    Ha: diff < 0                 Ha: diff != 0                 Ha: diff > 0
 Pr(T < t) = 0.0000         Pr(|T| > |t|) = 0.0000          Pr(T > t) = 1.0000
```

Variance ratio test

Variable	Obs	Mean	Std. Err.	Std. Dev.	[95% Conf.	Interval]
Kreditë	28	2455.711	34.15246	180.7178	2385.636	2525.786
Garanc~ë	28	15167.12	2350.837	12439.46	10343.6	19990.64
combined	56	8811.416	1446.108	10821.68	5913.35	11709.48

```
    ratio = sd(Kreditë) / sd(Garancitë)                           f =   0.0002
Ho: ratio = 1                                    degrees of freedom =   27, 27

    Ha: ratio < 1                Ha: ratio != 1                Ha: ratio > 1
  Pr(F < f) = 0.0000         2*Pr(F < f) = 0.0000          Pr(F > f) = 1.0000
```

Variance ratio test

Variable	Obs	Mean	Std. Err.	Std. Dev.	[95% Conf.	Interval]
NPL	28	88.47307	2.665015	14.10193	83.00491	93.94123
Garanc~ë	28	15167.12	2350.837	12439.46	10343.6	19990.64
combined	56	7627.797	1545.953	11568.85	4529.638	10725.96

```
    ratio = sd(NPL) / sd(Garancitë)                               f =   0.0000
Ho: ratio = 1                                     degrees of freedom =   27, 27

    Ha: ratio < 1               Ha: ratio != 1                 Ha: ratio > 1
  Pr(F < f) = 0.0000         2*Pr(F < f) = 0.0000           Pr(F > f) = 1.0000
```

Two-sample t test with equal variances

Variable	Obs	Mean	Std. Err.	Std. Dev.	[95% Conf.	Interval]
Kreditë	28	2455.711	34.15246	180.7178	2385.636	2525.786
Garanc~ë	28	15167.12	2350.837	12439.46	10343.6	19990.64
combined	56	8811.416	1446.108	10821.68	5913.35	11709.48
diff		-12711.41	2351.085		-17425.05	-7997.769

```
    diff = mean(Kreditë) - mean(Garancitë)                        t =  -5.4066
Ho: diff = 0                                      degrees of freedom =       54

    Ha: diff < 0                 Ha: diff != 0                 Ha: diff > 0
 Pr(T < t) = 0.0000         Pr(|T| > |t|) = 0.0000          Pr(T > t) = 1.0000
```

Shtojca 4

PYETËSOR – ZBATIMI I REFORMAVE INSTITUCIONALE NË FUNKSION TË PËRMIRËSIMIT TË BIZNES KLIMES DHE NDIKIMI I TYRE NË KREDITIMIN E SEKTORIT REAL TË EKONOMISË

Kodi i kompanisë	
Data	

Qëllimi i studimit: Ky studim ka për qëllim të përcaktojë zbatimin e reformave institucionale në funksion të përmirësimit të biznes klimes dhe ndikimin e tyre në rritjen e kreditmit të sektorit bankar ndaj sektorit real të ekonomisë së Kosovës.

Objektivi i këtij sondazhi është mbledhja e informacioneve dhe opinioneve nga bizneset në Kosovë në lidhje me efektet e zbatimit të këtyre reformave në funksion të përmirësimit të qasjes në financa.

Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë studim. Pjesëmarrja juaj është vullnetare dhe konfidenciale. Të gjitha përgjigjet e dhëna do të përdoren vetëm për qëllime studimore.

Bashkëpunimi juaj është shumë i rëndësishëm dhe do të më ndihmojë shumë për realizimin e disertacionit të doktoraturës.

Si e vlerësoni ndikimin e reformave institucionale në funksion të përmisimit të biznes klimes në rritjen e kredimit të sektorit bankar ndaj sektorit real të ekonomisë? *(5 shumë pozitivisht, 4 pozitivisht, 3 neutral, 2 negativisht, 1 shumë negativisht).*

Fillimi i një biznesi	1	2	3	4	5
Marrja e lejës së ndërtimit	1	2	3	4	5
Marrja e energjisë elektrike	1	2	3	4	5
Regjistrimi i pronës	1	2	3	4	5
Qasja në kredi	1	2	3	4	5
Mbrojtja e investitorëve	1	2	3	4	5
Pagesa e tatimeve	1	2	3	4	5
Tregtimi përtej kufijve	1	2	3	4	5
Zbatimi i kontratave	1	2	3	4	5
Zgjidhja e paaftësisë paguese	1	2	3	4	5
Rregullimi i tregut të punës	1	2	3	4	5

Duke u bazuar në kriteret e mëposhtme, vlerësoni nëpërmjet shkallës së Likertit efektin dhe ndikimin e reformave institucionale në funksion të miratimit të kredive bankare.

Fillimi i një biznesi *(5 shumë pozitivisht, 4 pozitivisht, 3 neutral, 2 negativisht, 1 shumë negativisht)*.

Para-regjistrimi (për shembull, verifikimi i emrit ose rezervimi, noterizimi)	1	2	3	4	5
Regjistrimi i biznesit	1	2	3	4	5
Post-regjistrimi (për shembull, regjistrimi i sigurimit social, vula e kompanisë)					
Marrja e miratimit nga anëtarët e tjerë të familjes për të filluar biznesin	1	2	3	4	5
Marrja e çfarëdo leje specifike që mund të ndikojë në regjistrimin e kompanisë, operacionet e kompanisë dhe procesin e marrjes së kartës së identitetit kombëtar	1	2	3	4	5
Koha e nevojshme për të përfunduar çdo procedurë	1	2	3	4	5
Kostoja e kërkuar për të përfunduar çdo procedurë (% e të ardhurave për kokë banori) - *Vetëm shpenzimet zyrtare, asnjë ryshfet, asnjë tarifë profesionale përveç shërbimeve të kërkuara me ligj ose që zakonisht përdoren në praktikë*	1	2	3	4	5
Kapitali minimal i paguar (% e të ardhurave për kokë banori) - *Fondet e depozituara në një bankë ose me palën e tretë para procesit të regjistrimit ose deri në 3 muaj pas regjistrimit.*	1	2	3	4	5

Marrja e lejes së ndërtimit *(5 shumë pozitivisht, 4 pozitivisht, 3 neutral, 2 negativisht, 1 shumë negativisht)*.

Dorëzimi i të gjitha dokumenteve relevante dhe marrja e të gjitha lejeve,licencave, lejeve dhe çertifikatave te nevojshme	1	2	3	4	5
Dorëzimi i të gjitha njoftimeve të kërkuara dhe pranimi i të gjitha inspektimeve të nevojshme	1	2	3	4	5
Marrja e lidhjeve për ujë dhe kanalizim	1	2	3	4	5
Regjistrimi dhe shitja e depos pas përfundimit të saj	1	2	3	4	5
Koha e nevojshme për të përfunduar secilën procedurë	1	2	3	4	5
Kostoja e nevojshme për të përfunduar secilën procedure (% e vlerës së depos) - *Vetëm shpenzimet zyrtare, pa ryshfet.*	1	2	3	4	5
Indeksi i kontrollit të kualitetetit ndërtimor	1	2	3	4	5

Marrja e energjisë elektrike *(5 shumë pozitivisht, 4 pozitivisht, 3 neutral, 2 negativisht, 1 shumë negativisht).*

Dorëzimi i të gjitha dokumenteve relevante dhe marrja e të gjith lejeve te nevojshme.	1	2	3	4	5
Marrja e punimeve të jashtme të instalimit dhe blerja e materiali për këto punime.	1	2	3	4	5
Përfundimi i çdo kontrate të nevojshme të furnizimit dhe marrja furnizimit përfundimtar	1	2	3	4	5
Koha e nevojshme për të përfunduar çdo procedurë	1	2	3	4	5
Kostoja e nevojshme për të përfunduar çdo procedurë (% e të ardhurave për kokë banori) - *Vetëm shpenzimet zyrtare, pa ryshfet. Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) është i përjashtuar.*	1	2	3	4	5
Besueshmëria e furnizmit dhe transparenca e indekesit të tarifav	1	2	3	4	5
Çmimi i energjisë elektrike - *i bazuar në faturen mujore*	1	2	3	4	5

Regjistrimi i pronës *(5 shumë pozitivisht, 4 pozitivisht, 3 neutral, 2 negativisht, 1 shumë negativisht).*

Procedurat e para-regjistrimit (psh, noterizimi i marrëveshjes së pagesa e taksave për transferimin e pronës)	1	2	3	4	5
Procedurat e regjistrimit të biznesit	1	2	3	4	5
Procedurat e post-regjistrimit (p.sh, plotësimi i titullit me komunën	1	2	3	4	5
Koha e nevojshme për të përfunduar çdo procedurë	1	2	3	4	5
Kostoja e nevojshme për të përfunduar çdo procedurë (% e vlerës së pronës) - *Vetëm shpenzimet zyrtare (si p.sh tarifat administrative doganat dhe taksat). TVSH, tatimi mbi fitmin ne kapital dhe pages e paligjshme përjashtohen.*	1	2	3	4	5
Kualiteti i indeksit për adiminsitrimin e tokës	1	2	3	4	5

Qasja në kredi *(5 shumë pozitivisht, 4 pozitivisht, 3 neutral, 2 negativisht, 1 shumë negativisht).*

Të drejtat e huamarrësit dhe huadhënësit nëpërmjet ligjeve të kolate	1	2	3	4	5
Mbrojtja e të drejtave të kreditorëve të siguruar nëpërmjet ligjeve të bankrotimit	1	2	3	4	5
Fushëveprimi dhe qasja e informacionit kreditor të shpërndara nga zyrat e kreditit dhe regjistrat e kredive	1	2	3	4	5
Mbulimi i zyrave të kredive	1	2	3	4	5
Mbulimi i regjistrit të kredive	1	2	3	4	5

Mbrojtja e investitorëve *(5 shumë pozitivisht, 4 pozitivisht, 3 neutral, 2 negativisht, 1 shumë negativisht).*

Kërkesat e shqyrtimit dhe miratimit për transaksionet e palëve të ndërlidhura	1	2	3	4	5
Aftësia e aksionarëve të vegjël për të ngritur padi dhe për të mbajtur drejtorët e interesuar përgjegjës për transaksionet.	1	2	3	4	5
Qasja në dokumentet e brendshme të korporatës; Dëshmitë e arritshme gjatë gjykimit dhe shpërndarjes së shpenzimeve ligjore	1	2	3	4	5
Të drejtat e aksionarëve dhe roli në vendimet e mëdha të korporatave	1	2	3	4	5
Transparenca e korporatave mbi aksionet e pronesisë, kompensimet, auditimet dhe perspektivat financiare.	1	2	3	4	5
Shkalla e rregullimit të konfliktit të interesave të qeverisjes së aksionarëve	1	2	3	4	5

Pagesa e tatimeve *(5 shumë pozitivisht, 4 pozitivisht, 3 neutral, 2 negativisht, 1 shumë negativisht).*

Numri total i tatimeve dhe kontributeve të paguara, duke përfshirë taksat e konsumit (TVSH, tatimi në shitje ose tatimi në mallra dhe shërbime).	1	2	3	4	5
Metoda dhe shpeshtësia e dorëzimit dhe pagesës.	1	2	3	4	5
Koha e nevojshme për t'i paguar tatimet.	1	2	3	4	5
Tatimet totale dhe përqindja e kontributit (% e fitimit para tatimit)- tatimi në fitim ose në të ardhurat e korporatës; kontributet sociale, tatimet e punës të paguara nga punëmarresi; tatimi në pronë; tatim në dividend etj.	1	2	3	4	5
Rimbursimi i TVSH-së dhe auditimi i tatimit në të ardhurat e korporatës	1	2	3	4	5

Tregtimi përtej kufijve *(5 shumë pozitivisht, 4 pozitivisht, 3 neutral, 2 negativisht, 1 shumë negativisht).*

Përputhshmëria me dokumentacionin - marrja, përgatitja dhe dorëzimi i dokumenteve gjatë transportit dhe inspektimeve jashtë kufijve	1	2	3	4	5
Zhdoganimi dhe inspektimet	1	2	3	4	5
Ngarkimi dhe shkarkimi i dërgesës në magazinë ose në kufi	1	2	3	4	5
Transporti ndërmejt magazinës dhe kufirit	1	2	3	4	5
Vonesat e trafikut dhe kontrollet e policisë rrugore gjatë kohës që dërgesa është në rrugë	1	2	3	4	5

Zbatimi i kontratave *(5 shumë pozitivisht, 4 pozitivisht, 3 neutral, 2 negativisht, 1 shumë negativisht)*.

Koha e nevojshme për të zbatuar një kontratë nëpër gjykata	1	2	3	4	5
Kostoja e kërkuar për të zbatuar një kontratë nëpër gjykata - tarifat e avokatit, tarifat gjyqësore dhe tarifat e ekzekutimit	1	2	3	4	5
Cilesia e indekseve të proceseve gjyqësore	1	2	3	4	5

Zgjidhja e paaftesisë paguese *(5 shumë pozitivisht, 4 pozitivisht, 3 neutral, 2 negativisht, 1 shumë negativisht)*.

Koha e nevojshme për *të rikthyer borxhin (vitet)*	1	2	3	4	5
Kostoja e kërkuar për *të rikthyer borxhin (% e pasurisë së debitorit)*	1	2	3	4	5
Rezultatet - nëse biznesi vazhdon të funksionojë ose asetet e saj shiten pak nga pak	1	2	3	4	5
Norma e rikthimit për kreditorët	1	2	3	4	5

Rregullimi i tregut të punës *(5 shumë pozitivisht, 4 pozitivisht, 3 neutral, 2 negativisht, 1 shumë negativisht)*.

Punësimi *(kohëzgjatja e periudhës provuese, paga minimale, etj.)*	1	2	3	4	5
Orari i punës *(nr. maksimal i ditëve të punës të lejuara në javë)*	1	2	3	4	5
Kualiteti i punes - *nëse ligji parashikon shpërblim të barabartë për punë me vlerë të barabartë dhe mosdiskriminim në baza gjinore;*	1	2	3	4	5